

VENDIM
Nr. 466, datë 3.7.2019

**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT STRATEGJIK DHE TË PLANEVE
KOMBËTARE PËR ZBUTJEN E GAZEVE ME EFEKT SERRË DHE PËR
PËRSHTATJEN NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 21, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit strategjik dhe të planeve kombëtare për zbutjen e gazeve me efekt serrë (NPM) dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (NAP), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Dokumenti strategjik dhe planet kombëtare për zbutjen e gazeve me efekt serrë (NPM) dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (NAP) rishikohen çdo 4 vjet.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

STRATEGJIA E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE DHE PLANEVE TË VEPRIMIT
Tiranë 2019

Tabela e përmbajtjes
PËRMBLEDHJE

1. HYRJE

1.1 Aspektet e zbutjes

1.2 Aspektet e përshtatjes

2. ANALIZË E SITUATËS AKTUALE

2.1 Shkenca e ndryshimeve klimatike

2.2 Konteksti ndërkombëtar i politikës së ndryshimeve klimatike

2.3 Politika e BE-së për ndryshimet klimatike

2.3.1 Sektori i tokës

2.3.2 Sektori i energjisë

2.3.3 Sektori i transportit

2.4 Monitorimi dhe raportimi i detyrimeve në kuadrin e UNFCCC-së dhe BE-së

2.5 Politika shqiptare për ndryshimet klimatike

2.6 Gjendja e ekonomisë shqiptare

2.6.1 Sektori i energjisë

2.6.2 Sektori i transportit

2.6.3 Sektori bujqësor

2.6.4 Sektori pyjor

- 2.7 Përmbledhje e bilancit historik dhe të ardhshëm të GES-it
 - 2.7.1 Analiza e prirjeve historike të shkarkimeve GES
 - 2.7.2 Parashikimi i prirjeve të shkarkimeve GES
- 2.8 Situata aktuale e Shqipërisë në procesin e përshtatjes
 - 2.8.1 Analizë e situatës ekzistuese
 - 2.8.2 Rezultatet e studimeve të mëparshme, vlerësimet e vulnerabilitetit dhe zhvillimet e koncepteve për përshtatjen
- 2.9 Parimet e NAP-it
 - 2.9.1 Mesazhet kryesore
 - 2.9.2 Funkcionet dhe parimet e përgjithshme
 - 2.9.3 Lidhja me procesin e paraaderimit në BE
- 3. VIZIONI DHE PRIORITETET E STRATEGJISË
- 3.1 Prioritetet e strategjisë
- 4. POLITIKAT KRYESORE QË PREKIN NDRYSHIMIN E KLIMËS
 - 4.1 Qasjet specifike të sektorit përmes zbutjes
 - 4.1.1 Strategji dhe plane ndërsektoriale
 - 4.1.2 Energjia
 - 4.1.3 Transporti
 - 4.1.4 Bujqësia dhe LUCF-ja
 - 4.1.5 Sinergjitë ndërsektoriale dhe boshllëqet/mungesat
 - 4.2 Objektivat kryesorë për trajtimin e zbutjes së efekteve prej ndryshimeve klimatike
 - 4.3 Integrimi i përshtatjes në qasjet sektoriale
 - 4.3.1 Qasja për integrim
 - 4.3.2 Integrimi për SKZHI 2014–2020
 - 4.3.3 Integrimi në politikat sektoriale
 - 4.3.4 Proceset e integritimit në të ardhmen
 - 4.3.5 Projektet pilot, konkrete për integrimin
 - 4.4 Objektivat kryesorë të politikave për adresimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike
- 5. PLANI KOMBËTAR PËR ZBUTJEN E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE
 - 5.1 Energjia
 - 5.2 Transporti
 - 5.3 Bujqësia
 - 5.4 Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pyjeve
 - 5.5 Sistemi kombëtar për matjen/monitorimin dhe raportimin
 - 5.7 Burimet Financiare për Planin e Zbutjes
 - 5.8 Kosto e masave
 - 5.8.1 Energjia
 - 5.8.2 Transporti
 - 5.8.3 Bujqësi
 - 5.8.4 Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pyjeve
 - 5.8.5 Pikëtakimet Ndërsektoriale
- 6. PLANI KOMBËTAR I PËRSHTATJES NDAJ NDRYSHIMEVE KLIMATIKE
 - 6.1 Lista e masave të përcaktuara si Veprime Prioritare
 - 6.2 Përshkrim i detajuar i Veprimeve Prioritare
 - 6.2.1 Veprimi Prioritar nr. 1

- 6.2.2 Veprimi Prioritar nr. 2
- 6.2.3 Veprimi Prioritar nr. 3
- 6.2.4 Veprimi prioritar nr. 4
- 6.2.5 Veprimi Prioritar nr. 5
- 6.2.6 Veprimi Prioritar nr. 6
- 6.2.7 Veprimi Prioritar nr. 7
- 6.2.8 Veprimi Prioritar nr. 8
- 6.2.9 Veprimi Prioritar nr. 9
- 6.2.10 Veprimi Prioritar nr. 10
- 6.2.11 Veprimi Prioritar nr. 11
- 6.2.12 Veprimi Prioritar nr. 12
- 6.2.13 Veprimi Prioritar nr. 13
- 6.2.14 Veprimi Prioritar nr. 14
- 6.2.15 Veprimi Prioritar nr. 15

6.3 Burimet financiare për planin e përshtatjes

6.4 Zhvillimi i kapaciteteve, informimi dhe përfshirja

RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Aneksi 1 – Lista e plotë e dokumenteve të analizuara për Planin e Zbutjes së Ndryshimeve Klimatike

Aneksi 2 – Lista e legjislacionit të BE-së për masat zbutëse për GES-in

Aneksi 3 – Dokumenti i financimit të NAP-it

Figura 1 Procesi i programimit të shpenzimeve vjetore në një Institucion të Qeverisë Qendrore

Aneksi 4 Lista e autorëve dhe bashkëpunëtorëve

AKRONIME

ADP	Grupi i Punës Ad Hoc për Platformën Durban për Veprim të Shtuar
FP	Fond i përshtatjes
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
RV	Raport Vlerësimi
MBE	Mjet me Bateri Elektrike
PBB	Politika e Përbashkët Bujqësore
NK	Ndryshimet klimatike
PNK	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike
PMRNM	Procesi i Menaxhimit të Rrezikut ndaj Ndryshimeve Klimatike
DNK	Departamenti e ndryshimeve klimatike dhe ajrit
NKE	Nxehtësi e Kombinuar dhe Energji
KM	Këshilli i Ministrave
KeP	Konferenca e Palëve
CPEC	Eficienca e Energjisë në Ndërtesa në Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë
DZHM	Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje
DPSMB	Dokumenti i Politikave Strategjike Për Mbrojtjen e Biodiversitetit
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
SMNS	Strategjia Mjedisore Ndërsektoriale
ECRAN	Rrjeti Rajonal i anëtarësimit për klimën dhe mjedisin
EE	Eficienca e Energjisë
DEE	Direktiva për Eficiencën e Energjisë
PEE	Përmirësimi i Eficiencës së Energjisë

EFTA	Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë
PEN	Performanca e Energjisë në Ndërtesa
CPE	Certifikatat e Performancës së Energjisë
ERE	Enti Rregullator i Energjisë Elektrike
VPB	Vendimi për Përparje të Përbashkëta
STSh	Skema për Tregtinë e Shkarkimeve
BE	Bashkimi Evropian
EUSAIR	Strategjia Evropiane për rajonin e bregdetit Adriatik dhe Jonian
KPK	Komunikimi i Parë Kombëtar
DCLD	Direktiva për Cilësinë e Lëndës Djegëse
GCF	Fondi i Gjellbër për Klimën
GDP	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GES	Gazet me Efekte Serrë
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit
PPK	Plani i Përgjithshëm Kombëtar
QSH	Qeveria e Shqipërisë
RREH	Mjeti Elektrik Hibrid
IEA	Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë
IMO	Organizata Ndërkombëtare Detare
IWG	Grupi Ndërmintor i Punës (për Ndryshimet Klimatike)
INDC	Kontributi i Kombëtar i Pikësnyuar
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
IPA	Instrumenti për Asistencën Paraanëtarësim
IPARD	Programi i Zhvillimit Rural 2014–2020 në kuadrin e Instrumentit për Asistencë Paraanëtarësim
IPCC	Panel Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike
IPMG	Grupet e menaxhimit të integruara të politikave
IPS	Sistemi i Integruar i Planifikimit
SNBZHR	Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural
IUCN	Bashkimi Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës
KP	Protokolli i Kiotos
NjQV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
GNL	Gaz Naftë i Lëngshëm
LUCF	Ndryshimi në Përdorimin e Tokës dhe Pylltaria
LULUCF	Përdorimi i Tokës, Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pylltaria
MACC	Kurba Marginale e Uljes së Kostos
MBZHR	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MRV	Monitorimi Raportimi Verifikimi
PBA	Programi Afatmesëm Buxhetor
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
MZHU	Ministria e Zhvillimit Urban
NAMA	Masa Zbutëse të Përshtatshme për Vendin
AKPT	Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit
SKNK	Strategjia Kombëtare e Ndryshimeve Klimatike
Dokumenti i SKNK	Dokumenti i Strategjisë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike
Dokumenti i SKNK&P	Dokumenti i Strategjisë Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike dhe Planit
KPK	Kontributet e Përcaktuara në Nivel Kombëtar
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit

PKVEE	Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë
NG	Gazi Natyror
NAP	Plani Kombëtar i Përshtatjes
NIE	Entet Zbatuese Kombëtare
PEIP	Shpenzimet e Programit dhe Planifikimi i Investimeve
PES	Pagesa për shpenzimet e ekosistemit
PPCR	Programi Pilot për një klimë Reziliente
PPP	Partneriteti Publik-Privat
PPR	Rishikimi i politikave të programit
PKT	Plani Kombëtar i Territorit
PKZNK	Plani Kombëtar për Zbutjen e Ndryshimeve Klimatike
SKZNK	Strategjia Kombëtare për Zbutjen e Ndryshimeve Klimatike
SKZNK&P	Strategjia Kombëtare për Zbutjen e Ndryshimeve Klimatike dhe Plani
SKZHI-II	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
PRREH	Mjetet Elektrike Hibrade me Karikim
DER	Direktiva e Energjisë së Rinovueshme
BER	Burimet e Energjisë së Rinovueshme
SEETO	Observatori i Transportit të Evropës Juglindore
KDK	Komunikimi i Dytë Kombëtar
TECTQ	Plani për Transport të Qëndrueshëm
TEN-T	Rrjeti Trans-Evropian i Transportit
KTK	Komunikimi i Tretë Kombëtar
FTPE	Furnizimi Total Primar me Energji
TEC	Termocentral
SSTPV	Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plani i Veprimit
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNFCCC	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
BB	Banka Botërore

PËRMBLEDHJE

Ndryshimet klimatike përfaqësojnë një kërcënim urgjent dhe potencialisht të pakthyeshem për shoqëritë njerëzore, sidomos për zonën e Mesdheut, ndaj zhvillimi drejt një ekonomie me karbon të ulët është kyçi për arritjen e objektivave të masave globale zbutëse, si dhe për një reagim të përshtatur të brezit të ardhshëm me kosto të arsyeshme mjedisore, ekonomike dhe sociale [3].

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Parisit nga Qeveria (Nju-Jork, 22 prill 2016), Shqipëria ka hyrë në epokën e re të procesit të politikave klimatike ndërkombëtare, ku të gjitha palët synojnë në mënyrë kolektive ta mbajnë rritjen e temperaturës globale në 2°C mbi nivelin paraindustrial [2.2].

Kjo Strategjie Përgjithshme Kombëtare e Ndryshimeve Klimatike dhe Plani (dokumenti i SKNK&P) janë hartuar për të mbështetur zbatimin e legjislacionit të BE-së për mjedisin dhe klimën, duke synuar përforcimin e koordinimit ndërsektorial në Shqipëri për masat mbi klimën, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, me qëllim që t'i përgjigjen nevojës për afrimin me kërkesat e BE-së, duke qenë se aktualisht, Shqipëria mban statusin zyrtar të vendit kandidat për anëtarësim në BE (që prej qershorit 2014) [2.3; 2.4; 2.5]. Dokumenti i SKNK&P-së kryhet në përputhje me vendimin 1/CP16 të UNFCCC-it dhe vendimin 525/2013/EU për pjesën e zbutjes. Ndërkohë, procesi i përshtatjes në Shqipëri orientohet nga “Udhëzimet teknike për proceset e NAP-it”, të përgatitura nga Grupi Ekspertëve të Vendeve më pak të zhvilluara të UNFCCC-së (LEG)¹ dhe të publikuara në dhjetor të vitit 2012 (të ashtuquajturat “Udhëzimet

¹ Grupi i Ekspertëve UNFCCC / LDC: Planet Kombëtare të Përshtatjes – udhëzime teknike për procesin kombëtar të planit të përshtatjes. Dhjetor 2012.

teknike”). Procesi i NAP-it është performuar në përputhje me Strategjinë e BE-së, për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, e miratuara nga Komisioni Evropian në prill 2013.²

Dokumenti i SKNK&P-së (pjesa e zbutjes) fokusohet në katër sektorët e mëposhtëm raportues të inventarit të gazrave serrë në Shqipëri: Energjia (me fokus të veçantë të Transporti), Bujqësia dhe sektorët e Ndryshimit të Përdorimit të Tokës dhe Pylltarisë(LUCF), duke mbuluar kështu 80% të shkarkimeve të Shqipërisë. NCCS & P-ja (aspekti i përshtatjes NAP) siguron një drejtim udhëzues dhe veprime të përpikta për procesin e përshtatjes në Shqipëri, së bashku me kornizën për përshtatjen ndaj Ndryshimeve të Klimës (CCA).

Meqë Këshilli i Ministrave i Shqipërisë dhe Ministrinë përkatëse kanë përgatitur apo po punojnë aktualisht me Strategjitë dhe Planet e Veprimit mbi ndryshimin e klimës për sektorët kryesorë në Shqipëri, dokumenti i SKNK&PV-së përfaqësojnë një strategji të përgjithshme ndërsektoriale dhe një plan që siguron një përmbledhje të pikësnyimeve, si dhe të objektivave politikë të fokusuar të zbutja e ndryshimeve klimatike, parashikuar në planet dhe strategjitë ekzistuese, duke vlerësuar sinergjitë potenciale dhe boshllëqet/mungesat, si dhe duke planifikuar rrugët për zhvillim me uljen e nivelit të karbonit [4].

Në bazë të dokumenteve kryesore ekzistuese, është dhënë një përmbledhje e gjendjes së ekonomisë shqiptare [2.6] për sektorët kryesorë të marrë në konsideratë, si dhe një analizë e prirjeve historike dhe të planifikuara të shkarkimeve GES [2.7].

Vizioni kombëtar fokusohet fort në tre komponentët kryesorë të ndryshimit të klimës në Shqipëri: masat zbutëse, adaptimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Janë identifikuar gjashtë përparësi të strategjisë së masave zbutëse (PS): SP.1 Sigurimi i një zhvillimi të qëndrueshëm të ekonomisë në përputhje me rrugët e shkarkimit GES të përcaktuara në Strategji, dhe ecja drejt një objektiv për gjithë ekonominë, për të cilin kontribuojnë të gjithë sektorët; SP.2 Ngritja e një sistemi monitorues, raportues dhe verifikues të GES-it në përputhje me kërkesat e BE-së; SP.3 Forcimi i kapacitetit të institucioneve përkatëse dhe bashkëpunimit ndër-institucional për trajtimin e çështjeve të ndryshimit të klimës; SP.4 Përmirësimi i ndryshimeve klimatike në planifikimin strategjik sektorial; SP.5 Forcimi i kapacitetit dhe ndërgjegjësimi mbi çështjet e ndryshimeve klimatike; SP.6 Afrimi me kuadrin ligjor të BE-së për ndryshimin e klimës në gjithë sektorët [3]. Janë identifikuar së bashku me qëllimet, dhe treguesit specifikë të gjashtë fushave kryesore interesi për rëndësinë strategjike gjithëpërfshirëse të procesit të adaptimit në Shqipëri: rezultatet e përshtatjes; drejtimi i zbatimit të NAP-it; integrimin e NAP-it në fusha të ndryshme; financimi për Përshtatjen e Ndryshimeve Klimatike, ngritja e kapaciteteve, informimi dhe përfshirja, krijimi institucional dhe zhvillimi i kapaciteteve.

Për të garantuar që politikat dhe mekanizmat shqiptarë përpiqen për një ekonomi me karbon të ulët me kosto efikase, janë identifikuar një numër objektivash politikë kyç, të domosdoshme për t’iu përgjigjur gjashtë përparësive të identifikuara në dokumentin e SKNK-së [4.6].

Në Planin e Zbutjes së Ndryshimeve Klimatike janë identifikuar 222 masa, kryesisht të fokusuar gjatë një periudhe afatshkurtër (deri në vitin 2020), si dhe disa të tjera të përcaktuara për periudhën e mesme (2030) dhe afatgjatë (2050). Pjesa kryesore e masave burojnë nga strategjitë dhe planet ekzistuese, disa prej tyre janë propozime të reja nga dokumenti i SKNK&P-së për trajtimin e boshllëqeve apo sinergjive.

Shumica e masave janë në sektorin e energjisë (77) dhe në sektorin e transportit (71), ndjekur nga LUCF-ja (53), Bujqësia (17) dhe 4 masa ndërsektoriale. Vëmendje e veçantë i kushtohet sistemit të matjes, monitorimit dhe raportimit në Shqipëri. Vlerësimi i fuqishëm, standard dhe transparent, raportimi dhe llogaritja e shkarkimeve GES dhe sekuestrimit janë thelbësore për të ndjekur progresin drejt arritjes së objektivave, vlerësimin e performancës së politikave dhe masave, si dhe vlerësimin në nivel ndërkombëtar të suksesit të përpjekjeve të përbashkëta për të zbutur efektet e ndryshimeve klimatike [5].

Ndërkohë në planin e përshtatjes janë identifikuar dhe dizenuar së bashku me grupin ndërministror të punës ndaj ndryshimeve klimatike (IMWG), 15 veprime prioritare nëpërmjet një

² https://ec.europa.eu/clima/sites/clima/files/docs/eu_strategy_en.pdf

zhvillimi të gjerë të kapaciteteve dhe qasjes pjesëmarrëse. Këto veprime prioritare (masa përshtatëse) perceptohen në formën e fishave të projektit në mënyrë që aktorët përkatës të mund t'i zhvillojnë ato më tej për financim.

Për më tepër, është ngritur një sistem koherent monitorimi dhe vlerësimi i dokumentit të SKNK&P-së për të siguruar arritjen efikase dhe efektive të objektivave të strategjisë, në bazë të kuadrit institucional dhe monitorues, tashmë të parashikuar nga strategjitë dhe planet ekzistues sektoriale dhe ndërsektoriale, me objektiva dhe tregues sipas metodologjisë specifike dhe institucioneve përgjegjëse [7].

1. HYRJJE

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Parisit nga Qeveria (Nju-Jork, 22 prill 2016), Shqipëria ka hyrë në epokën e re të procesit të politikave klimatike ndërkombëtare, ku të gjitha palët synojnë në mënyrë kolektive ta mbajnë rritjen e temperaturës globale në 2°C mbi nivelin para-industrial. Zbutja e efekteve të ndryshimeve klimatike është thelbësore, për të garantuar adaptimin me kosto të arsyeshme ekonomike, mjedisore dhe sociale, çka është kyçi për një vend jashtëzakonisht të cenueshëm si Shqipëria.

Duke qenë se Shqipëria mban aktualisht statusin zyrtar të vendit kandidat për anëtarësim në BE (që prej qershorit 2014), është bërë progres i qëndrueshëm lidhur me kriterin politik, duke zbatuar dhe konsoliduar reformat në fushën e shtetit ligjor dhe në administratën publike. Janë bërë përpjekje të frytshme për afrimin e legjislacionit shqiptar me kërkesat e BE-së në shumë fusha, duke rritur aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësisë. Megjithatë, Shqipëria ende duhet të bëjë përpjekje shumë të mëdha për të përmirësuar përgatitjet e saj për zbatimin e legjislacionit të BE-së në shumë fusha parësore kyçe si ndryshimet klimatike³.

Strategjia e Përgjithshme Kombëtare e Ndryshimeve Klimatike dhe Plani (dokumenti i SKNK&P) është hartuar për të mbështetur zbatimin e legjislacionit të BE-së për mjedisin dhe klimën, duke synuar forcimin e koordinimit ndërsektorial në Shqipëri për masa mbi klimën, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Dokumenti i SKNK&P-së fokusohet në zbutjen dhe adaptimin e ndryshimeve klimatike. Këshilli i Ministrave dhe ministritë përkatëse kanë përgatitur tashmë apo po punojnë, me strategji dhe plane veprimi për ndryshimet klimatike për sektorët kryesorë në Shqipëri. Megjithatë, nevojitet një strategji dhe plan i përgjithshëm më i integruar për klimën, që të mund të integrojë në mënyrë efektive gjithë planet dhe strategjitë brenda një dokumenti gjithëpërfshirës.

Me qëllim që të trajtohet kjo nevojë, ky dokument i SKNK&P-ëspërmbledh dhe sistematizon strategjitë dhe planet ekzistuese, duke siguruar një vlerësim gjithëpërfshirës të masave të planifikuara në Shqipëri për periudhën afatshkurtër dhe afatgjatë, rrjedhimisht ky dokument përfaqëson një strategji dhe plan të përgjithshëm ndërsektorial, që siguron një përmbledhje të synimeve, objektivave politike dhe masave të fokusuara të zbutja dhe adaptimi i ndryshimeve klimatike në sektorët përkatës, duke vlerësuar sinergjitë dhe boshllëqet potenciale, implikimet financiare, si dhe duke planifikuar rrugët për zhvillimin me karbon të ulët.

1.1 Aspektet e zbutjes

Dokumenti i SKNK&P-së për pjesën e zbutjes, kryhen në përputhje me vendimin 1/CP16 të UNFCCC-ës dhe vendimin 525/2013/EU, meqë “strategjitë apo planet pritet të kontribuojnë për ndërtimin e një shoqërie me karbon të ulët dhe të sigurojnë një zhvillim të madh dhe të qëndrueshëm, si dhe lëvizjen me kosto efektive drejt një objektiv afatgjatë për klimën, duke marrë në konsideratë statet e ndërmjetme”.

Dokumenti i SKNK&P-ës për pjesën e zbutjes, merr në konsideratë objektivat afatgjatë deri në vitin 2050, që kërkojnë reduktime afatgjata të shkarkimeve dhe shtimin e përthithësve në sektorët përkatës, në përputhje me objektivat e Bashkimit Evropian, për të reduktuar me kosto efektive shkarkimet nga 80% deri në 95% deri në vitin 2050, krahasuar me nivelet e vitit 1990.

³ Komisioni Evropian –Të dhëna. Gjetje kyçe të raportit 2015 për Shqipërinë. Bruksel, 10 nëntor 2015. http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-15-6035_en.htm

Marrëveshja e Parisit thekson gjithashtu, nevojën për të formuluar dhe komunikuar strategji zhvillimi afatgjata për reduktimin e gazeve serrë, deri në mesin e shekulli XXI (neni 4.19), dhe këto strategji duhen paraqitur deri në vitin 2020. Kjo kërkesë, e kombinuar me synimin afatgjatë për shkarkimet zero deri në gjysmën e dytë të këtij shekulli (neni 4.1), nënkupton që vendet duhet të përpiqen të demonstrojnë, sesi do të kontribuojnë me përpjekjet dhe politikat e tyre të planifikuara apo të zbatuara për këtë objektiv.

Kontributi i Kombëtar i Pikësnyuar i Shqipërisë (INDC) paraqitur në shtator 2015 (dhe paraqitur si NDC në shtator 2016), siguron një hap të parë drejt një rruge me karbon të ulët, që synon të arrijë 2 tCO₂eq për kokë të nivelit të shkarkimit GES deri në vitin 2050, krahasuar me objektivin politik të BE-së për vitin 2050.

Dokumenti i SKNK&P-ës fokusohet në katër sektorët e mëposhtëm raportues të inventarit të gazeve serrë të Shqipërisë⁴: Energjia (me fokus të veçantë të Transportit), sektorët e Bujqësisë dhe Ndryshimit të Përdorimit të Tokës dhe Pylltarisë (LUCF), duke mbuluar kështu 80% të shkarkimeve të Shqipërisë (shih tabelën 1).

Tabela 1. Përmbledhje e përqindjes në shkarkimet totale GES të sektorit të marrë në konsideratë, sipas Komunikimit të Dytë dhe të Tretë Kombëtar (të dhëna nga KDK dhe KTK, përkatësisht)

Sektorët e mbuluar nga strategjia	Përqindja në shkarkimet totale të vitit bazë	
	2000	2005
Energji-Bujqësia-LUCF në KDK	89%	
Energji-Bujqësi-LUCF në KTK	88%	80%

Duke marrë në konsideratë përfaqshen e propozuar, janë konsideruar dhe analizuar strategjitë, planet dhe ligjet e mëposhtme:

Ndërthurja sektoriale:

- Kontributi i Synuar i Përcaktuar në Nivel Kombëtar (INDC) në kuadrin e NFCCC-it (2015–2030)

- Draftstrategjia Mjedisore Ndërsektoriale (SMNS) (2015–2020)

- Strategjia Kombëtare për Integrim dhe Zhvillim (SKZHI-II) (2015–2020)

- Projektligji për Ndryshimet Klimatike (nga hyrja në fuqi deri në rishikim)

- Plani Kombëtar i Territorit (PKT) (2015–2030)⁵

Sektori i energjisë:

- NAMA – Zëvendësimi i lëndëve djegëse fosile me mbetje jo të rrezikshme në industrinë shqiptare të çimentos (2015–2020)

- NAMA – Financimi i mekanizmit për eficiencën e energjisë në ndërtesa (2015–2020)

- Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë 2018–2020

- Ligji nr. 124/2015 për Eficiencën e Energjisë (nga hyrja në fuqi deri në rishikim)

- Ligji nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë”

- Ligji nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave

- VKM nr. 709, datë 1.12.2017 për Planin kombëtar të eficiencës së Energjisë 2017–2020

Sektori i Transportit:

- Strategjia dhe Plani i Veprimit i Sektorit të Transportit (SSTPV) (2016–2020)

- Plane për Transport të Qëndrueshëm (TECTQ) – dokument informues (2016–2020)

Bujqësia dhe LUCF-ja:

⁴ Raportimi i GES-IT në Shqipëri bazohet në Udhëzuesin e Rishikuar të Praktikave të Mira të IPCC-ittë vitit 1996, ku kategoritë raportuese të burimit/ përthithësve GES grupohen në sektorë si vijon: • Energjia • Proceset Industriale • Tretës dhe Përdorime të Tjera të Produkteve • Bujqësia • Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pylltaria • Mbetjet

⁵ DCM No. 881, datë 14.12.2016 Për miratimin e planit të përgjithshëm kombëtar të territorit.

- Strategjia ndërsektorale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural në Shqipëri (SNBZHR) (2014–2020)

- Programi i Zhvillimit Rural 2014–2020 në kuadrin e Instrumentit për Asistencën para Anëtarësimit (IPARD) (2014–2020)

- Dokumenti Politik i Strategjisë për Mbrojtjen e Biodiversitetit (DPSMB) (2016–2020)

- Projektligji për Administrimin e Fondit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave në Republikën e Shqipërisë (nga hyrja në fuqi deri në rishikim).

Në kohën e shkrimit të dokumentit të SKNK-Së, po zhvilloheshin disa strategji dhe plane, prandaj janë në formë drafti, si në rastin e planit dhe strategjisë për Transportin, SKZHI-II dhe Komunikimit të Tretë Kombëtar ose ishin në stadin fillestar, si në rastin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë. Prandaj rekomandohet një rishikim periodik i këtij dokumenti në dritën e zhvillimit të strategjive kryesore sektoriale gjatë viteve të ardhshme.

1.2 Aspektet e përshtatjes

Plani kombëtar i përshtatjes është krijuar në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë e linjës, nën udhëheqjen e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM), në kuadrin e Grupit Ndërministror të Punës së Ndryshimeve Klimatike, përgjatë vitit 2015–2016.

NAP-i kuptohet kryesisht, si një proces afatgjatë për të cilin ky dokument ofron elementet kuadër, si: parimet, objektivat, treguesit, veprimet prioritare dhe elementet e procesit.

Ai ofron një kuadër për integrimin e ndryshimeve klimatike në sektorët e synuar si dhe vendos një kuadër zbatimi kryesisht, nëpërmjet veprimeve prioritare të mbështetura nëpërmjet mekanizmave mundësues, si buxheti përkatës, informimi dhe përfshirja, zhvillimi i kapaciteteve dhe monitorimi.

Një drejtim i efektshëm i procesit të përshtatjes do të sigurohet nëpërmjet objektivave dhe treguesve të orientuar nga rezultatet. Procesi i përshtatjes thjeshtohet, duke punuar mbi treguesit kryesorë që karakterizojnë progresin e përshtatjes, dhe duke punuar mbi objektivat dhe treguesit ekzistues, për shembull ata që janë të përcaktuar në SKZHI-në. Në pjesën e përshtatjes së dokumentit SKNK&P janë identifikuar indikatorët të cilët gjithsesi, duhen specifikuar më tej, nëpërmjet rezultateve të prodhuara nga një sistemi konciz monitorimi.

Procesi NAP-it në Shqipëri, orientohet nga “Udhëzimet teknike për proceset e NAP-it”, të përgatitura nga Grupi Ekspertëve të Vendeve më pak të zhvilluara të UNFCCC-së (LEG)⁶ dhe të publikuara në dhjetor të vitit 2012 (të ashtuquajturat “Udhëzimet teknike”).

Bazuar mbi karakteristikat e dhëna në “udhëzimet teknike”, procesi i NAP-it në Shqipëri ishte:

- Drejtuar dhe udhëhequr nga Shqipëria: U drejtua nga MM-ja dhe u përpoq të rrisë përputhshmërinë me proceset e tjera të planifikimit kombëtar, si dhe të sigurojë një përfshirje të lartë politike. Procesi i NAP-it synon të shfrytëzojë dhe të mbështetet në kapacitetet e nivelit kombëtar, me mbështetjen e partnerëve të ndryshëm sipas nevojës.

- Jopërsishkruar, në sensin që përzgjedhja e veprimeve prioritare reflekton nivelin e progresit në vend, aktivitetin e aktorëve të ndryshëm si dhe kushtet konkrete të kuadrit të NAP-it.

- Fokusuar në integrim, kështu sigurohet një koherencë mes planifikimit të përshtatjes dhe zhvillimit: Ky lloj integrimi përfshin gjithashtu, reflektimin e nevojave për përshtatje në të tërë burimet financiare të nevojshme.

- Orientuar drejt përmirësimit të menaxhimit të rreziqeve klimatike. Veprimet prioritare të përzgjedhura janë në fakt një listë ndërhyrjesh të cilat ndihmojnë në zvogëlimin e rreziqeve të klimës, identifikojnë pika hyrëse në proceset ekzistuese kombëtare si dhe gjejnë fonde nga burime publike, private. Kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në përputhje me udhëzimet teknike, Shqipëria e kupton NAP-in si një proces që përfshin palët e ndryshme të interesit dhe organizon bashkëpunimin e tyre, për ta rritur aftësinë rimëkëmbëse të Shqipërisë ndaj ndryshimeve të klimës, në një periudhë afatgjatë.

⁶ Grupi i Ekspertëve UNFCCC / LDC: Planet Kombëtare të Përshtatjes – udhëzime teknike për procesin kombëtar të planit të përshtatjes. dhjetor 2012.

Parimet orientuese për procesin NAP-it të Shqipërisë përcaktohen në kapitullin 2.9. Deri tani janë bërë hapat e mëposhtëm për zhvillimin e procesit NAP:

- Lançimi dhe fillimi i procesit NAP, më 19 shkurt 2015.
- Drejtimi i procesit NAP: Në bazë të vendimit të Kryeministrit, procesi drejtohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim të ngushtë me Grupin Ndërmnistror të Punës për Ndryshimet Klimatike.
- Vlerësimi i situatës: Më 19 shkurt 2015 u zhvillua një takim pune me pjesëmarrje të gjerë për vlerësimin e situatës, duke shfrytëzuar instrumentin SNAP-i të përgatitur nga GIZ-i. Kjo pati si rezultat një vlerësim përgjatë 7 faktorëve të suksesit dhe një analizë SWOT-i (pikat e forta, pikate dobëta, mundësi, rreziqe) për Shqipërinë.
- Vlerësimi i vulnerabilitetit nga klima realizuar në bazë të vlerësimeve të mëparshme të vulnerabilitetit, si ato të zhvilluar për Komunikimin e Dytë Kombëtar (2009), për Konventën Kuadër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), studimet e vulnerabilitetit për sektorin e Bujqësisë (2013), sektorin e Shëndetësisë (2011) dhe sektorin e energjetikës (2009).
- Organizimi i procesit: Më 10 qershor 2015, është zhvilluar një takim pune me pjesëmarrje të gjerë për zhvillimin e detyrave, afateve dhe përgjegjësiive për procesin NAP-it. Organizimi konkret i procesit të hartimit të NAP-it, është qartësuar gjatë takimit të Grupit Ndërmnistror të Punës më 8 shtator 2015. Gjithashtu, është hartuar dhe miratuar një draftide për kapitujt që do të mbulohen në këtë dokument.
- Përcaktimi i objektivave dhe treguesve: Në kuadër të një debati ndërveprues, GNMP-ës NAP-i zhvilloi/përshtati objektivat dhe treguesit për procesin e NAP-it gjatë takimit të datës 27 nëntor 2015.
- Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në politikat sektoriale dhe politikat për zhvillimin: Lançimi i përdorimit për herë të parë të thjerrës klimatike në SKZHI-në më 19 qershor 2015.
- Trajnimi dhe reflektimi për financimin në lidhje me klimën: Më 7 shtator 2015 u zhvillua një takim i posaçëm pune për financimin lidhur me klimën së bashku me Autoritetin Kombëtar të Përcaktuar. Më 8 shtator 2015 u zhvillua një seancë trajnimi për financimin e lidhur me klimën gjatë takimit të Grupit Ndërmnistror të Punës.
- Diskutim i përbashkët i versionit të parë të dokumentit NAP: Gjatë mbledhjes së GNMP-ës NAP-i më 28 prill 2016 u diskutua dhe u komentua për ndryshime versionit të parë të dokumentit të NAP-it.
- Trajnim mbi zbatimin e politikave të ndryshimeve klimatike në Shqipëri: Një trajnim u organizua për Departamentin e Ndryshimeve Klimatike dhe Ajrit (MM), si dhe për Agjencinë Kombëtare të Mjedisit më 13-15 korrik. Trajnimi kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve në veçanti për departamentin e ri të krijuar në MM, në përcaktimin e ndarjen e detyrave të veçanta dhe krijimin e një ideje mbi krijimin e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për procesin e NAP-it.
- Workshop-i mbi mundësitë e financimit për klimën: Me 21 tetor u organizua një seminar me pjesëmarrësit GPNM-ës dhe gjithashtu me personat respektivë të buxhetit të ministrive të linjës, për të diskutuar opsionet e mundshme të financimit (ato kombëtare dhe ndërkombëtare) për zbatimin NAP-it. Dokumenti i financimit të NAP-it jepet në aneksin 3.

2. ANALIZË E SITUATËS AKTUALE

2.1 Shkenca e ndryshimeve klimatike

Prova e ndikimit njerëzor në sistemin klimatik është rritur që prej fillimit të viteve '90, si dhe është afirmuar dhe pranuar gjerësisht në Raportin e Katërt Vlerësues (AR4) të Panelit Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike, botuar në vitin 2007. Ka shumë gjasa që rritja e vëzhguar në temperaturën mesatare globale sipërfaqësore, të jetë shkaktuar nga rritja antropogjenike e përqendrimeve GES-it dhe faktorëve të tjerë antropogjenikë së bashku.

Efekti i ndryshimeve klimatike është i qartë në mbarë botën, teksa ndryshimet në temperaturë dhe precipitime po i ndryshojnë sistemet hidrologjike, duke ndikuar në burimet ujore në sasi dhe

cilësi. Shumë specie tokësore, të ujërave të ëmbla dhe detare, i kanë zhvendosur shtrirjet e tyre gjeografike, aktivitetet sezonale, modelet e migrimit, sasisë dhe ndërveprimet e specieve, si reagim ndaj ndryshimeve klimatike në vazhdim. Po ashtu, janë vëzhguar shumë ngjarje të motit dhe klimës ekstreme, përfshirë rënien e ekstremeve të temperaturave të ftohta, rritjen e ekstremeve të temperaturave të larta, rritjen e niveleve të deteve dhe rritjen e numrit të ngjarjeve me precipitim të dendur në një numër rajonesh.

Në veçanti, rajoni i Mesdheut është konsideruar shumë i cenueshëm ndaj ndryshimeve klimatike. Rajoni i Mesdheut karakterizohet nga një risk i lartë për të pësuar dëmtime të shumta dhe të njëpasnjëshme, për shkak të ndryshimeve klimatike që përfshijnë njëkohësisht gjithë sektorët kryesorë, si turizmin, bujqësinë, pylltarinë, infrastrukturën, energjinë dhe shëndetin publik. Ndryshimet në përbërjen e llojeve, shtimi i specieve të huaja, humbja e habitatit dhe degradimi i tokës dhe detit, së bashku me humbjet e prodhimeve bujqësore dhe të pylltarisë, për shkak të shtimit të valëve të të nxehtit dhe thatësirave, që përkeqësohen gjithashtu nga gara për ujë- do ta rrisë cenueshmërinë⁷.

Skenari i ardhshëm klimatik për Shqipërinë parashikon ndryshime, si temperatura të rritura, pakësim të precipitimeve dhe reduktim të burimeve ujore dhe tokës së punueshme. Zonat më të ndjeshme në Shqipëri janë ato bregdetare, ndërsa sektorët më të cenueshëm janë burimet ujore, bujqësia, energjia dhe turizmi. Në veçanti, pritet gjithashtu, që ndryshimet klimatike të shkaktojnë rritje temperaturash me 0.8°C deri 1.0°C deri në vitin 2025, nga 1.2°C deri në 1.8°C deri në vitin 2050, si dhe nga 2.1°C deri në 3.6°C deri në vitin 2100⁸. Ky ndryshim në klimë do t'i reduktojë burimet ujore dhe lagështinë, si dhe do të ketë një ndikim të pafavorshëm mbi bujqësinë, pyjet dhe biodiversitetin. Ndryshimet e ardhshme të klimës priten të ndikojnë negativisht mbi rrjedhën e lumenjve, që nga ana e tyre do të ndikojnë në kapacitetin gjenerues të hidrocentraleve.

Shkarkimet e vazhdueshme të gazeve serrë do të shkaktojnë ngrohje të mëtejshme dhe ndryshime afatgjata në sistemin klimatik, duke rritur gjasat për ndikime të ashpra, përhapëse dhe të pakthyeshme për njerëzit dhe ekosistemet⁹. Shkarkimet antropogjenike GES nxiten nga shumë faktorë, si madhësia e popullsisë, aktiviteti ekonomik, stili i jetesës, përdorimi i energjisë, modelet e përdorimit të tokës, teknologjia dhe politikat klimatike. Parashikimet e ardhshme të shkarkimeve GES dhe përqendrimet atmosferike, shkarkimet që ndotin ajrin dhe përdorimi i tokës në skenarët RCP-ës për shekullin XXI të IPCC-ës AR5 tregojnë, se edhe në skenarin më të rreptë të masave zbutëse, një ngrohje globale me gjasë, nën 2°C të temperaturës globale të sipërfaqes mbi temperaturat e periudhës paraindustriale. Kufizimi i ndryshimeve klimatike do të kërkonte reduktime të mëdha të shkarkimeve të gazrave serrë që së bashku me adaptimin, mund t'i kufizojnë risqet e ndryshimeve klimatike.

2.2 Konteksti ndërkombëtar i politikës së ndryshimeve klimatike

Gjatë dy dekadave të fundit, sfida e ndryshimeve klimatike është përballur me një qasje për përgjegjësi të përbashkët në procesin ndërkombëtar të negociimit, që ka çuar në instrumente të rëndësishme ligjore të detyrueshme me angazhime të diferencuara ndonëse të krahasueshme, në bazë të parimit të përgjegjësi të përbashkëta, por të diferencuara dhe aftësive përkatëse mes vendeve.

⁷ Ulbrich, U., P. Lionello, D. Belušić, J. Jacobeit, P. Knippertz, F.G. Kuglitsch, G.C. Leckebusch, J. Luterbacher, M. Maugeri, P. Maheras, K.M. Nissen, V. Pavan, J.G. Pinto, H. Saaroni, S. Seubert, A. Toreti, E. Xoplaki, dhe B. Ziv, 2012: Klima i Mesheut: modelet sinoptike, temperatura, precipitimi, erërat dhe ekstrshkark e tyre. Në: Klima e Rajonit Mesdhetar: Nga e kaluara në të Ardhmen [Lionello, P. (ed.)]. Elsevier, London, UK dhe Waltham, MA, USA, f. 301–346.

⁸ Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave; Raport për kapacitetin kombëtar të Shqipërisë për vetëvlerësim për menaxhimin mjedisor global, 2007

⁹ IPCC, 2014: Ndryshimi Klimatik 2014: Raport Sintezë. Kontribut i Grupeve të Punës I, II dhe III në Raportin e Pestë Vlerësues të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimin Klimatik [Ekipi Hartues, R.K. Pachauri dhe L.A. Meyer (eds.)]. IPCC, Gjenevë, Zvicër, 151 f.

Objektivi për stabilizimin e përqendrimeve GES në atmosferë, duke lejuar zhvillimin e qëndrueshëm (neni 2 i UNFCCC), u përdor për herë të parë gjatë Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), të miratuar në “Samitin e Rios për Tokën” në vitin 1992. Konventa nuk vendos objektiva të matshëm reduktimi (që përfshihen në Protokollin e Kiotos), por përcaktoi detyrimet e raportimit të shkarkimeve GES nga gjithë sektorët (neni 4.1 i UNFCCC-ës).

Protokolli i Kiotos (PK), i miratuar në vitin 1997, gjatë Konferencës së 3-të të Palëve (KeP 3) të UNFCCC-ës, përcakton objektiva të matshëm për reduktimin e shkarkimeve GES, nga gjithë sektorët në vendet e zhvilluara (aneksi I i UNFCCC). Palët që nuk janë përfshirë në aneksin I, nxiten po ashtu të ndjekin një udhë të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të kontribuojnë për objektivin e fundit të Konventës përmes mekanizmit të zhvillimit të pastër (CDM). CDM lejon projekte për reduktimin e shkarkimeve në vendet në zhvillim për të fituar kredite të certifikuara për reduktimin e shkarkimeve GES, që do të përdoren nga Palët e përfshira në aneksin I, për arritjen e përputhshmërisë me angazhimet e tyre të matshme për reduktimin e shkarkimeve në kuadrin e nenit 3.

Në Konferencën e 18-të të Palëve të UNFCCC-ës (KeP 18), mbajtur në Doha, Katar, në dhjetor 2012, u miratua një amendim i Protokollit të Kiotos, që zyrtarizon hyrjen në fuqi të periudhës së dytë të angazhimit (2013-2020). Gjithsej 144 palëve u kërkohet ta miratojnë amendimin Doha për hyrjen e tij në fuqi. Në KeP18 mbajtur në Doha (2012) u bënë përparime në Grupin e Punës Ad Hoc të emërtuar për Platformën Durban për Veprim të Shtuar (ADP). Kjo Platformë synon të zhvillojë një protokoll të ri, një tjetër instrument ligjor apo të paktën, një rezultat të vendosur me forcë ligjore deri në vitin 2015, që do të zbatohet nga viti 2020, dhe detyruet për gjithë Palët. Njëkohësisht, vendet në zhvillim po nxiten të përpunojnë Masa të Përshtatshme Zbutëse Kombëtare (NAMA), me mundësinë për të marrë mbështetje dhe lehtësim nga financime dhe teknologji ndërkombëtare. NAMA-t përfshijnë politika apo aktivitete të përshtatshme nga ana kombëtare, që synojnë të kontribuojnë për përmbushjen e synimeve vullnetare të reduktimit të shkarkimeve të përcaktuara nga vendet në zhvillim. Gjithë sektorët kryesorë përgjegjës për shkarkimet GES në çdo vend janë përfshirë në NAMA.

Marrëveshja e Parisit, miratuar në dhjetor 2015, përcakton një pikë kthese në politikën ndërkombëtare të ndryshimeve klimatike, duke siguruar një kornizë të përbashkët për gjithë Palët, me synim mbajtjen nën kontroll të rritjes së temperaturës mesatare globale nën 2° C mbi nivelet e periudhës paraindustriale dhe vazhdimin e përpjekjeve për kufizimin e rritjes së temperaturës me 1,5°C (Neni 2). Për arritjen e një objektivi kaq afatgjatë, palët duhet të synojnë të arrijnë një pikë globale të shkarkimeve GES “sa më shpejt të jetë e mundur”, duke pranuar se piku do të zgjasë më shumë për palët e vendeve në zhvillim, si dhe të ndërmarrin reduktime të shpejta më pas, në përputhje me gjetjet më të mira të mundshme, për të arritur një balancë mes shkarkimeve antropogjenike nga burimet dhe përthithjen nga përthithësit në gjysmën e dytë të këtij shekulli (neni 4.1), përveç objektivave të masave zbutëse. Marrëveshja synon të forcojë reagimin global ndaj kërcënimit të ndryshimeve klimatike edhe përmes rritjes së aftësisë për t’u përshtatur me ndikimet e dëmshëm të ndryshimeve klimatike, ndërsa garantohet një zhvillim i qëndrueshëm, elastik dhe me nivele të ulëta karboni, përmes flukseve të përshtatshme financiare. Mbështetja duhet siguruar nga Palët e vendeve të zhvilluara lidhur me masat zbutëse dhe adaptimin, duke vazhduar synimin ekzistues kolektiv për mobilizimin e 100 miliardë USD në vit, deri në vitin 2025, kohë kur do të vendoset një objektiv i ri i përbashkët. Me qëllim që të arrihen objektivat e mësipërm për reduktimin e shkarkimeve, Marrëveshja përcakton një “sistem nga poshtë-lart” ku Palët do të duhet të përgatisin, komunikojnë dhe mbajnë Kontribute të Mëtejshme Kombëtare të Përcaktuara (KKP), që synojnë t’i arrijnë, duke ndjekur masa zbutëse vendore. Palët do t’i komunikojnë kontributet, çdo pesë vjet, me synim përmirësimin progresiv të përpjekjeve të tyre (neni 4.11).

Përveç kontributeve kombëtare, Palët duhet gjithashtu, të formulojnë dhe komunikojnë strategji zhvillimi afatgjatë, me GES-in të ulët në gjysmën e shekullit (neni 4.19), si dhe t’i

paraqesin ato deri në vitin 2020. Leximi i kombinimit të kësaj kërkesë me synimin afatgjatë të shkarkimeve zero në gjysmën e dytë të këtij shekulli (neni 4.1), nënkupton që vendet duhet të përpiqen të demonstrojnë, se si do të kontribuojnë përpjekjet e tyre dhe politikat e tyre të planifikuara apo të zbatuara për këtë objektiv.

Marrëveshja e Parisit do të hyjë në fuqi, pasi 55 vendet që zënë të paktën 55% të shkarkimeve globale, të kenë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit.

Figura më poshtë tregon programin e zbatimit të përcaktuar nga marrëveshja për arritjen e synimit 2°C (1,5°C).




Figura 1 – Afati kohor i procesit të përkufizuar në Marrëveshjen e Parisit

2.3 Politika e BE-së për ndryshimet klimatike

Një përjasje proaktive në nivel evropian përfshin gjithë shtetet anëtare për nxitjen e një reagimi të përbashkët ndërkombëtar ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo përfshin përpjekje për masa zbutëse për kontrollin e shkarkimeve të gazeve serrë, si dhe nxitjen e masave adaptuese për të luftuar ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike që janë ndërkaq të pashmangshme.

Ia vlen të vihet në dukje se veprimi politik i BE-së është nga ndërtimi dhe natyra, i gjerë dhe gjenerik. Parimi i varësisë, një shtyllë e sistemit qeverisës të BE-së, thërret për ndërhyrjen e BE-së vetëm në fushat që nuk mund të rregullohen më mirë në nivelin e shtetit anëtar, duke u lënë kështu nivele të larta autonomie shteteve anëtare në fusha të ndryshme politike. Në fushat klimë-energji, politika e BE-së mund të vendosë synime dhe të përcaktojë kriteret e pranueshme matëse, për të verifikuar arritjen e këtyre synimeve, si dhe mjetet e pranueshme të politikave për t'i arritur ato, por i lë çdo Shtet Anëtar zgjedhjen e masave konkrete që do të merren. Kështu, praktikrat më të mira në nivel kombëtar mund të jenë po aq me rëndësi në përcaktimin e mënyrës, sipas së cilës Shqipëria duhet ta zhvillojë strategjinë dhe planin e saj për klimën në sektorin e klimës.

“Plani për Ekonomi me Karbon të Ulët”

BE-ja ka miratuar “Planin për Ekonomi me Karbon të Ulët”¹⁰ në vitin 2011, duke përcaktuar një udhë efikase nga ana e kostos, për ta bërë ekonominë evropiane më miqësore me klimën dhe me më pak konsum energjie. Plani sugjeron që deri në vitin 2050, BE-ja duhet t'i reduktojë shkarkimet e saj në 80% në nivelet e vitit 1990. Piketat për arritjen e kësaj janë 40% reduktime të shkarkimeve deri në vitin 2030, dhe 60% deri në vitin 2040 (figura 2). Gjithë sektorët duhet të kontribuojnë për tranzicionin me karbon të ulët, sipas potencialit të tyre teknologjik dhe ekonomik. “Plani i BE-së për Ekonomi me Karbon të Ulët” kërkon masa në gjithë sektorët kryesorë përgjegjës për shkarkimet e Evropës – gjenerimi i energjisë, industria, transporti, ndërtesat, ndërtimet dhe bujqësia – si dhe duhen bërë investime të mëdha në:

- Teknologjitë e reja me karbon të ulët;
- Energjinë e rinovueshme;

¹⁰ COM(2011) 112 final/2. Gjetendet në: http://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:5db26ecc-ba4e-4de2-ac08-dba649109d18.0002.03/DOC_2&format=PDF

- Eficiencën e energjisë;
- Infrastrukturën e rrjetit.

Shkarkimet nga sektori i transportit mund të reduktohen me më shumë se 60% në nivelet e vitit 1990 deri në vitin 2050. Në periudhën afatshkurtër pjesa më e madhe e progresit mund të gjendet në motorët efikasë me benzinë dhe naftë. Në periudhën afatmesme, makinat e karikueshme hibride dhe elektrike do të mundësojnë reduktime të mëdha të shkarkimeve. Biokarburet do të përdoren gjithnjë e më shumë në aviacion dhe në transportin rrugor, pasi jo gjithë mjetet e rënda për transportin e mallrave do të punojnë me energji elektrike në të ardhmen.

Strategjia kërkon politika që nxisin klimën e qëndrueshme të biznesit, çka nxit investimet me karbon të ulët që duhet të bëhen sa më shpejt të jetë e mundur.




Figura 2 – Reduktimi i mundshëm i sektorëve në udhën drejt reduktimit -80%¹¹

“Paketa e Klimës dhe Energjisë 2020” dhe periudha e dytë e angazhimit të PK-ës (2013–2020)

Në vitin 2009 BE-ja miratoi “Paketën e Klimës dhe Energjisë 2020”, një grup legjislativ të detyrueshëm që garantojnë deri në vitin 2020, arritjen e objektivave të klimës dhe energjisë prej 20% reduktim në shkarkimet e gazeve serrë nga nivelet e vitit 1990, 20% të energjisë së BE-së nga burimet e rinovueshme, si dhe 20% përmirësim të eficiencës së energjisë.

Politika kryesore për përmbushjen e objektivave të reduktimit të shkarkimeve në BE, përfaqësohet nga Skema Evropiane për Tregtinë e Shkarkimeve (SETSH) për tregtinë e lejeve të shkarkimeve të gazeve serrë në Komunitetin Evropian¹², vendosur me Direktivën 2003/87/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit. SETSH-i mbulon kryesisht sektorin e energjisë dhe industrinë, duke mbuluar 45% të shkarkimeve të BE-së; megjithatë Shtetet Anëtarë kanë mundësi të mbajnë ose vendosin skema kombëtare tregtimi, që mbulojnë sektorë të tjerë ekonomikë, të përjashtuar përkohësisht nga skema e Komunitetit.

SETSH-i mbetet ende mjeti kryesor për reduktimet e shkarkimeve deri në vitin 2020, me një rishikim të madh të miratuar në vitin 2009, me qëllim forcimin e sistemit, duke hyrë në fazën e tij të tretë me rregulla më të harmonizuara në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2020. SETSH-i mbulon më shumë se 11,000 instalime të rënda, që përdorin energji në gjenerimin e energjisë dhe industrinë prodhuese, si dhe operatorët e avionëve që kryejnë aktivitete aviacioni në BE dhe në shtetet EFTA-s.

¹¹ Burimi: http://ec.europa.eu/clima/policies/strategies/2050/index_it.htm

¹² 28 shtetet anëtare të BE-së dhe tre shtete nga Zona Ekonomike Evropiane (EEA), Lihtenshtejri, Norvegjia dhe Islanda, si dhe Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë (EFTA)

Sektorët që nuk përfshihen në SETSH, si transporti (përveç aviacionit dhe transportit ndërkombëtar detar), ndërtesat, bujqësia dhe mbetjet, mbulohen nga vendimi për përpjekje të përbashkëta (vendimi nr. 406/2009/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit i datës 23 prill 2009). Vendimi për përpjekje të përbashkëta (VPB) vendos objektiva kombëtare për shkarkimet për shtetet anëtare, për periudhën 2013–2020, të shprehura si ndryshime në përqindje nga nivelet e vitit 2005.

Për periudhën 2013–2020 të Protokollit të Kiotos, vendet e BE-së (28 shtetet anëtare së bashku me Islandën) kanë rënë dakord të arrijnë së bashku një objektiv reduktimi prej 20% krahasuar me vitin 1990, në përputhje me objektivin e vetë BE-së prej 20% deri në vitin 2020, gjerësisht në përputhje me angazhime të tjera në çdo sektor të ekonomisë. Në veçanti, BE-ja është përgjegjëse për shkarkimet në sektorët e mbuluar nga SETSH-i, dhe çdo vend është përgjegjës për shkarkimet e veta kombëtare në sektorët jashtë SETSH-it.

Sipas analizave të Agjencisë Evropiane të Mjedisit, të parashikimeve të vetë Shteteve Anëtare; BE-ja ka gjasa t'i reduktojë shkarkimet e gazeve serrë, me të paktën 21% të niveleve të vitit 1990 deri në vitin 2020, duke e kaluar objektivin prej 20%. (EEA, 2014)¹³

“Kuatrili ligjor për klimën dhe energjinë 2030”

Më 23 tetor 2014, Këshilli Evropian miratoi “Kuatrili ligjor për klimën dhe energjinë 2030” për periudhën 2020–2030, që synon ta bëjë ekonominë dhe sistemin e energjisë në BE më konkurruese, më të qëndrueshme dhe më të sigurt, në udhën drejt ekonomisë me karbon të ulët, në përputhje me perspektivën afatgjatë të përcaktuar në planin për kalimin në një ekonomi konkurruese me karbon të ulët në vitin 2050 – Planin e Energjisë 2050 dhe Dokumentin e Bardhë të Transportit. Kuadrili ligjor për klimën dhe energjinë 2030 përcakton objektivin e reduktimit 40% nën nivelet e vitit 1990 deri në vitin 2030, të refuzuar në objektivat e mëposhtëm specifike:

- reduktimi prej 30% krahasuar me vitin 2005, për sektorët e përfshirë në SETSH (centrale më të mëdhenj se 20mw);
- reduktim prej 43% krahasuar me vitin 2005, për sektorë që nuk përfshihen në SETSH (si transporti, bujqësia, ngrohja, mbetjet);
- rritja e konsumit të energjisë së rinovueshme deri në 27% të konsumit total;
- 27% rritje në eficiencën e energjisë, krahasuar me parashikimet e konsumit të energjisë bazuar në kriterin aktual.

INDC-ja e BE-së në kuadrin e procesit ADP-ës për Marrëveshjen e Parisit, i përkthen objektivat e mësipërm deri në vitin 2030, duke u zotuar të arrijë të paktën 40% reduktim të brendshëm në shkarkimet GES krahasuar me nivelet e vitit 1990 deri në vitin 2030¹⁴.

2.3.1 Sektori i tokës

Bujqësia luan një rol të rëndësishëm në kalimin me karbon të ulët të ekonomisë evropiane, teksa kërkesa globale për ushqim parashikohet të rritet, dhe atëherë pjesa bujqësisë në shkarkimet totale të BE-së do të rritet me rreth 1/3 deri në vitin 2050. Bujqësia do të duhet t'i reduktojë shkarkimet nga plehurat kimike, organike dhe bagëtia, dhe mund të kontribuojë për ruajtjen e CO2 në toka dhe pyje.

Në kontekstin e lëvizjes drejt një ekonomie konkurruese me karbon të ulët në vitin 2050, gjithë përdorimi i tokës duhet marrë në konsideratë në mënyrë holistike dhe LULUCF-ja duhet trajtuar në kuadrin e politikës së BE-së për klimën.

Shkarkimet dhe përthithësit e gazeve serrë që rezultojnë nga sektori LULUCF-së, nuk llogariten kundrejt objektivave të BE-së për reduktimin e shkarkimeve të gazeve me 20% për vitin 2020, sipas objektivave të VPB-së dhe SETSH-it, ndonëse ato llogariten pjesërisht kundrejt kufizimit të matshëm të shkarkimeve të BE-së dhe angazhimeve për reduktim sipas nenit 3, të Protokollit të Kiotos në UNFCCC-ë.

¹³ <http://www.eea.europa.eu/media/newsreleases/policies-put-the-eu-on>

¹⁴ http://ec.europa.eu/clima/news/docs/2015030601_eu_indc_en.pdf

Ndonëse LULUCF-ja nuk përfshihet drejtpërdrejt në arritjen e objektivave të BE-së deri në vitin 2020, nevojitet një politikë menaxhimi e qëndrueshme për sektorin agropjor për të mbështetur prodhimin e energjisë së rinovueshme nga biomasa agropjore, pa kërcënuar rolin e rëndësishëm që kanë (të përthithësve të karbonit).

Spektori LULUCF-ës në kontekstin evropian, kornizohet nga vendimi nr. 529/2013/EU i Parlamentit Evropian dhe Këshillit i 21 majit 2013, që vendos rregullat raportuese për shkarkimet e gazeve serrë dhe përthithësit, që rezultojnë nga aktivitete që lidhen me përdorimin e tokës, ndryshimin e përdorimit të tokës dhe pyjeve, si dhe informacionin lidhur me veprimet që lidhen me këto aktivitete.

Vendimi 529/2013, ndërsa nënvizon përjashtimin e LULUCF-ës nga objektivat aktualë të BE-së, njeh mundësinë për një përfshirje të ardhshme të LULUCF-ës në përpjekjen e BE-së për reduktimin eGES-it. Në këtë kuptim, vendimi propozon një sistem gradual, ku shtetet anëtare do t'i raportojnë BE-së shkarkimet dhe përthithësit nga aktivitetet LULUCF-ës, duke filluar nga viti 2015 (dhe duke iu referuar vitit 2013), për të arritur në raportimin final në vitin 2022, për vitet e përfshira në periudhën 2013–2020.

“Kudri Ligjor për Klimën dhe Energjinë 2030” u njeh sektorëve të Bujqësisë dhe LULUCF-ës multifunksionalitetin e tyre, që konsiston në sigurimin e energjisë së rinovueshme nga biomasa, duke ruajtur objektivat e sigurimit ushqimor, si dhe duke siguruar një potencial zbutjeje, falë kapacitetit të tyre si përthithës të karbonit. Këshilli i bën gjithashtu, thirrje komisionit të shqyrtojë, sesi të inkurajohet sa më mirë intensifikimi i biomasës dhe prodhimi i ushqimit në mënyrë të qëndrueshme, duke bërë optimal kontributin në zbutjen e shkarkimeve të gazeve serrë, përfshirë pyllëzimin. Pavarësisht kësaj, integrimi i sektorit me objektivin prej 40% për vitin 2030, është shtyrë në të ardhmen, kur kushtet teknike ta lejojnë, dhe para vitit 2020.

Pa dyshim, Politika e Përbashkët Bujqësore (PBB) mbetet instrumenti kryesor ligjor për zbatimin e politikave në sektorin bujqësor dhe pyjor në nivel evropian. Lidhjet me politikën që mbulojnë sektorët e bujqësisë dhe LULUCF-ës janë thelbësore. Në fakt, bujqësia ka një sfidë të dyfishtë: të prodhojë ushqim, teksa mbron njëkohësisht natyrën dhe ruan biodiversitetin. PBB-ja u siguron fermerëve asistencë financiare për t'i përshtatur metodat dhe sistemet e tyre të kultivimit, për të përballuar efektet e dëmshme të ndryshimit të klimës. Për më tepër, për të shmangur efektet negative anësore të disa praktikave bujqësore dhe për të reduktuar shkarkimet GES, BE-ja siguron stimuj për fermerët që të punojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin.

E njohur si “shtylla e dytë” e PBB-së, Politika e Zhvillimit Rural e BE-së është përmirësuar për periudhën 2014–2020, përmes procesit të një reforme më të gjerë të PBB-së. Në përputhje me “Europa 2020” dhe objektivat e përgjithshëm të PBB-së, mund të identifikohen tre objektiva afatgjatë strategjike për politikën e zhvillimit rural të BE-së për periudhën 2014–2020: nxitja e konkurrencës në bujqësi; garantimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe veprimi për klimën; arritja e një zhvillimi territorial të balancuar të ekonomive dhe komuniteteve rurale, përfshirë krijimin dhe mbajtjen e punësimit.

2.3.2 Sektori i energjisë

Zbutja e ndryshimeve klimatike luan një rol të madh në Strategjinë e Energjisë së BE-së, kryesisht përmes rëndësisë që i jepet eficiencës së energjisë dhe burimeve të rinovueshme të energjisë. Në veçanti, janë marrë në konsideratë dy politika afatshkurtra dhe afatmesme: 2020 dhe 2030. Deri në vitin 2020, BE-ja synon të plotësojë 20% të nevojave për energji nga burimet e rinovueshme, dhe të zbatojë një rritje prej 20% të eficiencës së energjisë, kundrejt skenarit bazë të zhvillimit. Deri në vitin 2030, BE-ja synon një “reduktim prej 40% në shkarkimet e gazeve serrë krahasuar me nivelet e vitit 1990; të paktën një përqindje prej 27% të konsumit të energjisë së rinovueshme; të paktën 27% kursim energjie, krahasuar me skenarin e biznesit si zakonisht”.¹⁵

Direktiva e vitit 2012 për Eficiencën e Energjisë (DEE 2012/27/EU), është instrumenti kryesor politik evropian, që specifikon kudrin e përgjithshëm politik, me synim arritjen e

¹⁵<http://ec.europa.eu/energy/en/topics/energy-strategy/2030-energy-strategy>

objektivit për kursimin e energjisë në 20% deri në vitin 2020¹⁶, dhe përcakton një kuadër të përbashkët masash për këtë qëllim. Direktiva plotësoi kuadrin e politikave të BE-së për eficiencën e energjisë, përfshirë Direktivën e Performancës Energjetike të Ndërtesave, Direktivat Eco-dizajn dhe Etiketimin e Energjisë.

Përjasja e politikës DEE-së specifikohet kryesisht në nenin 7-të, dhe pritet të japë më shumë rezultat, sesa gjysma e kursimit të kërkuar të energjisë. Në mënyrë specifike, ajo kërkon që Shtetet Anëtare të fusin skema të detyrueshme për eficiencën e energjisë¹⁷ (EEOs) apo masa alternative politike me synim arritjen e një kursimi vjetor prej 1.5% për shitjet e energjisë konsumatorëve fundorë, të gjithë shpërndarësve të energjisë apo kompanive me pakicë. Në zbatimin e kësaj mase, Shtetet Anëtare mund të zgjedhin nga një gamë e gjerë masash politike dhe masash individuale, për përmirësimin e eficiencës së energjisë.

Në mënyrë analoge, Direktiva e Energjiave të Rinovueshme e vitit 2009 përcakton një politikë të përgjithshme për prodhimin dhe promovimin e energjisë nga burimet e rinovueshme në BE. Ajo kërkon nga BE-ja të përmbushë të paktën 20% të nevojave totale për energji nga burimet e rinovueshme deri në vitin 2020 – që do të arrihet përmes arritjes së objektivave individuale kombëtare. Gjithë vendet e BE-së duhet të garantojnë, gjithashtu, që të paktën 10% e lëndëve djegëse për transport, të vijnë nga burimet e rinovueshme – jo medoemos biokarbure – deri në vitin 2020. Sërish, Direktiva specifikon objektivat për energjinë e rinovueshme për çdo vend, duke marrë parasysh pikën e nisjes dhe potencialin e përgjithshëm për burime të rinovueshme. Objektivat shkojnë nga 10% në Maltë, në 49% në Suedi. Shtetet anëtare janë sërish përgjegjëse për të gjetur se si do t'i përmbushin këta objektiva, dhe u kërkohet të specifikojnë kursin e përgjithshëm të politikës së tyre për energjinë e rinovueshme, në plane veprimi kombëtare për energjinë e rinovueshme. Një opsion që u jepet vendeve anëtare përfshin bashkëpunimin për arritjen e objektivave të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (BRE), përmes mekanizmave të bashkëpunimit, si transferimi statistikor i energjisë së rinovueshme, projektet e përbashkëta për energjinë e rinovueshme dhe skemat e përbashkëta të mbështetjes për energjinë e rinovueshme. Janë hartuar dispozita specifike për biokarburet, meqë ato janë vendimtare për t'i ndihmuar vendet e BE-së të plotësojnë objektivin e tyre prej 10% për burimet e rinovueshme në transport, si dhe duhet t'i përgjigjen kriterit të qëndrueshmërisë për gjithë biokarburet e prodhuara, po të konsumuara në BE, për të garantuar që janë prodhuar në mënyrë të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin.

Së fundi, mjeti i tretë i madh i politikës lidhur me zbutjen e efekteve nga ndryshimet klimatike në sektorin e energjisë është gjithëpërfshirës dhe është sigurisht ETS (Sistemi i Tregtimit të Emisioneve). Ndryshe nga politika e eficiencës së energjisë, SETSH-i nga përkufizimi, duhet zbatuar në nivel ndërkombëtar. ETS ka qenë vitet e fundit objekt kritikash serioze, për shkak të mbifurnizimit të lejeve, duke rezultuar me çmimet aktuale (të ulëta deri në 6 €/tCO₂eq) që janë shumë poshtë asaj çka nevojitet për të siguruar stimujt e duhur për dekarbonizim. Po kryhet një rishikim i madh i sistemit dhe konkluzionet e tij priten në vitin 2018. Fokusi kryesor i këtij procesi reforme do të jetë afrimi i këtij instrumenti me 21 zotimet e KeP-it. Sipas disa vëzhguesve, kjo do të kërkojë një reduktim të madh të lejeve në treg, me një normë prej rreth 4%¹⁸ në vit. Kjo varet, sigurisht, nga roli që luajnë masa të tjera dhe nga kontributi i reduktimeve të shkarkimeve

¹⁶ Duke pasur parasysh objektivin e eficiencës së energjisë prej 27% deri në vitin 2030 të miratuar nga vendet e BE-së në tetor 2014 dhe (propozimin e Komisionit për rritjen e tij deri në 30%), Bashkimi Evropian ka hapur konsultime për rishikimin e Direktivës së Eficiencës së Energjisë (EED 2012/27/EU), duke kërkuar kontribute dhe komente nga palët e interesuara, përfshirë autoritetet publike, qytetarët, industrinë, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Një raport mbi këtë kërkesë pritet të nxirret në fund të vitit 2016.

¹⁷ Një skemë detyrimi, siç parashikohet në EED, vendos një detyrim për kompanitë e energjisë dhe u kërkon atyre të arrijnë kursime vjetore të energjisë prej 1.5% të shitjeve vjetore të konsumatorët fundorë. Me qëllim që të arrihet ky objektivi, kompanitë duhet të marrin masa që t'i ndihmojnë konsumatorët fundorë të përmirësojnë eficiencën e energjisë.

¹⁸ <http://carbonmarketwatch.org/eu-ets-reform-must-tighten-screws-on-the-number-of-pollution-permits/>

LULUCF-ë, por nënvizion magnitudën e rregullimit që nevojitet në mënyrë që ETS të përballojë objektivat e përforcuar të masave zbutëse të BE-së.

2.3.3 Sektori i transportit

Meqë rritja e lëvizjes në BE është e pashmangshme, masat për frenimin e shkarkimeve GES janë thelbësore në kuadrin e “Planit për Ekonomi me Karbon të Ulët deri në vitin 2050”. Dokumenti i Bardhë “Plani për një Zonë Unike Evropiane Transporti – Drejt një sistemi transporti konkurrues dhe efikas nga ana e burimeve”¹⁹ përmban 40 nisma konkrete për dekadën e ardhshme, për të ndërtuar një sistem transporti konkurrues që do të rrisë lëvizjen, do të largojë barrierat kryesore në fushat kyçe, si dhe do të nxisë zhvillimin dhe punësimin. Njëkohësisht, propozimet vështirë se do ta reduktojnë varësinë e Evropës nga nafta e importuar dhe do t'i reduktojnë shkarkimet GESTë sektorit të transportit me 60% deri në vitin 2050.

Duke nisur nga deklarata se “ulja e lëvizjes nuk është opsion” sfida është të zbutet varësia e transportit nga nafta, pa sakrifikuar efikasitetin. Mënyra për ta zhvilluar këtë ide është ndihma për krijimin e modeleve të reja të transportit, si dërgimi i vëllimeve të mëdha të mallrave dhe /ose pasagjerëve në destinacion me kombinimin më efikas të mënyrave që mund të mbështesin ndryshimin e paradigmes: efienca e energjisë, optimizimi i performancave operative dhe teknologjitë e reja. Prandaj, transformimi i përbashkët, i integruar dhe efikas i sektorit të transportit në nivel evropian, duhet rregulluar në mënyrë harmonike tani e tutje, duke qenë se një zhvillim vendor inkohorent mund të komprometojë rezultatet në fushat e përbashkëta.

Në Dokumentin e Bardhë përshkruhen dhjetë synimet specifike për një sistem transporti konkurrues dhe efikas në lidhje me burimet, si dhe për arritjen e objektivit për reduktimin e shkarkimeve GES me 60%. Objektivat specifikë lidhur me një Zonë Unike Transporti të Dokumentit të Bardhë janë mjaft ambicioze:

- Deri në vitin 2030, 30% e transportit rrugor me distancë mbi 300 km duhet të zhvendoset në mënyra të tjera, si transporti hekurudhor apo detar, dhe më shumë se 50% deri në vitin 2050.

- Deri në vitin 2050, duhet përfunduar rrjeti hekurudhor evropian shpejtësisë së lartë dhe një rrjet i dendur hekurudhor duhet krijuar në gjithë shtetet anëtare. Deri në vitin 2050, pjesa më e madhe e lëvizjes së pasagjerëve për distancat mesatare të transportit duhet të bëhet me hekurudhë.

- Deri në vitin 2030, duhet zbatuar një Rrjet Transporti TEN-T plotësisht funksional dhe multimodal në mbarë BE-në, me cilësi dhe kapacitet rrjeti të lartë deri në vitin 2050, si dhe duhet vënë në zbatim një numër korrespondues shërbimesh informuese.

- Deri në vitin 2050, gjithë aeroportet kryesore duhen lidhur me rrjetin hekurudhor, mundësisht me linja me shpejtësi të lartë.

- Deri në vitin 2050, duhet garantuar që gjithë portet kryesore detare të lidhen si duhet me rrjetin hekurudhor të transportit të mallrave dhe aty ku është e mundur, me sistemin e brendshëm të lumenjve.

Në kuadrin e “Paketës së BE-së për Klimën dhe Energjinë 2020”, sektori i transportit është marrë në konsideratë përmes Direktivës për Cilësinë e Lëndëve Djegëse (DCLD, Direktiva 2009/30/EC), Direktiva për Energjinë e Rinovueshme (DER, Direktiva 2009/28/EC) dhe objektivat Mjetet CO₂ (Reg. EU 333/2014).

DCLD-ja (direktiva 2009/30/EC) për kontrollin e shkarkimeve GES në nivel BE-je, kërkon që intensiteti i gazeve serrë të shkaktuara nga përdorimi i lëndëve djegëse nga mjetet, të reduktohet deri në 6% deri në vitin 2020. Kjo zbatohet për gjithë benzinën, naftën dhe biokarburet që përdoren në transportin rrugor, si dhe gazoilin e përdorur në makineritë jo për transport, çka në të kaluarën ka treguar rezultate me rëndësi në reduktimin e përmbajtjes së sulfurit të lëndëve djegëse. Objektiv i DER-it (direktiva 2009/28/EC) synon që 10% e energjisë që konsumohet për transport, të gjenerohet nga burime të energjisë së rinovueshme deri në vitin

¹⁹ Dokumenti i Bardhë – Plani për një Zonë Unike Evropiane Transporti – Drejt një sistemi transporti konkurrues dhe efikas nga ana e burimeve – COM(2011) 144 final (Bruksel, 28.3.2011). URL: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2011:0144:FIN:en:PDF>

2020. Objektivat për CO₂ përcaktohen në Rregulloren (BE 333/2014) për shitjet e mjeteve të reja në vitin 2021. Direktiva për Etiketimin e Makinave (direktiva 1999/94/EC), që ka qenë një instrument interesant për t'iu qasur ndërgjegjësimit të konsumatorëve privatë për përdorimin e lëndëve djegëse dhe shkarkimit të CO₂ dhe për politikën e kërkesës, konsiderohet një masë e rëndësishme plotësuese për t'i ndihmuar prodhuesit e makinave të përmbushin objektivat e tyre specifike për shkarkimet e CO₂, siç përcaktohen në Rregullore.

Me “Paketën e Lëvizjes Urbane”, Komisioni forcon masat mbështetëse në fushën e transportit urban, duke darë eksperiencat, duke treguar praktikat më të mira, duke nxitur bashkëpunimin, duke siguruar mbështetje të përcaktuara financiare, duke e fokusuar kërkimin dhe risinë të gjetja e zgjidhjeve për sfidat e lëvizjes urbane, duke përfshirë shtetet anëtare, si dhe duke nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar. Planifikimi i Lëvizjes së Qëndrueshme Urbane²⁰ është tema më e rëndësishme në Paketën e Lëvizjes Urbane të Komisionit. Koncepti i saj merr në konsideratë zonën urbane funksionale dhe parashikon që planet të hartohen në bashkëpunim, në fusha dhe sektorë të ndryshëm të politikave; në nivele të ndryshme të qeverisë dhe administratës, si dhe në bashkëpunim me qytetarët dhe palë të tjera të interesuara.

Objektivat politikë në zhvillimin urban të BE-së për periudhën 2014–2020, marrin në konsideratë masa të rëndësishme për lëvizjen e qëndrueshme urbane. Trajtimi i çështjes së reduktimit të shkarkimeve nga transporti, përmes mbështetjes së planifikimit dhe infrastrukturës urbane, është pa dyshim një përfaqëse fituese për një Evropë të gjelbër. Promovimi i transportit të qëndrueshëm dhe heqja e pengesave në infrastrukturat kyçe të transportit është një nga njëmbëdhjetë objektivat tematikë për politikën e kohezionit për periudhën 2014–2020. Mbështetja e Fondit Evropian për Zhvillim Rajonal (ERDF) dhe Fondit të Kohezionit siguron bashkëfinancimin e BE-së, për projekte që lidhen me përparësitë e mëposhtme të investimeve, në kuadrin e objektivit tematik 7-të:

- Investimi në rrjetin Transevropian të Transportit (TEN-T).
- Nxitja e lëvizjes rajonale, duke lidhur nyjat dytësore dhe terciare me infrastrukturën TEN-T përfshirë nyjat multimodale.
- Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemeve të transportit miqësore me mjedisin (përfshirë zhurmat e ulëta) dhe me nivele karboni të ulët, përfshirë transportin e brendshëm lumor dhe detar, portet lidhjet multimodale dhe infrastrukturën e aeroporteve, për të promovuar lëvizjen e qëndrueshme rajonale dhe vendore.
- Zhvillimi dhe rehabilitimi i sistemeve hekurudhore gjithëpërfshirëse, me cilësi të larta dhe ndëroperuese, si dhe nxitja e masave për reduktimin e zhurmës.

Për më tepër, BE-ja mbështet investimet e finalizuara për zhvendosjen drejt një ekonomie me karbon të ulët në sektorët e transportit, veçanërisht për të nxitur lëvizjen e qëndrueshme multimodale urbane (objektivi tematik 4). Për t'u siguruar që këto investime të kenë ndikimin maksimal, vëmendje e veçantë i kushtohet, gjatë periudhës 2014–2020, nevojës për të siguruar një mjedis të shëndetshëm strategjik.

Një Komunikatë Evropiane e kohëve të fundit (501/2016) i qaset në mënyrë specifike, kuadrin të Lëvizjes me Shkarkime të Ulëta, përmes objektivave kyç, si: (I) efikasitet më i lartë i sistemit të transportit, (II) energji me alternative shkarkimesh të ulëta për transportin, dhe (III) mjete me shkarkime të ulëta deri në zero.

2.4 Monitorimi dhe raportimi i detyrimeve në kuadrin e UNFCCC-së dhe BE-së

Shqipëria si vend kandidat për anëtarësim në BE, do ta ndryshojë statusin nga jopalë e aneksit I të UNFCCC-ës në aneksin I, me BE-në. Si palë e aneksit I të UNFCCC-ës dhe aneksit B të Protokollit të Kiotos, BE-së dhe shteteve anëtare u kërkohet të raportojnë:

- çdo vit - për shkarkimet e gazeve serrë përmes inventarëve të gazeve serrë,
- rregullisht - për politikën e ndryshimit të klimës, masat dhe progresin drejt objektivave, përmes “raportëve dyvjeçarë”, për të nxitur raportimin për objektivat e zbutjes dhe sigurimit e

²⁰ COM(2013) 913 final – aneks: një koncept për planet e zhvillimit të qëndrueshëm urban – Së bashku drejt një lëvizje urbane konkurruese dhe efikase në lidhje me burimet)

mbështetjes, si dhe 'komunikimeve kombëtare' çdo katër vjet, me të dhëna për shkarkimet dhe përthithjet; politikat dhe masat për reduktimin e shkarkimeve; sigurimin e mbështetjes financiare, teknologjike dhe për ndërtim kapaciteti; aktivitete të tjera të ndërmarra për zbatimin e Konventës.

Raportimi mbulon:

- Shkarkimet e gjithë gazeve serrë nga gjithë sektorët: energjia; proceset industriale; përdorimi i tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pylltaria (LULUCF); mbetjet; bujqësia etj.

- Parashikimet, politikat dhe masat për reduktimin e shkarkimeve të gazeve serrë.

- Masat kombëtare për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike.

- Strategjitë për karbon të ulët.

- Mbështetje financiare dhe teknike për vendet në zhvillim dhe angazhime të ngjashme në kuadrin e Marrëveshjes së Kopenhagës 2009 dhe Marrëveshjes së Kankunit 2010.

- Përdorimi nga qeveritë kombëtare i të ardhurave nga tenderimi i lejeve në sistemin e BE-së për shkëmbimin e shkarkimeve (ato janë angazhuar të shpenzojnë të paktën gjysmën e këtyre të ardhura për masa për klimën në BE dhe jashtë).

Zbatimi i regjistrit kombëtar kërkohet të marrë pjesë në mekanizmat e Kiotos. Çdo regjistër vlerësohet për të përcaktuar, nëse plotësohen kërkesat e duhura, dhe rezultatet kalohen në formën e një Raporti të Pavarur Fillestar Vlerësimi (IAR) dhe Raporteve të Tjera të Pavarura Standarde të Vlerësimit (SIARs), që vlerësojnë plotësinë e informacionit të raportuar, përmbajtjen dhe thelbin e informacionit që vënë palët në dispozicion për vlerësim.

Për momentin, si jopalë e aneksit I, Shqipërisë i kërkohet të paraqesë komunikata kombëtare (NCs) dhe raporte dyvjeçare të përditësuara (BURs). Verifikimi i raporteve trajtohet në nivel ndërkombëtar, përmes procesit të konsultimit ndërkombëtar dhe analizave (ICA) të BURs. Kjo për të rritur transparencën e veprimeve zbutëse dhe efektet e tyre, si dhe mbështetjen e kërkuar dhe të marrë.

Për më tepër, gjithë vendeve të BE-së u kërkohet të monitorojnë shkarkimet e tyre në kuadrin e mekanizmit të BE-së për monitorimin e gazeve serrë, që përcakton rregullat e brendshme raportuese të BE-së, bazuar në detyrimet e vendosura në mënyrë ndërkombëtare (vendimi 525/2013/EU). Sipas vendimit 525/2013/EU dhe rregullores së tij zbatuese (749/2014), kërkesat kryesore të mekanizmit monitorues për raportimin e shkarkimeve GES dhe informacionit lidhur me ndryshimet klimatike janë:

- Raporti i parë (9 janar 2015) mbi zbatimin e strategjive të zhvillimit me karbon të ulët (LDCS) dhe përditësime çdo vit (15 mars) për zbatimin e LDCS-ë.

- Inventari vjetor i GES-it (çdo vit më 15 janar).

- Raport vjetor (çdo vit më 15 janar) për sistemin kombëtar inventarizues përfshirë modifikime të mundshme, sipas rregullores së zbatimit nr. 749/2014 (neni 5).

- Raport vjetor për inventarin e vlerësuar dhe të përafërt të GES-it (çdo vit më 31 korrik).

- Krijimi dhe administrimi i regjistrave të shkarkimeve GES (neni 10).

- Komunikimi dhe raportimi mbi politikat dhe masat (çdo dy vjet, duke nisur nga 15 marsi 2015).

- Komunikimi dhe raportimi mbi parashikimet për shkarkimet GES (çdo dy vjet, duke nisur nga 15 marsi 2015).

- Raport dhe komunikatë mbi masat për adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike (strategjitë dheplanet) (çdo katër vjet, duke nisur nga 15 marsi 2015).

- Raport vjetor dhe komunikatë mbi mbështetjen financiare dhe teknologjike për vendet në zhvillim (çdo vit më 30 shtator).

- Ngritja e sistemeve kombëtare për politikat, masat dhe parashikimet (9 korrik 2016).

Në veçanti për sektorin LULUCF-ës, sipas kërkesave të vendimit nr. 529/2013/EU, shtetet anëtare do të përgatisin dhe mbajnë raporte për gjithë shkarkimet dhe përthithjen e tyre, që rezultojnë nga aktivitetet e mëposhtme: pyllëzimi/ripyllëzimi, shpyllëzimi, menaxhimi i pyjeve. Veç kësaj, Shtetet Anëtare, para 1 janarit 2022, do t'i sigurojnë dhe paraqesin komisionit deri më 15 mars, çdo vit, vlerësime fillestare, paraprake dhe jodetyruese vjetore të shkarkimeve dhe

përthithjes së tyre nga: menaxhimi i tokave bujqësore dhe menaxhimi i kullotave. Për çdo periudhë raportimi, shtetet anëtare mund të përgatisin dhe të mbajnë raportet e shkarkimeve dhe të përthithjes së tyre, që rezultojnë nga: ribimësimi, drenazhi i ligatinave dhe rikthimi i ujit në ligatina.

Gjatë përgatitjes dhe mbajtjes së raporteve të tyre, shtetet anëtare do të sigurojnë transparencë, saktësi, qëndrueshmëri, krahasueshmëri dhe plotësi (TACCC), kur vlerësojnë shkarkimet dhe përthithjen e tyre që lidhen me këto aktivitete.

2.5 Politika shqiptare për ndryshimet klimatike

Parlamenti Shqiptar ka ratifikuar Marrëveshjen e Parisit më 14 korrik 2016, duke hyrë në epokën e re të procesit të politikave ndërkombëtare për klimën. Shqipëria iu bashkua Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimin e Klimës (UNFCCC) në vitin 1995, dhe Protokollit të Kiotos në vitin 2005. Si jovend i aneksit I, të UNFCCC-ës, Shqipëria nuk ka detyrime të përcaktuara për reduktimin e shkarkimeve të gazeve serrë; megjithatë, Shqipëria ka detyrimi²¹ t'i komunikojë KeP-it, informacionin përkatës për zbatimin e Konventës, në lidhje me shkarkimet dhe përthithjen. Qeveria e Shqipërisë ka bërë hapa të mëdha përpara drejt zbatimit të UNFCCC-ës, me përgatitjen e tri komunikatave kombëtare (2002, 2009, 2016).

Shqipëria ka nisur procesin e ndryshimit të statusit, nga vend në zhvillim - në vend i zhvilluar, në kontekstin e UNFCCC-ës. Ky proces është pjesë përbërëse e procesit të integritimit në Bashkimin Evropian, dhe përfshin zhvillimin e kapaciteteve në nivel kombëtar për monitorimin dhe raportimin vjetor të GES-it, formulimin dhe zbatimin e politikave për reduktimin e GES-it dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, përafrimin dhe zbatimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian për ndryshimin e klimës.

Në përputhje me objektivat e BE-së, “Paketa e Klimës dhe Energjisë 2020”, Shqipëria ka përcaktuar objektiva sasiorë lidhur me eficiencën e energjisë (rritje me 9%) dhe burimet e energjisë së rinovueshme (rritje deri 38%), në kuadrin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Këta objektiva aktualisht po rishikohen në kuadrin e rishikimeve 2 dhe 3 të Planeve Kombëtare të Veprimit të Eficiencës së Energjisë.

Në vitin 2014, me urdhrin e Kryeministrit nr. 155, datë 25.4.2014, u ngrit një grup ndërmintor pune, për koordinimin e detyrave të ministrive, sipas detyrimeve të vendit në kuadrin e UNFCCC-ës. Grupi i kryesuar nga zëvendësministri i Mjedisit, përfshin përfaqësuesit e 12 ministrive shqiptare, dhe ka mandat, ndër të tjera, për hartimin e politikave dhe strategjive, si dhe koordinimin në nivel ndërinstitucional të zbatimit të veprimeve që lidhen me ndryshimin e klimës.

Shqipëria ka paraqitur INDC-në, në kuadrin e procesit të Marrëveshjes së Parisit, në shtator 2015, duke u angazhuar për reduktimin e shkarkimeve CO₂, krahasuar me skenarin bazë deri në vitin 2030 me 11.5%. Ky reduktim nënkupton reduktim të shkarkimeve të dyoksidit të karbonit me 708 kt deri në vitin 2030.

2.6 Gjendja e ekonomisë shqiptare

Gjatë dekadës së kaluar ekonomia shqiptare ka përjetuar modele të ndryshme zhvillimi. Siç raportohet në KTK-në, pas vitit 2002, ekonomia shqiptare iu nënshtua një periudhe zhvillimi ekonomik në rritje, duke arritur nivelin më të lartë në vitin 2008 (7.5%). Pas këtij viti, ekonomia iu nënshtua një zhvillimi në rënie, përkatësisht 2.8% në vitin 2011, 1.3% në vitin 2012, duke regjistruar nivelin më të ulët në vitin 2013 (0.4%). Shkaqet i janë atribuar jo vetëm krizave ekonomike globale, por edhe politikave të brendshme dhe një rruge zhvillimi të karakterizuar gjithashtu, nga një performancë e dobët e investimeve dhe konsumit privat. Ky model nuk parashikohet të vazhdojë. Megjithatë, sipas Perspektivës Ekonomike Botërore të Fondit Ndërkombëtar Monetar(IMF), pritet që ekonomia të rritet me një normë rritjeje prej 3.4% në vitin 2019-22.

²¹Neni 2 dhe 4.4 i UNFCCC

²²FMN, Raporti Vjetor 2014

Në terma sektorialë, zhvillimi i ekonomisë shqiptare u nxit nga rritja e sektorit të shërbimeve dhe sektorëve të industrisë.

Sektori i shërbimit, si publik ashtu dhe privat, është një ndër sektorët më të rëndësishëm dhe më dinamikë të ekonomisë shqiptare, që zë më shumë se 60% të vlerës së shtuar totale. Fokusi kryesor ekonomik i këtij sektori është aktiviteti tregtar. Sipas Bankës Kombëtare Shqiptare, pjesa më e madhe e rritjes ekonomike gjatë viteve i është atribuar zhvillimit të këtij sektorit dhe vlerësohet përmes indeksit të transaksioneve të korporatave, që mbulojnë kompanitë tregtare, hotelet dhe restorantet, transportin, shërbimet e telekomunikacionit dhe shërbime të tjera. Në vitin 2010, vlera e shtuar e gjeneruar nga sektori, kontribuoi me 3.2 pikë përqindje, në rritjen mesatare vjetore të PBB-ës.

Po ashtu sektori i industrisë–përfshirë nënsektorët e tij: metalurgjinë, industrinë kimike, materialet e ndërtimit, minierat, ushqimin/pijet/duhanin, tekstilet/lëkurët/këpucët, pyjet/letrën/shtypshkrimin/industrinë mekanike–ka regjistruar zhvillime shumë pozitive gjatë dekadës së fundit, duke e bërë sektorin industrial të renditet i dyti nga rëndësia, pas sektorit të shërbimit. Kontributi pozitiv i prodhimit industrial në rritjen ekonomike, reflektohet në numrin e shtuar të punonjësve në këtë sektor.

Po ashtu sektori i transportit është rritur me shpejtësi që prej vitit 2000. Numri i mjeteve në rrugë është rritur, ndërsa infrastrukturat e transportit janë përmirësuar. Rrjedhimisht, ngarkesa totale e trafikut për transportin e mallrave dhe pasagjerëve është rritur më shumë.

Sektori i bujqësisë luan një rol me rëndësi në ekonominë shqiptare, duke kontribuar përafërsisht me 20% të vlerës së shtuar në ekonomi. Ndonëse emigrimi dhe urbanizimi i dekadës së fundit ka sjellë një zhvendosje strukturore nga bujqësia drejt industrisë dhe shërbimit, bujqësia mbetet një nga sektorët më të mëdhenj dhe më të rëndësishëm në Shqipëri. Bujqësia është burimi kryesor i punësimit dhe të ardhurave – sidomos në zonat rurale të fshatit – dhe përfaqëson 22.6% të PBB²³-ës totale në vitin 2014, ndërsa zë rreth gjysmën e punësimit total (INSTAT 2013). Megjithatë, zhvillimi i sektorit ende ndikohet nga disa probleme strukturore, si teknologjia e dobët, investimet e ulëta dhe të lidhura, si dhe produktiviteti total i ulët krahasuar me mesataret e BE-së.

Zhvendosja në strukturën ekonomike të vendit nga bujqësia dhe sektori primar në përgjithësi, te sektori i shërbimit më pak intensiv nga ana e energjisë, si dhe prodhimi i produkteve me vlera më të larta, reflektohet në evolucionin e intensitetit të energjisë në Shqipëri që ishte më shumë se dyfishi i mesatares së BE-së në vitin 2000, por që atëherë ka rënë. Në një shkallë më të ulët, rënia e intensitetit të energjisë mund t'i atribuohet përmirësimit të efciencës së energjisë (EE) dhe zbatimit të masave përkatëse për izolimin termik të stokut të banesave, ndriçimin efikas dhe masat e tjera EE.

Në tabelën 2 paraqitet një përmbledhje e të dhënave për modelet e PBB-ës gjatë dy dekadave të fundit.

Tabela 2 – Përmbledhje e modeleve të PBB-së për Shqipërinë, 1996–2013

	1996	2002	2006	2008	2010	2013
PBB (milionë lekë)	346,403.2	622,710.8	882,208.8	1,089,293.1	1,222,462.1	1,445,765.5*
PBB për kokë (mijëra lekë)	103.6	190.8	280	342.3	387.5	480*
Rritja e PBB-së (%)	9.1	4.2	5	7.5	3.8	0.4
Norma e inflacionit (%)	-	-	2.4	3.4	3.6	1.9

Burimi: Tabela në KTN – Përshtatur nga Banka e Shqipërisë (2006, 2008, 2010, 2013) dhe Baza e të Dhënave Statistikore e Bankës së Shqipërisë (2014)

* **Burimi:** Banka Botërore

²³<http://www.worldbank.org/en/country/albania/overview>

2.6.1 Sektori i energjisë

Furnizimi kryesor i Shqipërisë me energji, që arrin në rreth 83.27 PJ (1989 Ktoe) në vitin 2012 (Burimi: IEA), dominohet nga nafta, hidrocentralet dhe biomasa, siç tregohet në figurën 3. Sektori energjetik i vendit mbështetet shumë në importet e naftës, qymyrit dhe energjisë elektrike (totali rreth 57 PJ).




Figura 3 – Furnizimi kryesor me energji në Shqipëri nga burimet vendore (ktoe)
(Burimi: AKBN Bilanci energjetik 2010–2014)

Vitet e fundit evolucioni ka qenë drejt një rritje të moderuar të furnizimit primar me energji që prej vitit 2012, pa ndryshime të mëdha në terma të pjesëve relative të vektorëve të ndryshëm të energjisë. Variacioni në hidrocentrale duket se kompensohet kryesisht nga importet e shtuara të naftës dhe produkteve të saj.

Një përmbledhje e mirë e fluksit energjetik të vendit mund të nxirret nga diagrami i fluksit të energjisë që tregohet më poshtë (figura 4).




Figura 4 – Fluksi i energjisë në Shqipëri (burimi: IEA në bazë të të dhënave të AKBN-së)

Karakteristikat kryesore të sektorëve energjetikë shqiptarë janë si më poshtë:

- Varësia e madhe nga importet e naftës;
- Fokusi i madh te hidrocentralet;
- Pjesa e madhe e sektorit të transportit;
- Mosekzistenca *defakto* e burimeve të gazit natyror.

Lidhur me nevojat për **energji elektrike**, historikisht ato janë plotësuar pothuaj ekskluzivisht nga hidrocentralet (figura 4). Kapaciteti total i instaluar i energjisë në Shqipëri, arrin në 1'895'000 mw (në fund të vitit 2015), i dominuar nga hidrocentralet. Kjo vlerë konfirmohet edhe nga raporti i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE) për vitin 2015, që jep të dhëna për sektorin energjetik shqiptar, me kapacitetin total të instaluar të gjenerimit të energjisë në Shqipëri në vitin 2009 në vlerën 1659 mw, nga e cila 86% është hidroelektrike. Hidroelektriciteti prodhohet nga tre centrale të mëdha në veri të vendit, në lumin Drin: Komani (600 mw), Fierza (500 mw) dhe Vau i Dejës (250 mw).

Për këtë arsye, burimet ujore luajnë rol vendimtar në sektorin e energjisë në Shqipëri, dhe periudhat e thatësirës mund të çojnë në rënie të menjëhershme të prodhimit, siç ndodhi mes vitit 2000 dhe 2002, si dhe sërish në vitin 2007. Po ashtu, duhet vënë në dukje roli pozitiv në gjenerimin e energjisë elektrike gjatë viteve me reshje, që jo vetëm plotëson kërkesën e brendshme për energji elektrike, por gjithashtu mund të eksportohet (për shembull, në vitin 2010). Potencial total i hidroenergjisë vlerësohet në 4500 mw (me gjenerim total të energjisë elektrike të barabartë me 50-58 PJ/vit). Aktualisht vendi ka shfrytëzuar vetëm 35% të potencialit të tij hidroenergjetik. Hidrocentralet të vendosura dhe të lidhura në kaskadën e lumit Drin, përfaqësojnë rreth 90% të gjenerimit total të energjisë elektrike në vend. Në vitin 2015, 75.9% e energjisë elektrike u prodhua në vend nga tre hidrocentrale publike të kaskadës së lumit Drin dhe diferenca prej 24.1% u prodhua nga hidrocentrale private dhe me koncesion(të dhëna të ERE-s).




Figura 5 – Furnizimi total me energji elektrike në Shqipëri (GWh/vit) (Burimi: AKBN, 2013)

Figura 5, më lart, tregon furnizimin e Shqipërisë me energji elektrike në periudhën 1985-2013. Ndryshimi në prodhimin e energjisë elektrike mund t'i atribuohet prodhimit të luhatur

hidroenergjetik. Termocentralet me naftë kanë kontribuar shumë në prodhimin e energjisë në vend deri në vitin 1990, por më pas prodhimi i tyre u reduktua shumë dhe shumica e tyre aktualisht janë jashtë përdorimit. Gjatë vitit 2015, nuk u prodhuan energji elektrike nga termocentrali i Vlorës (TEC). Ky TEC pritej të vihej në punë në vitin 2011, por për shkak të problemeve teknike të gjetura gjatë fazës së testimit, Vlorë TEC ende nuk është vënë në punë. Konvertimi i Vlorës (TEC) në gaz natyror pritet në planet aktuale për centralin, duke pasur parasysh ndërtimin e TAP-it (Gazsjellësit Trans-Adriatik), që mund të sjellë diversifikimin e burimeve të energjisë, duke reduktuar varësinë nga kushtet hidrologjike.

Zgjerimi i ardhshëm i kapacitetit hidroenergjetik planifikohet kryesisht, përgjatë lumenjve Mat, Vjosë, Devoll dhe Bistricë. Veç kësaj, Qeveria shqiptare po fokusohet në diversifikimin e furnizimit me energji dhe promovimin e burimeve të tjera të rinovueshme të energjisë, si biomasa, energjia diellore dhe ajo e erës.

Për të mbuluar nevojat, Shqipëria importon energji elektrike nga vendet fqinje, ndonëse importet kanë rënë në mënyrë progresive gjatë dhjetë viteve të fundit, duke ndjekur rritjen e gjenerimit vendas të energjisë dhe reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike (nga 45.04% në vitin 2013 në 31.34% në fund të vitit 2015), pas disa masave të marra nga qeveria për lehtësimin e zbatimit të projektit “Rimëkëmbja e Sektorit Energjetik” dhe punës riorganizuese të kohëve të fundit të kryer në rrjetet transmetim-shpërndarjes, gjatë viteve 2014-2015.

Në vitin 2012, konsumi total final me energji në Shqipëri arriti 79.7 PJ (Figura 4), ku energjia elektrike dhe produktet e naftës zunë afërsisht 80%. Analiza e konsumit final të energjisë nga lëndët djegëse zbulon mbizotërimin e produkteve të naftës. Nga vitit 1990 deri në 1995, mund të vërehet një rënie e mprehtë në kontributin e lëndëve djegëse të ngurta, pra qymyrit dhe gazit natyror. Qymyri u përdor për të mbuluar një pjesë të madhe të konsumit total final të vendit, por pjesa e tij u reduktua në fillim të vitit 1990. Biomasa, kryesisht dru zjarri – ka luajtur një rol me rëndësi ndër vite, duke qenë burimi kryesor i energjisë së përdorur për ngrohje mjedisi dhe gatim, kryesisht në banesat rurale.




Figura 6 – Konsumi Final i Energjisë nga Lëndët Djegëse (Burimi: AKBN, 2012)




Figura 7 – Konsumi Final i Energjisë sipas Sektorëve (Burimi: AKBN, 2012)




Figura 8 – Konsumi Final i Energjisë sipas Lëndës Djegëse (Burimi: AKBN – Balancat Vjetore të Energjisë –përfshirë gjithë produktet e naftës)




Figura 9 – Konsumi Final i Energjisë sipas Lëndës Djegëse (Burimi: AKBN – Balancat Vjetore të Energjisë – përfshirë vetëm produktet e naftës të përdorura për qëllime të energjisë)




Figura 10 – Konsumi Final i Energjisë sipas Lëndës Djegëse (Burimi: AKBN – Balancat Vjetore të Energjisë)




Figura 11 – Pjesët e Konsumit Final të Energjisë sipas Sektorëve (Burimi: AKBN – 2014 - Balancat Vjetore të Energjisë)

Prirjet e fundit të konsumit final të energjisë konfirmojnë atë çka është vërejtur në terma të FTPE-ës: një rritje të moderuar, pa ndryshim të madh, në pjesët relative të vektorëve të ndryshëm të energjisë.

Figura 7 sugjeron se sektori industrial u tkurr shumë pas vitit 1990, dhe rrjedhimisht, konsumi i energjisë nga sektori u tkurr, ndërsa sektori i transportit u rrit gradualisht. Sektori i banesave ka qenë po ashtu konsumator me rëndësi i energjisë. Në vitin 2014 (figura 11), sektori i transportit ishte konsumatori më i madh i energjisë, duke zënë 39.15% të konsumit total final, pasuar nga

sektori i banesave(25.82%), sektori industrial (19.71%), sektori i shërbimit (8.33%), dhe sektori bujqësor (5.38%).


2.6.2 Sektori i transportit

Sektori i transportit në Shqipëri nisi të zhvillohet me ritme të shpejta rritjeje sidomos pas viteve '60, kur përveç rritjes sasiore të mjeteve të transportit rrugor, u zhvillua infrastruktura dhe kapacitetet transportuese të rrugëve, hekurudhave dhe mjeteve detare, duke krijuar strukturën e transportit. Sektori i transportit luan një rol me rëndësi në konsumin e burimeve të energjisë.

Rrugët dhe autostradat përbëjnë mënyrën mbizotëruese të transportit tokësor dhe sigurojnë lidhje thelbësore për lëvizjen e mallrave dhe pasagjerëve. Shqipëria duhet të përfundojë një rrjet infrastrukture rrugore efikas dhe modern, si hap i parë për një sistem transporti të integruar. Me gjithë disa investime së fundmi, cilësia e transportit rrugor mbetet e ulët dhe ka ndryshim të konsiderueshëm rajonal lidhur me qasjen në tregje dhe shërbimet bazë. Rrjeti mban rreth 4.5 milionë mjete*km/y. Gjatë periudhës 2010–2013 rritja vjetore e pasagjerëve ishte rreth +0.5% dhe 3.4% për mallrat²⁴.

Rrjeti hekurudhor shqiptar është ndërtuar në periudhën nga viti 1946 deri në vitin 1986, për t'i shërbyer industrisë kombëtare. Pas vitit 1991, shumica e industrive u mbyllën. Pa të ardhura direkte nga sektori hekurudhor, mbështetja e qeverisë u kthye nga programet e investimeve për rrugët. Vonesa në miratimin e Direktivës 2012/34 për sektorin hekurudhor, i ngadalësoi investimet e mëtejshme. Nuk ka lidhje fizike hekurudhore mes Shqipërisë dhe vendeve fqinje Kosovës, Republikës së Maqedonisë së Veriut apo Greqisë; hekurudha nuk është e elektrifikuar, është me një binar dhe me bajpase.

Prirjet e transportit (burimi i të dhënave INSTAT) tregohen në figurën 12: numri i mjeteve rrugore po rritet në mënyrë të qëndrueshme, ndërsa transporti publik ka humbur më shumë se 50% të pasagjerëve gjatë dy dekadave të fundit. Rritja e dukshme në numrin e mjeteve rrugore u shoqërua me rritjen e aktivitetit të transportit dhe një rritje evidente e konsumit të lëndëve djegëse, kryesisht naftë dhe benzinë.



²⁴ Shih “Asistenca teknike për përgatitjen e Strategjisë së Sektorit të Transportit në Shqipëri” – Strategjia përfundimtare dhe plani i veprimit – Draft 0.1 – 31.1.2016

Figura 12–Prirja e indeksuar (baza 1993 = 100) e pasagjerëve*km për transporturban, pasagjerë *km për hekurudhë dhe numri i mjeteve rrugore (përpunim i të dhënave nga INSTAT)

Transporti detar është mënyra më e rëndësishme për transportin e mallrave, nga një vend në tjetrin. Afërsia e Shqipërisë dhe ndërlidhja e transportit me vendet fqinje, si: Italia, Greqia dhe Kroacia, përveç mundësisë për vendet pa dalje në det, si Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Kosova, i japin transportit detar shqiptar një përfitim të madh potencial. Për më tepër, portet shqiptare janë pjesë e rrugëve të korridoreve detare në Evropën Juglindore. Për fat të keq, kapaciteti dhe strukturat operative nuk janë sa duhet efikase dhe të integruara për t'i kaluar standardet.

Shqipëria ka bërë progres të madh në kryerjen e reformave ligjore dhe rregullatore në sektorin e transportit ajror. Fluturimet dhe trafiku i pasagjerëve në aeroportin e Tiranës u rrit në mënyrë të qëndrueshme deri në vitin 2011, kur kriza ekonomike rajonale e ngadalësoi zhvillimin e sektorit ajror.

Analizat e dokumenteve të sektorit të transportit tregojnë se ka mungesë të serive të plota dhe të besueshme të të dhënave statistikore që të lejojnë parashikime të strukturuar. Me gjithë këtë kufizim, është bërë një vlerësim cilësor i sektorit në bazë të parametrave të vëzhguar dhe të shqyrtuar, duke mundësuar konsideratat e mëposhtme:

- Ka një mungesë të përgjithshme të burimeve ekonomike, për të mbështetur mirëmbajtjen e duhur dhe zhvillimin sistematik të sistemit të lëvizjes;
- Mirëmbajtja e keqe e rrugëve ndikon në eficiencën e transportit rrugor (koha e udhëtimit, konsumi i lëndës djegëse, shkarkimet dhe siguria);
- Mungesa e zhvillimit të rrjetit rrugor;
- Roli i vogël i sistemit hekurudhor;
- Dobësia e transportit intermodal;
- Një rënie e përgjithshme e popullsisë dhe rritja e përqendrimit në zonat e mëdha urbane (Tirana dhe pak zona të tjera urbane);
- Ekzistenca e mjeteve rrugore të vjetra, të patestuara plotësisht.

2.6.3 Sektori bujqësor

Përdorimi i tokës në Shqipëri në një sipërfaqe totale prej 28,750 km², ndahet mes tokës bujqësore (24%), pyjeve (37%), kullotave dhe livadheve (15%), si dhe tokave të tjera përfshirë zonat urbane, rreth 135,000 hektar liqene dhe tokë e papërdorur shkëmbore dhe malore (FAO, 2006²⁵).

Sektori bujqësor luan një rol me rëndësi në ekonominë kombëtare, megjithëse pjesa e tokës bujqësore në totalin e tokës në Shqipëri është vetëm 24 % (krahasuar me rreth 40% në EU28), dhe përmasat e vogla mesatare të fermave bujqësore (1.21 ha) dhe rrjedhimisht, shkallë e lartë e copëzimit të tokës. Shkaku kryesor për përqindjen e ulët të tokës bujqësore është fakti që bujqësia shqiptare nuk është konkurruese, krahasuar me vendet fqinje. Zona e ujitur është e kufizuar për shkak të dëmeve në infrastrukturën e ujitjes. Toka e kultivuar shtrihet nga 55% deri në 60% të sipërfaqes totale të tokës bujqësore, me një përdorim mesatar të plehrave kimike prej rreth 87.5 kg/ha (të dhëna 2011-2015 burimi FAO), kundrejt mesatares së EU-27 prej 76 kg/ha (të dhëna 2010 burimi EUROSTAT²⁶).

Infrastruktura relativisht e pazhvilluar në zonat rurale, i pengon produktet bujqësore shqiptare të shkojnë në treg. Ky fenomen, së bashku me probleme të tjera strukturore, si teknologjia e prapambetur, nivelet e ulëta të mekanizimit, qasja e kufizuar në lehtësitë e kreditimit dhe produktiviteti i ulët krahasuar me mesataret e BE-së, për shkak të aplikimit jo gjithnjë të praktikave të duhura agronomike, e ka kufizuar investimin e vazhdueshëm në sektorin bujqësor.

²⁵ <http://www.fao.org/ag/agp/agpc/doc/counprof/Albania/albania.htm#landuse>

²⁶ http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Agri-environmental_indicator_-_mineral_fertiliser_consumption

Për përmirësimin e situatës së sektorit dhe për ta bërë zhvillimin më të qëndrueshëm, zhvillimet dhe reformat strukturore duhet të jenë përparësi në politikat e ardhshme ekonomike²⁷, me synim rritjen e efikasitetit në prodhimin bujqësor, lehtësimin e qasjes së produkteve bujqësore vendore në tregjet e vendit dhe të huaja, si dhe mbështetjen financiare të bizneseve dhe fermave.

2.6.4 Sektori pyjor

Pjesa më e madhe e sipërfaqes totale të vendit është e mbuluar me pyje²⁸, rreth 1,040,881 ha të klasifikuara sipas formës së qeverisjes në pyje të lartë (45.7%) dhe pyje të ulët (cungishte) dhe shkurre (54.3%), ndarë në pyje të thjeshtë 72.3% dhe të përzierë 27.7%. Sipas kadastrës pyjore, pronësia e pyjeve shqiptare është rreth 96% shtetërore dhe pjesa tjetër private. Sektori pyjor shqiptar në përgjithësi ka pësuar një mbi shfrytëzim vitet e fundit, me rënie të madhe të sipërfaqes dhe volumit (figurat 11-12), me një reduktim vjetor mesatar prej rreth 540,000 m³/vit, si për pyjet halore, ashtu dhe për ato gjethegjera, e përdorur si lëndë drusore për industrinë e ndërtimit, industrinë e minierave, industrinë e përpunimit të drurit dhe për bioenergjë.




Figura 13–Sipërfaqja pyjore gjatë 2000-2013




Figura 14 – Volumi stok gjatë periudhës 2000-2013

²⁷ Eficienca e Energjisë Financa II, DETYRA 1 Potenciali i Eficocencës së Energjisë-Raport për Shqipërinë. Allplan GmbH. 2015

²⁸ INSTAT 2015. <http://www.instat.gov.al/al/themes/mjedisi.aspx>

Për të siguruar një menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve është shumë e rëndësishme të ruhet një raport pozitiv mes rritjes natyrore të pyjeve shqiptare që është shumë e ulët (1.2-1.7 milionë m³/vit²⁹) dhe prerjes së tyre.




Figura 15 – Rritja e pyjeve dhe konsumi i druve gjatë periudhës 2000-2013

Rritja natyrore e pyjeve është mesatarisht 27% më e ulët se konsumi i druve dhe lëndës drusore (figura 17) në Shqipëri. Kjo do të thotë se stoku kombëtar pyjor është menaxhuar dhe ende menaxhohet në mënyrë jo të qëndrueshme. Një tjetër çështje me rëndësi lidhur me këtë proces, është që pjesa më e madhe e rënies së volumit vjen si pasojë e prerjeve të paligjshme: vetëm 10% e volumit total të biomasës pyjore që pritet është e ligjshme, ndërsa pjesa tjetër merret në mënyrë ilegale. Kjo shifër është shumë e lartë dhe përbën shkakun kryesor të degradimit të pyjeve shqiptare. Nga perspektiva globale, efektet e degradimit të pyjeve dhe humbja e biodiversitetit të mbulesës pyjore mund të jetë e madhe, duke qenë se Shqipëria ndodhet në pellgun e Mesdheut, që njihet si pikë e nxehtë globale e biodiversitetit lidhur me florën endemike dhe speciet e faunës (Myers et al. 200030).

Për më tepër, cilësia e të dhënave ekzistuese për përdorimin e tokës, zonave pyjore dhe përdorimin pyjor në Shqipëri është shumë e paqartë, duke e bërë të vështirë çdo vlerësim të saktë të sektorit, me paqartësi të madhe edhe në vlerësimet e prirjeve të GES-it. Historikisht sektori pyjor është organizuar në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve dhe Kullotave. Ky ka qenë një institucion qendror i varur nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Bujqësisë. Duke filluar nga vitit 2005, shërbimi pyjor u organizua nën Ministrinë e Mjedisit (MM), ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve u shkri. Për momentin ka një sektor që merret me pyjet në Shqipëri, pjesë e Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Mjedisit në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Për më tepër, ngritja e një shërbimi pyjor është parashikuar nga projektligji mbi “Administrimin e Fondit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave në Republikën e Shqipërisë”, që mund të hyjë në fuqi në të ardhmen e afërt.

2.7 Përmbledhje e bilancit historik dhe të ardhshëm të GES-it

Burimi kryesor i të dhënave të shkarkimeve historike të GES-it, balancës dhe prirjeve të reduktimit paraqitet nga tre Komunikimet Kombëtare Shqiptare: Komunikimi i Parë Kombëtar (KPK) u paraqit në vitin 2002; Komunikimi i Dytë Kombëtar (KDK) në vitin 2009; dhe Komunikimi i Tretë Kombëtar (KTK) që do të paraqitet në vitin 2016 (ende në gjendje hartimi në kohën që po shkruajmë).

²⁹ Kadastra pyjore për periudhën 2000–2009, Ministria e Mjedisit

³⁰ Ndryshimi i Peizazhit Rural në Shqipëri: Braktisja e tokës bujqësore dhe prerja e pyjeve në tranzicionin postsocialist. Daniel Mueller dhe Darla K. Munroe. 2007. Analet e Shoqatës së Gjeografëve Amerikanë, 98(4) 2008, f. 1–22. 2008 nga Shoqata e Gjeografëve Amerikanë.

KPK-ja për Shqipërinë ishte inventari i parë i zbatuar i shkarkimeve të GES-it, sipas burimeve dhe përthithësve për Shqipërinë. Sipas Udhëzimeve IPCC-ë të rishikuara në vitin 1996, ajo merrte në konsideratë pesë sektorë kryesorë— energjinë, proceset industriale, bujqësinë, mbetjet dhe LUCF-ja – tre GES-e direkte – CO₂, CH₄dhe N₂O – dhe tre indirekte – CO, NO_x, si dhe përbërësit organikë shpërthyes jometan (NMVOC). Viti referencë ishte 1994, ndërsa seritë kohore 1990-1994 u përdorën vetëm për kategorinë e shkarkimeve CO₂ nga djegia e lëndëve djegëse.

KDK-ja për Shqipërinë u publikua në vitin 2009 dhe mbulon periudhën 1990–2000 për gjashtë kategori kryesore, të rekomanduara nga udhëzimet e IPCC-së të rishikuara në 1996: aktivitetet e energjisë (përfshirë gjithë llojet e aktivitetit lidhur me nxjerrjen, transportimin, përpunimin dhe djegjen e lëndëve djegëse), proceset industriale, përdorimi i tretësve dhe produkteve të tjera, bujqësia, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet, si dhe mbetjet. Inventari GES-it merr në konsideratë tre GES-e direkte (CO₂, CH₄ dhe N₂O) dhe shkarkime GES-i indirekte (CO, NO_x, SO_x dhe NMVOC). Veç kësaj, lidhur me KPK-në, përfshihen PFCs dhe SF6të vlerësimeve HFCs. Vlerësimi nga KDK-ja i serive kohore GES të periudhës (1990–2000) përfshin gjithashtu rillogaritjen për vitin 1994.

KTK-ja për Shqipërinë mbulon seritë kohore të përpunuara për periudhën 2000–2009 dhe siguron një analizë më të ngushtuar dhe më të thellë se inventari i mëparshëm (nivele më të detajuara aktiviteti, nëse e lejojnë të dhënat) me vit bazë 2005, viti i fundit për të cilin ka të dhëna të plota të regjistruara. Që prej KDK-ës, nuk ka pasur studime të mëdha për përmirësimin e faktorëve të shkarkimit apo vlerësime të tjera. Udhëzimet IPCC-ë të rishikuara (1996) aplikohen për gjithë kategoritë. Duke pasur parasysh rolin e aktivitetit të energjisë, inventari ka adoptuar nivelet e larta të metodologjisë IPCC-ë dhe ka ruajtur një fokus të fuqishëm të vlefshmëria e të dhënave për sektorët e energjisë dhe transportit.

Të dhënat më të fundit historike mbi shkarkimet GES për vitet 2012 dhe 2015, janë gjithashtu të disponueshme në studimin e kryer për Kontributin Kombëtar të Pikësnyuar (INDC), paraqitur nga Shqipëria në kuadër të procesit të UNFCCC-ës në vitin 2016, megjithatë, këto të dhëna janë limituar vetëm për sektorët e energjisë, të proceseve industriale dhe për gazin CO₂ (këto të dhëna janë paraqitur në kapitullin 2.7.2).

Parashikimet e ardhshme të prirjeve të shkarkimeve sigurohen në KTK-ën “Analiza e masave zbutëse për shkarkimet e GES-it”, seksionet për sektorët e bujqësisë, LUCF-ës dhe Energjisë dhe në studimin e kryer për INDC-ën, që mbulon sektorët e energjisë dhe të proceseve Industriale të limituara për shkarkimet e CO₂. Të dy studimet përmbajnë një bazë dhe parashikime të skenarëve të shkarkimeve në kuadrin e opsioneve të masave zbutëse për periudhën 2020–2030.

2.7.1 Analiza e prirjeve historike të shkarkimeve GES

Sipas prirjeve të raportuara në Komunikatat Kombëtare Shqiptare (tabela 3), është bërë e mundur të rindërtohet një seri e plotë e prirjes historike të shkarkimeve GES, për periudhën 1990–2009, siç tregohet në figurën 16.

Viti 1994 raportohet në kuadrin e KPK-ës, por rillogaritet në KDK-ë, si dhe për shkarkimet totale GES në vitin 2000 që zënë një total prej 7619.91 Gg CO₂eq në KDK-ë, dhe rillogariten në një total prej 9075.00 Gg CO₂eq në KTK-ë.

Diferenca shkaktohet kryesisht nga sektori pyjor, ku cilësia e të dhënave u përmirësua nga Inventari i Parë Kombëtar i Pyjeve (ANFI 2003, referuar vitit 2000), duke e ndryshuar vlerën nga viti 2000 nga 930 Gg CO₂eq e KDK-së në 2295 Gg CO₂eq e KTK-ës. Gjithashtu, proceset industriale pësuan një rishikim të madh, duke i dyfishuar shkarkimet e tyre nga 264 Gg CO₂eq e KDK-ës në 520 Gg CO₂eq e KTK-ës.




Figura 16–Prirja e shkarkimeve GES nga vitit 1990 në vitin 2009 sipas KPK-ës, KDK-ës dhe KTK-ës

Tabelat 3 dhe 4 tregojnë kontributin e shkarkimeve direkte GES të shprehura në Gg të ekuivalentit CO₂, në njësi fizike dhe në përqindje relative, në seritë kohore.

Tabela 3 – Prirja e shkarkimeve totale GES nga vitit 1990 deri në vitin 2009 sipas KPK-ës, KDK-ës dhe KTK-ës në gG të CO2 eq

	Sektori	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
KPK	Energji	-	-	-	-	3107	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Industrial Processes	-	-	-	-	209	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Bujqësi	-	-	-	-	1915	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	LULUCF	-	-	-	-	1525	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Mbetje	-	-	-	-	340	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	TOTAL	-	-	-	-	7062	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KDK	Energji	3107	5064	3350	3240	3390	3248	3247	3406	4126	4444	4528	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Industrial Processes	210	423	253	269	296	304	250	158	143	151	265	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Bujqësi	880	849	801	871	942	1012	1082	1082	1105	1175	1363	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	LULUCF	3493	3534	2015	1510	1798	1517	1447	1318	1096	910	903	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Mbetje	144	151	177	205	279	318	417	462	460	534	561	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	TOTAL	7834	10020	6597	6096	6704	6399	6443	6426	6929	7214	7620	-	-	-	-	-	-	-	-	-
KTK	Energji	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	4117	4152	4274	4447	4698	4633	4671	4722	4779	5116
	Industrial Processes	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	520	852	806	966	1043	1118	1195	1470	1599	1701
	Bujqësi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1553	1510	1464	1476	1464	1403	1375	1283	1205	1131
	LULUCF	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2295	1855	1391	1054	1123	1056	860	970	530	213
	Mbetje	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	591	593	592	601	647	653	723	731	698	828
	TOTAL	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	9075	8962	8527	8544	8976	8863	8824	9175	8810	8989

Sipas KTK-ës, kontribuesi kryesor në terma të shkarkimeve GES (CO₂ eq) për vitin 2005 (figura 15) është sektori i Energjisë (47.9%), ndjekur nga bujqësia (14.26%), industria (11.37%), ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjet (20.64%), si dhe mbetjet (6.64%).




Figura 17 – Shkarkimet CO₂eq nga gjithë sektorët ekonomikë për vitin 2005 (%) (Burimi KTK)




Figura 18 – Shkarkimet nga gjithë sektorët ekonomikë për vitet 2000 (rrethi i brendshëm), 2005 dhe 2009 (rrethi i jashtëm) (GtCO₂ eq) (Burimi TNC)

në 2009, me luhatje të vogla gjatë

periudhës së inventarit. Pjesa e shkarkimeve ka ndryshuar në kohë: shkarkimet janë rritur në sektorin e energjisë (kryesisht për shkak të transportit), sektorin industrial dhe mbetjet me +24% dhe +227% dhe +40% përkatësisht në vitin 2009 krahasuar me 2000. Procesi industrial është rritur shumë, për shkak të zgjerimit të prodhimit të çimentos. Nga ana tjetër, shkarkimet CO₂eq nga bujqësia dhe LUCF-ja kanë rënë gjatë periudhës së inventarit (2000–2009) me -27% dhe -91% përkatësisht, por mbeten ende burim shkarkimesh.

Sektori i energjisë tregon një përqindje në rritje të shkarkimeve nga vitit 2000 (43.57%) në vitin 2009 (56.92%). Mes nënsektorëve të energjisë, transportikontribuon më shumë, me rreth 45%, pasuar nga sektori i banesave (23%), industria e përpunimit dhe ndërtimet (14%), bujqësia (7%) dhe shërbimet (4%). (tabela 4). Transporti dhe industrinë e energjisë janë rritur me 27% të shkarkimeve të tyre nga vitit 2000 deri në vitin 2009, sektori i shërbimit me 25%, ndërsa bujqësia dhe sektori i banesave me 24% (figura 21).

Gjatë periudhës 2000–2009, shkarkimet CO₂eq ndryshuan nga 9075 GtCO₂eq në shkarkimet e vitit 2000, në 8988 GtCO₂eq

çrregullta											
Industria përpunuese dhe ndërtimi	14.88	14.87	14.45	13.89	13.91	13.91	13.91	13.91	13.91	13.92	+16%
Transporti	44.15	44.21	44.60	44.90	45.02	45.02	45.02	45.00	45.00	45.08	+27%
Sektori banesave	22.93	22.91	22.95	23.07	22.89	22.89	22.89	22.93	22.93	22.83	+24%
Shërbimi	4.71	4.68	4.72	4.75	4.76	4.76	4.76	4.76	4.76	4.74	+25%
Bujqësia	7.17	7.16	7.08	7.13	7.15	7.15	7.15	7.14	7.14	7.16	+24%

Aktivitetet bujqësore (kultivimi i të mbjellave dhe rritja e blegtorisë për plotësimin e nevojave të njerëzve me ushqim) kontribuojnë në shkarkime në shumë mënyra: shkarkimet CH₄ dhe N₂O nga bagëtitë shtëpiake (fermentimi i zorrëve dhe menaxhimi i plehrave organike); CH₄, CO, N₂O, dhe shkarkimet NO_x nga djegia e mbetjeve bujqësore; shkarkimet CH₄, dhe N₂O nga tokat bujqësore për shkak të fertilizimit dhe praktikave të menaxhimit, shkarkimet nga sektori i bujqësisë kanë rënë gjatë periudhës 2000–2009, si pasojë e reduktimit të CH₄të shkarkuar nga sektori i blegtorisë, për shkak të fermentimit të zorrëve dhe menaxhimit të plehrave organike pas tkurrjes së numrit të kafshëve.

Sektori LULUCF-ë zë shkarkimet dhe përthithjen e CO₂ në gjashtë përdorimet e tokës (pyje, tokë bujqësore, kullota, ligatina, vendbanime dhe toka të tjera), për shkak të menaxhimit dhe ndryshimit të përdorimit të tokës. Balanca e shkarkimeve/sekuestrimit të sektorit dominohet nga shkarkimet e pyjeve, si pasojë e menaxhimit të tyre të paqëndrueshëm, që e bën këtë sektor një burim neto shkarkimesh, shkaktuar nga përdorimi i lartë i biomasës krahasuar me rritjen natyrore vjetore të pyjeve. Në të kundërt, shkarkimet LULUCF-ë ndjekin një prirje në rënie, që shkon nga 2295 GtCO₂eq në vitin 2000 në 213 GtCO₂eq në vitin 2009. Zbatimi i parimeve të menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve në vijimësi do t'i kthejë ato në një sekuestrues të GES-it.

Pasiguria e përgjithshme kombëtare e inventarit GES është 9.92% dhe kontribuesi kryesor për këtë pasiguri janë shkarkimet e CO₂, nga konsumi i druve të zjarrit në sektorët e banesave dhe të shërbimeve. Kjo vjen sidomos nga një shkallë e madhe pasigurie e të dhënave të aktivitetit në këtë nënkategori (sidomos vetëkontrolli i druve të zjarrit nga zonat rurale).

Gjatë tranzicionit në statusin e Aneksit I, Shqipëria do të duhet të përmirësojë shumë mbledhjen e të dhënave dhe sistemin përpunues, duke krijuar një kuadër të fortë institucional dhe ligjor për të përmirësuar inventarin transparent, të saktë, të plotë, të krahasueshëm dhe të qëndrueshëm, në përputhje me sistemet ndërkombëtare (UNFCCC-ë) dhe të BE-së (525/2013/UE) për monitorimin, raportimin dhe verifikimin.

2.7.2 Parashikimi i prirjeve të shkarkimeve GES

2.7.2.1 Analiza e masave zbutëse e komunikimit të tretë kombëtar

Sektori i energjisë

Sipas popullsisë së pritshme dhe rritjes ekonomike të shprehur si PBB-ë, dhe vlerës së saj të shtuar nga çdo sektor, siç raportohet në KTK-ë. Seksioni i analizave për masat zbutëse, shkarkimet GES të parashikuara të gazeve kryesore (CO₂, CH₄, N₂O, shprehur si CO₂ ekuivalent) nga gjithë sektorët që konsumojnë energji, duke përdorur softuerin/modelin LEAP (Planifikim i Gjatë i Alternativave të Energjisë), pritet që pothuaj të dyfishohen nga 4795.6 kt në vitin 2009, në 9753.7 kt në vitin 2030. Kjo vlerë rritet, nëse marrin gjithashtu në konsideratë shkarkimet GES të gazeve kryesore (CO₂, CH₄, N₂O, shprehur si CO₂ ekuivalent) nga gjenerimi i energjisë elektrike, nxitur nga rritja e vlerësuar e kërkesës vjetore për energji elektrike në vitin 2030, që pritet të arrijë 13533 GWh. Duke pasur parasysh shkarkimet GES nga sektori i gjenerimit të energjisë (industritë e energjisë), shkarkimet totale GES nga gjithë sektorët që konsumojnë energji, rriten përafërsisht 2.15 herë nga 5108 kt CO₂eq në vitin 2009 në 11004 kt CO₂eq në vitin 2030.

Sipas parashikimeve bazë të KTK-ës– seksioni për analizën e masave zbutëse, ndërsa shkarkimet absolute GES do të rriten, kontributi relativ i sektorëve do të ndryshojë si vijon:

- Pjesa e familjeve do të bjerë nga 22.87% në vitin 2009 në 21.52% në vitin 2030, me gjithë faktin që shkarkimet totale GES nga familjet do të rriten në terma absolutë me përafërsisht dy herë nga viti 2009 deri në vitin 2030. Në fakt, sektori është shumë i rëndësishëm, duke qenë se konsumon më shumë se një të katërtën e energjisë totale, ndërsa përfaqëson gjithashtu një faktor të madh trysnie për sistemin e mbingarkuar të shpërndarjes së energjisë elektrike. Kërkesa për ngrohje nga familjet do të rritet, edhe me reduktimet në konsumin e paregjistruar të energjisë elektrike (përdorimi i paligjshëm). Energjia elektrike mbetet burimi kryesor për ngrohjen e banesave, duke përfaqësuar 60% të gjithë burimeve të energjisë, sidomos që prej vitit 2005, kur struktura e kërkesës për energjisë ka ndryshuar shumë (përveç zonave rurale), kryesisht për shkak të një ndryshimi nga drutë e zjarrit për ngrohje, gatim dhe ujë të ngrohtë, tek përdorimi i energjisë elektrike.

- Pjesa e sektorit të shërbimit do të rritet nga 4.75% në vitin 2009 në 5.42% në vitin 2030, me një rritje neto të shkarkimeve GES nga sektori, përafërsisht 2.5 herë më shumë nga viti 2009 deri në vitin 2030. Megjithatë, rritja i detyrohet një rritjeje mjaft të përmbajtur të kërkesës për energji prej rreth 10%, falë njëfarë modernizimi të energjisë së adoptuar në mënyrë më intensive në sektorin e shërbimit, sesa në sektorin publik, që zakonisht kanë sisteme ngrohjeje të vjetra dhe mund të mbështetet vetëm në pak instalime të reja.

Pjesa e industrisë do të mbetet pak a shumë konstante, duke kaluar nga 13.94% në vitin 2009 në 13.98% në vitin 2030, me një rritje neto të shkarkimeve GES nga sektori, me përafërsisht dy herë nga viti 2009 deri në vitin 2030.

- Pjesa e sektorit të transportit do të bjerë nga 45.15% në vitin 2009 në 40.97% në vitin 2030, ndonëse shkarkimet totale GES nga transporti do të rriten në terma absolutë, me përafërsisht dy herë nga viti 2009 në vitin 2030. Në fakt, numri i mjeteve po rritet me shpejtësi që prej vitit 2000, ndërsa infrastruktura e transportit po përmirësohet, duke çuar në një ngarkesë totale të trafikut edhe më të shtuar, si për transportin e mallrave, ashtu dhe të pasagjerëve, duke konsumuar sasi shumë të mëdha energjie (kryesisht në formë naftë dhe benzine).

- Pjesa e bujqësisë do të bjerë nga 7.17% në vitin 2009 në 6.38% në vitin 2030, megjithëse shkarkimet totale GES nga bujqësia do të rriten në terma absolutë. Në fakt, bujqësia është ende një konsumatore e vogël e energjisë dhe një sektor me intensitet të ulët të energjisë, për shkak të nivelit të përgjithshëm të ulët të mekanizimit. Megjithatë, sektori parashikohet të rritet me 1.7 herë në periudhën 2009-2030, me një rritje të parashikuar të intensitetit të energjisë së bujqësisë, ndonëse jo në nivelin e bujqësisë intensive. Shkarkimet e parashikuara GES nga bujqësia do të rriten përafërsisht me 2.5 herë nga viti 2009 deri në vitin 2030.

- Pjesa e sektorit të energjisë (industrisë e energjisë) do të rritet nga 6.12% në vitin 2009 në 11.37% në vitin 2030, duke pasur parasysh kërkesën e pritshme vjetore për energji elektrike prej 13533 GWh në vitin 2030 dhe përmirësimin gradual të eficiencës së transmetimit dhe shpërndarjes që do të arrijë 10% të humbjeve në vitin 2030.

Në KTK-ë – seksioni i analizës së masave zbutëse, parashikohet zbatimi i një liste masash zbutëse në sektorin e energjisë, me synim përcaktimin e një skenari me masa zbutëse deri në vitin 2030. Shumica e masave të listuara janë përfshirë tanimë në strategjitë dhe planet kryesore lidhur me sektorin e energjisë (BERBER dhe PKVEE) dhe janë mbledhur në KTK-ë – seksioni i analizës së masave zbutëse, me synim sigurimin e një skenari të përgjithshëm masash zbutëse për sektorin. Masat e listuara synojnë të reduktojnë si kërkesën për energji, ashtu dhe shkarkimet GES nga familjet, duke përmirësuar eficiencën e energjisë në sektorin e shërbimit, në sektorin industrial, si dhe në sektorin e transportit (reduktimi i konsumit të lëndës djegëse), për të reduktuar si kërkesën për energji, ashtu dhe shkarkimet GES.

Për më tepër, masa reduktuese parashikohen gjithashtu, në sektorin e transformimit të energjisë, duke pasur parasysh potencialin hidroenergjetik, pyjet dhe potencialin tjetër të biomasës

(gjeneruar nga industria e përpunimit të drurit dhe industria e përpunimit të ushqimit), si dhe potencialin e energjisë elektrike nga era.

Tabela e mëposhtme raporton një vlerësim të kryer në KTK-ë – seksioni i analizës së masave zbutëse, të potencialit reduktues të shkarkimeve CO₂ shoqëruar me çdo masë dhe efikasitetin financiar, me zbatim në periudhën afatshkurtër (2020) dhe afatmesme (2030). Duke zbatuar gjithë masat e skenarit të masave zbutëse, reduktimi total potencial deri në vitin 2020 për sektorin e energjisë është 12.06% krahasuar me skenarin bazë, me një reduktim total të shkarkimeve prej 1051 kt CO₂eq në vit. Këto vlera rriten deri në 19.12% në vitin 2030, me një reduktim total të shkarkimeve prej 2104 kt CO₂eq në vit.

Tabela 7 – Shkarkimet CO₂ reduktimi i masave zbutëse dhe efikasiteti financiar deri në vitin 2030. Burimi: KTK-ja Analiza e Masave Zbutëse

<i>Opsioni i reduktimit</i>	<i>US\$/tCO₂</i>	<i>Tipi i njësisë</i>	<i>Reduktimi i shkarkimit tCO₂/njësi</i>	<i>Njësitë depërtuese më 2020</i>	<i>Reduktimi i shkarkimit në vitin 2020 për opsion ktCO₂/vit</i>	<i>Njësitë depërtuese në 2030</i>	<i>Reduktimi i shkarkimit në vitin 2030 për opsion ktCO₂/vit</i>
Izolimi termik i banesave -drutë	-30.95	apartamente	0.49	25,000	7.66	45,000	11.56
Izolimi termik i banesave -GNL	-78.91	apartamente	1.60	25,000	24.78	45,000	37.42
Korrigjimi i faktorit të fuqisë	-32.49	MVAR	499.61	80	24.78	120	31.17
Izolimi termik i banesave—energji elektrike	-19.93	apartamente	0.55	25,000	8.46	50,000	14.19713
Izolimi termik i banesave -vajguri	-81.07	apartamente	1.64	0	0.00	1,000	0.85
Taksitë me gaz	-321.65	1 taksi	11.14	10,000	69.06	35,000	202.73
Ndriçimi efikas	-153.79	1000 llamba	0.15	900	0.09	4,420	0.35
Bojlerë efikasë lëndë djegëse naftë -dizel	-85.70	bojler	492.56	360	109.94	500	128.06
Metan nga ujërat e zeza	-69.94	impiant	820.52	1	0.51	3	1.28
Bojlerë efikasë qymyr	-68.47	bojler	929.39	50	28.81	200	96.65
Çelësa termikë	-68.28	njësi	1.18	30,000	21.95	60,000	36.82
Matës me parapagesë	-54.87	apartamente	1.06	50,000	32.75	100,000	54.94
Turbina me erë	-21.74	kW	1.37	20,000	16.96	60,000	42.68
Hidrocentrale të vegjël, të mesëm	-184.22	kW	1.56	300,000	290.95	630,000	512.44
Izolimi termik i banesave -DH	-48.21	apartamente	1.67	0	0.00	300	0.26
Motorë efikasë	-28.01	kW	4.33	20,000	53.69	80,000	180.14
Frigoriferë efikasë	-47.59	frigorifer	0.84	20,000	10.46	30,000	13.15
Sisteme diellore për ujë të ngrohtë	-59.12	njësi	2.59	20,000	32.05	60,000	80.65
Hidrocentral i vogël	-214.57	kW	5.61	25,000	86.98	80,000	233.43
Impiant gazi në vend groposjeje me	29.90	Impiant i vend	24,019.17	2	29.78	8	99.92

<i>Opsioni reduktimit</i>	<i>US\$/tCO₂</i>	<i>Tipi i njësisë</i>	<i>Reduktimi i shkarkimit tCO₂/njësi</i>	<i>Njësitë depërtuese më 2020</i>	<i>Reduktimi i shkarkimit në vitin 2020 për opsion ktCO₂/vit</i>	<i>Njësitë depërtuese në 2030</i>	<i>Reduktimi i shkarkimit në vitin 2030 për opsion ktCO₂/vit</i>
70% përpunim		groposjes					
Central me gaz	-85.12	kW	2.43	97,000	146.23	150,000	189.66
Kogjenerim-NKE	-114.75	kW	2.65	5,000	8.23	14,000	19.32
Ngrohja zonale-NZ	-77.42	kW	5.59	6,000	20.79	13,000	37.77
Ngrohja qendrore-NQ	-64.64	kW	3.36	5,000	10.43	15,000	26.24
Pyllëzimi me pisha	10.56	ha	29.42	0	0.00	--	--
Biogaz për banesat rurale	28.28	tretës	8.84	1,000	5.48	5,000	22.99
Ajër i kondicionuar	60.43	Njësi	2.12	0	0.00	--	--
CV energji elektrike 1	70.76	kW	0.77	20,000	9.49	62,000	24.68
CV diellor pompa uji	114.87	kW	0.19	10,000	1.16	50,000	4.86
Shkarkime Totale				1051			2104
Reduktimi final CO₂eq				12.06%			19.12%

KTK-ja arrin në konkluzionin se, duke marrë parasysh rolin e BER në situatën aktuale shqiptare, mund të propozohen objektivat e mëposhtëm politikë:

- Reduktimi i importeve të energjisë elektrike;
- Diversifikimi i burimeve primare të energjisë për furnizimin me energji elektrike;
- Reduktimi i humbjeve të transmetimit dhe shpërndarjes nga promovimi i gjenerimit të shpërndarë;
- Krijimi i biznesit vendor dhe mundësive të punësimit, duke instaluar dhe prodhuar pjesë/komponentë/sisteme të impianteve BER nga sektori industrial shqiptar;
- Përdorimi i burimeve të energjisë vendore sidomos në zonat e largëta, duke sjellë vende pune dhe duke përmirësuar standardin e jetesës.

Sektorët e bujqësisë dhe pyjeve

KTK-ja – seksioni për analizën e masave zbutëse për Bujqësinë, parashikon një listë konsideratash lidhur me masat që do të zbatohen në sektorin e Bujqësisë dhe LULUCF-së, me synim zbutjen e ndryshimit të klimës përmes reduktimit të shkarkimeve, shtimit të përthithësve dhe shmangies (apo sekuestrimit) e shkarkimeve. Masat e përgjithshme zbutëse të sugjeruara për Bujqësinë dhe LULUCF-ë janë:

- Reduktimet në shkarkimet CH₄ apo N₂O nga tokat bujqësore, tokat kullotë dhe bagëtitë
- Konservimi i stoqeve ekzistuese të karbonit, për shembull, konservimi i biomasës së pyjeve, zonave kënetore dhe karbonit të tokës, që ndryshe do të humbte.
- Reduktimet e humbjeve të karbonit nga biota dhe dherat, për shembull, përmes ndryshimeve të menaxhimit brenda të njëjtit lloj përdorimi toke (p.sh. duke reduktuar humbjet e karbonit të tokës me kalimin nga lëvrimi në kultivim të thjeshtuar), apo duke reduktuar humbjet e ekosistemeve të pasura me karbon, për shembull, shpyllëzimi i reduktuar, rikthimi i ujit në tokat kënetore të thara.
- Shtimi i izolimit të karbonit në dhera, biota dhe produkte jetëgjata përmes rritjeve në zonën e ekosistemeve të pasura me karbon, si pyjet (pyllëzimi, ripyllëzimi), rritja e rezervave të karbonit për njësi zone, për shembull, duke rritur densitetin e rezervave në pyje, izolimin e karbonit në dhera, si dhe përdorimin e druve në aktivitete ndërtimi.

- Sigurimi i produkteve me shkarkime të ulëta GES që mund të zëvendësojnë produktet me shkarkime më të larta GES, për të dhënë të njëjtin shërbim (p.sh. zëvendësimi i betonit dhe çelikut në ndërtesa me dru dhe disa opsione të bioenergjisë).

- Reduktimet e shkarkimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta (p.sh. prodhimi i plehrave kimike, përdorimi i energjisë fosile në bujqësi, peshkim, akuakulturë dhe pylltari apo nga prodhimi i inputeve).

Megjithatë, masat zbutëse për bujqësinë, të përfshira në skenarin e masave zbutëse të KTK-ës, lidhen kryesisht me reduktimin e shkarkimeve CH₄nga bagëtia, duke marrë parasysh tri kategori të përgjithshme: i) praktika ushqyerje të përmirësuara; ii) përdorimin e agjentëve specifike apo shtesave dietetike dhe; iii) ndryshimet afatgjata të menaxhimit dhe mbarështimit të kafshëve. Duke hamendësuar se zbatimi i këtyre masave konkrete kërkon kohë të gjatë, vlerësohet një periudhë kohore prej 40 vjetësh (2010–2050), me një rritje vjetore të teknologjisë prej 2.5%.




Figura 20 – Shkarkimet e parashikuara GES nga bagëtia, 2010-2050, në Gg CO₂eq. Burimi: KTK-ja

Masat zbutëse për sektorin e pylltarisë të përfshira në skenarin e masave zbutëse të KTK-ës janë:

- Përmirësimi i teknologjisë së shfrytëzimit të pyjeve dhe dëgjies së druve. Përmes kësaj mase, efienca aktuale e përdorimit të druve pritet të përmirësohet nga 40% në 86% në një periudhë prej 35 vitesh (2015–2050) me një normë prej 1.3% në vit.

- Rritja e sipërfaqes pyjore. Në mënyrë që të përdoren pyjet në mënyrë të qëndrueshme, duke pasur parasysh rritjen vjetore kombëtare të pyjeve, është me rëndësi të jashtëzakonshme që të investohet në mbjellje të reja pyjesh. Duke pasur parasysh rrethanat aktuale kombëtare të sektorit të pylltarisë, sasia e sipërfaqes pyjore që do të mbillet në vit duhet të jetë 500–1000 ha.

Efektet e balancës GES (CO₂eq) të zbatimit të masave të propozuara raportohen në figurat e mëposhtme (figurat 23–24), që tregojnë se masat e skenarit “me projekt” e kthejnë sektorin pyjor nga një burim neto në një përthithës neto CO₂.




Figura 21 – Shkarkimet CO₂ për periudhën 2015–2050 në Kt, pa projekt dhe me projekt për pyllëzimin e 1000 ha/vit. Burimi: KTK-ja




Figura 22–Shkarkimet CO₂ për periudhën 2015–2050 në Kt, pa projekt dhe me projekt për pyllëzimin e 500 ha/vit. Burimi: Draft KTK-ja

2.7.2.2 Parashikimet në kontributin e synuar të përcaktuar në nivel kombëtar

Sipas INDC-ës, është parashikuar një skenar bazë i shkarkimeve GES deri në vitin 2030, duke nisur në 2012 si vit bazë, dhe duke përdorur modelin “PRIMES” për parashikimet e intensitetit të energjisë dhe nivelet e aktivitetit, si dhe modele të tjera sektoriale (në veçanti modelet SLED të energjisë elektrike dhe ndërtimit dhe modelin UNDP LEAP), të dhëna nga AKBN-ja dhe INSTAT-i.

Në mënyrë ideale e gjithë ekonomia duhet mbuluar nga parashikimet e raportuara në INDC-ë, por dy aspekte duhen konsideruar me kujdes, ndërsa dëshirohet një mbulim sa më gjithëpërfshirës i sektorëve, mungesa e të dhënave të disponueshme apo cilësisë së të dhënave në disa sektorë, mund ta kufizojë atë çka mund të mbulohet. Për këto arsye, sipas dokumentit teknik bazë INDC-ë, të miratuar nga qeveria shqiptare në shtator 2015, të dhënat e disponueshme dhe kufizimet e cilësisë së të dhënave janë menaxhuar me dy kufizime:

- Duke mos përfshirë sektorin LULUCF-ës, duke qenë se inventari shqiptar GES –që aktualisht përmbledh pesë sektorë kryesorë: energjinë, proceset industriale, bujqësinë, ndryshimin në përdorimin e tokës dhe pylltarinë, si dhe mbetjet –përmban një pasiguri të madhe të përthithjes që lidhen me LULUCF-në. Megjithatë, qeveria shqiptare ka rezervuar të drejtën ta përfshijë pylltarinë në INDC-ë në të ardhmen, por para fillimit të “periudhës së parashikuar të angazhimit”, 2020.

- Duke mos përfshirë GES-in përveç CO₂. Në fakt, inventari i gazeve serrë të Shqipërisë, ka seri kohore të plotë deri në vitin 2000, dhe inventari i të dhënave u vu në dispozicion për vitet 2005 dhe 2009 si pjesë e Komunikimit të Tretë Kombëtar. Duke mos i pasur seritë kohore deri në vitin 2012 dhe duke pasur një pasiguri të lartë relative të raportimit të gazeve të tjerë përveç CO₂, Shqipëria zgjodhi vetëm CO₂si gazi ku shprehet INDC-ja e saj. Megjithatë, Shqipëria njoftoi synimin për ta shtrirë INDC-nënë gaze të tjerë në një stad të mëvonshëm, sapo cilësia e të dhënave të përmirësohet. Kjo do të përjashtonte automatikisht bujqësinë dhe mbetjet, meqë inventari nuk përmban shkarkime të lidhura me GES-in, lidhur me bujqësinë dhe mbetjet.

- Duke përjashtuar LULUCF-në dhe gaze të tjera përveç CO₂, shkarkimet GES të mbuluara nga parashikimet e INDC-ës shqiptare, për momentin kufizohen me **sektorët që lidhen me energjinë, përfshirë transportin dhe proceset industriale**, që së bashku mbulojnë më pak se 60% të shkarkimeve totale GES në inventar. Kjo mund të përfaqësojë një kufizim serioz, edhe nëse përfshirja e LULUCF-ës dhe gazeve të tjerë jo-CO₂do të sillnin pasiguri të madhe. Megjithatë, Shqipëria me gjasë do ta shtrijë INDC-nënë sektorë të tjerë ekonomikë dhe gaze serrë para vitit 2020, nëse cilësia e të dhënave dhe disponueshmëria përmirësohen.

Tabela 8 raporton shkarkimet totale CO₂nga nënsektorët që lidhen me energjinë, me shkarkime gati zero CO₂, lidhur me sektorin e energjisë.

Tabela 8 – Shkarkimet totale CO₂ (Gg CO₂), jobiogjenike (Burimi: INDC2015)

Sektori	2012	2015	2020	2025	2030
Sektori i banesave dhe shërbimeve	251	269	293	320	352
Industria	980	1064	1243	1534	2032
Transporti	2238	2431	2682	2898	3197
Bujqësia	243	275	307	341	311
Përdorimi Joenergjetik	101	101	101	101	101
Dega e Energjisë	139	142	155	159	175
Prodhimi i Energjisë Elektrike	0	0	0	0	7
Totali	3952	4282	4781	5353	6174

Ky skenar konfirmon se sektorët e transportit, industrisë dhe banesave janë sektorët kyçë shkarkues, me shkarkimet e shërbimeve, transportit dhe industrisë që do të rriten shumë gjatë periudhës deri në vitin 2030, nxitur nga rritja ekonomike. Kjo tregohet në figurën 4.3, si më poshtë.




Figura 23–Shkarkimet e sektorit të energjisë në vitin 2012 dhe 2030 (Gg CO₂) (Burimi: INDC2015)

Duke pasur parasysh gjendjen aktuale të Shqipërisë, si vend kandidat për anëtarësim në BE, ka gjasa që në periudhën e vlefshmërisë së dokumentit të SKNK&P-ës, Shqipëria të hyjë në BE. Për këtë arsye, është me rëndësi shumë të madhe të garantohet që veprimet zbutëse të ndërmarra në këtë dokument të SKNK&P-ës të jenë në nivelet e ambicies së shprehur në objektivat dhe synimet politike të BE-së.

Duke pasur parasysh shkarkimet për kokë në Shqipëri, siç raportohen në INDC-ë, shkarkimet për kokë në Shqipëri janë më pak se një e treta e mesatares së shkarkimeve të BE-së për kokë. Kjo mund t'i atribuohet pjesërisht gjendjes së zhvillimit të saj dhe pjesërisht sektorit të dekarbonizuar të gjenerimit të energjisë elektrike. Duke marrë në konsideratë këta dy faktorë, INDC-ja afirmon se mund të pritet, në mënyrë të arsyeshme, që shkarkimet e gazeve serrë në Shqipëri të rriten, duke iu përshtatur nevojave të zhvillimit të vendit, por me prirje që mund të ndjekin një rrugë me karbon të ulët, duke e ndarë rritjen ekonomike nga rritja e shkarkimeve.

Tabela 9 – Supozimet kryesore lidhur me skenarët e shkarkimeve GES për Shqipërinë – Tabela nga INDC 2015 (Burimet e të dhënave: JRC, Eurostat, Instat, Primes, të dhëna të inventarit)

	1990	2000	2010	2030
Shkarkimet totale botërore Gg	38,232,170.06	40,563,437.00	50,911,113.68	
BE 28	5,636,933.47	5,103,281.75	4,834,156.78	3,382,160.08
Popullsia e BE-së 28	475,160,781.00	486,958,178.00	503,234,845.00	518,499,055.00
Shkarkimi/kokë BE	11.86	10.48	9.61	6.52
Popullsia e Shqipërisë	3,286,000	3,196,130	3,150,143	
Shkarkimet e Shqipërisë Gg CO₂eq	4,341.02	6,774.54	8,687.00 ³¹	
Shkarkimi / kokë i Shqipërisë	1.32	2.44	2.76	
Shkarkimet e Shqipërisë në % të shkarkimeve botërore	0.011	0.017	0.017	

Analiza INDC-ë supozon se rruga e parashikuar për Shqipërinë mundëson arritjen e nivelit të shkarkimit GES- 2 tonë për kokë, deri në vitin 2050. Kjo nënkupton një rritje të kufizuar të shkarkimeve GES në dy dekadat e ardhshme, krahasuar me synimin politik të BE-së për vitin 2050. INDC-ja specifikon se ky objektiv është i arritshëm, me besim të lartë me rritjen e parashikuar të shkarkimeve pasuar nga ndarja dhe ulja e ngadaltë e shkarkimeve.

Veprimet zbutëse GES bazuar në INDC-ë kërkojnë përdorimin e politikave specifike, strategjive sektoriale apo veprimeve të tjera, që do të kenë një potencial reduktues të shkarkimeve dhe përbëjnë një zotim kundrejt komunitetit ndërkombëtar për zbatimin e këtyre veprimeve. Këto veprime përfshijnë gjithashtu NAMA të planifikuara.

Tabela e mëposhtme përmbledh reduktimet absolute dhe në përqindje nga shkarkimet bazë CO₂që mund të arrihen në vitin 2030, që bazohen në supozimin e zbatimit të një numri paketash politike të identifikuara për eficiencën e kostos së tyre. Këto përfshijnë:

- Gjithë masat zbutëse të identifikuara me kosto efektive në KTK-ë dhe PKVEE-n e parë, përveç ngrohjes zonale/qendrore;
- Masat për sektorin e ndërtimeve të identifikuara si me kosto efektive në raportin Eficiencia e Energjisë në Ndërtesa në Palët Kontraktore të Komunitetit të Energjisë (CPEC);
- Opsione të tjera zbutëse për sektorët e transportit dhe industrisë bazuar në përvojën ndërkombëtare;
- Futjen e 10% biokarbureve në përzierjen e lëndëve djegëse për transportin deri në vitin 2030.

³¹ Të dhënat e inventarit të vitit 2009 përdoren si të dhëna të tërthorta për vitin 2010, meqë nuk disponohen të dhëna inventari GES për Shqipërinë për vitin 2010.

Kontributi i sektorit të gjenerimit të energjisë pritet të jetë minimal.

Tabela më poshtë raporton kontributet e pritshme zbutëse deri në vitin 2030 nga sektorët e ndërtimit, industrisë dhe transportit, sipas dokumentit bazë INDC-ë.

Tabela 10 – Potencial i vlerësuar zbutës me kosto efektive për Shqipërinë në vitin 2030, MtCO₂ (Burimi: INDC 2015)

Paketat e masave	kursimet ktCO ₂ në vitin 2030	Përqindja e reduktimit nga shkarkimet bazë CO ₂ në vitin 2030
Ndërtesat	50	
Industria	277	
Transporti	381	
Totali	708	11.5%

Dokumenti teknik bazë INDC-ja jep një vlerësim të koston së investimit lidhur me çdo masë zbutëse të raportuar në tabelën 11.

Tabela 11 – Kostot e investimit për masat zbutëse deri në vitin 2030 (m€)³² (Burimi: INDC 2015)

Sektori	Masa	Zbutja ktCO ₂	Kosto investimit m€	Burimi/supozimi
Ndërtesat	Izolimi termik	50	21	Të dhëna specifike për Shqipërinë për koston nga Komunikata e Tretë Kombëtare
Industria	Bojlerë më efikasë	225	15	Nga modeli GACMO i përdorur për Komunikimin e Tretë Kombëtar
Industria	Ndryshimi i lëndës djegëse	52	0	Duke mos supozuar kosto shtesë për pajisjet me gaz natyror kundrejt pajisjeve me qymyr/naftë dhe që gazi natyror është i disponueshëm në vendet kryesore industriale në kuadrin e bazës.
Transporti	Masa me kosto efektive	116	195	Gjithë masat me kosto efektive në transport MACC; të dhënat e koston së BE-së, supozon se gazi natyror gjendet në depot e mjeteve pa kosto shtesë për shpërndarjen e gazit.
Transporti	10% biokarbure	265	456	Supozon se një impiant me kapacitet 100 milionë litra biokarbure kushton 250m\$ (të dhëna MB)
Totali	Gjithë masat e mësipërme	708	687	

Masat në tabelën 11 përfshijnë ndryshimin e lëndës djegëse në gaz natyror në sektorët e industrisë dhe transportit, çka përputhet me supozimin se gazi natyror do të futet në Shqipëri para vitit 2030, fillimisht për përdorim në sektorin e energjisë. Në INDC-ë nuk përfshihej asnjë kosto investimi lidhur me ndërtimin e një rrjeti të shpërndarjes së gazit që lidhte tubacionin e gazit me zonat kryesore industriale dhe depot e mjeteve, meqë kjo supozohet se do të ndërtohet në kuadrin e skenarit bazë.

³² Vlerësim i koston së investimit lidhur me çdo masë zbutëse, pra shpenzimi marginal (capex). Dokumenti teknik INDC-ë paralajmëron se këto kosto investimi nuk përfshijnë kostot e hartimit dhe administrimit të politikave për zbatimin e këtyre masave, që normalisht do të ishin 2-5% të shpenzimeve kapitale.




Figura 24 – Shkarkimet e skenarit bazë dhe zbutës, paketa C (Gg CO₂) (Burimi INDC 2015)

2.8 Situata aktuale e Shqipërisë në procesin e përshtatjes

Sipas parimeve të parashikuara në Udhëzimet Teknike për NAP-in, procesi i NAP-it duhet të ofrojë vlerë të shtuar, përmes mbështetjes në strukturat dhe proceset ekzistuese. Në përputhje me këtë, vlerësimi i situatës konsiderohet si një hap i rëndësishëm fillestar për hartimin e një procesi adekuat të NAP-it, i cili t’i trajtojë boshllëqet në mënyrën e duhur.

2.8.1 Analizë e situatës ekzistuese

Si një hap fillestar për analizimin e situatës ekzistuese, instrumenti analitik “Vlerësimi i situatës për planifikimin kombëtar të përshtatjes (SNAP)”³³, përgatitur nga GIZ-i, është përdorur gjatë një takimipune më 19 shkurt 2015. Instrumenti ofroi një panoramë të kapaciteteve të përshtatjes që ekzistojnë aktualisht, si dhe që mendohet të krijohen në vend. Elementi kryesor i instrumentit SNAP është vlerësimi i nevojave dhe kapaciteteve të vendit, i cili mundëson një perspektivë strategjike për procesin e përgjithshëm NAP. Përdorimi i instrumentit SNAP ka ndihmuar në identifikimin e një pikënisjeje të përbashkët, nga e cila palët e interesit të mund të fillojnë të formulojnë një dokument udhërrëfyes për procesin e NAP-it.

Ky instrument u zbatua nëpërmjet përfshirjes së palëve të interesit të lidhura me procesin e përshtatjes. Në takimin e punës për vlerësimin e situatës u krye një analizë dhe një diskutim i përbashkët, si edhe u plotësua një pyetësor në formë individuale nga secili pjesëmarrës. Pyetësori që hartuar në bazë të 20 faktorëve të suksesit, që janë parë se kanë pasur rëndësi kryesore në procese të ngjashme në vende të tjera. Faktorët u grupuan në 7 fusha suksesi:

- Informacion për klimën;
- Kapacitetet njerëzore dhe institucionale;
- Vizioni afatgjatë dhe mandati;
- Zbatimi;
- Integrimi;
- Pjesëmarrja;
- Monitorimi dhe vlerësimi.

Rezultatet kryesore të analizës së situatës janë kondensuar në një “diagram rrjete”, si në figurën 25. Vija e kaltër identifikon situatën aktuale, siç u vlerësua nga pjesëmarrësit e takimit të punës, ndërsa vija e kuqe përfaqëson objektivin strategjik, siç e shihnin pjesëmarrësit. Të gjitha

³³ GIZ: Udhëzues për përdorimin e instrumentit të vlerësimit të situatës për planifikimin kombëtar të përshtatjes (SNAP). Eschborn 2014.

kontributet e pjesëmarrëse dokumentohen në një dosje të veçantë vlerësimi që përfshin shpjegimin për secilin kontribut.

Diagrami rrejtë mundëson këto përfundime të përgjithshme:

- Në përgjithësi, ekziston një boshllëk i konsiderueshëm midis situatës aktuale dhe objektivit strategjik. Kjo shpjegon një proces ambicioz të NAP-it, ku të trajtohen pak a shumë të gjithë faktorët e suksesit të lartpërmendur.

- Situata aktuale tregon një nivel mbi mesataren për fushën e suksesit “vizioni afatgjatë dhe mandati”. Kjo i detyrohet mandatit të qartë ekzistues i cili është parashikuar nëpërmjet urdhrin të Kryeministrit nr. 155, datë 25.4.2014, për krijimin e Grupit Ndërministror të Punës për Ndryshimet Klimatike, dhe është përforcuar nëpërmjet lançimit të procesit të NAP-it nga zëvendësministri e Mjedisit më 19 shkurt 2015. E kundërta ndodh me dy faktorët e tjerë të suksesit për vizionin afatgjatë (ekzistenca e një plani koherent për përshtatjen dhe mbajtja në konsideratë e ndryshimit klimatik në planin zyrtar) të cilët janë vlerësuar si të dobët.

- Instrumenti SNAP e vlerëson situatën aktuale për informacionin mbi klimën shumë më poshtë se niveli i nevojshëm. Nga diskutimi doli se ekzistojnë një sërë studimesh, vlerësimesh dhe parashikimesh, por këto nuk njihen dhe nuk janë në dispozicion të ekspertëve të sektorit. Prandaj, e drejta për të marrë informacion duket se përbën një sfidë më të fortë se vetë informacioni.

- Ndjeshëm nën mesataren për situatën aktuale është fusha e suksesit “monitorimi dhe vlerësimi”. Kjo nuk përbën habi duke qenë se procesi i NAP-it është ende në fillimet e tij dhe nuk ka filluar ende me monitorimin e progresit të mëtejshëm të tij.




Diagram rrejtë nga analiza SNAP për Shqipërinë. Siç është përmendur, analiza SNAP ofron potencial për projektimin e një procesi NAP, që u jep zgjidhje boshllëqeve të dukshme dhe shfrytëzon mundësitë ekzistuese. Përfundimet në lidhje me projektimin e procesit të NAP-it janë nxjerrë gjatë takimit të punës, të vlerësimit të situatës nëpërmjet një analize SWOT. Rezultatet e analizës SWOT e nxjerra përgjatë këtij takimi, janë pasqyruar dhe përshtatur në diskutimet e mëpasshme nga të cilat ka dalë dhe diagrami SWOT, që paraqitet në figurën 26.

Pikat e forta	Pikat e dobëta
<ul style="list-style-type: none"> • Këshilli i Ministrave e ka dhënë mandatin për përgatitjen e NAP-it • Motivim i lartë nga ana e Ministrisë së Mjedisit • Cilësi e mirë e informacioneve ekzistuese për klimën. 	<ul style="list-style-type: none"> • Nuk ka të dhëna të gatshme dhe të përpunueshme për ministrinë e linjës • Nuk ka struktura të konsoliduara shtetërore për ndryshimet klimatike • Struktura të pamjaftueshme bashkërendimi për

	ndryshimet klimatike / nuk ka angazhim proaktiv nga ministrinë e linjës <ul style="list-style-type: none"> Mbizotëron puna e konsulentëve të jashtëm e palidhur me proceset shtetërore.
Mundësitë <ul style="list-style-type: none"> Këshilli i Ministrave e ka dhënë mandatin për përgatitjen e NAP-it Ka ekspertë të gatshëm jashtë administratës Opsionet teknike dihen në parim Ka potenciale për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në disa plane të reja të ardhshme Procesi NAP përfiton nga mundësitë e ardhshme për fonde klimatike. 	Rreziqet <ul style="list-style-type: none"> Mungesë kapacitetesh në të gjitha fushate qeverisjes shtetërore Kapaciteti i ulët personeli për ndryshimet klimatike Njohuri relativisht të ulëta për ndryshimet klimatike në ministrinë e linjës Mospranim i rëndësishëm së ndryshimeve klimatike nga politikat dhe publiku. Përputhshmëri e kufizuar mes fushave të ndryshme të bërjes së politikave.

Figura 256: Analiza SWOT për procesin shqiptar të NAP-it

Mesazhet kryesore të analizës SWOT mund të përmbledhen si vijon:

- Situata e informacionit ekzistues për klimën është relativisht e mirë, por nuk njihet mirë dhe nuk është e aksesueshme, siç është thënë më parë.

- Studimet, siç është përmendur më lart, ofrojnë baza të mira tematike për procesin e përshtatjes, por nuk janë të lidhura mjaftueshëm me proceset e qeverisë.

- Ndërgjegjësimi i kufizuar për ndryshimet klimatike në nivel politikëbërës, si dhe njohuritë e limituara të publikut e pengojnë të paturit e një procesi të fuqishëm të NAP-it. Politikat për ndryshimet klimatike vijojnë të jenë relativisht në fund të agjendës politike.

- Njohja e ndryshimeve klimatike dhe e procesit të NAP-it në veçanti, mund të përfitojë nga fakti që NAP-i mund të nxisë mundësitë për të marrë financim për klimën në përgjithësi dhe për të përfituar nga Fondi i Gjellbër për Klimën në veçanti.

- Një mundësi e rëndësishme lind nga fakti se janë duke u zhvilluar disa plane zhvillimi dhe plane sektoriale të cilët mundësojnë integrimin e ndryshimeve klimatike. Kjo analizohet më tej në kapitullin 4.6.

Në bazë të këtij instrumenti SNAP me pjesëmarrje dhe analize SWOT, procesi i NAP-it do të asistojë në plotësimin e boshllëqeve të identifikuara dhe do të përmbushë nevojat përmes zhvillimit të veprimeve prioritare në kapitullin 6.1.

2.8.2 Rezultatet e studimeve të mëparshme, vlerësimet e vulnerabilitetit dhe zhvillimet e koncepteve për përshtatjen.

2.8.2.1 Statusi i dijeve për efektet dhe vulnerabilitetin ndaj ndryshimeve klimatike

Shqipëria ka filluar mjaft herët të analizojë sistematikisht vulnerabilitetin ndaj ndryshimeve klimatike. Studimi i parë në këtë kuadër është kryer me 1993 për “Rrjedhojat e ndryshimeve klimatike për bregdetin shqiptar”³⁴, në kuadër të Programit të Menaxhimit të Zonave Bregdetare të UNEP/MAP-it. Komunikimi i Parë (KPK) dhe i Dytë (KDK) Kombëtar i Shqipërisë për UNFCCC-në (KPK-ja në vitin 2002 dhe KDK-ja në 2009) japin në kapitujt e tyre përkatës për vulnerabilitetin, dhe përshtatjen, informacion për skenarët e ndryshimit të klimës, analizën e efektit të ndryshimeve klimatike aktuale dhe të pritura, si edhe për vlerësimin e masave dhe veprimeve të përshtatjes. Komunikimi i Tretë Kombëtar jep njohuri të përditësuara dhe më të

³⁴Gjendet

në

adresën

<http://www.unepmap.org/index.php?module=library&mode=mts&action=results&styp=3&category=MAP%20Technical%20Reports%20MTS&descriptors=Climate%20change>

hollësisht për efektet e klimës dhe zgjedhjet alternative për përshtatjen për zonën bregdetare të Shqipërisë.

Procesi i komunikimeve kombëtare jo vetëm që është konsideruar si një instrument për raportimin përpara UNFCCC-ës, por edhe për nxitjen e integritimit, nëpërmjet identifikimit dhe integritimit të drejtimeve kryesore të politikave për klimën në proceset kombëtare të planifikimit dhe programimit.

Analiza e efektit për ndryshimet klimatike aktuale dhe të pritura, si dhe formulimi i nevojave për përshtatje, janë fokusuar në disa sektorë/sisteme:

- Burimet ujore (KPK, KDK dhe KTK);
- Ekosistemet natyrore (KPK, KTK);
- Ekosistemet e menaxhuara (bujqësia, pylltaria – KPK);
- Energjetika, transporti (KPK, KDK);
- Turizmi (KPK, KDK dhe KTK);
- Popullsia (KPK, KDK dhe KTK);
- Shëndetësia (KPK dhe KTK);
- Fatkeqësitë natyrore të lidhura me klimën (KTK).

Krahas komunikimeve kombëtare të gjithanshme, studimet dhe projektet sektoriale dhe rajonale sigurojnë informacion të rëndësishëm për modelimin klimatik, analizën e efekteve, vulnerabilitetet dhe masat e mundshme të përshtatjes në Shqipëri:

- “Identifikimi dhe zbatimi i masave përshtatëse në grykëderdhjet e Drinit dhe Matit” (GDDM)³⁵: Në rezultatet e këtij projekti pilot, të mbështetur nga GEF/UNDP/Qeveria shqiptare përfshihen:

1. Zhvillimi i kapaciteteve për të monitoruar dhe për t’iu përgjigjur efekteve të pritura të ndryshimeve klimatike në GDDM-ë në nivel institucional dhe në nivel komuniteti; 2. Integrimi i rreziqeve të ndryshimit të klimës dhe veprimeve vendore pilote për përshtatjen bregdetare në programet, planet dhe politikat për ruajtjen dhe zhvillimin e rajonit të GDDM-ës; 3. Zhvillimi i kapaciteteve për menaxhim, monitorim dhe vlerësim përshtatës për nxjerrjen e mësimave dhe përhapjen e rezultateve të projektit.

- “Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor”: Ky projekt i mbështetur nga GIZ-i këshillon ministrinë përkatëse në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Malin e Zi dhe Serbi, për hartimin dhe zbatimin e strategjive për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Në mënyrë specifike, projekti synon uljen e rreziqeve të përmbajtjeve dhe thatësirës, si edhe fuqizimin e bashkëpunimit rajonal në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

- “Ulja e vulnerabilitetit ndaj ndryshimeve të klimës në sistemet agrare të Shqipërisë: Vlerësimi i ndikimit dhe alternativat për përshtatjen”. Ky projekt i mbështetur nga Banka Botërore, ofron zgjedhje alternative për t’iu përshtatur ndryshimit të klimës, për sektorin agrar dhe atë të burimeve ujore, së bashku me masat konkrete të përshtatjes, për katër zonat e veçanta agroekologjike të Shqipërisë³⁶.

- “Vlerësimi i vulnerabilitetit, rreziqet dhe përshtatja në lidhje me ndryshimet klimatike në sektorin energjetik të Shqipërisë”: Ky projekt ka ofruar rritje të njohurive teknike dhe të kapaciteteve teknike për të arritur zgjedhje energjetike të qëndrueshme nga aspekti mjedisor dhe me aftësi rimëkëmbëse, në kuadër të uljes së varfërisë dhe rritjes ekonomike.

2.8.2.2 Njohuritë ekzistuese për ndryshimet klimatike, efektet e saj dhe vulnerabiliteti i Shqipërisë

Klima e Shqipërisë është një klimë tipike mesdhetare. Karakterizohet nga dimra të butë dhe reshje të bollshme dhe nga vera të nxehta dhe pa shira. Në bazë të relievit dhe të largësisë nga

³⁵Raportisintezë (2013) gjendet në adresën http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/environment_energy/



³⁶Raporti (2013) gjendet në adresën <http://hdl.handle.net/10986/16198>

deti, territori i Shqipërisë ndahet në katër zona klimatike: zona fushore mesdhetare, zona kodrinore mesdhetare, zona paramalore mesdhetare dhe zona malore mesdhetare.

Parashikimet për temperaturat

Të gjitha studimet ekzistuese thonë se Shqipëria ka të ngjarë të ngrohet më shumë sipas skenarëve të IPCC-ës. Figura 27 tregon se vëzhgimet reale të bëra pas vitit 2000, kanë dëshmuar se vlerat e arritura janë të barabarta me ato që qenë parashikuar më parë për vitin 2020.

³⁷ Në parashikimet për verën, ndryshimi i temperaturës vjetore ka të ngjarë të arrijë deri në 5,3°C (4,6 - 6,0°C) deri në vitin 2100. Zona bregdetare nuk ka të ngjarë të ketë temperatura mesatare më të ulëta se 25°C, duke filluar nga viti 2050; temperatura mesatare deri në 30°C do të mbizotërojë në të gjitha pjesët e kësaj zone nga viti 2100. Skenarët e IPCC-ës parashikojnë rritje më të ulët për temperaturat e dimrit dhe rritje më të larta për pranverën.



Parashikimet për reshjet

Figura 28: Parashikimet e reshjeve vjetore, pa dhe me ndryshimin e klimës (skenari mesatar). Fusha e përhirtë tregon ndrysheshmërinë e lartë të reshjeve (5%, kuantile 95%), që dëshmon rritjen e mundshme të shpeshtësisë së reshjeve të dendura dhe thatësirës. Burimi: Projektraporti i KTK-së.

Të gjithë skenarët parashikojnë një pakësim të mundshëm të reshjeve stinore në krahasim me vitin 1990 për të gjitha periudhat krahasuese. Reshjet vjetore ka të

ngjarë të pakësohen deri në -8,5% (-56,0 deri në 47,4 mm), deri në vitin 2050; dhe deri në -18,1% (-89,7 deri në 94,9 mm) brenda vitit 2100. Pavarësisht nga trendi i përgjithshëm në rënie, pritet ndryshim më i madh (vjetor dhe stinor), shoqëruar me një rritje të shpeshtësisë së reshjeve ekstreme dhe rreziqe të lidhura me klimën (figura 4). Parashikohet se, një herë në 10 vjet, mund të ndodhin dukuri të rrezikshme reshjesh në rajonin bregdetar verior (zona e Shkodrës) ndërsa në rajonin bregdetar të mesëm dhe jugor pritet të ndodhin një herë në 20 vjet. Megjithëse numri i dukurive të reshjeve ekstreme pritet të rritet, sa i takon shkallës dhe shpeshtësisë, ulja e niveleve të reshjeve në përgjithësi, do të rrisë numrin e ditëve të njëpasnjëshme pa reshje (thatësirë). Numri maksimal i ditëve me thatësirë ka të ngjarë të jetë më i madh në pjesën veriore (23 ditë) dhe deri në 15 ditë më në jug, brenda vitit 2100 në krahasim me periudhën krahasuese 1960-1990.

³⁷Parashikimet klimatike llogariten duke përdorur treguesin e skenarëve SRES IPCC AR4 (software MAGGIC/SCENGEN v.5.3, AR4 IPCC) zvogëluar në shkallën 1:1 km.

Parashikimet për ngritjen e nivelit të detit

Rritja e parashikuar e nivelit të detit (shih figurën 29) do të sjellë rreziqe më të larta të përmytjes për shumicën e zonave urbane në bregdet dhe rritje të rreziqeve të erozionit bregdetar.




Figura 29: Ndryshimet e mundshme në nivelin mesatar vjetor të detit (cm)

Si pasojë e rritjes së nivelit të detit, niveli i lumenjve pritet të rritet në pjesët e poshtme të baseneve lumore dhe prurjet të ngadalësohen. Gjithsej, deri në vitin 2030 afërsisht 1082,45 km² (32% e sipërfaqes së zonave bregdetare ose 3,76% e sipërfaqes së vendit) do të vuajë pasojat e drejtpërdrejta të përmytjeve. Do të humbasin sipërfaqe të mëdha toke

bujqësore të cilat nuk do të përdoren dot më, për shkak të mbulimit me ujë dhe të rritjes së sasisë së kripës në të. Shumica e habitateve bregdetare, si dunat e rërës, ligatinat me ujë të ëmbël dhe të kripur, kënetat dhe lagunat, do të zhduken ose do të përkeqësohet më tej statusi i tyre. Vija bregdetare e Adriatikut do të futet më në brendësi të tokës, erozioni bregdetar do të intensifikohet, ndërsa migrimi nga ligatinat bregdetare dhe habitatet e tjera në brendësi të tokës do të pengohet nga argjinaturat dhe veprat e kullimit të ndërtuara në kuadër të veprave të bonifikimit gjatë viteve '50-'60 të shekullit të shkuar.

SHËNIM. *Informacione të hollësishme për studimet kërkimore më të fundit për parashikimet e ndryshimeve klimatike dhe efektin e pritur do të jepen në raportin e Komunikimit të Tretë Kombëtar të Shqipërisë për UNFCCC-en.*

2.8.2.3 Njohuritë ekzistuese për vulnerabilitetin

Disa studime, si edhe Komunikimi i Parë, i Dytë dhe i Tretë, japin një pamje të qartë për vulnerabilitetet ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri. Shumë elemente të prekshmërisë kanë të bëjnë me sektorët e veprimtarive shoqëro-ekonomike. Përmbledhja e mëposhtme pasqyron kryesisht situatën aktuale, për shembull, ato fusha të vulnerabilitetit që janë të dukshme që tani. Megjithatë, shumica e efekteve mund të parashikohen se do të rriten në shkallë në të ardhmen.

- **Sistemet hidrologjike:** Ndryshimi i reshjeve ose shkrirja e borës po i ndryshon sistemet hidrologjike, duke prekur burimet ujore në sasi dhe në cilësi (siç është rasti i akuifereve të Matit).

- **Bujqësia:** Efektet negative të ndryshimit klimatik të rendimentet e kulturave bujqësore, kanë qenë më të shumta se efektet pozitive. Efektet mund të vijnë nga ndryshimi i temperaturave, reshjeve, sistemeve hidrologjike (për shembull, sistemet e ujitjes), cilësisë së tokës, erozionit dhe dukurive të motit ekstrem. Ndryshimet klimatike ka dhënë tashmë efekte negative në rendimentin e grurit, misrit dhe të kulturave të tjera në shumë krahina, si: Shkodra, Lezha, Lushnja, Fieri dhe Vlora. Disa periudha me rritje të shpejtë të çmimeve të ushqimeve dhe drithërave pas dukurive ekstreme të motit, në disa krahina bujqësore, tregojnë dhe ndjeshmërinë e tregjeve të tanishme nga moti ekstrem, ndër faktorë të tjerë.

- **Energjetika:** Përqindja e lartë që zënë burimet hidroenergjetike (lumi Drin prodhon rreth 90% të energjisë elektrike që përdoret nga industria dhe konsumatorët familjarë në Shqipëri) nënkupton efekte të drejtpërdrejta që mund të kenë ndryshimet e sistemeve hidroenergjetike të prodhimi i energjisë. Prodhimi i energjisë elektrike mund të shkojë nga thuhet 6.000 GWh në më pak se një e dyta e kësaj sasi në vite me shumë thatësi. Ndryshimet klimatike kanë të ngjarë të kenë një efekt negativ në prodhimin hidroenergjetik, deri në vitin 2050; prodhimi mesatar vjetor i energjisë elektrike nga HEC-et e mëdhenj të Shqipërisë, mund të bjerë me rreth 15% dhe nga HEC-et e vegjël me rreth 20%.

- **Shëndetësia:** Ka pasur rritje të vdekshmërisë së lidhur me motin e nxehtë dhe me motin e ftohtë në disa rajone, si pasojë e ndryshimeve klimatike. Ndryshimet lokale të temperaturave dhe shirave e kanë modifikuar përhapjen e disa sëmundjeve që transmetohen përmes ujit dhe të disa vektorë sëmundjeve. Megjithatë, statistikat nuk janë ende të qarta lidhur me shkaqet.

- **Vulnerabiliteti social:** Pabarazitë dhe vulnerabiliteti social, që vijnë si rrjedhojë e proceseve me zhvillim jo të njëjtë, i rëndojnë rreziqet nga ndryshimet klimatike. Personat në rrezik përjashtimi social janë sidomos të prekshëm nga ndryshimet klimatike, siç është parë në vendbanimet e paligjshme në brigjet e lumenjve dhe komunitetet periferike të Tiranës, në kënetë të Durrësit, në Mifol dhe në rrethinat e Vlorës, Shkodrës dhe Lezhës.

- **Pyjet:** Zjarret e pakontrolluara kanë qenë të pranishme përpara disa vjetësh në zonën e lisnajave, por nuk ka prova të qarta për shkaqet e tyre (sigurisht që këto zjarre ndihmohen nga efektet e lidhura me klimën).

- **Rreziqet dhe fatkeqësitë e lidhura me klimën:** Rritja e shpeshësisë së përmytjeve, thatësisë dhe dukurive të tjera ekstreme i përkeqësojnë faktorët e tjerë, shpesh me rezultate negative për infrastrukturën, sektorët e prodhimit dhe mjetet e jetesës së popullsisë, sidomos për komunitetet në rrezik përjashtimi social. Rreziqet e lidhura me klimën mund të prekin drejtpërdrejt jetën e njerëzve ose tërthorazi, nëpërmjet pasigurisë ushqimore, ndërprerjes së furnizimit me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, shkatërrimit të shtëpive etj.

- **Ekosistemet:** Ndryshimet e klimës kanë shkaktuar efekte në sistemet natyrore, të cilat janë të dukshme që tani në lagunat dhe zonat e mbrojtura bregdetare (që nga lumi i Bunës deri te lumi i Pavlës), si edhe në basenet lumore në ultësi (shpeshësia është më e madhe në lumenjtë Drin, Bunë dhe Vjosë). Dëshmitë për efektet e ndryshimeve klimatike janë më të forta dhe më të plota për sistemet natyrore, përfshirë zonat e mbrojtura bregdetare (p.sh. në Kune–Vain).

- **Speciet:** Shumë specie të tokës, ujërave të ëmbla dhe ujërave detare i kanë ndryshuar territoret e tyre, aktivitetet stinore, skemat e shtegtimin, numrin e popullatës dhe ndërveprimet mes specieve, si kundërpërgjigje ndaj ndryshimeve klimatike. E zakonshme po bëhet në Shqipëri hyrja në numër të madh e breshkave të detit *Caretta caretta*, në lagunën e Patokut, krahas hyrjeve të tjera të shumta të specieve të huaja (peshq, gaforre etj.).

- **Turizmi:** Ky sektor është i ekspozuar ndaj efekteve të shumta të drejtpërdrejta dhe të tërthorta nga ndryshimi i klimës. Rritja e nivelit të detit do ta rrezikojë infrastrukturën turistike dhe pikat turistike natyrore.

2.9 Parimet e NAP-it

2.9.1 Mesazhet kryesore

Procesi i NAP-it për Shqipërinë ndjek këto parime:

- NAP-i kuptohet kryesisht si një proces që zgjat shumë për të cilin ky dokument ofron elementet kuadër, si: parimet, objektivat, treguesit, veprimet prioritare dhe elementet e procesit.

- Ofron një kuadër për integrimin e synuar.

- Vendos një kuadër zbatimi.

- Mbështet mundësinë për të marrë financim sistematik nëpërmjet një dokumenti financiar.

- Është një katalizator për pjesëmarrjen dhe ndërgjegjësimin.

- Dokumenti Strategjik BE-IPA II Procesi në lidhje me Strategjinë e BE-së për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike është një udhëzues i rëndësishëm për integrimin e veprimeve për klimën në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE.

2.9.2 Funkcionet dhe parimet e përgjithshme

Në përputhje me kuadrin konceptual, siç parashikohet në Udhëzimet Teknike për NAP-in, NAP-i është projektuar në Shqipëri, si një proces nën drejtimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Grupin Ndërmintor të Punës për Ndryshimet Klimatike. Me anë të këtij procesi, ai mbështetet në orientimet që japin Udhëzimet Teknike, por i zbaton orientimet sipas situatës në Shqipëri në mënyrë të përshtatur, duke marrë në konsideratë situatën në fushën e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Në këtë mënyrë, Shqipëria siguron që procesi i NAP-it të ofrojë vlerë të shtuar, siç pritjet.

Në këtë kontekst, procesi i NAP-it në Shqipëri do të ndjekë funksionet e mëposhtme:

- **NAP si një proces efektiv:** Siç thuhet edhe më lart, NAP-i do të ndërtohet si një proces i vazhdueshëm gjatë një periudhe të gjatë kohore (me këtë dokument parashikohet një periudhë prej 20 vjetësh) që përfshin elementet e hartimit të planit, zbatimit të tij dhe nxjerrjes së mësimave nga përvojat. Ky proces përfshin ministrinë e linjës, të cilat do të luajnë një rol proaktiv në integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në portofolat sektoriale përkatës.

- **Dokumenti i NAP-it si “një ombrellë” që orienton drejtimin dhe veprimet e procesit të NAP-it:**

Në përputhje me parimet e lartpërmendura, dokumenti i NAP-it është formuluar në formë koncize, që të japë orientim për elementet e procesit gjithëpërfshirës, siç janë objektivat dhe treguesit, specifikimet e procesit, qasjet integruese, veprimet prioritare, financimi, strategjitë e informimit dhe përfshirjes, zhvillimi i kapaciteteve, monitorimi dhe rishikimi. Kjo natyrë “ombrellë” e dokumentit NAP, justifikohet edhe me faktin se ekzistojnë ose janë duke u përgatitur disa dokumente planifikimi dhe programimi për politikën klimatike, sidomos Komunikimet Kombëtare.

Kuadër për integrimin e synuar: Siç është përmendur, integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në sektorë është një qasje kyçe e parashikuar nga UNFCCC-ja dhe Udhëzimet Teknike të NAP-it. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike është e lidhur ngushtë me planifikimin afatgjatë të zhvillimit urban, burimeve ujore, bujqësisë, ruajtjes së natyrës dhe zhvillimit të territorit. Prandaj përfshirja e përshtatjes klimatike në sektorët e linjës që preken nga ndryshimet klimatike, është një qasje e efektshme. Vetëm në këtë mënyrë përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike mund të shndërrohet në kontribues për vendin, dhe mund të ndihmojë në sigurimin e rritjes ekonomike.

- **Krijimi i mekanizmave të zbatimit:** Studimet dhe strategjitë ekzistuese, sikurse përmendet në kapitullin 3, mbulojnë sektorë dhe aspekte të ndryshme të përshtatjes dhe përfshijnë disa propozime për veprime konkrete, për shembull nëpërmjet “fishave të projekteve”, për disa prej të cilave është rënë dakord të zbatohen. Megjithatë, në to nuk jepet një kuadër i njëtrajtshëm zbatimi. Ky dokument i NAP-it ofron vlerë të shtuar, nëpërmjet vënies në eficiencë të zbatimit. Por kjo nuk shkon përtej veprimeve të ashtuquajtura prioritare, të cilat konsiderohen se janë me rëndësi kryesore për të gjithë procesin e përshtatjes në Shqipëri. Dokumenti NAP përcakton piketat, afatet, aktorët dhe burimet për këto veprime kryesore në kapitullin 6.1. Një mekanizëm monitorimi do të ndjekë progresin e zbatimit për këto veprime dhe do të mundësojë bërjen e korrigjimeve, nëse del nevoja.

- **Mbështetje në mënyrë sistematike për financimin:** Sigurimi i financimit përbën parakusht për zbatimin dhe pasqyrohet në dokument. Gjithashtu një dokument financiar mbështetës është përgatitur me një grup më të gjerë se GNMPNK-ja, duke përfshirë përfaqësues nga zyrat e planifikimit të buxhetit të ministrive respektive (6.2). Aksesit i mekanizmave të reja të klimës do të operacionalizohet përmes procesit të NAP-it në bashkëpunim të ngushtë me institucionet përkatëse, si dhe do të mbështetet nga donatorë të fushës. Aspekti i marrjes së burimeve shtesë financiare nëpërmjet NAP-it, mund të forcojë njohjen e tij në nivel politik. Përveç burimeve ndërkombëtare të financimit, burimet nacionale dhe lokale të buxhetit duhet të hulumtohen sistematikisht, për financimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

- **Katalizator për pjesëmarrjen dhe ndërgjegjësimin:** Analiza SWOTka identifikuar dobësitë në njohjen publike të ndryshimeve klimatike dhe të nevojave për t’u përshtatur këtyre ndryshimeve. Procesit i NAP-it do të ketë me shumë pjesëmarrje dhe do të vazhdojë të aplikojë aktivitete të informimit dhe përfshirjes së publikut të gjerë dhe të grupeve të veçanta të synuara, si bujqit, sektori privat etj.

2.9.3 Lidhja me procesin e paraaderimit në BE

Shqipërisë i është dhënë statusi i vendit kandidat për shtet anëtar në Bashkimin Evropian dhe po ecën përpara në përafrimin e legjislacionit të brendshëm me kërkesat e BE-së. Për këtë arsye, strategjia e BE-së për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, e miratuar nga Komisioni

Evropian në prill 2013, do të konsiderohet si një kuadër referimi i rëndësishme, brenda të gjithë procesit të NAP-it. Rëndësi të madhe sa i takon veprimet të programuar dhe mundësisë për të përfituar nga fondet e BE-së, ka Dokumenti Strategjik Orientues për Instrumentin e BE-së për Asistencën Paraaderimit³⁸, miratuar më 18 gusht 2014. Dokumenti Strategjik për IPA II përcakton objektivat, treguesit dhe veprimet në një kapitull të veçantë “Dritarja për mjedisin dhe klimën” dhe e përcakton veprimin për klimën si një element ndërsektorial, i cili prek shumicën e sektorëve në Dokumentin Strategjik, sidomos transportin, energjetikën, bujqësinë, zhvillimin rural dhe menaxhimin e fatkeqësive. Shpenzimet e lidhura me klimën do të monitorohen në të gjithë gamën e ndërhyrjeve në Shqipëri, në përputhje me treguesit statistikorë të OECD-DAC-ës për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj saj. Kjo ofron një potencial të lartë për procesin e përgjithshëm të zbatimit të NAP-it të Shqipërisë.

3. VIZIONI DHE PRIORITETET E STRATEGJISË

Vizioni i strategjisë kombëtare të ndryshime klimatike fokusohet fort në tre komponentë kryesorë të ndryshimit të klimës në Shqipëri: masat zbutëse, adaptimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, që kanë rezultuar me vizionin e përgjithshëm si më poshtë:

*“Duke pranuar se ndryshimi i klimës përfaqëson një kërcënim urgjent dhe potencialisht të pakthyesbëm për shoqëritë njerëzore, sidomos për zonën e Mesdheut, **zhvillimi drejt ekonomisë me karbon të ulët është kyç për arritjen e objektivave globalë të zbutjes dhe për të lejuar një reagim të përshtatur të brezit të ardhshëm me kosto të arsyeshme mjedisore, ekonomike dhe sociale.**”*

3.1 Prioritetet e strategjisë

Në ndjekje të vizionit të lartpërmendur, janë identifikuar përparësitë e mëposhtme të strategjisë (PS):

- **SP.1** Garantimi i një rritjeje të qëndrueshme të ekonomisë në përputhje me rrugët e shkarkimit GES, të përcaktuara në NDC-ë(Kontributi Kombëtar),dhe shkuarja drejt një pikësnyimi në një ekonomi me karbon të ulët për të cilin kontribuojnë të gjithë sektorët.

- **SP.2** Ngritja e një sistemi monitorues, raportues dhe verifikues GES, në përputhje me kërkesat e BE-së.

- **SP.3** Forcimi i kapacitetit të institucioneve përkatëse dhe bashkëpunimi ndërinstitutional për trajtimin e çështjeve të ndryshimit të klimës.

- **SP.4** Integrimi i ndryshimeve klimatike në planifikimin strategjik sektorial.

- **SP.5** Përforcimi i kapacitetit dhe ndërgjegjësimit për çështjet e ndryshimit të klimës.

- **SP.6** Afrimi me kuadrin ligjor të BE-së për ndryshimin e klimës në gjithë sektorët.

Objektivat kryesorë të politikave specifikohe në paragrafët e mëposhtëm, duke marrë parasysh strategjitë dhe planet kryesorë sektoriale dhe ndërsektoriale. Për sa i përket përshtatjes, objektivat gjithëpërfshirës dhe indikatorët e NAP-it kontibuojnë në plotësimin e e prioriteteve të strategjisë së lartpërmendura 3-6 (siç jepen dhe në tabelën 16). Sidoqoftë, rezultatet përfundimtare afatgjata të procesit të përshtatjes do të synojnë:

- Zvogëlimin e dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet.

- Përmirësimin e aftësisë rimëkëmbëse të bujqësisë ndaj përmbytjeve.

- Sigurimin e ujit të pijshëm cilësor pavarësisht ndikimeve nga ndryshimet klimatike.

4 POLITIKAT KRYESORE QË PREKIN NDRYSHIMIN E KLIMËS

4.1 Qasjet specifike të sektorit përmes zbutjes

Planet dhe strategjitë ekzistuese janë përmbledhur dhe analizuar në perspektivën e zbutjes së ndryshimeve klimatike, duke trajtuar sinergjitë e shumta, boshllëqet dhe dobësitë, si dhe duke siguruar listën e masave kryesore strategjike, për të garantuar rrugët e zhvillimit me karbon të ulët.

Në kohën e shkrimit, po hartoheshin disa strategji dhe plane, dhe prandaj janë në formë drafti (si në rastin e planit dhe Strategjisë së Transportit, SKZHI-II dhe Komunikimit të Tretë Kombëtar) apo në stadin fillestar (si në rastin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë). Ndaj është

³⁸Komisioni Evropian: Dokumenti Strategjik Orientues për Instrumentin e BE-së për Asistencën Paraaderimit për Shqipërinë (2014-2020), datë 18 gusht 2014.

parashikuar një rishikim periodik i kësaj strategjienë dritën e zhvillimit të strategjive kryesore sektoriale në rrjedhën e viteve të ardhshme.

Tabela më poshtë rendit strategjitë, planet dhe ligjet e analizuara me vlefshmërinë e tyre, institucionet përgjegjëse dhe versionin e përdorur në kohën e shkrimit.

Përveç strategjive dhe planeve të përmendura në tabelë, janë marrë në konsideratë një seri raportesh dhe analizash të renditura në aneksin 1. Mes tyre, vëmendje e veçantë i është kushtuar Komunikimit të Tretë Kombëtar, që ndonëse nuk mund të konsiderohet plan operativ, siguron tregues të dobishëm për veprimet e masave zbutëse që janë marrë në konsideratë në hartimin e strategjisë dhe planit.

Tabela 12 – Lista e strategjive, ligjeve dhe planeve të përfshira në dokumentin e SKNK-ës

Dokumenti	Vlefshmëria	Institucionet*	Versioni aktual
Ndërsektorial			
Kontributi i Kombëtar i Pikësnyuar (INDC) në kuadrin e UNFCCC-ës	2015-2030	MIE	25 gusht 2015
Strategjia Mjedisore Ndërsektoriale (SMNS)	2015-2020	MIE	Nuk ka datë në dokument
Strategjia Kombëtare për Integrimin e Zhvillimit (SKZHI-II)	2015-2020	QSh	Drafti i dytë korrik 2015
Projektligj për Ndryshimin e Klimës	Nga hyrja në fuqi deri në rishikim	MM	Drafti i tretë (Janar 2018)
Plani Kombëtar i Territorit (PKT)	2015-2030	AKPT dhe MZHU	Aprovuar me VKM nr. 881, datë 14.12.2016
Plani i integruar ndërsektorial për bregdetin.	2015-2030	AKPT dhe MZHU	Dhjetor 2016
Sektori i energjisë			
NAMA- Zëvendësimi i lëndëve djegëse fosile me mbetje të parrezikshme në industrinë e çimentos në Shqipëri	2015-2020	MIE /ME	Nuk ka datë në dokument
NAMA-Financimi i mekanizmit për eficiencën e energjisë në ndërtesa	2015-2020	MIE /ME	10 dhjetor 2014
Plani i Parë Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE)	2010-2018	MIE	Miratur 2011
Plani i Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë në Shqipëri (BERBER)	2015-2020	MIE	Janar 2016 (miratur nga Këshilli i Ministrave)
Ligji 124/2015 për Eficiencën e Energjisë	Nga hyrja në fuqi deri në rishikim	MIE	Miratur nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Presidenti në nëntor 2015
Projektligj për Burimet e Energjisë së Rinovueshme	Nga hyrja në fuqi deri në rishikim	MIE	Drafti shtator 2015
Projektligj për Performancën e Energjisë në Ndërtesa (PEN).	Nga hyrja në fuqi deri në rishikim	MIE	Draftifinal – 15 dhjetor 2015
Sektori i Transportit			
Strategjia dhe Plani i Veprimit i Sektorit të Transportit (SSTPV)	2016-2020	MTI	Draft 0.1 – 31 janar 2016
Plani për Transport të Qëndrueshëm (TECTQ) – Dokumenti bazë.	2016-2020	MTI	Raporti i Objektivave të Qëndrueshëm – 05 maj 2015
Bujqësia dhe LUCF-ja			
Strategjia ndërsektoriale për Bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri (SNBZHR)	2014-2020	MBZHR	Versioni i fundit qershor 2014
Programi i Zhvillimit Rural 2014–2020 në kuadrin e Instrumentit për Asistencë para Anëtarësimit (IPARD)	2014-2020	MBZHR	28 Maj 2015
Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit (DPSMB)	2016-2020	ME	Miratur me VKM nr. 31 datë 20 janar 2016
Projektligj për Administrimin e Fondit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave në Republikën e Shqipërisë.	Nga hyrja në fuqi deri në rishikim	ME	Drafti janar 2015
Sektori i ujit			
Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore		MBZHR	Drafti 21 dhjetor 2016

4.1.1 Strategji dhe plane ndërsektoriale

Strategjia e Dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI-II), Strategjia Mjedisore Ndërsektoriale (SMNS) dhe Plani Kombëtar i Territorit (PKT) “Shqipëria 2030” janë strategjitë kryesore ndërsektoriale që trajtojnë, ndër të tjera, çështje që lidhen me zbutjen e ndryshimit të klimës, duke përfshirë veprime dhe masa për të trajtuar drejtpërdrejt apo tërthorazi, çështjet e ndryshimit të klimës. SKZHI-II, që ishte ende në formë drafti në kohën e shkrimit, paraqet vizionin e Shqipërisë për zhvillimin e saj kombëtar, social, demokratik dhe ekonomik gjatë periudhës 2015–2020, si dhe aspiratat e saj për Integrimin Evropian. Strategjia Mjedisore Ndërsektoriale 2015–2020, miratuar së fundmi, fokusohet te çështjet mjedisore në përgjithësi, përfshirë ndryshimin e klimës, ndërsa Plani Kombëtar i Territorit (PKT) “Shqipëria 2030” përfaqëson një instrument me rëndësi të planifikimit të territorit në Shqipëri, dhe fokusohet në zhvillimin e qëndrueshëm strategjik të territorit, përmes përdorimit racional të tokës, menaxhimit të përgjegjshëm të burimeve të tij natyrore dhe mbrojtjes së mjedisit.

Draftstrategjia Mjedisore Ndërsektoriale (SMNS)

Vlefshmëria: 2015-2020

Vizioni i përgjithshëm i dokumentit është “një vend me zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik, ndërsa mbron burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, përmes menaxhimit të integruar dhe promovimit të vlerave, duke i vënë në dobi të prosperitetit ekonomik. Ky vizion bazohet në parimin e zhvillimit të integruar, ku mbrojtja dhe përmirësimi i gjendjes afatmesme mjedisore garanton sigurinë e rritjes ekonomike dhe mirëqenies sociale.”

Strategjia siguron një listë veprimesh dhe masash për temat kryesore, si vijojnë: ndryshimi i klimës, cilësia e ajrit, produktet kimike, ujërat, menaxhimi, mbrojtja e natyrës, pyjet dhe kullotat, me synim mbrojtjen e mjedisit, me disa veprime të fokusuara veçanërisht te përshtatja dhe zbutja e ndryshimeve klimatike, për periudhën afatmesme (2015–2017) dhe afatgjatë (2017–2020).

Shumë nga masat e shumta të përfshira në dokument ndikojnë pozitivisht në zbutjen e ndryshimit të klimës, ndonëse nuk synojnë në mënyrë eksplicite atë qëllim. Masa të tilla janë përfshirë në sektorë të ndryshëm:

- **Cilësia e ajrit dhe shkarkimet:** planifikimi më i mirë urban (sidomos në qytetet më të ndotura Tiranë dhe Durrës), optimizimi i trafikut, përmirësimi i transportit publik për të zëvendësuar mjetet private, dhe përdorimi i mjeteve alternative të transportit rrugor, kontrolli i shkarkimeve të gazrave të mjeteve etj., dhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbra;

- **Kimikatet:** menaxhim më i mirë i produkteve kimike për mbrojtjen/fertilizimin e bimëve, duke përfshirë këtu paddyshim plehrat azotike që janë përgjegjëse për shkarkimet GES;

- **Zonat e mbrojtura:** rritja e sipërfaqes dhe përmirësimi i menaxhimit të atyre ekzistuese, identifikimi dhe ngritja e rrejtës “Natura 2000” të Zonave Speciale të Konservimit me rëndësi për Bashkimin Evropian, për të siguruar një gjendje të favorshme konservimi, si dhe rritja e potencialit të izolimit të karbonit të ekosistemit natyror;

- **Pyjet dhe kullotat:** përmirësimi i pyjeve me plane menaxhimi të qëndrueshme dhe multifunksionale dhe pyllëzimi, parandalimi i prerjeve të paligjshme përmes kontrollit të Policisë Pyjore, parandalimi i zjarreve, ripyllëzimi i pyjeve bregdetare dhe të brendshme për të shmangur erozionin e tokës me pasojë humbjen e karbonit, parandalimi i degradimit të mëtejshëm, si dhe mbrojtja e biodiversitetit, duke siguruar potencialin maksimal për të përmbushur funksionet ekologjike, dhe për të rritur sekuestrimin e karbonit;

- **Burimet ujore:** përfshirja e çështjeve të ndryshimit të klimës në gjithë dokumentet strategjike të menaxhimit të ujit, menaxhimi më i mirë i burimeve ujore, për reduktimin e efekteve të përmbytjeve dhe thatësive dhe humbjeve pasuese të tokës.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI-II)

Vlefshmëria: 2015-2020

Vizioni i përgjithshëm i dokumentit është “Shqipëria – një demokraci vibruese në udhën drejt integritit me Bashkimin Evropian, me një ekonomi konkurruese, të fortë dhe të qëndrueshme, si dhe me garanci të të drejtave themelore dhe lirive të njeriut”.

Strategjia identifikon gjashtë përparësi kyçe të qeverisë, synimi kryesor i të cilave është integrimi në BE: (1) shërbime publike novatore dhe të përqendruara te qytetarët (qeverisja e

mirë); (2) furnizimi me kosto efektive me energji elektrike (energji); (3) rritja e novacionit dhe konkurrencës (investime të huaja direkte); (4) rritja e disponueshmërisë së tokës së ujitur dhe të kulluar (uji dhe bujqësia); (5) rritja e qëndrueshmërisë së tregjeve të tokës (pronat); (6) reforma strukturore e taksave.

Synimet e strategjisë mbështeten nga katër shtylla: Zhvillimi përmes stabilitetit makroekonomik dhe fiskal- përbën **Shtyllën 1** të mbështetjes mbi të cilën do të arrihet vizioni i SKZHI-II; Rritja përmes shtimit të konkurrencës- përbën **Shtyllën 2**; Investimi te njerëzit dhe kohezioni social- përbën **Shtyllën 3**; Zhvillimi përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve- përbën **Shtyllën 4**.

Strategjia bazohet ndër të tjera te **Parimet e Qëndrueshmërisë**. SKZHI-II bazohet në zbatimin e parimeve të pranuar botërisht të zhvillimit të qëndrueshëm, përfshirë ato të Deklaratës së Komisionit Evropian për Parimet Udhëheqëse për Zhvillimin e Qëndrueshëm.³⁹Ndër shumë parime të përfshira te qëndrueshmëria, theks i veçantë i jepet ruajtjes mjedisore, përmes promovimit të prodhimit dhe konsumit të qëndrueshëm, parandalimit të degradimit mjedisor, integritit të çështjeve mjedisore në gjithë strategjitë sektoriale, në nocionin e përgjegjësisë së përbashkët sociale, si dhe në zbatimin e parimit parandalues në aktivitetet e planifikuara⁴⁰.

Mes gjashtë përparësive, përparësia 6 synon të **sigurojë rritje përmes ndërlidhjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve**. Ajo parashikon investime në infrastrukturën e vendit – energji, transport, burime natyrore dhe mjedis, bujqësi, miniera, turizëm, ujë – që do të zgjerojnë mundësitë për biznesin dhe ekonominë, do të rrisin mirëqenien e qytetarëve shqiptarë, si dhe do ta çojnë përpara vendin në udhën e tij të integritit në sistemet evropiane përmes:

- një sistemi energjie me kosto efektive dhe të qëndrueshme bazuar te parimet e tregut
- një sistemi transporti kombëtar dhe të integruar
- një sektori bujqësor dhe agroushqimor më të diversifikuar
- një mjedisi të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm
- një industri minierash të qëndrueshme dhe të diversifikuar
- sisteme të zgjeruara dhe të përmirësuara të furnizimit me ujë dhe të menaxhimit të ujit
- forcimin e planifikimit të territorit, hapësirës dhe të banesave.

Veprimet që ndikojnë pozitivisht në zbutjen e ndryshimit të klimës në kuadrin e **Shtyllës 4: Rritja përmes Përdorimit të Qëndrueshëm të Burimeve**, synojnë:

- Nënsektorin e energjive të rinovueshme dhe eficiencën e energjisë: (1) duke arritur angazhimet e Shqipërisë në kuadrin e nismës së BE-së “Paketa për Klimën dhe Energjinë 2020” për rritjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme; (2) përmirësimi i eficiencës së energjisë dhe reduktimin e shkarkimeve CO₂; (3) diversifikimi i burimeve të rinovueshme në vend, jo vetëm nga burimet hidroenergjetike, por edhe nga era, dielli, biomasa dhe burimet gjeotermale; (4) menaxhimi i kërkesës për energji përmes rritjes së eficiencës së përdorimit të energjisë, sidomos në banesa.

- Reduktimi i humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes deri në 14%.

Deri në vitin 2020, të arrihet një rritje e pesëfishtë në vëllimin e pasagjerëve krahasuar me nivelet e vitit 2013, dhe një rritje e dyfishtë në transportin hekurudhor të mallrave mbi nivelet e vitit 2013 (me theks te transporti rajonal), përmes rindërtimit të hekurudhës që lidh Tiranë–Durrës, Vorë–Hani i Hotit, Durrës–Elbasan, Rrogozhinë–Vlorë dhe Elbasan–Pogradec–Kufi me Maqedoninë⁴¹.

³⁹<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52005DC0218>.

⁴⁰ Çdo projekt, program dhe/ose aktivitet duhet planifikuar dhe zbatuar në një mënyrë që të ketë ndikimin më të vogël të mundshëm negativ mbi mjedisin, ose ta zbusë çdo ndikim të tillë negativ përmes masave korrigjuese dhe/oseparandaluese.

⁴¹Kjo do të përfshinte zgjatimin tregues të TEN-T në Rrjetin Hekurudhor të Ballkanit Perëndimor: Linja 2 - Podgoricë (Mali i Zi) – Durrës/Tiranë (Shqipëri).

- Arritja e targetit prej 38% në përdorimin e energjisë së rinovueshme krahasuar me konsumin përfundimtar total të energjisë, përmes miratimit dhe zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Energjinë e Rinovueshme.

- Nxiti prodhimin e qëndrueshëm të ushqimit dhe cilësinë, duke zhvilluar një sektor konkurrues dhe novator agrorshqimor që është i aftë të përballojë trysnitë e konkurrencës.

- Siguron menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ndërmerr veprime për klimën përmes:

- Menaxhimin më të mirë të pyjeve dhe ujërave, si dhe zbatimit të metodave të prodhimit bujqësor në mbrojtjen e mjedisit dhe zbutjen e ndryshimeve të klimës;

- Një rritje të synuar e numrit të fermave organike të certifikuara deri në vitin 2020;

- Një rritje në numrin e fermerëve që përfitojnë nga infrastruktura e ujitjes, me 300,000 deri në vitin 2020.

- Reagimit ndaj ndryshimit të klimës dhe kontributit për mbrojtjen e shtresës së ozonit deri në vitin 2020 përmes:

- Pikësynimit për reduktimin me 8% të GES-it krahasuar me skenarin bazë⁴²;

- Pikësynimit për reduktimin me 40% të sasisë së HCFC-ës (hidroklorofluorokarboni).

- Rritja dhe forcimi i mbrojtjes së natyrës përmes:

- Pikësynimit për rritje me 17% të sipërfaqes së zonave të mbrojtura të territorit, përmes përmirësimit dhe menaxhimit të integruar të zonave të mbrojtura.

- Ngritja e rrjetit ekologjik “Natura 2000”.

- Sigurimi i statusit të konservimit për 5% të specieve dhe habitateve të rrezikuara.

- Forcimi i menaxhimit dhe ruajtjes së burimeve pyjore dhe kullotave përmes:

- Një pikësynimi për reduktimin 40% të prerjeve të paligjshme deri në vitin 2020.

- Arritjes së mbulimit 100% me plane menaxhimi për gjithë ekonominë pyjore në mbarë vendin.

- Rehabilitimit të 25% të zonave të degraduara.

- Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm në Shqipëri, që ndikon në mënyrë indirekte pozitivisht në ndryshimin e klimës, duke qenë se ruan ekosistemet natyrore.

- Forcimi i menaxhimit të përdorimit të ujit, me qëllim që të reduktohen përmytjet dhe fenomeni i erozionit dhe humbjes së tokës, përmes:

- Rehabilitimit dhe modernizimit të infrastrukturës ekzistuese lidhur me ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmytjet.

- Zhvillimit dhe zbatimit të mekanizmave për menaxhimin e qëndrueshëm të ujitjes, kullimit dhe sistemeve të mbrojtjes nga përmytjet (përmirësimi cilësor i funksionalitetit të sistemit të kullimit).

- Përgatitjes dhe zbatimit të planeve të menaxhimit të baseneve të lumenjve.

- Koordinimit dhe menaxhimit të përdorimit të ujërave në kontekstin e çështjeve që lidhen me ndryshimin/zbutjen e klimës.

- Rehabilitimit të shtretërve të dëmtuar të lumenjve.

Plani Kombëtar i Territorit (PKT)

Vlefshmëria: 2015-2030

Plani Kombëtar i Territorit (PKT) “Shqipëria 2030” është përgatitur nga Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit dhe ish Ministria e Zhvillimit Urban, në përputhje me Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Ai përfaqëson një instrument me rëndësi të planifikimit të territorit në Shqipëri, që i trajton çështjet sektoriale në mënyrë të integruar, në kuadrin e synimit për planifikimin e territorit shqiptar (61 bashki të organizuara në 4 zona kryesore) si i tërë.

⁴² Parashikimet aktuale të shkarkimeve GES në vitin 2020 tregojnë 18,000 Gg CO₂ eq. Parashikimi do të rishikohet gjatë periudhës 2014/2015 në kuadrin e Komunikimit të Tretë Kombëtar të UNFCCC-ës. Në rast financimi ndërkombëtar për NAMA-n (masat përkatëse kombëtare për reduktimin e GES-it) reduktimi i GES-it mund të rritet me 16%, krahasuar me skenarin bazë.

Synimi kryesor i PKT-ës është përgatitja e një kuadri zhvillimi hapësinor për territorin shqiptar, me qëllim që të rritet mirëqenia e qytetarëve dhe rritja ekonomike e vendit, duke zvogëluar pabarazinë, duke forcuar partneritetin strategjik me vendet fqinje dhe zbatimin e politikave që forcojnë konkurrencën e sektorëve ekonomikë, duke siguruar kështu integrimin në Bashkimin Evropian. PKT-ja përfaqëson bazën për harmonizimin e politikave ndërsektoriale dhe siguron kuadrin strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit për 15 vitet e ardhshme, duke siguruar një zhvillim të balancuar ekonomik dhe social, përmes përdorimit racional të tokës, menaxhimit të përgjegjshëm të burimeve të saj natyrore dhe mbrojtjes së mjedisit.

PKT-ja përfshin shumë masa që ndikojnë pozitivisht në zbutjen e ndryshimit të klimës në sektorë të ndryshëm.

Energjia:

- Zhvillimi i infrastrukturës së energjisë për të rritur energjinë e rinovueshme;
- Realizimi i korridoreve të energjisë për integrimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe gazit me korridoret e transportit, duke realizuar unifikimin e korridoreve të infrastrukturës;
- Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike në rajonin perëndimor, skajet verilindore dhe në juglindje të vendit, duke shtuar qasjen në rrjetin kombëtar;
- Forcimi i rrjetit të furnizimit me energji elektrike për t'i shërbyer grupeve specifike për kërkesat në zonat industriale, zonave përpunuese të paraqitura si zona të lira ekonomike, dhe të tjera të ngjashme;
- Një integrim më i mirë në rrjetin e jugut dhe juglindjes së Shqipërisë;
- Përfundimi i projektit të Gazsjellësit Trans-Adriatik (TAP);
- Realizimi i projektit të Gazsjellësit Jon-Adriatik (IAP).

Transporti:

- Reduktimi i shkarkimeve ndotëse (CO₂) deri në vitin 2030, përmes investimeve në teknologji, inovacionit dhe ndërtimit të kapacitetit, në përputhje me objektivin evropian për vitin 2030, për reduktimin e shkarkimeve me 60% për transportin në përgjithësi;
- Stimulimi i sistemit inteligjent të zhvillimit urban me sisteme transporti multimodale dhe miqësore me mjedisin, nëpërmjet lidhjeve të linjave hekurudhore me portet dhe aeroportet kryesore;
- Nxitja e përdorimit të teknologjive të reja miqësore me mjedisin në transport, si përdorimi i energjisë elektrike, hidrogjenit dhe teknologjive hibride, për transportin e mallrave në distanca të largëta;
- Promovimi i transportit publik urban dhe infrastrukturës alternative të transportit, si rrugët për biçikleta;
- Ristrukturimi i sistemit hekurudhor për linjat kombëtare që lidhin Shqipërinë me Ballkanin dhe Evropën, si dhe ndërtimi i linjave hekurudhore dhe sistemeve rrugore efikase për të mbështetur lëvizjen ndërqytetëse, në distancë të gjatë dhe ndërkufitare;
- Forcimi i strukturave ekzistuese të porteve dhe aeroporteve.

Bujqësia:

- Ngritja dhe konsolidimi i qendrave kërkimore për analizën e produkteve bujqësore;
- Ndërtimi i strukturave me kapacitet të mjaftueshëm për mbledhjen, përpunimin dhe paketimin e produkteve të ndryshme bujqësore, të mbledhura nga fermerët vendorë;
- Krijimi i tregjeve vendore për promovimin dhe marketingun e produkteve bio-organike;
- Mbrojtja dhe ruajtja e zonave të thella të përshtatshme për kultivimin e bimëve aromatiko-mjekësore, si dhe sigurimi i mbështetjes për të garantuar vazhdimin e kultivimit dhe mbledhjes së llojeve të ndryshme të bimëve aromatike-mjekësore, të përdorura gjerësisht në tregun farmaceutik;
- Promovimi i lidhjeve kërkimore dhe zhvilluese mes qendrave të inovacionit dhe fermave/qendrave të përpunimit të ushqimit, me qëllim që të krijohen qendra bujqësore të nivelit të lartë.

LUCF-ja:

- Ruajtja e ekosistemeve, biodiversitetit dhe burimeve natyrore në zonat e gjelbra, duke balancuar efektet e sistemeve të banesave dhe aktiviteteve ekonomike;
- Rritja e zonave natyrore dhe hapja e korridoreve parësorë që lidhin luginat natyrore përgjatë lumenjve;
- Njohja e tri zonave strategjike, si tri parqe kombëtare, zhvillimit të të cilave i duhet dhënë përparësi për ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të peizazhit natyror: parku i Alpeve, parku i Bunës, parku i Vjosës;
- Zbatimi i projektit “Rrjeti kombëtar i biçikletave, që hyn dhe kalon në zona natyrore, historike dhe të trashëgimisë kulturore”;
- Projektet e ripyllëzimit dhe rigjenerimit në zonat e degraduara nga erozioni dhe ndodhitë e përmytjeve.

Projektligj për ndryshimet klimatike

Vlefshmëria: Nga hyrja në fuqi (pritet brenda vitit 2019) deri në rishikim

Qeveria e Shqipërisë po punon aktualisht për të përfunduar një ligj mbi ndryshimet klimatike, me qëllim që të përmbushë detyrimet kombëtare në kuadrin e UNFCCC-ës, duke pasur parasysh detyrimet e ardhshme të Marrëveshjes së Parisit, si dhe për të garantuar një kuadër institucional efektiv në nivel kombëtar që kontribuon për zbutjen e shkarkimeve GES të vendit, dhe ruan e shton përthithësit dhe sekuestruesit e karbonit.

Synimi i ligjit është që të krijojë një bazë ligjore në Republikën e Shqipërisë, për përmbushjen e detyrimeve kombëtare në kuadrin e UNFCCC-ës dhe garantimin e masave efektive për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës, si në nivel kombëtar ashtu dhe vendor, si dhe veprimet matëse/monitoruese, raportuese dhe verifikuese që lidhen me to.

Ligji fokusohet te rregullimi i aktiviteteve që lidhen me shkarkimet dhe përthithjen e GES-it, si dhe me matjen, monitorimin, raportimin dhe verifikimin e tyre në lidhje me operatorët e instalimeve të mëdha, sektorin e transportit, referuar veçanërisht aviacionit, aktiviteteve të transportit të mallrave dhe atij rrugor, energjisë dhe sektorit të ndërtimeve, substancave holluese të ozonit dhe gazet e fluorit, pylltarisë dhe bujqësisë, si dhe kapjes nëpërmjet përthithësve të karbonit dhe magazinimit gjeologjik.

4.1.2 Energjia

Kuadri kryesor i politikës i cili duhet konsideruar brenda dokumentit të SKNK&P-së për sektorin e energjisë është INDC-ja shqiptare, i cili u dorëzua në shtator 2015, dhe përshkruan uljen e intensitetit të shkarkimeve deri në vitin 2030. Përveç këtij, një tjetër dokument i rëndësishëm është Plani i Veprimit BER, i cili është miratuar nga Këshilli i Ministrave në janar 2016, dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e tij janë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me Agjencitë e saj të varësisë – Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN).

Dokumentit i SKNK&PV-ës fokusohen në Planin e dytë dhe të tretë Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë për Shqipërinë, 2017-2020.

Veç PKVEE-së, tre janë ligjet kryesore të cilat rregullojnë sektorin: Ligji nr. 7/2007 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme”, Ligji 124/2015 mbi Eficiencën e Energjisë dhe Ligji nr. 116/2016 “Për performancën e energjisë së ndërtesave. Së bashku, këto ligje sigurojnë themelin mbi të cilin mund të ndërtohet një kuadër më i plotë rregullator, mund të sigurojnë strukturën institucionale dhe mbështetje financiare, si dhe të zbatojnë masat e parashikuara brenda PKVEE-ës dhe Planit të Veprimit BER. Për më tepër, ligjet përfaqësojnë shumë kërkesa të legjislacionit të BE-së.

Së fundi, merren parasysh dhe Masat Zbutëse të Përshtatshme për Vendin (NAMA-t). NAMA-t i referohen një sërë politikash dhe veprimesh të cilat ndërmarrin vendet si pjesë e një angazhimi, për të reduktuar shkarkimet e gazet me efektin serrë nën UNFCCC-ë. NAMA-t mund të marrin forma të ndryshme në varësi të vendit në zhvillim, i cili i propozon, ato zakonisht kërkojnë asistencë financiare dhe teknike nga vendet e zhvilluara për të reduktuar shkarkimet.

Qeveria shqiptare ka aprovuar dy NAMA-t, një që merret me përdorimin e mbetjeve si burim energjie në industrinë e çimentos dhe tjetra që merret me mekanizmin e financimit për përmirësimin e eficiencës së energjisë në banesa.

Gjatë analizës së mjeteve ekzistuese të politikave, është marrë gjithashtu në konsideratë si referencë Plani i Procesit të Uljes së Karbonit në Shqipëri, i cili u hartua nën projektin e LOCSEE⁴³-së. Ky dokument nuk është një plan i plotë, por i jep sugjerime të përgjithshme Qeverisë shqiptare, se si të vendosë objektivin e zhvillimit të një procesi të uljes së karbonit në Shqipëri, në bazë të objektivave dhe planeve ekzistuese (të përshkruara në PKVEE dhe BER), si dhe çështjeve të tjera përkatëse.

Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar i Shqipërisë (INDC)

Vlefshmëria: 2016–2030

Ky dokument përcakton karakteristikat kryesore të Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar nga Shqipëria në Procesin e Marrëveshjes së Parisit, dërguar pranë Sekretariatit të UNFCCC-ës, në shtator 2015. INDC-ja përfaqëson një deklaratë nga një Palë e UNFCCC-ës mbi kontributin e saj kundrejt zbutjes së ndryshimeve klimatike, sipas Marrëveshjes së Parisit. Në INDC-në e saj, Shqipëria shpreh angazhimin e saj për uljen e shkarkimeve CO₂ krahasuar me skenarin bazë gjatë periudhës 2016 dhe 2030 në masën 11.5%. Kjo ulje nënkupton ulje 708 kt CO₂ deri në vitin 2030. Sipas dokumentit, kjo është në përputhje me normën vjetore për frymë të shkarkimit të gazit të 2 ton CO₂, deri në vitin 2050. Karakteristikat kryesore të INDC-ës janë:

- Përqendrimi vetëm mbi CO₂ dhe në sektorët e energjisë dhe industrisë;
- Synimi për të shitur kreditet e karbonit deri në vitin 2030, në kuadër të një “mekanizmi të tregut ndërkombëtar” “kushtëzuar nga të pasurit e rregullave efektive të kontabilitetit, të zhvilluara nën UNFCCC-ën për të siguruar integritetin mjedisor të mekanizmave”;
- Synimi për të zhvilluar një strategji Mjedisore dhe të Ndryshimeve Klimatike, të bashkërenduar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Dispozita kryesore dhe zyrtare është përcaktimi i objektivit të uljes së shkarkimeve, të përcaktuara si ulje kundrejt një kufiri bazë të shkarkimit, të llogaritur me anë të një skenari bazë. Duke iu referuar përkufizimit, ky objektiv do të ndikojë pozitivisht në zbutjen e ndryshimeve klimatike, në qoftë se përfshihet në mënyrë efektive në planifikimin e politikave në Shqipëri, dhe në qoftë se ushtrimi i modelimit, i cili mbështet këtë objektiv kryhet në mënyrë korrekte. Objektivi përcaktohet si më tej: “të ulë shkarkimet CO₂ në krahasim me skenarin bazë gjatë periudhës të vitit 2016 dhe 2030 në masën 11.5%”. Uljet duhet të kryhen në sektorin e industrisë dhe energjisë, duke zbatuar mundësitë e zbutjes së kostos efektive, të identifikuar në KTK-ën dhe PKVEE-në, duke përfshirë futjen në masën 10% të biokarbureve në përzierjen e karburantit të transportit deri në vitin 2030.

Synimi i shprehur nga Shqipëria për të marrë pjesë në një treg ndërkombëtar karboni ka gjithashtu një potencial të mirë për të kontribuar në uljen e shkarkimeve GES në një mënyrë me kosto efektive.

NAMA: Zëvendësimi i lëndëve djegëse fosile me mbetje të parrezikshme në industrinë shqiptare të çimentos

Vlefshmëria: 2015 -2017 (me synimin për të vazhduar edhe pas kësaj periudhe)

Ky është një nga dy Masat Zbutëse të Përshtatshme për Vendin (NAMA), të aprovuara nga qeveria shqiptare. Veprimi propozon organizimin e grumbullimit të mbetjeve në mënyrë të tillë që të çojë në përdorimin e mbetjeve, në vend të lëndëve djegëse fosile në furra, nga industria shqiptare e çimentos. Kjo do të ndihmojë në uljen e ndotjes lokale, për shkak të mbetjeve dhe

⁴³ Projekti LOCSEE-së (Karboni i Ulët i Evropës Juglindore) është një projekt dyvjeçar (2012-2014) bashkëfinancuar nga Bashkëpunimi Transnacional i Evropës Juglindore, i cili ka si qëllim përmirësimin e procesit të integritetit territorial, ekonomik dhe social në SEE, duke përfshirë edhe Shqipërinë.

depozitimit të jashtëligjshëm të tyre, uljen e shkarkimeve të karbonit dhe varësisë nga lëndët djegëse fosile. Masa përmbledhet në një subvencion në sektorin e grumbullimit të mbetjeve.

Sipas studimit që mbështet tek NAMA-t, i gjithë veprimi do të zvogëlonte më mënyrë efektive shkarkimet e karbonit nga këta sektorë. Masa është një plan (pilot) i vetëkontrolluar, i cili zëvendëson lëndën djegëse fosile me mbetje në procesin prodhues të industrisë së çimentos në Shqipëri. Sidoqoftë, në dokument, janë veçuar fazat e mëposhtme:

- Komponenti 1: Studimi i mundësive teknologjike dhe mundësia e përdorimit të mbetjeve të ngurta të bashkisë si lëndë djegëse alternative në industrinë e çimentos.

- Komponenti 2: Investimi në qendra riciklimi në nivel bashkie.

- Komponenti 3: Vënia në punë e qendrave të riciklimit.

- Komponenti 4: Ngritja e kapaciteteve në sektorët përkatës të sistemit të menaxhimit të mbetjeve.

- Dokumenti diskuton gjithashtu mundësitë e financimit dhe MRV-ës.

Plani i Parë i Veprimit në Nivel Kombëtar mbi Eficiencën e Energjisë (2011)

Vlefshmëria: 2010–2018

PKVEE-ja e parë për Shqipërinë u zhvillua në përputhje me përafrimin e Direktivës 2006/32/EC të BE-së në vitin 2009, me Vendim të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë. Plani u miratua nga Qeveria e Shqipërisë në shtator 2011 dhe parashikonte realizimin e kursimeve të energjisë vjetore kumulative në masën 3% në vitin 2012, dhe 9% në vitin 2018, të llogaritura si një përqindje e konsumit të energjisë përfundimtare mesatare të periudhës pesëvjeçare, duke përfshirë vitet 2004–2008.

PKVEE-ja e parë është një plan afatshkurtër, i cili përcakton objektivat e eficiencës së energjisë dhe mbledhjen e masave ekzistuese dhe të planifikuara në sektorët e banesave, terciarë (privatë dhe publikë), sektorët industrialë dhe ata të transportit, me një potencial për të kontribuar në arritjen e një objektivit të tillë.

Kontributi pozitiv kryesor në ndryshimet klimatike është ai i vendosjes së objektivave për eficiencën e energjisë (ulje në masën 9% deri në vitin 2018 në lidhje me konsumin mesatar gjatë periudhës 2004–2008, ose një ulje të konsumit të energjisë me 168 Ktoe), i cili pritet të sjellë uljen e shkarkimeve të karbonit me 332.8 tonë të CO₂/vit deri në vitin 2018.

Objektivat e para të PKVEE-së ishin menduar të arriheshin me anë të një sërë masash politike. Lista është mjaft e gjatë, duke qenë se përfshin të gjithë gamën e politikave ekzistuese dhe atyre të planifikuara, në lidhje me eficiencën e energjisë, si dhe përfshin masat specifike sektoriale dhe ato ndërsektoriale.

Për banesat, ka kërkesa minimale për cilësinë termike të banesave të reja, të cilat mbulojnë shtëpi me një familje, banesa me shumë familje si dhe sektorin e shërbimit privat. Specifikimi i standardeve mbështetet nga masa ndihmëse që garantojnë zbatimin efektiv të standardeve. Do të ketë më shumë masa mbështetëse, specifike, për secilin nënsektor: një program mbështetës për instalimin e ngrohjes diellore të ujit në shtëpitë me një familje (me një linjë të veçantë krediti dhe trajnim për instaluesit); përafrimin e rregullave të BE-së për administrimin e bashkëpronësisë për banesat me shumë familje, duke siguruar një kuadër më të favorshëm ligjor për përmirësimin e banesave; një skemë subvencionimi që mbështet përmirësime të tilla, me kusht që të veprojnë në përputhje me standardet e eficiencës së energjisë, dhe që rritet me vlerën e eficiencës së energjisë të përmirësimit. Përdorimi i energjisë së banesave, pritet të jetë gjithashtu, subjekt i standardeve minimale të energjisë për pajisjet dhe për një skemë të etiketimit për pajisje të tilla. Në të njëjtën mënyrë, zyrat në sektorin privat do t'iu nënshtrohen standardeve minimale për pajisje zyre dhe për një skemë të etiketimit të pajisjeve në fjalë.

Sektorin publik ⁴⁴ pritet që të zbatojë standarde më të rrepta të eficiencës së energjisë në ndërtesa, standarde më të rrepta se sa sektori privat ("të përdoret sa më pak energji të jetë e

⁴⁴ Vini re se promovimi i ngrohjes diellore të ujit, të ujërave sanitare është përfshirë përsëri këtu, por aktualisht u përket shtëpive me familje me një person. Ky mund të jetë një gabim në përpilimin e tabelave të dokumentit të PKVEE-së.

mundur nga ana teknike”). Kjo do të shoqërohet me rinovimin e ndërtesave publike (si ato që janë në pronësi të shtetit ashtu edhe atyre që janë në pronësi të bashkive). Masa të tjera specifike sektoriale për sektorin publik kanë të bëjnë me nxitjen e kontraktimit dhe prokurimit që synon, ndërtesat publike dhe ndriçimin me eficiencë energjike, si dhe me trajnimin e stafit të administrimit të ndërtesave mbi eficiencën e energjisë.

Sektori i industrisë do të jetë përfituesi i masave të veçanta që përfshijnë një skemë auditimi të energjisë, kërkesa minimale për eficiencën e motorëve elektrikë, sistemet e ndriçimit dhe furrave industriale (zbatimin e direktivës së BE-së); ndërtimin e një impianti të kombinuar me ngrohje dhe energji (NKE) për përdorim industrial, dhënien e informacionit dhe trajnimit, si dhe monitorimin e kuadrit ligjor; përfshirjen e kërkesave të eficiencës së energjisë në lejen mjedisore, për të punuar në fabrika të reja, në industri intensive të energjisë; promovimin e marrëveshjeve vullnetare.

Një numër masash janë parashikuar edhe për sektorin e transportit: etiketimin e makinave me energji; një taksë mbi përmbajtjen e CO₂; fushata informuese; promovim të ndarjes së mënyrës së transportit (përmirësimi i transportit publik, përmirësimi hekurudhor; promovimi i lëvizjes në këmbë dhe me biçikleta). Për transportin tregtar janë parashikuar kurse patente për makinat ekologjike për shoferët e kamionëve, dhe përmirësimi i transportit hekurudhor të mallrave.

Së fundi, do të ketë një sërë masash të ndërlydhura: politika informacioni për përdoruesit përfundimtarë (familjarët, punëtorët në sektorin privat/shërbimin publik), të tilla si: fushatat e ndërgjegjësimit; edukimi dhe trajnimi i audituesve të energjisë dhe administratorëve të banesave; certifikimi i energjisë së banesave.

Shqipëria u përball me një sërë sfidash në zbatimin e masave të përfshira në PKVEE-n e parë. Shumica e masave kishin të nevojshëm bashkëpunimin e ministrive dhe subjekteve të tjera jashtë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë. Sidoqoftë, vizioni, bashkërendimi dhe hartimi i planit ndërministror munguan, duke penguar integrimin e masave brenda planeve sektoriale të një kuadri më të gjerë. Gjithashtu u vonua miratimi i Ligjit për Eficiencën e Energjisë – i nevojshëm për të siguruar kuadrin ligjor dhe rregullator për krijimin e tregjeve të shërbimit të energjisë, një agjenci e dedikuar për EE-në, dhe një fond i EE-së. Për më tepër, disa masa nuk mund të realizoheshin brenda afateve kohore të propozuara dhe nuk iu nënshtruan një vlerësimi të detajuar të ndikimit.

Pavarësisht vështirësive të lartpërmendura, është arritur deri diku progres mbi EE-në në Shqipëri. U bënë një numër projektsh pilote për restaurimin e ndërtesave publike, u zhvilluan disa trajnime për auditues dhe administratorë të energjisë dhe me mbështetjen e instituteve ndërkombëtare të financimit (IFI) dhe donatorëve; banka vendase dhanë kredi për masat e eficiencës së energjisë, kryesisht për përmirësimin e veshjes së banesave. PNUD-i ka mbështetur gjithashtu një përdorim të konsiderueshëm të ngrohjeve diellore të ujit (SWH).

Përgatitja e Planit të dytë dhe të tretë Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë u zhvillua me asistencën e BERZH-it. PKVEE-ja e dytë dhe e tretë u përgatitën në një dokument në përputhje të plotë me formatin e Sekretariatit të Energjisë për Komunitetin.

Projektligji përfundimtar i PKVEE-së së dytë dhe të tretë përfundoi në fund të muajit prill 2016, dhe pas marrjes së mendimeve nga departamentet e MIE-t, dokumenti është gati për t’iu dërguar për mendim institucioneve të linjës, pra nuk ishte ende i disponueshëm në kohën kur është shkruar dokumenti i SKNK&P-ës.

Projektligji vuri në dukje se objektivi i vitit 2018 bie ndjeshëm me 169 ktoe (ose 9%) të cilat ishin brenda PKVEE-së së parë për të njëjtin vit. Megjithatë, për shkak të afatit të shkurtër të mbetur përpara përmirësimit të tij përfundimtarë dhe kërkesave të mbetura për zhvillimin e legjislacionit dytësor dhe rregulloreve, si dhe arkitekturën e nevojshme për zbatimin e skemave, ky objektivi nuk konsiderohet realist. Prandaj, projektligji i dytë dhe i tretë i PKVEE-së me shumë gjasa, do të propozojë, se deri në vitin 2020, kursimet kumulative të energjisë përfundimtare t’i afrohen këtij niveli me një objektivi të kursimit të energjisë përfundimtare në masën 123.7 ktoe (ose 6.8%).

Plani i Dytë dhe i Tretë i Veprimit Kombëtar mbi Eficiencën e Energjisë (2017–2020)

Vlefshmëria: 2017–2020

Përmbledhje ekzekutive


Politika Kombëtare për Eficiencën e Energjisë

Sektori i energjisë konsiderohet nga Qeveria e Shqipërisë si një sektor strategjik për zhvillimin ekonomik të vendit. Për të ofruar një kuadër parimesh operative që mundësojnë planifikimin e politikave qeveritare, në mënyrë të koordinuar, koherente dhe të integruar, Shqipëria ka miratuar një Sistem Planifikimi të Integruar (SPI). Një karakteristikë kryesore e SPI-së është Strategjia e dytë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI-II), e cila përshkruan objektivat kombëtarë të zhvillimit social, demokratik dhe ekonomik për periudhën 2015–2020.

SKZHI-II identifikon furnizimin me energji, në mënyrë të sigurt dhe me kosto efektive, si një objektiv kryesor të politikave për Shqipërinë. Kjo është përcaktuar në kuadër të qëllimeve më të gjera ekonomike, që përfshijnë një normë rritjeje reale të përkohshme e të synuar të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) prej 4.9%, deri në 2020. Kjo është në kontrast me një normë rritjeje të ngadalësuar, megjithëse pozitive, ndërmjet 2009 dhe 2013, e shkaktuar pjesërisht nga efektet e krizës financiare globale të 2008–2009 që ende vazhdojnë.

Konsumi final i energjisë në Shqipëri u rrit në mënyrë graduale, ndërmjet 2007 dhe 2011, përpara se të tkurrej në 2012, që përkon me një ngadalësim të ekonomisë shqiptare, siç paraqitet në **figurën 26**. Kjo rënie e konsumit në 2012 ishte veçanërisht e dukshme në nën-sektorin e ndërtimit dhe sektorin e transportit, të cilët janë të ndjeshëm ndaj prodhimit ekonomik. Megjithatë, pavarësisht se rritja e PBB-së mbeti e ulët, prapëseprapë konsumi i energjisë u rrit në mënyrë të shpejtë, në 2013, kryesisht për shkak të rritjes së kërkesës në sektorin e banesave. Më pas, në 2014, konsumi pësoi një rritje të madhe të mëtejshme, kryesisht në sajë të sektorit të hekurit dhe çelikut. Si përmbledhje, gjatë periudhës 2009-2014, konsumi final i energjisë u rrit nga 1,871 ktoe në 2,070 ktoe. Kjo përfaqëson një rritje prej rreth 11%, por norma e rritjes nuk ishte e qëndrueshme gjatë periudhës.

Figura 26 Konsumi final i energjisë gjatë periudhës së shqyrtuar



Burimi: Bilanci Energjetik i Shqipërisë 2009–2014, AKBN; INSTAT

Plani i Parë Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë në Shqipëri u hartua në përputhje me transpozimin e Direktivës së Bashkimit Evropian (BE) 2006/32/KE (Direktiva e Shërbimeve Energjetike – DSHE) dhe me vendimin e Këshillit Ministerial të Komunitetit të Energjisë të vitit 2009. Plani u miratua nga Qeveria e Shqipërisë, në shtator 2011, dhe parashikoi arritjen e kursimeve vjetore të energjisë prej 3% në vitin 2012⁴⁵ dhe 9% në vitin 2018, të

llogaritura si përqindje e konsumit mesatar final të energjisë për periudhën pesëvjeçare 2004-2008 (përfshirë).

Me VKM-në nr. 348, datë 11.5.2016 “ Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015–2020” për sektorin e energjisë, SKZHI 2015–2020 nxjerr në pah objektiva strategjike shtesë, të cilat përfshijnë një numër objektivash që kanë rëndësi për zbatimin e masave për eficiencën e energjisë:

- Uljen e intensitetit të energjisë me mbi 12.5%, deri në 2020, krahasuar me nivelin e 2012-s;
- Plotësimi i angazhimeve të Shqipërisë në kuadrin e iniciativës 20/20/20, me përmirësimi i eficiencës së energjisë dhe ulja e emetimeve të karbonit (CO₂);
- Menaxhimi i kërkesës për energji përmes rritjes së eficiencës të përdorimit të energjisë, sidomos në sektorin e ndërtesave;
- Uljen e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes deri në 14%, deri në 2018;

Në lidhje me ndryshimet klimatike, Shqipëria ka paraqitur *objektivin e saj kombëtar të pikësnyuar* (INDC), i cili është pjesë e procesit të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), për përcaktimin dhe përmbushjen e objektivave për uljen e emetimeve në nivel ndërkombëtar. Në përputhje me vendimin 1/CP.19 dhe vendimin 1/CP.20 të UNFCCC-së, INDC-të e vendeve përcaktojnë objektivat që lidhen me uljen e emetimeve, mbi bazën e kushteve ekonomike dhe industriale vendase. Shqipëria ka përcaktuar një objektiv të skenarit bazë, i cili synon një nivel kursimesh (ulje të emetimeve të CO₂ me 11.5%, deri në 2030) nën nivelin e trajektores së parashikuar të skenarit bazë.

Për të përmirësuar performancën e sektorit të energjisë në Shqipëri dhe për të përmbushur objektivat e mësipërm, ka zhvillime të konsiderueshme. Për këtë qëllim, Plani Kombëtar i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme (PKVBER), për periudhën 2015-2020, u miratua nga Këshilli i Ministrave më 20 janar 2016, i cili përcakton planin për arritjen e objektivit të vitit 2020, që 38% e konsumit final të energjisë të jetë nga burimet e energjive të rinovueshme.

Në lidhje me Eficiencën e Energjisë (EE), ligji i referimit për eficiencën e energjisë (ligji nr. 124/2015) u miratua në nëntor 2015, i cili transponon shumë prej kërkesave të Direktivës 2012/27/BE (“Direktiva për Eficiencën e Energjisë”). Në mënyrë të ngjashme ligji nr. 116/2016 “Për performancën energjetike të ndërtesave (PEN)”, i cili transponon direktivën 2010/31/BE (“Direktiva për performancën energjetike të ndërtesave”) – një fushë me potencial të lartë në Shqipëri, janë referenca të qarta për zhvillimin e eficiencës së energjisë.

Së bashku, këto ligje krijojnë bazën mbi të cilën mund të ngrihet një kuadër rregullator më i plotë, mund të krijohet struktura institucionale dhe mbështetja financiare, si dhe të zbatohen në mënyrë të suksesshme masat e parashikuara në kuadër të kësaj PKVEE-je të re. Në të vërtetë, ligji për eficiencën e energjisë parashikon një detyrim ligjor, i cili mungonte më parë, për Agjencinë për Eficiencën e Energjisë që të hartojë një PKVEE për Shqipërinë.

PKVEE parashikon një plan sesi këto zhvillime do të arrijnë objektivat e Shqipërisë për eficiencën e energjisë dhe përmbushin detyrimet e saj në kuadër të direktivës 2012/27/BE (“DEE”), e cila u miratua nga Komuniteti i Energjisë, më 16 tetor 2015, duke mbuluar edhe aspektet përkatëse të DPEN-së.

Pikat kryesore të PKVEE-së

Kjo PKVEE e re për Shqipërinë rishikon arritjet e PKVEE-së I, për periudhën 2010–2014, dhe më pas përshkruan një plan për përmbushjen e objektivave të rinj që dalin, për periudhën deri në vitin 2020.

Arritjet e PKVEE së parë, 2011–2018

Shqipëria nuk përballoi një sërë sfidash në zbatimin e masave që përmbahen në PKVEE-në I të miratuar nga Qeveria në shtator 2011. Shumë prej masave kërkuan bashkëpunimin e ministrive dhe entiteteve të tjera jashtë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Megjithatë, mirëkuptimi, koordinimi ndërministror, dhe si rrjedhojë mbështetja me akte ligjore dhe financiare për planin mungoi, duke penguar integrimin e masave në planet sektoriale. Gjithashtu, miratimi i ligjit për eficiencën e energjisë, i kërkuar për

plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator për krijimin e tregut për shërbimet energjetike, për Agjencinë e dedikuar për EE-në dhe Fondin për EE-në, u vonuan së tepërmi. Për më tepër, disa masa nuk ishin realiste, si për sa u përket afateve kohore të propozuara, ashtu edhe gatishmërisë për të monitoruar dhe implementuar ato.

Pavarësisht vështirësive të mësipërme, pak progres është bërë për EE-në në Shqipëri. Janë zhvilluar një sërë projektsh pilote për rinovimin e ndërtesave publike, është kryer trajnim për audituesit dhe menaxherët e energjisë, dhe me mbështetjen e institucioneve financiare ndërkombëtare (IFN) dhe donatorëve, bankat vendase ofruan linja kreditimi për masat për eficiencën e energjisë, kryesisht për përmirësimin e veshjeve të jashtme të ndërtesës.

Vlerësimi formal i kursimeve të energjisë të arritura nga masat e mësipërme është penguar nga mungesa e një platforme monitorimi dhe verifikimi, sipas së cilës do të llogariteshin kursimet me metodën “Poshtë-Lart” (PL) (*Bottom-Up*), ndërsa ekzistenca dhe cilësia e ulet statistikave kombëtare ka kufizuar dobishmërinë e metodës “Lart-Poshtë” (LP) (*Top-Down*). Prandaj, për të mundësuar raportim të saktë e në kohë, gjatë periudhës së mbuluar nga kjo PKVEE e re, është parë si masë prioritare krijimi i platformës së monitorimit dhe verifikimit të masave.

Prioritetet për kursimin e energjisë për PKVEE e re

Stoku i ndërtesave të banimit në Shqipëri dhe eficientia e energjisë 2020

Kërkesa për energji nga sektori i ndërtesave të banimit përbën një sfidë të madhe për Shqipërinë. Në vitin 2013, ky sektor ishte përgjegjës për 30 për qind të konsumit fundor kombëtar të energjisë dhe për 60 për qind të konsumit kombëtar të energjisë elektrike. Përgjithësisht, banesat shqiptare ngrohen pjesërisht për pak orë në ditë. Përdorimi i vazhdueshëm i sobave të vjetra me dru zjarri sjell probleme të shumta për mjedisin dhe shëndetin.

Janë propozuar dy paketa në shtesë të kuadrit të sotëm të politikave, të cilat kanë si qëllim ta shndërrojë stokun e ndërtesave të banimit në ndërtesa me nivelin minimal të harxhimit të energjisë dhe çlirimit të karbonit deri në vitin 2050. Është vlerësuar shkalla e përpjekjeve të nevojshme për të arritur këto objektiva të matur për sipërfaqen e dyshemesë (banimit) të marre në konsiderate, si edhe investimet e kërkuara. Është vlerësuar kursimi i energjisë, kostot e kursyera lidhur me energjinë, impakti në shkarkimet e CO₂ që dhe kosto-efektshmërinë e paketave të ndërhyrjeve⁴⁶.

Gjetjet se konsumi përfundimtar i energjisë në vitin 2015 në sektorin e banimit për shërbimet e energjisë termike ishte 4.9 miliardë kWh, nga të cilat 54% përmbusheshin nga energjia elektrike, 37% nga lënda drusore dhe 9% nga gazi i lëngët. Sektori shkarkoi 96 mijë tonë CO₂ i bashkëlidhur me konsumin e gazit të lëngët. Energjia përfundimtare e konsumuar e përlllogaritur mbi bazën e veçorive gjeometrike dhe termike të ndërtesave si dhe veçoritë e sistemeve të instaluar energjisë ndryshojnë në mënyrë thelbësore nga balanca e energjisë. Për këtë shkak, konsumi përfundimtar i energjisë u kalibrua kundrejt balancës duke korrigjuar nivelin e sotëm të komfortit termik, shprehimisht sipërfaqja e pjesshme e dyshemesë e ngrohur dhe e ftohur dhe kohëzgjatja e ngrohjes dhe ftohjes së hapësirës.

Duke ndjekur tendencat e tregut, ne supozojmë një rritje të shpejtë të ngrohjes me energji elektrike të banesave ekzistuese. Për këtë shkak, gjatë periudhës 2015–2030 konsumi i energjisë elektrike do të rritet afërsisht me 2.2%/vit, ndërsa konsumi i druve të zjarrit dhe gazit të lëngët do të ulet respektivisht me afërsisht 11%/vit dhe 10%/vit. Në vitin 2030, shkarkimet e CO₂ do të zënë 23% të nivelit të tyre në vitin 2015, ndikuar kryesisht prej ndryshimit në llojit të energjisë, kalimit nga gazi i lëngët tek energjia elektrike. Kërkesa për energji në ndërtesat ekzistuese pritet të zvogëlohet pavarësisht rritjes së komfortit termik për shkak të përmirësimeve që lidhen me periudhën e përdorimit të ndërtesës duke marrë në konsiderate ritmin e rinovimit të ndërtesave të stokut ekzistues me 2.8%/vit.

Është e domosdoshme që kodet energjetike të ndërtimit që do të miratohen brenda 2018 dhe në vitin 2022 duhet të parashikohet një kod energjetik edhe më i rreptë, me kërkesa që përfshijnë jo vetëm ndërhyrjet në izolimin termik, por edhe vendosjen e sistemit termik me

⁴⁶ <http://sled.rec.org/building.html>

eficiencë të lartë. Me qëllim që tregu të përgatitet, Shqipëria duhet të zbatojë kreditë me interesa të ulëta për ndërtimin e ndërtesave të reja në mënyrë të arrijë performancën e kërkuar prej kodit të ndërtesave të vitit 2022.

Për të siguruar kryerjen e rinovimit të ndërtesave të stokut ekzistues, Shqipëria duhet të fusë stimujt financiarë për investitorët e sektorit të ndërtesave të banimit. Deri në vitin 2022, duhet të jepen stimujt financiarë, në mënyrë që të arrihet shkalla e performancës sipas modelit me karbon të ulët.

Stoku i ndërtesave publike dhe eficientia e energjisë 2020

Një studim i financuar nga ADA (Austrian Development Agency) siguroi informacion për modelimin sektorial të stokut të ndërtesave publike të Shqipërisë me qëllim strategjinë e rinovimit të tyre me Eficientinë e Energjisë. Një element kyç i arritur në këtë studim është identifikimi i tipologjisë së ndërtesave publike për Shqipërinë, i cili nuk ka ekzistuar më parë. Bazuar në studim janë identifikuar gjashtë kategori në bazë sipas funksionit të ndërtesave Publike që mirëmbahen nga buxheti qendror dhe Lokal: (i) konvikte, (ii) spitale, (iii) kopshte, (iv) zyra, (v) shkolla dhe (vi) universitete. Është vlerësuar kërkesa për energji për çdo kategori.

Është bërë identifikimi dhe kosto e përfitimeve të tjera lidhur me përmirësimin e eficientës termike përtej kursimeve të kostove të energjisë. Këto përfitime përfshijnë, përveç të tjerave (i) komfortin termik, (ii) shmangiet e çlirimeve të CO₂, (iii) shmangie e efekteve ekonomike nga ndotësve ajrit, (iv) punësimin, dhe (v) rritjen ekonomike

U vlerësuan 6.6 milionë m² sipërfaqe e target grupit të llojeve kryesore të ndërtesave publike, shifër që nuk pritet të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme. Ndërkohë që klasifikimi sipas **Tipologjisë tregon se rreth 75% ose $\frac{3}{4}$ e sipërfaqes është e zënë nga ndërtesa që përdoren për qëllime arsimore, 13% zyrat dhe 11% spitalet. Analiza tregon se 57%, është e vendosur në zonën e klimës A, 26% në zonën klimatike B dhe 17% është në zonën klimatike C.**

Kosto e rikonstruksionit dhe prioritete

Prioriteti sipas kërkesës për investim klasifikohet fillimisht për Kopshtet, të ndjekur nga Shkollat, Spitalet dhe Zyrat. Investimi më i madh është i nevojshëm në zonën klimaterike A.

Kursimet më të larta të kërkesës për energji primare dhe fundore, si dhe reduktimet e emetimeve të CO₂ për m² janë pa mëdyshje në ndërtesat e zonës klimatike C. Këta tregues janë dy herë më të vegjël për të zonat klimatike A dhe B, dallimi midis tyre nuk është dhe aq i rëndësishëm. Kursimet me të larta të kërkesës për energji primare dhe për m² janë në konvikte, spitale dhe zyra

Zona Klimatike A zë pjesën më të madhe të kursimeve finale të energjisë në vlera absolute për shkak të numrit më të madh të ndërtesave në zonën klimatike A se sa në zonën klimatike C. Për sa i përket potencialit absolut për kursime fillestare dhe përfundimtare, kopshtet janë në radhë të parë, të ndjekur nga shkollat dhe spitalet. Në kushtet e kursimeve të mundshme të shkarkimeve CO₂, potenciali më i madh është në spitale dhe kopshte.

Kursimet Mesatare të Energjisë sipas jetëgjatësisë së rikonstruksionit janë 4.4 EUR/m² në vit, ose 76 EUR/m² gjatë gjithë jetëgjatësisë. Ndërsa Totali i Kursimeve të kostos së energjisë është 29 milionë EUR/vit dhe 502 milionë EUR gjatë jetëgjatësisë. Pothuajse 45% e saj është në zonën klimaterike A për shkak të numrit të madh të ndërtesave. Kursimet më të larta të kostos së energjisë për m² janë të ofruara nga spitalet, të ndjekur nga konviktet. Shpenzimet e kursyera të energjisë për m² në zonën klimaterike C janë më shumë se dy herë më të larta se ato në zonën klimaterike A dhe janë 65% më të larta se ato në zonën klimaterike B.

Rikonstruksionet e universiteteve nuk janë financiarisht të realizueshme, nëse vetëm shpenzimet e ruajtjes së energjisë do të merren si përfitime (vetëshlyerje më të lartë se jetëgjatësia, raporti kosto-benefit më i lartë se 1, NPV negative, IRR negative). Gjithashtu, rikonstruksionet e shkollave dhe kopshteve, nuk do të jenë financiarisht tërheqëse (NPV negative, raporti kosto-benefit më e lartë se 1). Konviktet dhe spitalet janë financiarisht të realizueshme për rikonstruksione ndërsa zyrat janë në kufi të fizibilitetit.

Veçanërisht të larta janë edhe efektet në GDP dhe punësim. Nëse të gjitha këto përfitime do të merren parasysh në analizën financiare, kost-efektiviteti i rikonstruksioneve të eficientës termale i të gjitha llojeve të ndërtesave publike do të jetë shumë më i lartë.

Skenarët e rinovimit të ndërtesave publike të parashikuara në PKVEE 2018–2020

Nga modelimi, janë identifikuar 2 skenarë të mundshëm që mund të përfshihen në PKVEE.

Skenari i Parë, fokusohet në tipologjinë e ndërtesave ku rikonstruktionet janë me kosto efektive më të lartë dhe të cilat mund të zgjidhen si prioritet nga pikëpamja sociale, të cilat janë, Spitale dhe Kopshtet për të cilat parashikohet rikonstruktimi i 545,000 m², në zonën klimatike C ku kosto totale e investimit është 40 Mil. EUR në periudhën 2018-2020 dhe përbën rreth 8% të stokut total të ndërtesave publike ose 2% në vit (10 Mil. EUR/Vit)

Të gjitha kopshtet dhe spitalet në zonën e klimës C do të rikonstruktohen duke pasur parasysh nivelin e **moderuar** të performancës të përcaktuar masat për përmirësimin e performancës së energjisë.

Skenari i Dytë, parashikon të njëjtën sasi investimi të shpërndarë në të gjitha zonat në mënyrë proporcionale me ndarjen e sipërfaqes së ndërtesave sipas tipit të ndërtesave. Ky skenar sugjeron 530,000 m² sipërfaqe të rikonstruktuar të shpërndarë proporcionalisht në tre zonat ku kosto 40 mil. EUR do të aplikohet në 8 % të sipërfaqes së ndërtimeve ose 2%/vit që përbën 10 mil. EUR në Vit

Aktivitetet e planifikuara për PKVEE-në e re

Miratimi i ligjit për eficientë e energjisë (124/2015) dhe miratimi i ligjit për performancën energjetike të ndërtesave (116/2016), ofrojnë bazën mbi të cilën mund të krijohet një strategji e re për eficientë e energjisë në Shqipëri. Kjo përfshin krijimin e Agjencisë për Eficientë e Energjisë (AEE) dhe Fondit për Eficientë e Energjisë, hartimin e akteve nënligjore e mjeteve rregullatore të nevojshme, dhe më e rëndësishmja zbatimin e një sërë masash të reja, siç propozohet në këtë PKVEE.

Masat e propozuara këtu dhe objektivat për eficientë e energjisë të krijuara prej tyre, përbëjnë deklaratën e qëllimit të Shqipërisë për përmbushjen e detyrimeve të saj, në kuadër të transpozimit të direktivës së EE-së. Ato përfshijnë kursimet në energjinë primare dhe përdorimin fundor dhe për këtë të fundit adresojnë masa për përdorimin e energjisë në ndërtesa, proceset industriale dhe transportin, si dhe respektimin e rëndësisë së rolit model që duhet të luajë sektori publik.

Tabelat paraqesin, përkatësisht, një pasqyrë të të gjitha masave të propozuara për kursimin e energjisë primare dhe finale, së bashku me kursimet e pritshme deri në 2018, si dhe deri në 2020. Kursimet e pritshme të energjisë për një sërë masash nuk janë dhënë ose për shkak se kërkohet punë shtesë, përpara se ato të mund të vlerësohen me një nivel të arsyeshëm besimi (ky është rasti për pjesën më të madhe të masave në energjinë primare), ose ato janë masa mbështetëse që ndihmojnë në kursimin e energjisë, por vetë nuk rezultojnë drejtpërdrejt në kursime (ky është rasti për masat horizontale).

Kërkesa për financime publike në PKVEE-në e re

Zbatimi i masave të propozuara për EE-në në Shqipëri, do të varet nga atraktiviteti i kostos së atyre masave, në krahasim me koston e energjisë në mungesë të tyre. Konkurrueshmëria e kostos do të varet nga çmimet e tregut, subvencionet, politikat dhe mirëqenien dhe vendimet e konsumatorit. Parashikimet e penetrimit të teknologjive të ndryshme në treg dhe vendimet e konsumatorit janë çështje që po fitojnë terren në modelimin e politikave energjetike dhe qarqet vendimmarrëse në BE, megjithatë ende nuk janë publikuar kërkime të mjaftueshme për të kryer analizë gjithëpërfshirëse. Në të vërtetë, masat specifike në kuadër të kësaj PKVEE-je mund t'i nënshtrohen veçmas vlerësimeve të plota të ndikimit rregullator për të vlerësuar kostot neto për zbatimin e tyre, si për sektorin publik ashtu edhe atë privat. Kjo do të thotë masat e parashikuara në këtë dokument do kenë plane konkrete zhvillimi dhe plane të ndërhyrjeve të mëtejshme, të cilat, do të japin të dhëna më konkrete mbi zbatimin e masave.

Ky dokument adreson pritshmërinë për reduktimin e energjisë në mënyrë realiste, i cili, vjen i mbështetur në 3 prioritetet (sektori i ndërtesave, industrisë dhe transporti) dhe i jep shembull

ekzemplar veprimeve të Qeverisë. Kjo nënkupton se për të arritur objektivin (6.8% deri në 2020) nevojiten masa të financuara drejtpërdrejt nga Buxheti.

Tabelat e mëposhtme paraqesin gjithashtu një vlerësim të kostove direkte nga buxheti publik për masat e propozuara dhe të kostuara, kur vlerësime të tilla janë të mundura. Për më tepër, masat e propozuara përfshijnë aktivitete të cilat kanë përfitime të konsiderueshme më të gjera sesa efienca e energjisë, veçanërisht në lidhje me përmirësimin e infrastrukturës së transportit dhe furnizimit me ujë, dhe prandaj një krahasim direkt i efektivitetit të kostos ndërmjet masave mund të jetë çorientues.

NAMA – Mekanizëm Financimi për Eficiencën e Energjisë në Banesa

Vlefshmëria: 2016-2020 (me qëllim për të vazhduar më tej nëse fondet janë të disponueshme)

Kjo është NAMA e aprovuar nga Qeveria e Shqipërisë në fushën e energjisë dhe përbëhet nga katër veprimet e mëposhtme, me qëllim uljen e shkarkimeve GES. Thelbi i veprimit është sigurimi i mbështetjes financiare, përmes granteve ose kredive të subvencionuara për përmirësimet e eficiencës së energjisë në banesa.

Këto masa janë:

- Ekzistenca e një mekanizmi financues që siguron grante dhe kredi me interesa të ulëta për investime në eficiencën e energjinë në banesa (në bashkëpunim me Institucionet Financiare Ndërkombëtare – IFIs – dhe donatorët).

- Mbështetja teknike për projektet e financuara nga fondi në të gjitha fazat e projektit, nga projektimi deri në zbatimin dhe menaxhimin e funksionimit të banesave. Mbështetja teknike përfshin MRV-ën.

- Përhapja dhe ndërgjegjësim i që promovojnë avantazhet e eficiencës së energjisë dhe investimeve në energjinë e rinovueshme, si dhe promovimin e mundësive financiare të ofruara nga vetë fondi.

- Mbështetja për përmirësimin e administrimit të ndërtesave.

Për më tepër, dokumenti ka një seksion të veçantë mbi politikat e informimit. Më i rëndësishëm është përcaktimi i bazës së centralizuar të të dhënave, duke mbledhur të gjithë informacionin përkatës për monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë së planit. Një mjet i dytë është konsultimi publik, që, sipas dokumentit, përfshin një platformë të palëve të interesuara me bazë të gjerë. Këto palë të interesuara duhet të mbahen të përditësuara sipas planit, me hartimin e dokumenteve kryesore strategjike të cilat do të botohen nga qeveritë në këtë fushë dhe në veçanti, të përditësuara me dokumentin strategjik nga Komiteti Kombëtar për Planifikimin Afatgjatë të Energjisë, që pritet të përfundojë brenda gjysmës së dytë të vitit 2016.

Plani i Veprimit mbi Burimet Rinovueshme të Energjisë 2018–2020

Vlefshmëria: deri në vitin 2020

Plani i Veprimit BER u miratua në janar 2016 dhe institucioni përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e tij është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me agjencinë e saj vartëse – Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN). BER-i ka një objektiv parësor: të modernizojë politikat e saj BER me politikat RE-a të BE-së (direktiva 2009/28), në përputhje me procesin e përcaktuar brenda Komunitetit të Energjisë.

Objektivat e BER-it synojnë rritjen e përdorimit të burimeve të energjisë pa karbon/nivel të ulët karboni deri në vitin 2020, të gjithë do të kontribuojnë në zbutjen e përdorimit të tyre. Veçanërisht:

- Përcaktimi i një objektivi të përgjithshëm 38% për vitin 2020 (për sa i përket pjesës së BER-it mbi konsumin bruto të energjisë përfundimtare). Ky duhet të jetë ekuivalent me 1017.28 ktoe, krahasuar me 29.74% (560.76 ktoe) në vitin bazë.

- Ky objektiv ndahet në një objektiv në masën 10.8% për ngrohje dhe ftohje, një objektiv në masën 23.67% për energjinë elektrike dhe një tjetër në masën 3.65% për transportin. Dokumenti vë në dukje se objektiva të tillë mund të jenë mesatarisht rreth 3% më shumë ambiciozë, nëse plani i PKVEE-së zbatohet në mënyrë korrekte.

- Një objektiv në masën 10% për vitin 2020 për pjesën e BER-it të lëndëve djegëse të përdorura në transport (duke përbushur kërkesat e nenit 3(4) të direktivës 2009/28/EC).

Për më tepër, Plani i Veprimit i BER paraqet këto objektiva të përgjithshëm të politikave të energjisë:

- Reduktimin e importit të energjisë;
- Diversifikimin e burimeve të energjisë primare për furnizimin me energji;
- Reduktimin e humbjeve të transmetimit dhe shpërndarjes duke nxitur prodhimin e energjisë;
- Krijimin e bizneseve vendore dhe mundësive të punësimit, duke instaluar dhe prodhuar pjesë/komponentë/sisteme të impianteve BER nga sektori industrial shqiptar;
- Shfrytëzimin e burimeve vendase të energjisë, veçanërisht në zonat e largëta, duke hapur vende pune dhe përmirësimin e standardit të jetesës;
- Rritje të pjesës së biokarbureve dhe lëndëve të tjera të djegshme nga burimet e energjisë së rinovueshme.

Objektivat BER, të cilat sipas llogaritjeve të bëra në mënyrë efektive duhet të çojnë në rritje të përdorimit të burimeve të energjisë pa karbon/nivel të ulët karboni deri në vitin 2020, do të kontribuojnë të gjitha në zbutjen e efekteve. Masat ndihmëse të përmendura si të dobishme, por jo të përcaktuara në mënyrë të qartë në plan, janë:

- Marrja e “masave të përgjithshme për parandalimin e mospagimit të energjisë”
- Përmirësimi i procesit të licencimit për zhvillimin e projekteve RE.

Ligji nr. 24/2015 mbi eficiencën e energjisë

Vlefshmëria: hyrja në fuqi në vitin 2016 dhe më tej e pakufizuar, deri në rishikime të mëtejshme

Ky ligj tregon prioritetet kryesore strategjike në fushën e Eficiencës së Energjisë në Shqipëri dhe përcakton institucionet kryesore dhe instrumentet e përfshirë në realizimin e prioriteteve të tilla, duke përafruar shumë nga kërkesat e direktivës 2012/27/EU (“Direktiva mbi eficiencën e energjisë”).

Çka është më e rëndësishmja, ligji nuk përcakton drejtpërdrejt objektiva sasiore dhe as zgjedh masat e politikave për t’i vënë ato në zbatim, por delegon zgjedhje të tilla në aktet nënligjore dhe në PKVEE-n në vazhdim. Sidoqoftë, ai parashikon se objektiva të tillë duhet të përbushen dhe të bëhet një listë e mjeteve të politikave nga të cilat autoritetet përgjegjëse për zbatimin e ligjit mund të zgjedhin, si ta gjykojnë të arsyeshme, pa qenë të shtrënguara të ndërmarrin masa specifike politikash. Megjithatë, ka disa përjashtime të rëndësishme, për shkak se një grup mjeteve përcaktohet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ligj. Hollësi të mëtejshme mbi këto masa do të prezantohen më tej në këtë seksion.

Pas përcaktimit të qëllimeve të ligjit dhe fushës së veprimit si dhe terminologjisë përkatëse (kreu I), në kreun II, ligji dikton parimet frymëzuese të politikës së eficiencës së energjisë në Shqipëri (neni 5), ndër të cilat janë të rëndësishme ruajtja e operacioneve të tregut, përmendja haptas e stimuljeve financiare dhe promovimi i investimeve që nxisin eficiencën e energjisë, roli shembullor që i jepet sektorit publik, rëndësia e hulumtimit, arsimit, informimit dhe bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm, ndërmjet aktorëve të interesuar në fushën e eficiencës së energjisë, dhe kujdesi ndaj qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale.

Ligji i delegon Këshillit të Ministrave detyrën e përcaktimit të objektivave për Kursimin e Energjisë (neni 6) ndërsa Agjencisë për Eficiencën e Energjisë detyrën e hartimit të PKVEE-së (neni 7) dhe monitorimin e zbatimit të tij (neni 8).

Më poshtë jepen në mënyrë të detajuar masat specifike që kanë synim të drejtpërdrejtë nxitjen e eficiencës së energjisë: Neni 9 trajton masat në sektorin publik dhe ato ndërsektoriale, ku sektori publik duhet të identifikojë rregullat e prokurimit që përshkruajnë standardet e duhura të eficiencës së energjisë, sa herë që konsumi i energjisë mund të ndikohet nga vendimet e prokurimit; gjithashtu neni rendit klasat e masave që konsiderohen të kenë ndikime ndërsektoriale, si në sektorët privatë ashtu edhe në ato publike (standardet, rregullorja, informacioni tatimor dhe edukimi, monitorimi); Neni 10 parashikon që konsumatorët e mëdhenj (që përcaktohen si ata me konsum vjetor të energjisë mbi ekuivalentin e 3 milionë KWh energjie

elektrike) duhet të emërojnë një Administrator të Energjisë profesionalisht të kualifikuar, “përgjegjës për mirëmbajtjen e objekteve që konsumojnë çdo lloj energjie, duke përmirësuar dhe mbikëqyrur metodën e përdorimit të energjisë, si dhe kryerjen e të gjitha punëve të tjera për përdorimin racional të energjisë në industri dhe ndërtesa”. Gjithashtu, konsumatorët e mëdhenj duhet të marrin masa specifike për të rritur kursimet e energjisë, në mënyrë që të respektohen objektivat specifike që PKVEE-ja do të caktojë për ta (neni 11). Në nenin 12 nxiten marrëveshje vullnetare mes konsumatorëve të mëdhenj të energjisë (dhe ndoshta Agjencisë së Eficiencës së Energjisë – teksti nuk është plotësisht i qartë në këtë pikë).

Kreu III trajton informacionin dhe masat e matjes së eficiencës së energjisë. Në veçanti, ai përcakton se duhet ngritur një bazë e centralizuar të dhënash mbi konsumin e energjisë e cila duhet përditësuar çdo vit (neni 13); ai përcakton se duhen instaluar sisteme matëse individuale ose, kur këto nuk janë të realizueshme, rregulla transparente për caktimin e volumit të konsumit të matshëm në mënyrë kolektive të të gjithë konsumatorët dhe llojin e përdorimit (neni 14), dhe se Agjencia e Eficiencës së Energjisë duhet t’i japë rëndësinë e duhur informacionit përkatës (neni 15). Kreu IV trajton objektivat dhe rregulloren e ofrimit të shërbimeve që mund të përmirësojnë eficiencën e energjisë, të tilla si auditet e energjisë (neni 16 dhe 17) dhe ato të kompanive të shërbimit të energjisë (ESCO). Kreu V trajton themelimin e Fondit të Eficiencës së Energjisë, një mjet financiar me statusin e organizatës jofitimprurëse që synon mbështetjen financiare të veprimeve përmirësuese të eficiencës së energjisë. Së fundi, kreu VI përcakton Agjencinë e Eficiencës së Energjisë, si dhe kompetencat, qëllimet dhe përgjegjësitë e saj.

- Ligji nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjie”

Vlefshmëria: Nga hyrja në fuqi dhe më tej e pakufizuar deri në rishikime të mëtejshme

Ky ligj tregon prioritetet kryesore strategjike në fushën e burimeve të energjisë së rinovueshme në Shqipëri, dhe përcakton institucionet dhe instrumentet kryesore të përfshira në realizimin e prioritetëve të tilla. Ai ofron gjithashtu specifikime teknike të drejtpërdrejta që lidhen me rregullin e llogaritjes për pjesën e BER-it në prodhimin e energjisë, dhe për objektiva të ngjashëm dhe në integrimin në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike BER për prodhimin e energjisë elektrike. Përveç këtyre rregulloreve teknike, struktura e tij është shumë e ngjashme me ligjin e eficiencës së energjisë.

Ky ligj nuk përcakton direkt objektivat sasiorë dhe as zgjedh masat e politikave për t’i zbatuar ato, por ia delegon zgjedhje të tilla akteve nënligjore dhe planeve të njëpasnjëshme të BER-it. Megjithatë, ai parashikon se objektiva të tillë duhen përcaktuar, dhe rendit një listë të mjeteve të politikave nga të cilat autoritetet përgjegjëse për zbatim mund të zgjedhin si ta gjykojnë të përshtatshme, pa qenë të detyruara të ndërmarrin masa specifike politikash. Sa i përket ligjit të EE-së, ka një set kryesor të mjeteve të përcaktuara në mënyrë të drejtpërdrejtë me ligji, kryesisht me natyrë teknike. Hollësi të mëtejshme mbi këto masa do të sigurohen në vijim të këtij seksioni.

Ligji fillon me përcaktimin e qëllimit të përgjithshëm të tij (rritje të depërtimit të burimeve të rinovueshme, rritje të diversifikimit të burimeve të energjisë, ulje të shkarkimeve GES, promovimin e teknologjive të pastra). Më tej, rendit objektivat e politikave në nenin 2, të cilat përfshijnë përcaktimin e objektivave kombëtarë, përcaktimin e përgjegjësive administrative, si dhe harton mekanizma nxitës për promovimin e BER-it. Terminologjia përkatëse përcaktohet në nenin 3. Në kreun II ligji i delegon Këshillit të Ministrave detyrën e përcaktimit të objektivave të detyrueshëm për pjesën e BER-it në konsumin bruto të energjisë përfundimtare (neni 4), dhe i delegon Ministrisë së Energjisë, në vijim të propozimit të Agjencisë për Burimet e Energjisë së Rinovueshme, detyrën e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit të Energjisë së Rinovueshme dhe monitorimin e zbatimit të tij (neni 5). Neni 6 përcakton rregullat që duhen ndjekur në mënyrë që të llogariten pjesën e BER-it për vektorë të ndryshëm të energjisë dhe teknologjive, të cilat duhet të dorëzohen nga Agjencia BER, në Ministrinë e Energjisë dhe Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE) çdo vit. Rregullat për miratimin zyrtar nga ana e qeverisë të aktivitetit të monitorimit dhe raportimit të Agjencisë mbi zbatimin e Planit paraqiten në nenin 7.

Neni 8 ka të bëjë me autorizimin e projekteve të përbashkëta ndërmjet Qeverisë shqiptare, shteteve anëtare të BE-së ose palëve kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Neni 9 përmban një listë mjetesh të politikave të mundshme të cilat mund të përdoren në nxitjen e BER-it. Neni 10 përcakton Fondin e Burimeve të Energjisë së Rinovueshme, një mjet financiar që synon mbështetjen financiare të investimeve në BER, ndërsa neni 11 siguron rregullat bazë për administrimin e tij.

Neni 12 merret në terma shumë të përgjithshme me masat informuese dhe trajnuese për BER-in, duke siguruar një listë të veprimeve të mundshme mes të cilave ministria mund të zgjedhë nisma të veçanta dhe lejon përdorimin e Fondit BER si burim financues. Nenet 13 dhe 14 përcaktojnë rregullat të krijimit, përcaktimin e qëllimit dhe përgjegjësitë e Agjencisë BER, ndër të cilat: hartimin e planit BER, zhvillimin e rregullave të veçanta për kontabilitetin e energjisë së teknologjive të veçanta, zhvillimin e rregullave që autorizojnë dhe licencojnë instalime të reja, mbledhjen dhe raportimin e informacioneve, të tilla si bilanci i energjisë dhe aksionet BER në konsumin e energjisë.

Masa teknike të veçanta që synojnë nxitjen e BER-it përcaktohen më tej në kreun III. Nenet 14-17 trajtojnë rregullat në lidhje me impiantet BER. Neni 18 përcakton prodhuesit të cilëve do t'iu jepet përparësi në shpërndarjen e energjisë elektrike, bazuar në kapacitetin e tyre (më pak se 10mw), dhe fakti në se ata përdorin BER-in. Procedurat parësore favorizohen nga ky ligj nëpërmjet nenit 21, ku jepen opsionet që, ose ta shesin energjinë e tyre elektrike në tregun konkurrues, ose t'ia shesin transmetimin e energjisë elektrike kompanive shpërndarëse ("përfituesve" në përkthimin e ligjit që na është dhënë), që do të jenë më pas të detyruara ta blejnë në kushtet e paracaktuara nga ERE, ku përfshihet një tarifë furnizimi (neni 22). Përfituesit do të jenë në gjendje të mbulojnë shpenzimet e bëra, për shkak të detyrimeve të tyre kontraktuale me prodhuesit parësorë, nga konsumatori përfundimtar (neni 22). Rregullat për caktimin e tarifave të furnizimit renditen në nenin 24.

Prodhimi i Energjisë së Rinovueshme duhet të certifikohet në mënyrë që të marrë përfitimet që përcaktohen në kreun II të ligjit, kjo kërkon një Garanci të Origjinës. Ky dokument lëshohet nga ERE me kërkesë të prodhuesit, për çdo MWh të prodhuar. Procedura për lëshimin e këtyre certifikatave jepet në mënyrë të detajuar në nenin 26.

Kreu IV trajton rregullimin e masave të mëtejshme që mbështesin përhapjen e BER-it në sektorët e ngrohjes dhe ftohjes, pra në atë fushë që lidhet drejtpërdrejt me sjelljen dhe vendimet e konsumatorit familjar dhe biznesit të vogël. Ai trajton objektivat minimalë (neni 30), veçanërisht për bojlerët diellorë, dhe i jep mundësi ministrisë të vendosë instalimin e detyrueshëm të sistemeve të ngrohjes diellore të ujit, bazuar në karakteristikat e banesave. Neni 31 përmban lidhjet interesante me ligjin e Energjisë Efikase, sepse instalimi i bojlerëve duhet të konsiderohet nga certifikimi i performancës së energjisë së banesave dhe në mënyrë analoge, në rastin e eficiencës së energjisë, ndërtesave publike u kërkohet të vendosin një shembull dhe të jenë të parat që instalojnë bojlerë të tillë. Bojlerët diellorë të instaluar duhet të përmbushin standarde teknike të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave. Këto standarde, nëse është e mundur, duhet të hartohen duke ndjekur kriteret e BE-së dhe të testohen duke ndjekur procedurat e BE-së (neni 32). Instalimi i sistemeve me ngrohje diellore do të gëzojë të drejtën e përjashtimit nga TVSH-ja dhe detyrimet doganore (neni 33). Grantet në sektorin bujqësor deri në 30% të kostos së investimit për ngrohje dhe ftohje, duke përdorur burimet e rinovueshme, parashikohen në nenin 34. Së fundi, drafti përfshin titullin për nenin 35 mbi sanksionet administrative, i cili nuk ishte hartuar ende në kohën e shkrimit të këtij dokumenti.

Ligji nr. 116/2016 "Për performancën e energjisë së ndërtesave"

Vlefshmëria: Nga hyrja në fuqi dhe më tej e pakufizuar deri në rishikime të mëtejshme

Një pjesë e veçantë e legjislacionit parësor mbi performancën e energjisë në banesa (Projektligji PEN) është përgatitur në përputhje me dispozitat e direktivave të banesave mbi performancën e energjisë së BE-së (direktiva 2010/31/EU).

Ligji i PEN-it përfshin dispozitat përkatëse për banesa me energji thuajse zero (NZEB), dhe për këtë arsye përcakton bazën për identifikimin e objektivit (objektivave) kombëtar përkatës dhe përgatitjen e planit për arritjen e objektivit (objektivave). Në mënyrë të veçantë, dispozitat përkatëse të ligjit për PEN parashikojnë ndër të tjera:

- Përgjegjësinë për përgatitjen e planit do ta mbajnë ministrinë e energjisë dhe ndërtimit;
- Objektivat janë vendosur për t'u zbatuar nga të gjitha banesat e reja publike, pas 31 dhjetorit 2018, dhe nga të gjitha ndërtesat e reja, pas 31 dhjetorit 2020;
- Objektivat e ndërmjetëm që janë vendosur për përmirësimin e performancës së banesave të reja dhe stokut të banesave ekzistuese, të cilat mund të jenë të diferencuara, sipas kategorisë së ndërtimit.

Masat kryesore të kursimit të energjisë të cilat përfshihen në ligj janë:

- **Taksa e shkarkimeve direkte CO₂ për banesat bazuar në performancën e energjisë së banesave**, e cila parashikon funksionin e menjëhershëm të Fondit për Eficiencën e Energjisë, në mënyrë që fondet të kanalizohen në programet e eficiencës së energjisë.

- **Zbatimi i skemës së certifikimit të performancës së energjisë bazuar në energjinë përfundimtare**. Përkufizimi i faktorëve parësorë të energjisë dhe shkarkimeve CO₂ bazuar në bilancin kombëtar të energjisë.

- **Certifikimi i energjisë për banesat**, në përputhje me kuadrin ligjor aktual (Kodi i Energjisë së Banësive dhe ligji i EE-së).

Prokurimi publik “i gjelbër”: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe me organizma të tjerë, duhet të hartojnë një manual udhëzimesh për integrimin e kërkesave të eficiencës së energjisë në procedurat e prokurimit publik, të cilat do të përfshijnë një zhvillim të detajuar të kriterëve teknike për prokurimin e gjelbër për produkte të caktuara. Me udhëzim të qeverisë, ky manual duhet t'u dërgohet të gjitha institucioneve shtetërore dhe autoriteteve rajonale dhe vendore. Pas hartimit të manualit, duhet të hartohen dhe zbatohen kurse dhe aktivitete të tjera edukative për punonjësit e administratës publike qendrore dhe vendore, të cilët do të kryejnë prokurimin, si edhe të krijohet një sistem monitorimi për përdorimin e kriterëve të gjelbra. Megjithatë, zbatimi i plotë i ligjit qëndron mbi zhvillimin akteve nënligjore shoqëruese, që përfshijnë:

- Një Metodë Kombëtare të Llogaritjes (NCM) për llogaritjen e performancës së energjisë së integruar të një ndërtese apo njësie të ndërtimit dhe që janë përdorur në llogaritjen e niveleve optimale të kostos së kërkesave të performancës së energjisë për ndërtesat, njësitë dhe elementët e ndërtimit që do të mundësojnë lëshimin e certifikatave të performancës së energjisë (CPEs).

- Kërkesat minimale të performancës së energjisë për ndërtesat (të llogaritura në përputhje me NCM).

- Kërkesat e sistemit për performancën e përgjithshme të energjisë, instalimin dhe dimensionimin e duhur, rregullimin dhe kontrollin e sistemeve teknike të ndërtimit në ndërtesat ekzistuese.

- Metodologjia për llogaritjen e kërkesave të performancës së energjisë për banesat, njësitë dhe elementet e ndërtimit.

- Kërkesat minimale të performancës dhe kërkesat e përdorimit të sistemit alternativ me eficiencë të lartë për banesa që përdorin 100% energji të rinovueshme.

- Procedurat me të cilat do të kryhet certifikimi i energjisë së banesave dhe njësie të ndërtimit, si dhe për llojin, mostrën, përmbajtjen, ashtu edhe për procedurat për lëshimin dhe regjistrimin e certifikatës së performancës së energjisë të njësisë përkatëse.

- Procedurat për inspektimin e sistemeve të ngrohjes dhe ajrit të kondicionuar.

- Ekspertiza e një eksperti të pavarur dhe kërkesat e përshtatshme për procedurat e certifikimit, procedurat operative si dhe ato të regjistrimit, mbikëqyrjes dhe trajnimit.

- Një kod i praktikës për ekspertë të pavarur që kryen certifikimin e energjisë të banesave dhe njësie të banimit.

- Një sistem i pavarur kontrolli që verifikon CPEs me anë të një verifikimi të të dhënave të banesave dhe njësave të banimit të përdorura, për të lëshuar certifikatën e performancës së energjisë dhe rezultat e përcaktuara në certifikatë.

Ligji PEN kërkon gjithashtu, që ministria përgjegjëse për ndërtimin, të hartojë një plan kombëtar për të rritur numrin e banesave që përdorin pothuajse 100% energji të rinovueshme në Shqipëri. Planin do të përfshijë:

- Përkufizimin e detajuar për banesat që përdorin pothuajse 100% energji të rinovueshme në Shqipëri, me një referencë me tregues numerik të përdorimit të energjisë primare (në kWh/m² në vit).

- Objektivin se të gjitha ndërtesat e reja duhet ta përmbushin këtë kusht deri në 31 dhjetor 2020.

- Objektivin se të gjitha banesat e reja të banuara dhe në pronësi të autoriteteve publike duhet ta përmbushin këtë kusht deri më 31 dhjetor 2018.

- Objektivat e ndërmjetëm për të përmirësuar performancën e banesave të reja dhe të stokut të banesave ekzistuese.

- Objektivat e ndryshëm që varen nga kategoria e banesave.

- Informacionin mbi politikën shtesë dhe ato financiare ose masa të tjera të nevojshme për përmbushjen e këtyre objektivave. Planin do të konsiderojë instrumentet më të përshtatshme çdo tre vjet, duke filluar nga data 30 qershor 2015, do të rendisë masat ekzistuese, si dhe masat dhe instrumentet e propozuara.

Ky ligj i përgjigjet një objektiv strategjik të përcaktuar brenda SKZHI-II, i cili përcakton gjithashtu MIE si entin kryesor përgjegjës për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në SKZHI-II me asistencën e Agjencisë Rregullatore të Energjisë dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.

4.1.3 Transporti

Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën kohët e fundit është duke punuar për dy strategjitë dhe planet kryesore: Planin Shqiptar të Transportit të Qëndrueshëm dhe Strategjinë Sektoriale të Transportit. Të dy dokumentet ishin ende në proces apo përpunim në kohën e shkrimit të dokumentit të SKNK&P-ës, kështu që analiza e mëposhtme bazohet në draftin e parë të dokumenteve. Të dy dokumentet kanë si qëllim përcaktimin e një rruge për riorganizimin e sektorit të Transportit sipas *acquis* dhe standardeve të BE-së, si dhe zbatimin e udhëzimeve themelore strategjike të parashikuara nga strategjitë e energjisë, planet dhe rrjeti i lëvizshmërisë.

Plani i Qëndrueshëm i Transportit (TECTQ) – Dokumenti bazë

Vlefshmëria: 2016-2020

Qeveria shqiptare është angazhuar përparaqitjen e politikave dhe praktikave të eficiencës së energjisë, si pjesë të Strategjisë së saj Kombëtare për Energjinë, e cila nxit mes të tjerash harmonizimin me kërkesat e BE-së, si pjesë e procesit më të gjerë të paraanëtarësimit. Në këtë kuadër, një Plan i Qëndrueshëm Transporti (TECTQ) po përgatitet nga Ministria përgjegjëse për Transportin dhe Infrastrukturën për të ndihmuar në përmbushjen e objektivave të konsumit të reduktuar të energjisë, si dhe për të përmirësuar qëndrueshmërinë e përgjithshme në sektorin e transportit.

Politikat e qëndrueshme të transportit do të përqendrohen në uljen e nevojës për të udhëtuar dhe në zhvendosjen e udhëtimit në mënyrën më efektive të mundshme sociale, ekonomike dhe mjedisore, si dhe në vendosjen e përmirësimit teknologjik të automjeteve dhe karburanteve në qendër të vëmendjes.

Kjo paradigmë është përkthyer në një kuadër metodologjik, qasja “Shmang–zhvendos–përmirëso”, të pranuar gjerësisht si një udhëzues për politikën që promovojnë lëvizjen e qëndrueshme. Kjo do të thotë se politika e transportit duhet të ulë nevojën e udhëtimit dhe të shkurtojë gjatësitë e udhëtimit, të promovojë një zhvendosje ndaj mënyrave të qëndrueshme dhe të përmirësojë qëndrueshmërinë e të gjitha mënyrave, duke përdorur

teknologjitë më efikase të energjisë. Një program i detajuar dhe një përkufizim i një buxheti të mundshëm financiar është zhvilluar për pjesën më të madhe të masave të propozuara.

Të nëntë masat e përfshira në TECTQ përfshijnë pesë masa të cilat japin një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të matshëm në lidhje me kursimin e energjisë dhe uljen e ndotësve, dy masa të zhvilluara si udhëzime për palët e interesuara (duke pasur një horizont konkret të zbatimit përtej 2020) dhe dy masa shoqëruese të cilat mbështesin planin e përgjithshëm me komunikimin e duhur dhe mjetet e monitorimit. Të nëntë masat e përfshira janë si më poshtë:

1. Zgjerimi i kapaciteteve rrugore: ulja e shkarkimit të ndotësve të ajrit dhe konsumi i energjisë, duke ulur ngarkesën e qarkullimit rrugor falë kapaciteteve shtesë në seksionet rrugore me trafik më të rënduar (në bashkëpunim me Projektet Parësore të Infrastrukturës së Transportit), ka të bëjë kryesisht me zgjerimin e kapacitetit të akseve rrugore më të nevojshëm. Projektet e këtij lloji mund të kursejnë energji dhe të ulin shkarkimet e automjeteve kur zbatohen në segmente rrugore me trafik të lartë, ku efikasiteti i karburantit ulet ndjeshëm.

2. Përmirësimi i kushteve të shtrimit të rrugëve: ulja e shkarkimit të ndotësve të ajrit dhe konsumit të energjisë me anë të përmirësimit të kushteve të shtrimit të rrugëve, nëpërmjet një strategjie të re të mirëmbajtjes rrugore.

3. Risia e shtrimit të rrugëve: zbatimi i teknologjive të reja në shtrimin e rrugëve, duke ulur ndikimet mjedisore të mirëmbajtjes rrugore dhe qarkullimit rrugor, si teknologjia e ftohtë e riciklimit dhe trajtimi fotokatalitik antindotje.

4. Transport i integruar dhe shfrytëzimi tokës: ulja e nevojës së udhëtimit dhe shkurtimi i gjatësisë së udhëtimeve, falë strategjive të përziera të shfrytëzimit të tokës dhe vlerësimit paraprak të transportit, ndikon në planet e zhvillimit. Në Shqipëri, mungesa e vëmendjes ndaj planifikimit të territorit rezultoi me rritje të frekuencës dhe gjatësisë së udhëtimit, për shkak të mungesës së strategjive që synojnë bashkërendimin e zhvillimit të zonave rezidenciale, industriale dhe ato të shërbimit.

5. Përmirësimi i transportit publik rrugor: zhvendosja e trafikut nga transporti privat në atë publik përmes racionalizimit dhe qasjes më të mirë në rrjetin ndërqytetës të autobusëve. Transporti ndërqytetës/rajonar në Shqipëri, për momentin, është tejet i varur nga kushtet e rrugëve dhe në veçanti, nga makinat private. Për shkak të cilësisë së keqe aktuale të sistemit hekurudhor, transporti hekurudhor nuk mund të konsiderohet një zgjidhje afatshkurtër. Prandaj, masa afatshkurtra për uljen e udhëtimeve ndërqytetëse me makinë do të bazohen në zhvillimin e transportit publik me autobusë. Masa është koherente me skenarin zbutës të INDC-ës.

6. Menaxhimi i integruar i mallrave: ulja e shkarkimit të ndotësve të ajrit dhe konsumi i energjisë përmes përmirësimit të faktorit të ngarkesës së mallrave rrugorë, në sajë të veprimeve të konsolidimit të mallrave. Masa ka për qëllim racionalizimin e proceseve logjistike që çojnë në përmirësimin e produktivitetit dhe besueshmërinë e operacioneve të transportit, si dhe trajtimin e mallrave (dhe në veçanti një rritje në faktorin e ngarkesës së kamionëve), duke çuar në kursim të kostos dhe ndotjes.

7. Tarifat e makinave eficiente dhe stimujt për rinovimin e flotës: ulja e shkarkimeve të ndotësve dhe konsumit të energjisë përmes rinovimit të flotës së makinave stimuluar nga tarifat e eficiencës dhe stimujt. Skema e taksave të makinave mbi eficiencën e tyre dhe stimujt që mbështesin rinovimin e flotës, përdoret në të gjithë botën për të përshpejtuar përhapjen e mjeteve me ndotje të ulët, ndërsa në Shqipëri taksat e automjeteve të transportit nuk lidhet ngushtë me klasën e Euros dhe nuk ekzistojnë skema bonusesh që stimulojnë prirjen për të zëvendësuar automjetet e vjetruara. Flota aktuale shqiptare mbizotërohet fuqishëm nga automjete të vjetra ndotëse, që ndikojnë negativisht në ndotjen e ajrit, në shkarkimet CO₂ dhe në konsumin e energjisë. Në përputhje me praktikën ndërkombëtare, masa duhet zbatuar përmes modifikimi të skemës së taksave të makinave dhe strukturave të stimujve financiarë. Masa është në përputhje me skenarin e zbutjes së INDC-ës.

8. Masa të buta dhe të ashpra (iniciativa të ndërgjegjshme të lëvizjes): mbështetja e zbatimit TECTQ përmes fushatave të duhura të informacionit që kanë si qëllim gjithashtu, shmangien ose uljen e sjelljeve më pak të qëndrueshme të transportit.

9. Monitorimi i cilësisë së ajrit dhe trafikut: monitorimi i cilësisë së ajrit dhe trafikut në rrjetin rrugor kryesor për të vlerësuar eficiencën e zbatimit TECTQ dhe zhvillimit të përgjithshëm në kushtet e trafikut dhe ajrit. Çdo plan që synon një sistem transporti më të qëndrueshëm do të kërkojë një monitorim efektiv të cilësisë së ajrit dhe kushteve të trafikut përgjatë rrjetit. Sistemi i monitorimit duhet të lejojë të kuptuarit në detaje të burimeve kryesore GES dhe shkarkimeve të ndotësve të ajrit; monitorimi i efektivitetit të të gjitha masave të identifikuar në TECTQ; zhvillimin e politikave të ardhshme dhe strategjive për të përmirësuar cilësinë e ajrit; vlerësimin e pajtueshmërisë me objektivat dhe vlerat kufi, duke e bërë çështjen më të dukshme.

Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plani i Veprimit (SSTPV)

Vlefshmëria: 2016–2020

Objektivi i përgjithshëm i SSTPV 2016–2020 është ai i zhvillimit të mëtejshëm të sistemit kombëtar të transportit në Shqipëri dhe përmirësimit të ndjeshëm të qëndrueshmërisë së tij, ndërlidhjes, ndërveprimit dhe integritimit me sistemin më të gjerë të transportit ndërkombëtar, si dhe atë rajonal.

Vizioni, prioritetet strategjike dhe objektivat janë në përputhje me vizionin strategjik të Qeverisë shqiptare dhe me konceptet kryesore të politikës evropiane të transportit. Ai siguron zhvillimin e një sistemi efikas, të qëndrueshëm dhe të një transporti miqësor ndaj mjedisit, në gjendje të mbështesë objektivat kryesorë të zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë, si dhe integritimin e mëtejshëm të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Të gjitha masat e cituara janë të përfshira në SKZHI-II dhe konsiderohen në përputhje me dokumente të tjera përkatës që kanë të bëjnë me planifikimin, si Libri i Bardhë 2011 i BE-së mbi Transportin, Strategjia 2020 e Evropës Juglindore (SEE2020) dhe disa objektiva të mbetur të cilët përfshihen në 2010 ANTP-ën (Plani Kombëtar Shqiptar për Transportin).

Prioritetet strategjike për transportin rrugor kanë të bëjnë me kushtet ligjore dhe qeverisëse, përfundimin dhe modernizimin e rrjetit shqiptar primar dhe sekondar, si dhe fuqizimin e bashkëpunimit rajonal përmes lidhjeve rrugore. Qasja e përgjithshme është arritja e një tregu të transportit rrugor në përputhje me standardet e BE-së. Prioritetet strategjike për transportin hekurudhor lidhen me ngritjen e një tregu të hapur për investitorë dhe rritjen dukshëm të visibilitetit të zonës së SEETO-s (Observatorit të Transportit të Evropës Juglindore).

Prioritetet strategjike për transportin detar synojnë përmirësimin e sistemit rregullator në përputhje me rregulloret e BE/IMO (Organizata Ndërkombëtare Detare), mbështetjen e zhvillimit të tregjeve detare dhe portuale. Për sa i përket transportit ajror, zhvillimi i infrastrukturës së re të aeroportit në jug të vendit duhet të shërbejë për të zhvilluar turizmin; një treg më konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara, zbatimin dhe unifikimin e standardeve ndërkombëtare ajrore, si dhe uljen e tarifave të udhëtimit për pasagjerët janë prioritetet për periudhën e vlefshmërisë.

Një prioritet agregat final duhet të mbështesë krijimin e një **sistemi transporti** efikas dhe të **integruar** përmes veprimeve të tërthorta.

Dokumenti parashikon secilën nga strategjitë e mësipërme në politika specifike dhe të detajuara (Veprime Parësore), vendosjen e piketave, treguesve dhe objektivave.

Tridhjetë e nëntë politikat (Veprime Parësore) e identifikuar për periudhën pesëvjeçare, ndërlidhen thellë, duke vendosur një ekuilibër mes masave të buta dhe investimeve, dhe janë zgjedhur për të përcaktuar një Plan të Qëndrueshëm të Veprimit të Strategjisë së Transportit Kombëtar.

Efikasiteti dhe zhvillimi rajonal patjetër që udhëheqin strategjitë dhe politikat; vetëm disa prej veprimeve të detajuara parësore kanë rëndësi për një strategji të drejtpërdrejtë masash zbutëse

dhe vetëm dy veprime parësore (në lidhje me transportin rrugor dhe atë intermodal) kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në zbutje, përkatësisht:

- Finalizimi i përshtatjes së legjislacionit shqiptar të transportit me *acquis* të BE-së, nëse finalizohet duke përfshirë rregulloren dhe zbatimin e standardeve të shkarkimit të automjeteve⁴⁷.

- Bashkëndimi i masave të politikave kombëtare që promovojnë transportinintermodal dhe të kombinuar, përmes një detyre institucionale dhe specifike gjatë periudhës 2017–2020⁴⁸, e cila zyrtarizon zbatimin e rekomandimeve të Planit të Transportit të Qëndrueshëm.

4.1.4 Bujqësia dhe LUCF-ja

Kuadri kryesor i politikës që duhet marrë në konsideratë në dokumentin e SKNK&P-së për sektorin bujqësor është Strategjia Ndësektoriale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (SNBZHR) dhe Programi i saj për Zhvillimin Rural 2014–2020 në kuadër të Instrumentit dhe Asistencës Paraanëtarësim (IPARD), të dyja të dorëzuara në maj 2014 dhe që shtjellojnë, në përputhje me “Paketën e BE-së për Klimën dhe Energjinë 2020”, masat dhe veprimet për rritje të fortë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, në sektorin e bujqësisë në Shqipëri. Sektori pyjor është rregulluar me projektligjin për administrimin e fondit kombëtar të pyjeve dhe kullotave në Republikën e Shqipërisë, i cili është gati që në dhjetor 2015, por në kohën e shkrimit të dokumentit nuk ishte miratuar ende. Për më tepër, një tjetër kuadër politik për t’u konsideruar për ekosistemet natyrore në përgjithësi, është Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit (DPSMB - Dokumenti i Politikave Strategjike Për Mbrojtjen e Biodiversitetit) 2016–2020, i cili siguron një listë masash për mbrojtjen dhe rritjen e ekosistemeve natyrore.

Strategjia Ndësektoriale për Zhvillimin e Bujqësor dhe Rural (SNBZHR) dhe Programin e Zhvillimit Rural 2014–2020 nën Instrumentin e Asistencës Paraanëtarësim (IPARD)

Vlefshmëria: 2014–2020

SNBZHR-ja dhe IPARD-i u përgatitën nga ish Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHR) nga muaji tetor 2012 deri në maj 2014, dhe u përpunuan në përputhje me kuadrin e strategjisë “Europa 2020” për rritje të fortë, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse⁴⁹, si dhe me objektivin e përgjithshëm strategjik të anëtarësimit të Shqipërisë në BE, në përputhje me parimet kryesore të ardhshme, të Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së (PBB) 2014–2020 dhe politikave të paraanëtarësim.

SNBZHR-ja dhe IPARD-i paraqesin ndërhyrjet strategjike për zhvillimin e bujqësisë në Shqipëri dhe që zonat rurale të jenë të afta të përmbushin sfidat e kërkesave të tregut të vetëm të BE-së, si dhe përshtatjen e politikave shqiptare të zhvillimit bujqësor dhe rural me PBB.

Vizioni është zhvillimi i kushteve të duhura të kuadrit ligjor për një sektor efikas, novator dhe praktik agroushqimor, i aftë të mbështesë presionin konkurrues dhe të përmbushë kërkesat e tregut të BE-së, përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve dhe zonave të qëndrueshme rurale që ofrojnë aktivitete ekonomike dhe mundësi punësimi, përfshirje sociale dhe cilësi jete për banorët e zonave rurale.

SNBZHR-ja përfshin një përshkrim të detajuar të gjendjes aktuale të bujqësisë dhe zonave rurale në Shqipëri, nga një pikëpamje ekonomike, mjedisore dhe sociale; përcakton objektivat për zhvillim ekonomik dhe ulje të varfërisë, bazuar në rritjen e konkurrencës, përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, si dhe zhvillimin gjithëpërfshirës dhe territorial në zonat rurale; përshkruan politikat e MBZHR-t për periudhën 2014–2020 për tri nga politikat kryesore: (i) Zhvillimin Rural në përputhje me PBB-ën shtylla 2, (ii) Mbështetje të drejtpërdrejtë ndaj fermerëve sipas PBB-ës shtylla 1, investime në infrastrukturën rurale në administrimin e ujërave

⁴⁷ Veprimi Parësor nr. 1 i Asistencës Teknike për përgatitjen e Strategjisë së Sektorit të Transportit në Shqipëri – Strategjia Përfundimtare dhe Plani i Veprimit – draft 0.1 – 31/01/2016

⁴⁸ Veprimi Parësor nr. 37 i Asistencës Teknike për përgatitjen e Strategjisë së Sektorit të Transportit në Shqipëri – Strategjia Përfundimtare dhe Plani i Veprimit – draft 0.1 – 31/01/2016

⁴⁹ Komisioni Europian: Shpjegim mbi Bashkimin Europian: Europë 2020 – Strategjia e Zhvillimit Europian, Luksemburg, 2013

dhe konsolidimin e tokës si dhe veprime që mbështesin mundësi të barabarta, (iii) Zhvillim institucional, rregullim dhe zbatim.

Për më tepër, përcaktohet një ndarje e përgjithshme e buxhetit për periudhën 2014–2020, si dhe kuadri i monitorimit dhe vlerësimit. Është përgatitur dhe bashkëngjitur në strategji, një plan veprimi i MBZHR-t, që përshkruan veprimet specifike që do të ndërmerren në një periudhë afatshkurtër (2014 dhe 2015), afatmesme (2016-2020) dhe afatgjatë (pas vitit 2020).

SNBZHR-ja është përgatitur gjithashtu, si një pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI-II), e bashkërenduar nga Planifikimi Strategjik dhe Programet e Zhvillimit pranë Zyrës së Kryeministrit.

IPARD-i identifikon trembëdhjetë masa në kuadrin e Zhvillimit Rural në përputhje me PBB-ën, shtylla 2, për të përmbushur standardet përkatëse të BE-së. Pesë nga këto masa (masat 1-5) kanë për qëllim rritjen e qëndrueshmërisë dhe konkurrencës së bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit, duke u kujdesur njëkohësisht për sigurinë dhe cilësinë e ushqimit, rritjen e prodhimit organik dhe mbrojtjen mjedisore.

Në veçanti **Masa 3 – Investimet në asete fizike që lidhen me përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe ato të peshkimit**, ndihmojnë për trajtimin e sfidës ndaj ndryshimeve klimatike, duke nxitur eficiencën e burimeve dhe energjisë së rinovueshme.

Masat 6 dhe 7 kanë si objektivi të veçantë atë të restaurimit, ruajtjes dhe rritjes së ekosistemeve, të administrimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe veprimeve klimatike, duke administruar burimet pyjore dhe ujore, si dhe futjen e metodave të prodhimit bujqësor që mbrojnë mjedisin dhe ulin ndikimin në klimë. Në veçanti, **Masa 6 - Agromjedisi dhe bujqësia organike**, mbështet futjen e metodave të prodhimit bujqësor me ndikim pozitiv ndaj mjedisit (bujqësi organike) dhe **Masa 7 – Krijimi dhe mbrojtja e pyjeve** përqendrohet në:

- Zgjerimin dhe përmirësimin e burimeve pyjore përmes pyllëzimit të tokës, me qëllim parandalimin e erozionit, mbrojtjen e burimeve ujore, zhvillimin e biodiversitetit, si dhe ndihmon me përshtatjen ndaj sfidave të ndryshimeve klimatike;

- Rikthimin e potencialit pyjor në pyjet e dëmtuara nga zjarri dhe futjen e veprimeve parandaluese, me qëllim mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve, si një nga burimet kryesore të shërbimeve të ekosistemit.

Gjithashtu, veprimet për mbështetjen e drejtpërdrejtë të fermerëve sipas PBB-së shtylla 1, që i ndihmojnë fermerët shqiptarë të ndërmarrin praktika bujqësore në dobi të klimës dhe mjedisit, dhe që ndihmojnë zhvillimin institucional, rregullimin dhe zbatimin e parashikuar nga SNBZHR-ja dhe IPARD-i do të lejojnë gradualisht futjen e kriterëve të BE-së për rregullimin e tregjeve, standardeve shëndetësore dhe të higjienës, mbrojtjen e mjedisit dhe zbutjen e efekteve prej ndryshimit të klimës në sektorin bujqësor shqiptar.

Projektligji mbi administrimin e fondit kombëtar të pyjeve në Republikën e Shqipërisë

Vlefshmëria: pritet të hyjë në fuqi në vitin 2019, pa afat deri në rishikime të mëtejshme

Projektligji mbi Administrimin e fondit kombëtar të pyjeve në Republikën e Shqipërisë” po përgatitet dhe në momentin e shkrimit të dokumentit ende nuk ishte miratuar.

Qëllimi i ligjit është zhvillimi dhe mbrojtja e pyjeve, si një pasuri kombëtare e një rëndësie të veçantë, duke njohur vlerat e tyre të mëdha për mbrojtjen e klimës dhe tokës, biodiversitetit, burimeve gjenetike dhe regjimit hidrik, si një detyrim për brezat e tanishëm dhe ata të ardhshëm.

Ligji synon të përcaktojë administrimin, qeverisjen dhe mbrojtjen e fondit kombëtar të pyjeve dhe kullotave, duke u bazuar në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe të përcaktojë rregullat, detyrimet, të drejtat, përgjegjësitë dhe marrëdhëniet e institucioneve shtetërore, pronarëve dhe bizneseve private. Për këtë qëllim ai përcakton funksionimin e **shërbimit pyjor** si një shërbim publik.

Sipas projektligjit, Politikat e Zhvillimit të Pyjeve do të përfaqësojnë objektivat, prioritetet dhe udhëzimet kryesore afatgjata dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve, të cilat duhet të zbatohen në një periudhë afatgjatë të **Strategjisë së Zhvillimit të Pyjeve dhe Kullotave**, e cila duhet të përcaktojë qëllimet dhe objektivat strategjike që duhen zbatuar në periudhën afatgjatë, në

përputhje me detyrimet që rrjedhin nga konventat, marrëveshjet, protokollet ndërkombëtare dhe nga politikat dhe strategjitë e sektorëve të tjerë. Për zbatimin e Strategjisë së Pyjeve dhe Kullotave, do të hartohet një **Program Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave** për një periudhë 10-vjeçare, duke ofruar veprime, buxhet, afate konkrete dhe detyra përkatëse për institucionet e përfshira në zbatimin e tij në nivel qendror, rajonal dhe vendor, për një administrim të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, me qëllim sigurimin e përdorimit shumëfunksional të pyjeve dhe kullotave.

Ligji ndalon shumë aktivitete, të tilla si ai i prerjes në mënyrë të paligjshme të pyjeve, i cili aktualisht shkakton një problem konkret të uljes së stokut të karbonit nga pyjet në Shqipëri, dhe aktivitete të tjera të paautorizuara, të paparashikuara nga **plani i administrimit** të secilit pyll, i cili do të jetë një dokument zyrtar dhe instrument qeverisës i zhvillimit dhe mbrojtjes së pyjeve dhe kullotave, i vlefshëm për një periudhë dhjetëvjeçare.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i projektligjit është organizimi i **Kadastrës Kombëtare të Pyjeve dhe Kullotave**, që do të bashkojë sistemin e informacionit të pyjeve dhe kullotave, duke përfaqësuar regjistrin zyrtar dhe bazën e të dhënave, duke regjistruar tërësinë e informacionit të nevojshëm për administrimin dhe qeverisjen e fondit kombëtar të pyjeve dhe kullotave, të shoqëruar nga Sistemi i Informacionit Strategjik (GIS). Ligji nxit gjithashtu, parandalimin e zjarreve dhe krijimin e Regjistrit të Zjarreve.

Për më tepër, mbledhja e të dhënave mbi pyjet shqiptare, shumë e dobishme për të lejuar një vlerësim të saktë të sektorit edhe në terma të përafërta të tendencave GES nga LUCFF-ja, përcaktohet nga Inventari Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave, që do të përditësohet nga ministria të paktën një herë në dhjetë vjet.

Zbatimi dhe hyrja në fuqi e këtij projektligji është shumë e rëndësishme për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit pyjor, veçanërisht duke pasur parasysh përdorimin e drurit, si një burim alternativ energjie për të zëvendësuar lëndët e djegshme fosile. Vetëm duke iu bindur rregullave të rrepta për administrimin e qëndrueshëm të pyjeve, do të jetë i mundur kthimi i sektorit shqiptar të LCF-ës, nga një sektor shkarkimi në një depozitë pozitive e sekuestrimit të karbonit, duke sjellë një kontribut konkret në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Dokumenti i Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit (DPSMB)

Vlefshmëria: 2016-2020

Objektivat kryesorë të Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit (DPSMB) janë: rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura; hartimi dhe zbatimi i planeve të administrimit; plotësimi i kuadrit ligjor në përputhje me *acquis* e BE-së mbi natyrën dhe mjedisin; eliminimi i prerjeve dhe gjuetisë së jashtëligjshme, duke zbatuar kuadrin ligjor dhe aktivitetet që shërbejnë për rritjen e kapaciteteve dhe së fundi, zbatimi i planeve të veprimit për mbrojtjen e specieve dhe habitateve të rrezikuara.

Është përpiluar një listë masash, në mënyrë që të arrihen objektivat specifike të mëposhtëm:

- Deri në vitin 2020 - të sigurohet harmonizimi dhe zbatimi i *acquis*të BE-së në fushën e mbrojtjes së natyrës.

- Deri në vitin 2015 - të miratohet rishikimi i dokumentit strategjik mbi biodiversitetin (DPSMB) në përputhje me objektivin Aichi 17⁵⁰.

- Deri në vitin 2020 - të përcaktohet një objektiv konservimi në masën 17% të zonave tokësore dhe ujore dhe 5% të zonave detare bregdetare. Të krijohet Rrjeti Ekologjik Kombëtar i Shqipërisë, si një pjesë përbërëse e Rrjetit Ekologjik Panevropian (PEEN) – në përputhje me objektivin e Aichi 11.

- Të rimëkëmben të paktën 15% e zonave të degraduara, përmes aktiviteteve të konservimit dhe përtëritjes – në përputhje me objektivat e biodiversitetit Aichi – ky veprim do të arrihet

⁵⁰<https://www.cbd.int/sp/targets/>

përmes zbatimit të planeve të administrimit për zonat e mbrojtura dhe zbatimit të planeve të veprimit për specie dhe habitate në veçanti.

Për t'i përmbushur objektivat e identifikuar, është hartuar Plani Kombëtar i Veprimit, që shërben si një udhërrëfyes për zbatimin e kësaj strategjie sektoriale, me masa dhe afate konkrete. Për më tepër, janë identifikuar dhe treguesit e monitorimit.

4.1.5 Sinergjitë ndërsektoriale dhe boshllëqet/mungesat

Në bazë të analizës së mësipërme, janë identifikuar sinergjitë dhe boshllëqet/mungesat kryesore në mënyrë që të dalin në pah përpjekjet e përbashkëta për arritjen e objektivave të zbutjes, dhe të analizohen boshllëqet/mungesat dhe dobësitë e sistemit, duke propozuar masa korrigjuese për t'i adresuar ato.

Në përgjithësi, ekziston një sinergji e mirë ndërmjet masave të propozuara në nivelet sektoriale dhe ndërsektoriale të cilat mbulojnë plotësisht çështjet e zbutjes së efekteve prej ndryshimeve klimatike në të gjithë sektorët ekonomikë shqiptarë përkatës, që përfshijnë edhe sektorin e energjisë, zhvillimit të transportit dhe planifikimit të territorit, bujqësisë dhe burimeve natyrore. Vihen re disa boshllëq/mungesa dhe dobësi në të gjithë sektorët ,që duhen kapërcyer përmes masave specifike të propozuara në PKVZNK-ë:

- mungesa e një kuadri ligjor që lidhet me ndryshimet klimatike, çka pengon zbatimin e masave afatgjata dhe të qëndrueshme;
- mungesa e kapacitetit institucional për të vlerësuar ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe për ta zbatuar më tej këtë informacion teknik, për mobilizimin e zgjedhjeve programatike që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm;
- ekziston një nevojë urgjente për ngritjen e kapaciteteve dhe krijimin e bazës për t'iu përgjigjur në mënyrë proaktive nevojave për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, veçanërisht në procesin e planifikimit.

Energjia

Sinergjitë dhe Pikëtakimet Ndërsektoriale: Sektori i energjisë shtjelohet mirë edhe nga strategjitë dhe nga plani i analizuar, edhe pse Strategjia Kombëtare e Energjisë mungonte në kohën kur u shkrua ky dokument.

Strategjitë dhe planet emarra deri tani në konsideratë për sektorin e energjisë, me përjashtim të NAMA-vembi mekanizmin financiar për eficiencën e energjisë në banesa, në përgjithësi kanë një potencial të mirë për sinergji dhe karakteristika të përbashkëta me sektorë të tjerë ekonomikë, ku janë zbatuar ose mund të zbatohen masa të njëjta. Në veçanti, INDC-ja natyrshëm vë në dukje përfshirjen e sektorit të transportit dhe bujqësisë/pyllëzimit, megjithëse shkarkimet LUCF-ë nuk janë marrë parasysh në këtë llogaritje të objektivit, edhe pse rishikimi i parashikuar që përmendet në dokument duhet të çojë në përfshirjen e tij deri në vitin 2020. Në mënyrë të ngjashme, PKVEE-ja ka një seksion mbi sektorin e transportit dhe kjo tregon nevojën për një kontroll të qëndrueshëm, kundrejt dokumenteve strategjike dhe planifikuese nga Ministria përgjegjëse për Transportin.

Masat që synojnë zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe që merren në konsideratë si nëSKZHI-II dhe në PKT-ë, shpesh mbivendosen me masat kryesore të përfshira në strategjitë sektoriale dhe dokumentet për sektorët strategjikë (BER dhe PKVEE) dhe me masat që synojnë rritjen e përdorimit të energjisë efikase dhe uljen e humbjeve të energjisë elektrike.

Së fundi, edhe propozimi shumë i përqendruar iNAMA-s, mbi zëvendësimin e lëndëve djegëse fosile me mbetje jo të rrezikshme në industrinë shqiptare të çimentos, bazohet në një sinergji të pashfrytëzuar ndërmjet këtyre dy sektorëve, dhe një sinergji e tillë mund të shtrihet nëpërmjet logjistikës së mbledhjes së mbetjeve në sektorin e transportit.

Miratimi i ligjit mbi Eficiencën e Energjisë dhe ligji mbi Performancën e Energjisë në Banesa, që është në pritje për t'u miratuar, sigurojnë bazën mbi të cilën mund të ngrihet strategjia e re e EE-së në Shqipëri. Kjo përfshin krijimin e Agjencisë për Eficiencën e Energjisë (AEE) dhe Fondin për Eficiencën e Energjisë, zhvillimin e akteve nënligjore të nevojshme dhe mjetet

rregullatore, dhe çka është më e rëndësishmja, zbatimin e një sërë masash të parashikuara në rishikimin e parë të PKVEE-së.

Bosllëqet/mungesat dhe konfliktet: Sa u përket boshllëqeve/mungesave dhe konflikteve, ka disa arsye për t'u shqetësuar. Në përgjithësi, disa masa të parashikuara nga ISKZHI-II mund të sjellin rrezikun potencial të ndikimit negativ mbi zbutjen e ndryshimeve klimatike. Në fakt, strategjia ndjek objektivat e përmbushjes së kërkesave në rritje për energji, për të siguruar zhvillim ekonomik dhe social, për të rritur prodhimin industrial dhe shfrytëzimin e mineraleve të tjera, të tilla si magnezi, i kombinuar me një nivel në rritje të përpunimit. Megjithatë, ky rrezik mund të shmangej falë **Prioriteteve 6**, që duhet të garantojnë një zhvillim ekonomik në përputhje me përdorimin e qëndrueshëm të burimeve.

Një arsye e zakonshme për shqetësim, për disa nga masat e renditura në PKVEE-n dhe në një nivel më të vogël për NAMA-t, është përshtatshmëria e buxhetit të propozuar për një zbatim afatgjatë dhe në shkallë mbarëkombëtare. Shkalla e buxheteve të propozuara duket, në shikim të parë, e përshtatshme për veprimet e kufizuara pilote dhe përhapja e këtyre veprimeve në shkallë mbarëkombëtare për periudhën afatgjatë, kërkon studime të thella të fizibilitetit financiar.

Një tjetër hendek i rëndësishëm, i përbashkët për INDC-ën dhe PKVEE-n, është mbulimi jo i plotë sektorial, çka mund të çojë në rrjedhje të karbonit. Sektori i papërfaqësuar mirë në të dy rastet është ai bujqësor dhe pyjor, pavarësisht rolit të tij të rëndësishëm si sektor prodhues dhe përdorues i energjisë (dhe për këtë arsye si një objektivi i masave të eficiencës së energjisë) dhe si shkarkues GES.

Një fushë e tretë e përmirësimit është: koha dhe bashkërendimi mes nismave të ndryshme strategjike. Për shembull, PKVEE-ja aktuale është tepër afatshkurtër dhe nuk jep tregues të qartë rreth vizionit për periudhën pas vitit 2018. Një drejtim i qartë për bashkërendim do të ishte riorganizimi i botimeve të ardhshme të këtij plani me strategjitë e uljes së nivelit të karbonit, si ato të përfshira në INDC-ën dhe në planin e Karbonit të Ulët – si dhe, me sa duket, planin BER dhe Strategjinë e Energjisë.

Një arsye e katërt shqetësuese është mbështetja në stimujt financiarë dhe në skemat mbështetëse, që mbështeten te NAMA, për mekanizma financimi dhe për disa masa të renditura në PKVEE-n për sektorin e banesave. Është e njohur në literaturë se stimujt financiarë për eficiencën e energjisë janë të prirë ndaj rrezikut të drejtimit falas, që do të thotë, se ka gjasa të mëdha që përfituesit e subvencioneve t'i përvetësojnë fondet e rinovimit, që ata do të kishin kryer gjithsesi. Kështu, efektiviteti i kostos së programit mund të jetë tejet i ulët. Fatmirësisht, këto politika në NAMA-n e përmendur dhe në PKVEE-n nuk qëndrojnë vetëm, por përfshihen në paketa që përfshijnë masa (të tilla si: standardet e detyrueshme, masat monitoruese dhe rritjen e ndërjegjësimit), që janë në gjendje ta zbusin këtë pengesë të mundshme.

Një arsye e pestë për t'u shqetësuar është nevoja e forcimit të anës së zbatimit. Ligji i eficiencës së energjisë është dokumenti i vetëm i politikave, ku parashikohen sanksionet për mos pajtueshmëri. Kjo duhet të shtrihet në të gjithë spektrin e veprimeve të politikave që lidhen me zbutjen e ndryshimeve klimatike; në veçanti, ky nen thelbësor mungon në projektligjin mbi BER dhe parandalimin e humbjeve joteknike. Për shkeljet më të rënda duhen marrë në konsideratë sanksione administrative shtesë për vepra penale.

Së fundi, veprimi i politikave të BE-së në fushën e energjisë së qëndrueshme thekson fort zhvillimet teknologjike që mundësojnë një përdorim më efikas të energjisë, dhe shpërndarjen e më shumë burimeve konkurruese të energjisë së rinovueshme. Pra, ka një mundësi të qartë për Shqipërinë që të përfitojë nga kjo tendencë dhe të ndërmarrë një perspektivë që drejtohet nga zgjidhjet teknologjike të avancuara, çka sigurisht do të mirëpritet nga BE-ja në procesin e anëtarësimit.

Transporti

Sinergjitë dhe pikëtakimet ndërsektoriale: Duke qenë se transporti është një burim i rëndësishëm i shkarkimeve GES, masat që lidhen me një lëvizshmëri të qëndrueshme shpesh përfshihen gjithashtu, në strategjitë dhe planet ndërsektoriale: INDC, SKZHI-II, PKT, SMNS dhe PKVEE.

Masat ndërsektoriale marrin në konsideratë disa nga praktikat më të mira ndërkombëtare, duke përjashtuar ndryshimin kundrejt lëvizjes me mjete elektrike, që nuk duket prioritet afatshkurtër i këtij sektori. Megjithatë, praktikat më të mira mbeten për t'u integruar plotësisht në planifikimin sektorial.

Si PKVEE-ja dhe SMNS-ja theksojnë rëndësinë e miratimit të standardeve të BE-së në sektorin e transportit dhe cilësisë së ajrit. Rinovimi i flotës së automjeteve, rregullimi, sistemi i monitorimit dhe kontrollit të shkarkimeve të makinave janë prioritete të rëndësishme. PKVEE-ja përshkruan përmirësimin e transportit publik (urban dhe rajonal), si dhe merr në konsideratë disa masa të vogla, si: ngarja e mjeteve ekologjike, nxitja e lëvizjes më këmbë dhe përdorimit të biçikletës në bashkitë e zgjedhura. Një kërkesë e përgjithshme për integrimin në planet vendore të çështjeve të ndryshimeve klimatike përshkruhet në SMNS-ën.

Boshllëqe/mungesa dhe konflikte: Në zbatim të objektivave të disa dokumenteve ndërsektoriale (SKZHI-II dhe PKT), për të përballuar shkëmbimin në rritje të mallrave në treg përmes zgjerimit të rrugëve dhe zhvillimit të porteve, mund të ketë rrezik që disa nga masat të ndikojnë negativisht në zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike. Megjithatë, ky rrezik duhet të shmanget përmes një vizioni të qartë të politikave gjithëpërfshirëse të rritjes ekonomike, përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve.

Duke marrë në konsideratë nevojën e përgjithshme të rehabilitimit dhe modernizimit të sektorit të transportit, është e nevojshme të krijohet një lidhje e fortë ndërmjet lëvizshmërisë dhe strukturës urbane, me qëllim optimizimin e sektorit të transportit. Kjo çështje nuk është studiuar gjithmonë dhe transporti urban pothuajse, është anashkaluar në strategjitë sektoriale. Edhe pse është cituar në disa raporte ndërsektoriale (INDC, PKVEE) dhe shkurtimisht në TECTQ, duhet marrë në konsideratë në mënyrë korrekte një kuadër ligjor lidhur me planifikimin e qëndrueshëm të transportit urban, duke qenë se popullsia parashikohet të rritet, veçanërisht në qendrat kryesore urbane.

Mungesa e vëmendjes ndaj planifikimit të territorit shpesh rezulton në rritje të frekuencës dhe gjatësisë së udhëtimeve, për shkak të mungesës së strategjive që synojnë bashkërendimin e zhvillimit në fushat e banesave, industriale dhe të shërbimeve.

Përmirësimi i nënsektorit të transportit hekurudhor kombëtar mund të jetë një qasje e rëndësishme për një strategji të masave lehtësuese, në sajë të zhvendosjes së pasagjerëve dhe mallrave nga transporti rrugor në hekurudhor. Ky objektiv strategjik është parashikuar në SKZHI-II, edhe pse rehabilitimi i plotë i rrjeteve përkatëse hekurudhore do të jetë i mundur vetëm pas shumë kohësh. Objektivi i SKZHI-II për të rritur në mënyrë të dukshme transportin hekurudhor deri në vitin 2020, përmes rikonstruksionit të hekurudhave që lidhin Tiranën me Durrësin, Vorën me Hanin e Hotit, Durrësin me Elbasanin, Rrogozhinën me Vlorën dhe Elbasanin me Pogradecin, duhet të monitorohet dhe përfundimisht të përafrohet me ecurinë aktuale të punës.

Masat e parashikuara për këtë sektor kanë si qëllim uljen e GES-it, edhe duke u nisur nga një bazë e dobët të dhënash dhe të gjitha masat dhe vlerësimi i planeve të analizuara duket se bazohen në parametra agregatë, me besueshmëri të ulët dhe prirje historike. Prandaj, efikasiteti dhe efektiviteti i masave mund të mbivlerësohet (ose nënvlerësohet).

Ndarja mes SSTPV-ës dhe Planit të Qëndrueshëm të Transportit i jep formë strategjive të ndryshme dhe masave për zhvillimin e transportit dhe zhvillimit veçmas të Transportit të Qëndrueshëm. Për përditësime të mëtejshme, MTI-ja duhet të marrë në konsideratë lidhjen e dy planeve dhe të krijojë një strategji të vetme transporti me një objektiv gjithëpërfshirës për uljen e shkarkimeve.

Një rrezik i mundshëm në sektorin e transportit mund të jetë një zhvendosje drejt një rritjeje të madhe të trafikut rrugor, në sajë të përmirësimeve të kapacitetit që duhet monitoruar. Numri total i automjeteve në rrugë po rritet (burim i INSTAT), edhe pse është ende mesatarisht 200 automjete për 1000 banorë. Përmirësimi i kapacitetit rrugor, stimujt për makina të reja dhe një

objektiv i zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies mund të rrisin dukshëm numrin e makinave, krahasuar me mesataren e BE-së prej 450-500 automjete/1000 banorë.

Bujqësia dhe LUCF-ja

Sinergjitë dhe pikëtakimet ndërsektoriale: Strategjia kryesore që mbulon sektorët e bujqësisë dhe LUCF-ës është SNBZHR-ja, e cila është një strategji shumë e plotë, që synon përmirësimin dhe rritjen e nivelit të përgjithshëm të bujqësisë shqiptare, për të përmbushur standardet përkatëse të PBB-ës të BE-së. Masat specifike të përfshira në SNBZHR-në dhe në IPARD mbulojnë bujqësinë dhe pyjet, si dhe përmbajnë disa masa që ndërlidhen me sektorët e energjisë dhe transportit, lidhur me përmirësimin e eficiencës së energjisë në pajisjet e fermave dhe zhvillimin e infrastrukturës rrugore në zonat rurale.

Spektori pyjor mbulohet nga projektligji për Administrimin e Fondit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave në Republikën e Shqipërisë, dhe rregullohet me Dokumentin Strategjik për Planin e Veprimit për Mbrojtjen e Biodiversitetit (DPSMB) dhe strategjia specifike sektoriale për Zhvillimin e Pyjeve dhe Kullotave. DPSMB-ja trajton me vëmendje të veçantë çështjen në lidhje me prodhimin e energjisë nga hidrocentralet në zonat natyrore, me qëllim sigurimin e mbrojtjes së zonave natyrore të prekura nga hidrocentralet, përmes monitorimit dhe vlerësimit periodik të florës dhe faunës në lumenj dhe degët e lumenjve në të cilët janë ndërtuar dhe do të ndërtohen hidrocentralet.

Masat që lidhen me zbutjen e ndryshimeve klimatike të parashikuara nga dokumentet kryesore të përgatitura për sektorin bujqësor dhe LUCF-ës konsiderohen gjithashtu si opsione të vlefshme në KTK-ë; seksioni i analizës së masave zbutëse për bujqësinë dhe pyjet, me një mbivendosje të objektivave koherente, të tilla si ulja e shkarkimeve nga tokat bujqësore, kullotat dhe bagëtitë; ulja e humbjeve të karbonit nga gjallesa dhe toka; rritja e sekuestrimin të karbonit në toka, gjallesa dhe produkte që jetojnë gjatë.

Masat synonin zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike, të cilat konsiderohen në dokumentet ndërsektoriale, të tilla si SMNS, SKZHI-II dhe PKT, dhe përputhen në mënyrë koherente me masat kryesore të përfshira në dokumentet sektoriale dhe ato mbi bujqësinë dhe LUCF-ë, dhe me masat që synonin promovimin e prodhimit të ushqimit të qëndrueshëm, përmirësimin dhe forcimin e mbrojtjes së natyrës, si dhe ruajtjen e pyjeve dhe kullotave.

Boshllëqet/mungesat, dobësitë dhe konfliktet: Rreziku hipotetik i një rritje të madhe të shkarkimeve GES nga sektori i bujqësisë, për shkak të masave që nxisin prodhimin bujqësor shqiptar dhe konkurrencën në SNBZHR-ë, parandalohet nga qasja e tij e fortë dhe e qëndrueshme ndaj përdorimit të burimeve natyrore. Nga ana tjetër, në sektorin e pyjeve, mungesa e strategjive sektoriale specifike për zhvillimin e pyjeve dhe kullotave, përfaqëson një mangësi thelbësore, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se biomasa e pyjeve drusore konsiderohet si burim alternativ i energjisë për ngrohje, siç parashikohet nga masat e përfshira në KTK-ë dhe BER. Ashtu sikurse theksohet edhe nga projektligji mbi Administrimin e Fondit Kombëtar të Pyjeve dhe Kullotave në Republikën e Shqipërisë, do të duhej një qasje e bashkërenduar me qëllim parandalimin e shfrytëzimit të burimeve pyjore.

4.2 Objektivat kryesorë për trajtimin e zbutjes së efekteve prej ndryshimeve klimatike

Për të siguruar që politikat dhe instrumentet e Qeverisë shqiptare përpunohen të orientohen drejt një ekonomie me nivel të ulët të karbonit, më poshtë janë identifikuar një grup objektivash kryesore të nevojshme për t'iu përgjigjur gjashtë prioritetëve të identifikuar të SKZNK-ës (tabela 13).

Tabela 13 – Objektivat e politikave kryesore dhe lidhja e tyre me prioritetet strategjike.

Objektivi i politikave kryesore	Lidhja me Prioritetet Strategjike (SP)
1. Përpjekja për të përmbushur Kontributin e Synuar të Përcaktuar në Nivel Kombëtar në kuadrin e Marrëveshjes së Parisit.	SP.1
2. Forcimi i kapaciteteve të institucioneve përkatëse dhe bashkëpunimi ndër-institucional për trajtimin e zbutjes së ndryshimeve klimatike.	SP.3; SP.4; SP.5
3. Krijimi i sistemit të të dhënave dhe sistemeve MRV për inventarin vjetor GES, në përputhje me kërkesat e raportimit të BE-së dhe UNFCCC –së.	SP.2; SP.5

4.	Nxitja e aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe edukuese që mbështetin veprimet e uljes së shkarkimeve.	SP.1; SP.5
5.	Nxitja e eficiencës së energjisë.	SP.1; SP.6
6.	Nxitja e Burimeve të Qëndrueshme të Energjisë së Rinovueshme.	SP.1; SP.6
7.	Nxitja e mënyrave të qëndrueshme të transportit.	SP.1; SP.6
8.	Nxitja e një sistemi mjetesh miqësore me mjedisin.	SP.1; SP.6
9.	Nxitja e shkarkimeve të ulëta të qëndrueshme për prodhimin e ushqimit.	SP.1; SP.6
10.	Mbajtja në kontroll dhe rritja e përmbajtjes së karbonit në tokat bujqësore.	SP.1; SP.6
11.	Rritja e potencialit të përthithësve të karbonit dhe mbrojtja e rezervave të karbonit në ekosistemet tokësore.	SP.1; SP.6

Prandaj, objektivat e çdo sektori grupohen sipas njëmbëdhjetë objektivave të politikave kryesore, që tregojnë burimin e dokumenteve ku trajtohet, për t'i siguruar Qeverisë shqiptare një hartë strategjike mbi politikat që duhet të jenë prioritet në sektorë të ndryshëm në procesin e uljes së nivelit të karbonit.

Tabela 14 – Lista e objektivave kryesorë politikë që lidhen me objektiva specifike për secilin sektor dhe burim

<i><u>Objektivi kryesor i politikës /Sektori</u></i>	<i><u>Përshkrimi</u></i>	<i><u>Burimi</u></i>
Ngritja e sistemit të të dhënave dhe sistemeve MRV për inventarin vjetor GES në përputhje me kërkesat e raportimit të BE-së dhe UNFCCC-ë (SP2; SP5)		
<i>Energjia</i>	Krijimi i një baze të dhënash mbi energjinë e cila do të mbledhë gjithë informacionin që i duhet një sistemi monitorimi	Ligji 124/2015 mbi Eficiencën e Energjisë
<i>Transporti</i>	Konsolidimi i Sistemit Kombëtar të Monitorimit të Cilësisë së Ajrit dhe Trafikut	SMNS; TECTQ; OZHQ 13
<i>Bujqësia</i>	Krijimi i një monitorimi të përhershëm kombëtar të tokave dhe aktiviteteve bujqësore	Dokumenti i SKNK; OZHQ 13
<i>LUCF-ja</i>	Krijimi i një monitorimi të përhershëm kombëtar të pyjeve dhe kullotave, që përfshijnë zonat e konservimit	SMNS; SKZHI-II; DPSMB; Projektligji i fondit të pyjeve dhe kullotave; OZHQ 13
Përpjekja për të përmbushur Kontributin e Synuar të Përcaktuar në Nivel Kombëtar në kuadrin e Marrëveshjesë Parisit (SP1)		
<i>Ndërsektoriale</i>	Ulja e shkarkimeve CO ₂ krahasuar me skenarin bazë në periudhën 2016 dhe 2030 në masën 11.5%. Kjo do të thotë 708 kt CO ₂ ulje deri në vitin 2030	INDC; OZHQ 13
	Rishikim të objektivave tëINDC-sëderi në vitin 2020, për përfshirjen e gazeve të tjera përveç CO ₂ , dhe sektorëve të tjerë, si Bujqësia dhe LUCF-ja	INDC; OZHQ 13
	Integrimi i objektivave të përshtatjes dhe masave zbutëse në planifikimin fizik, administrimit të ujit dhe tokës që përfshijnë bujqësinë, pyjet, ujërat dhe konservimin e natyrës	SMNS; OZHQ 13
Forcimi i kapaciteteve të institucioneve përkatëse dhe bashkëpunimi ndërinstytucional për trajtimin e zbutjes së ndryshimeve klimatike (SP3; SP4; SP5)		
<i>Energjia</i>	Bashkëpunim mes të gjitha strategjive dhe planeve të Ministrive që lidhen direkt ose indirekt me energjinë, kryesisht ndërmjet energjisë dhe transportit për lëndët e djegshme fosile dhe në një perspektivë afatgjatë, për energjinë elektrike dhe me bujqësinë dhe pyjet për biomasën.	Dokumenti i SKNK; OZHQ 13
<i>Transporti</i>	Bashkëpunimi mes institucioneve dhe qeverive lokale për cilësinë e ajrit dhe politikave të trafikut, si dhe miratimin dhe zbatimin e planeve të veprimit për cilësinë e ajrit	SMNS; OZHQ 13
<i>Bujqësia</i>	Forcimi i administrimit të përdorimit të ujit, me qëllim uljen e përmbytjeve dhe fenomenit të erozionit dhe humbjes së tokës	SKZHI-II; OZHQ 13
<i>LUCF-ja</i>	Forcimi i kapaciteteve për administrimin e qëndrueshëm dhe shumëfunktional të pyjeve dhe kullotave	SMNS; SNBZHR OZHQ 13
Nxitja e aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe edukuese që mbështetin veprimet e uljes së shkarkimeve (SP1; SP5)		
<i>Ndërsektoriale</i>	Riorganizimi i çështjeve të ndryshimeve klimatike në arsim dhe rritja e aktiviteteve ndërgjegjësuere në të gjithë sektorët	Dokumenti i SKNK; OZHQ 13
<i>Energjia</i>	Nxitja e fushatave të ndërgjegjësimit publik, për të informuar publikun mbi mundësitë dhe përfitimet nga eficienta e energjisë	Nama – Mekanizëm Financimi për Eficencën e Energjisë në Banesa (fondi për eficientë e energjisë); PKVEE; OZHQ 13
<i>Transporti</i>	Investime në arsimin publik dhe ndërgjegjësim, për të ndikuar në sjelljen individuale	SMNS; TECTQ; PKT;

		OZHQ 13
<i>Bujqësia</i>	Forcimi i sistemit kërkimor, zhvillimeve teknologjike dhe inovacionit në sektorin bujqësor, duhet të kryhen nga institucionet arsimore dhe shkencore	SMNS; SNBZHR; PKT; OZHQ 13
<i>LUCF-ja</i>	Forcimi i sistemit kërkimor, zhvillimeve teknologjike dhe inovacionit në sektorin e pyjeve dhe kullotave duhet të kryet nga institucionet arsimore dhe shkencore	SMNS; PKT; Projektligji mbi fondin e pyjeve dhe kullotave; OZHQ 13
Nxitja e eficiencës së energjisë (SP1; SP6)		
Energjia	Ulja e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e rrjetin e shpërndarjes deri në 14%	SKZHI-II; OZHQ 13
	Arritja e rritjes në masën 6.8% të eficiencës së energjisë në të gjithë sektorët ekonomikë, krahasuar me konsumin përfundimtar total të energjisë deri në vitin 2020	SKZHI-II; PKVEE 2020; OZHQ 13
	Arritja e uljes në masën 6.8% deri në vitin 2020 krahasuar me skenarin baze, ose një ulje në konsumin e energjisë prej 123.7 Ktoe	PKVEE 2&3 2020; OZHQ 13
Transporti	Ulja e shkarkimit të ndotësve të ajrit dhe konsumit të energjisë, përmes përmirësimit të kushteve të rrugëve dhe futja e teknologjive të reja të shtrimit të rrugëve	TECTQ; OZHQ 13
	Përmirësimi i transportit rrugor që nxit kalimin nga trafiku privat në atë publik, përmes racionalizimit dhe qasjes më të mirë në rrjetin e autobusëve ndërurbanë	TECTQ
Nxitja e Burimeve të Qëndrueshme të Energjisë së Rinovueshme(SP1; SP6)		
Energjia	Arritja e rritjes në masën 38% të përdorimit të energjisë së rinovueshme krahasuar me konsumin përfundimtar total të energjisë, përmes aprovimit dhe zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Energjinë e Rinovueshme	SKZHI-II; BER 2020; LOCSEE Plani i Procesit të Uljes së Karbonit; OZHQ 13
	Rritje të sasisë shtesë të konsumuar energjisë elektrike nga burime të rinovueshme me të paktën 172 ktoe (2,044 GWh) deri në vitin 2020	Plani i Veprimit BER
Transporti	Arritja e kuotës së transportit tëBERnë 3% në konsumin final bruto të energjisë	Plani i Veprimit BER
	Arritja e objektivit specifik për transportin që kërkon që 10% e konsumit të të gjithë karburantit në transport të vijë nga biokarburet	Plani i Veprimit BER; INDC
Energjia/LUCF-ja	Rritja e efektivitetit ekonomik dhe eficiencës së energjisë nga përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve shtetërore, me qëllim uljen e shfrytëzimit të pyjeve dhe përmirësimin e përdorimit të teknologjisë drusore (përdorimi i mbetjeve nga të korrat dhe përmirësimi teknologjive të djegies së biomases)	SMNS; KTK
Energjia	Diversifikimi i burimeve të rinovueshme në vend, jo vetëm nga burimet hidrike, por edhe nga era, dielli, biomasa dhe burimet gjeotermale	SKZHI-II
Nxitja e mënyrave të transportit të qëndrueshëm(SP1; SP6)		
Transporti	Bashkëndimi i masave politike kombëtare që nxisin transportin shumëformësh dhe atë të kombinuar	SSTPV
	Integrimi dhe nxitja e proceseve të planifikimit të lëvizjes në planet lokale dhe programet e bashkive si dhe në planifikimin e përdorimit të tokës	TECTQ; PKT
	Dyfishimi i transportit hekurudhor të mallrave mbi nivelet e vitit 2013 deri në vitin 2020	SKZHI-II
Nxitja e një sistemi të makinave miqësor me mjedisin (SP1; SP6)		
Transporti	Miratimi dhe zbatimi i plotë i standardeve evropiane të cilësisë së ajrit urban dhe shkarkimeve në ajër	SMNS; TECTQ

	Ulja e shkarkimeve të ndotësve të ajrit dhe konsumi i energjisë së automjeteve	TECTQ; SSTPV; PKVEE
	Përmbushja e përafrimit të legjislacionit shqiptar të transportit me <i>acquis</i> e BE-së	SSTPV
Nxitja e prodhimit të ushqimit të qëndrueshëm me shkarkime të ulëta (SP1; SP6)		
Bujqësia	Zhvillimi i një sektori agro-ushqimor konkurrues dhe novator, si dhe nxitja e prodhimit të ushqimit të qëndrueshëm dhe cilësisë	SKZHI-II; SMNS; KTK
	Nxitja e futjes së metodave të prodhimit bujqësor miqësore me mjedisin (bujqësi organike) dhe ajo e rritjes së numrit të fermave organike të certifikuara deri në vitin 2020	SKZHI-II
Bujqësia/Uji	Përmirësimi i menaxhimit të ujit për bujqësinë për mbrojtjen e tokës dhe rritjen e produktivitetit të të mbjellave	SKZHI-II
Mbajtja në kontroll dhe rritja e përmbajtjes së karbonit të tokave bujqësore(SP1; SP6)		
	Ulja e ndërhyrjeve në tokë dhe parandalimi i erozioneve të mëtejshme të tokës së punueshme dhe kullotave në masën 25% të sipërfaqes deri në vitin 2020	KTK; SMNS
Bujqësia/LUCF-ja	Optimizimi i administrimit të mbetjeve me qëllim rritjen e karbonit të tokës dhe zëvendësimin e plehrave kimike	KTK
	Përmirësimi i eficiencës së plehrave kimike dhe rritja e ndryshimeve organike me qëllim rritjen e ruajtjes së karbonit të tokës dhe produktivitetit të tokës	KTK
	Stimulimi i intensitetit dhe kohëmatjes së kullotave të qëndrueshme me qëllim ruajtjen e rritjes, shpërndarjen e karbonit dhe florën e kullotave, duke ndikuar në këtë mënyrë në sasinë e depozitimit të C në toka.	KTK
Rritja e potencialit të depozitës së karbonit dhe mbrojtja e stoqeve të karbonit në ekosistemet tokësore (SP1; SP6)		
	Mbrojtja e biodiversitetit dhe rritja e statusit të konservimit të specieve dhe habitateve të kërcënuara	SMNS; SKZHI-II; DPSMB
	Parandalimi i degradimit të mëtejshëm të tokës dhe rehabilitimi në masën 25% i zonave të degraduara deri në vitin 2020	SMNS; SKZHI-II
	Përfundimi i kuadrit ligjor kombëtar për natyrën dhe biodiversitetin	DPSMB
LUCF-ja	Nxitja e zgjerimit dhe përmirësimit të burimeve pyjore përmes pyllëzimit të tokës me qëllim parandalimin e erozionit, mbrojtjen e burimeve ujore, rritjen e biodiversitetit dhe duke ndihmuar në përshtatjen ndaj sfidave të ndryshimeve klimatike	SNBZHR; SMNS; KTK; DPSMB
	Parandalimi i zjarreve në pyje dhe zbatimi i masave të nevojshme për zhdukjen e shpejtë të tyre	SMNS; KTK
	Përmirësimi i kushteve të pyjeve, rritja e produktivitetit të pyjeve, mbështetja ndaj zhvillimit shumëfunksional të burimeve pyjore dhe të kullotave, si dhe rritja e aftësisë ripërtëritëse në 3.000 ha deri në vitin 2017 dhe në 30.000 ha deri në vitin 2020	SMNS; PKT
	Rritja e zonës pyjore nëpërmjet pyllëzimit dhe ripyllëzimit me ara pyjore dhe sipërfaqe pyjesh, në një zonë prej 6.000 ha deri në vitin 2017, dhe në masën 15% të sipërfaqes me bimësi pyjore dhe tokë ugare deri në vitin 2020	SMNS; SNBZHR

4.3 Integrimi i përshtatjes në qasjet sektoriale

Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, në planet dhe politikat sektoriale përkatëse, është parimi kryesor për procesin e NAP-it në Shqipëri. Aktivitete integruese janë kryer tashmë për disa sektorë dhe për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim. Procesi i anëtarësimit në BE mund të kuptohet si një nxitës i fuqishëm për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke mbajtur në konsideratë qasjen integruese të Strategjisë së BE-së për Përshtatjen, si dhe integrimin e detyrueshëm në kuadër të procesit të IPA-s. Integrimi duhet të organizohet si një proces afatgjatë, i cili do të trajtojë edhe përgatitjen e politikave dhe planeve të ardhshme.

Rast praktik: Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në planin e integruar ndërsektorial për bregdetin

Ministria përgjegjëse për Zhvillimin Urban lançoi një draftplan të integruar ndërsektorial për bregdetin, në vitin 2015. Gjatë hartimit të planit është kryer një vlerësim strategjik mjedisor, në të cilin janë pasqyruar edhe politikat për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatja ndaj tij. Doli se qe me rëndësi të merreshin në konsideratë efektet e mundshme të ndryshimeve klimatike në qytetet bregdetare, në infrastrukturë dhe në peizazhin natyror. Rekomandohet që bashkitë të mendojnë marrjen e masave të përshtatjes, të tilla si:

- Pyllëzimi / mbjellja e pemëve në zonat më vulnerabël;
- Ndërtimi i digave për parandalimin e përmytjeve;
- Kufizimi i shtrirjes urbane etj.;

Masat e përshtatjes përshkruhen në shtojcën e planit.

4.3.1 Qasja për integrim

Si një sfidë e përgjithshme për zhvillimin, përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike lipset të integrohet në proceset e qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore, përfshirë formulimin e politikave, planifikimin, shpërndarjen e burimeve, zbatimin dhe monitorimin. Integrimi i përshtatjes ka rëndësi, si për politikat e gjithanshme për zhvillimin (p.sh. SKZHI), ashtu edhe për politikat sektoriale.

Integrimi në kuadër të politikës së BE-së

Shqipëria është vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe, si i tillë, ka filluar ta harmonizojë legjislacionin dhe kuadrin e politikave me kërkesat e BE-së, në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Sikurse shpjegohet në kapitullin 4, Strategjia e BE-së për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike do të bëhet e rëndësishme edhe për Shqipërinë. Kjo strategji përcakton në objektivin nr. 3 të saj, se përshtatja duhet integruar në sektorët më kryesorë e më vulnerabël, nëpërmjet politikave të bujqësisë, peshkimit dhe kohezionit. Po kështu, edhe Instrumenti për Asistencën Para-aderimit (IPA II) 2014–2020 ndjek një qasje ndërsektoriale për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në shumicën e sektorëve, sidomos transportin, energjetikën, bujqësinë, zhvillimin rural dhe menaxhimin e fatkeqësive. Një instrument i fuqishëm për integrimin është qasja për të ndjekur shpenzimet e lidhura me klimën në të gjithë gamën e ndërhyrjeve të IPA II në Shqipëri, në përputhje me treguesit statistikorë të OECD-DAC-it për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj tyre.

4.3.2 Integrimi për SKZHI 2014–2020

Përdorimi i thjerrës klimatike është një koncept që përshkruhet në Udhëzimin e OECD-ës “Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në bashkëpunimin për zhvillim”⁵¹. Thjerra klimatike analizon korrelacionet e mundshme midis politikave sektoriale dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, me fokusin te dhënia e një informacioni dhe orientimi të përgjithshëm, çka dallon nga vlerësimet e thella klimatike.

Thjerra klimatike është përdorur në qershor 2015 për Projektstrategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2014-2015, duke qenë se ekzistonte në atë kohë. Ky proces ndoqi një qasje me 3 hapa si më poshtë:

Hapi 1: Përcaktimi i fushëveprimit: SKZHI-ja mbulon një numër të madh sektorësh të ndryshëm, me objektiva dhe masa të ndryshme. Sigurisht, jo të gjithë këta sektorë kanë lidhje për

⁵¹Gjendet në adresën: <http://www.oecd.org/dac/43652123.pdf>

integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Prandaj, hapi i përcaktimit të fushëveprimit siguroi që përpjekjet (e kufizuara) e integrimit të fokusoheshin tek ato pjesë të SKZHI-së që kishin më shumë lidhje me këtë proces.

Hapi 2: Vlerësimi sipas objektivave. Objektivat e identifikuar në hapin 1, si objektiva që lidheshin me integrimin e mëtejshëm, u vlerësuan më me hollësi, sipas një skeme me matricë.

Hapi 3: Përfundime dhe rekomandime. Rezultatet e vlerësimit me matricë u përmblodhën në konstatime dhe rekomandime kryesore, për të cilat duhej vepruar më tej.

Vlerësimi sipas objektivave, në hapin 2, nxori përfundime sipas kategorive të mëposhtme (të paraqitura me kode me ngjyra):

Rekomandohen korrigeime të objektivave	
Nevojitet integrim i mëtejshëm në strategjitë sektoriale	
Përcaktohen kushte për procesin e mëtejshëm të zbatimit	
Rekomandohet pasqyrim në diskutimin e mëtejshëm të politikave	

Përfundimet dhe rekomandimet konkrete që dolën nga përdorimi i thjerrës klimatike mund të përmbliidhen në pikat më kryesore, si vijon:

Korrigjimi i objektivave (kodi me ngjyrë të kuqe)

Korrigjimi i objektivave është rekomanduar vetëm në raste të jashtëzakonshme. Disa shembuj të korrigeimeve të rekomanduara:

Treguesit e zhvillimit për turizmin: Ndryshimet klimatike mund të kërkojnë korrigeime në strukturat e turizmit. Rekomandohet që kjo të përmendet, të paktën, me fjalë (në mos me shifra të detajuara).

Sigurimi i statusit në ruajtje për 5% të specieve dhe habitateve të rrezikuara përmes një objektivi është i mirëformular, por kjo mund të ndikohet nga ndryshimet klimatike. Ndaj, mund të jetë nevoja për vendosjen e njëfarë diferencimi.

Integrimi i mëtejshëm në strategjitë dhe planet sektoriale (kodi me ngjyrë portokalli)

Në shumë raste, SKZHI përmend strategjitë dhe planet sektoriale, që po hartohen ose ekzistojnë. Rekomandohet integrimi i ndryshimeve klimatike në këto strategji dhe plane. Disa shembuj për të cilët është identifikuar gjatë përdorimit të thjerrës klimatike nevoja për integrim të ndryshimeve klimatike janë:

- Strategjia Kombëtare e Energjisë;
- Strategjia Kombëtare për Burimet Ujore;
- Plani i Menaxhimit të Burimeve Ujore;
- Plani Kombëtar për Zhvillimin e Turizmit;
- Plani për Rregullimin e Territorit;
- Plani për Zhvillimin e Bregdetit;
- Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

Kushtet për proceset e zhvillimit në të ardhmen (kodi me ngjyrë të verdhë)

Në disa raste, objektivat sektoriale janë të mirëformular, edhe në lidhje me efektet e mundshme të ndryshimeve klimatike në të ardhmen. Sfida e ardhshme, sa i takon përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, do të jetë sigurimi i arritjes së objektivave në një klimë që ndryshon. Kjo vlen për:

- përmirësimin e mirëmbajtjes së rrugëve,
- masat e lidhura me administrimin e pellgjeve lumore, si ruajtja e pyjeve dhe kullotave,
- fuqizimin e shërbimeve shëndetësore.

Pasqyrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në diskutimin e politikave për të ardhmen (kodi me ngjyrë të kaltër)

Në një sërë rastesh, objektivat sektorialë siç janë formuluar nga SKZHI, ofrojnë potencial të madh për masat e lidhura me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Ky potencial për integrim kërkon diskutim të mëtejshëm me sektorët përkatës, duke qenë se nuk ka një qasje të qartë për integrimin ende, si në rastet e shënuara me ngjyrë portokalli. Shembujt përfshijnë:

- Përdorimin e reformave të parashikuara statistikore dhe të inventarit ujqor / Kadastrës Kombëtare për Burimet Ujqore për të zhvilluar një sistem të monitorimit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo mund të realizohej madje, si pjesë e reformave statistikore.

- Përfshirjen e mbrojtjes ndaj ndryshimeve klimatike në aktet nënligjore për vlerësimet mjedisore strategjike dhe vlerësimet e ndikimit mjedisor, të cilat sigurojnë një pasqyrim të përgjithshëm të ndryshimeve klimatike në përgatitjen e të gjitha projekteve dhe planeve.

- Përfshirjen e integritit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në procesin e përgatitjes së buxhetit dhe në fondet rajonale dhe vendore.

- Sigurimin e pasqyrimit adekuat të konflikteve të mundshme ujqore, nën nxitjen e ndryshimit klimatik në politikën e jashtme.

- Pasqyrimin e temave të lidhura me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në programin kërkimor kombëtar.

- Diskutimin e alternativave për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në planifikimin e zhvillimit rrugor⁵².

4.3.3

Sektori i ujqit

Janë në zhvillim një sërë nismash të cilat ndihmojnë në rritjen e kapaciteteve të përshtatjes. Këtu përfshihen:

- Plani i Menaxhimit të Rrezikut të Përmbytjes Qarku Shkodër⁵³, 2012–2018, i cili është hartuar për të përmirësuar menaxhimin e rrezikut të përmbytjes, veçanërisht duke u fokusuar në masat jostrukturore, si sistemet e paralajmërimit të hershëm, gatishmërinë dhe planifikimin hapësinor. Përfshirja e masave të gatishmërisë për përmbytjet dhe një kuadër rajonal për menaxhimin e rrezikut të përmbytjeve, do ta zhvillojë kapacitetin përshtatës për menaxherët e rrezikut ndaj përmbytjeve, dhe mund të përdoren edhe nga menaxherët e qarqeve të tjera.

- Aprovimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujqore, do ta përmirësojë kapacitetin e atyre që administrojnë burimet ujqore, për të trajtuar faktorët e stresit klimatik në administrimin e burimeve ujqore. Kjo do të ndihmojë edhe në zhvillimin e kapaciteteve për përshtatjen te këta persona, të sigurisë ushqimore dhe energjetike dhe mbrojtjen nga përmbytjet.

Në përgjithësi, sektori ujqor duhet të fokusohet më shumë tek Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore (PMBL), që përfshijnë në tërësi pellgjet lumore (për momentin ka nisur puna me PMBL të Drin–Bunës dhe Semanit) dhe të integrohet më tej te çështjet e klimës në të gjitha planet dhe projektet e lidhura me ujqin. Strategjia e re Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujqore do të japë orientimet adekuate në këtë drejtim.

Bujqësia

Një faktor kyç në përmirësimin e kapaciteteve për përshtatje të Shqipërisë në bujqësi, është procesi i aderimit në BE. Tashmë Shqipëria i ka zhvilluar ligjet për rregullimin e tokës bujqësore, mbrojtjen e tokës dhe mjedisin, në përputhje me standardet dhe kërkesat evropiane. Krahas këtyre reformave, BE-ja nxit veprimin drejt gatishmërisë dhe përshtatjes për ndryshimet e klimës. Për t'iu përshtatur efekteve dhe mundësive që rrjedhin nga ndryshime klimatike, ekziston nevoja

⁵²Detaje mbi gjetjet e nxjerra nga përdorimi I thjerrës klimatike mund të gjenden në raportin e thjerrës klimatike të datës 19 qershor 2015.

⁵³Planet e menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet janë përgatitur me mbështetjen e Ministrisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik së Republikës Federale të Gjermanisë (BMZ) nëpërmjet projektit “Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në rajonin e Ballkanit Perëndimor.” Dokumentet mund t'i gjeni në <http://www.qarkushkoder.gov.al/sq>

për t'u fokusuar te rritja e mundësive të bujqve për aksesin në teknologji dhe informacion, si dhe për të përmirësuar shpërndarjen e informacioneve hidrometeorologjike te bujqit. Kjo mund të jetë një sfidë e veçantë për bujqit e vegjël në Shqipëri, të cilët kanë akses të limituar në burimet financiare.

Energjetika

Strategjia Kombëtare e Rishikuar për Energjinë (miratimi i së cilës pritet në vitin 2017) parashikon mundësi për të integruar më fort përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në politikën energjetike, e cila ka një vulnerabilitet të lartë ndaj ndryshimeve klimatike, krahas rëndësisë së madhe që politika energjetike ka për zbutjen e pasojave të ndryshimeve klimatike.

Larmia biologjike

Shqipëria ka marrë fonde ndërkombëtare për biodiversitetin, të cilat kanë sjellë përfitime gjithashtu për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Shembujt përfshijnë:

- Projekti i Shërbimeve Mjedisore (2014–2019)⁵⁴, i cili synon ngritjen e skemave të Pagesave për Shërbimet Mjedisore (PSHM), për të ndaluar degradimin e mëtejshëm të tokave dhe pyjeve dhe për të siguruar një përdorim racional të burimeve natyrore në vend.

- Masat e përshtatjes të propozuara dhe rekomanduara në kuadër të projektit “Identifikimi dhe zbatimi i masave të kundërpërgjigjes përshtatëse në grykëderdhjet e Drinit dhe Matit”, të cilat janë marrë në konsideratë dhe janë shtrirë më tej në të gjithë bregdetin shqiptar.

- Projekti “Mbrojtja e larmisë biologjike detare dhe bregdetare të Shqipërisë”⁵⁵, i cili mbështet planet e qeverisë për të dyfishuar numrin e zonave të mbrojtura detare dhe për të përmirësuar menaxhimin e përgjithshëm të tyre.

- Ngritja e kapaciteteve në nivel vendor, për nevojën e rritjes së aftësisë rimëkëmbëse të ekosistemeve dhe mënyrës së jetesës nga rreziku i përmbytjes dhe thatësisë, nëpërmjet aktiviteteve demonstruese pilot të përshtatjes me bazë ekosistemin në sistemin e lagunës së Kune–Vainit, financuar nga SCCF-ja.

Turizmi

Deri tani, planifikimi ekzistues për turizmin nuk e ka të integruar mjaftueshëm përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Për shembull, ndërtimi i infrastrukturës turistike është bërë pa marrë në konsideratë dëmet e mundshme nga dukuritë ekstreme të motit (përmbytjet, stuhitë, erozioni detar dhe thatësira). Qasjet e para për t'i ndryshuar në kah të kundërt këto praktika janë:

- Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në Planin Ndërsektorial të Bregdetit, i cili është përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit. Plani Ndërsektorial i Bregdetit fokusohet fuqimisht te sektori turistik shqiptar dhe tek infrastruktura e këtij sektori.

- Një version paraprak i Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Turizmin, 2014–2020, me potencial për të përmirësuar edhe aftësinë rimëkëmbëse ndaj ndryshimeve klimatike.

Shëndetësia

Janë marrë një sërë hapash në Shqipëri për të siguruar një lidhje të fortë ndërmjet masave të përshtatjes të fokusuar te mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit, si dhe ruajtja e mirëqenies së njerëzve.

- Qeveria shqiptare është përfshirë në një sërë deklaratash ndërkombëtare, të fokusuar në ndryshimin e klimës dhe shëndetit. Ndër to përfshihet rezoluta që ka nxjerrë Asambleja e 61-të Botërore për Shëndetësinë, e cila i nxit shtetet anëtare të marrin masa me vendosmëri për t'u dhënë përgjigje efekteve në shëndetësi që vijnë nga ndryshimet klimatike, duke paralajmëruar kështu rreziqet e mundshme që i kanosen shëndetit të njeriut.

- Ministria përgjegjëse e Shëndetësisë ka hartuar, si sektor i parë, një strategji të veçantë për shëndetësinë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, ku parashikohen qasjet strategjike për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në politikat e shëndetësisë.

Përgjigja në situata të jashtëzakonshme/emergjente

Plani Kombëtar për Emergjencat Civile përfshin dhe sqaron rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve publike dhe private të interesit. Kjo synon kanalizimin e lëvizjes së informacioneve

⁵⁴Financuar nga IBRD-ja, BB-ja, Qeveria e Suedisë dhe GEF dhe zbatuar nga Qeveria e Shqipërisë.

⁵⁵Financuar nga UNDP-ja dhe GEF-i.

përkatëse, fuqizimin e vendimmarrjes dhe, nëpërmjet bashkërendimit, përforsimin e kapaciteteve për t'iu përgjigjur të gjitha fazave të ciklit të katastrofave. Zhvillimi i kapaciteteve të tilla ka rëndësi edhe për fatkeqësitë e shkaktuara nga ndryshimet klimatike. Veprimi prioritar nr. 12 (kapitulli 6.2) përcakton masat/veprimet për rritjen e aftësisë ripërtëritëse ndaj përmblytjeve, si një ndërkatastrofat më e rëndësishme lidhur me ndryshimet klimatike, nëpërmjet sistemeve të lajmërimit të hershëm dhe mekanizmave të tjerë të parandalimit të fatkeqësive në Shqipëri.

4.3.4 Proceset e integritimit në të ardhmen

Nevojitet një fuqizim i mëtejshëm sistematik, i cili kërkon një strategji integrimi gjithëpërfshirëse. Hollësitë për një strategji të tillë jepen në veprimin prioritar nr. 2. Në aktivitetet përkatëse të kësaj strategjie përfshihen:

Integrimi duhet kuptuar si një proces i vazhdueshëm i cili kërkon bashkërendim dhe bashkëpunim të palëve të ndryshme sektoriale të interesit. GNMP-ja për Ndryshimet Klimatike do të vijojë të punojë nën drejtimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke përfshirë nismat integruese si një prej detyrave kryesore. Nevojat dhe rezultatet e integritimit do të pasqyrohen rregullisht gjatë mbledhjeve të GNMP-ës.

Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike mund të mbështetet dhe të vihet në eficiencë, nëpërmjet një pakete instrumentesh të ndryshme, si: thjerra klimatike, mbrojtja klimatike, vlerësimi mjedisor strategjike me ndjeshmëri klimatike dhe treguesit e shpenzimeve klimatike. Kjo paketë instrumentesh do të shtjellohet dhe përcaktohet për situatën shqiptare, nëpërmjet kontributit të një eksperti në vitin 2016.

GNMP-ja do të vendosë të ketë një projekt pilot mbi integrimin në vit, që do të kryhet nga një ministri sektoriale përkatëse dhe do të mbështetet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit si dhe me kontribut të ekspertëve.

Zyra e Kryeministrisë do ta përdorë kuadrin zbatues të SKZHI-së për të bërë pasqyrime të rregullta të asaj që është arritur, si dhe për të kuptuar se deri ku janë ndjekur rekomandimet e bëra sipas thjerrës klimatike.

Edhe procesi i anëtarësimit në BE do të përdoret për integrimin e ndryshimeve klimatike nëpërmjet asistencës financiare në kuadër të IPA-s. Në këtë kontekst, në 2016, zbatimi i dokumentit të NAP-it si dhe zbatimi i Veprimeve Prioritare të këtij dokumenti u përfshinë në rishikimin e Dokumentit Strategjik Kombëtar EU IPA II. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të sigurojë përputhjen e NAP-it me strategjinë e BE-së për klimën.

Asistenca e BE-së do të duhet për të bërë ndjekjen në mënyrë sistematike të shpenzimeve brenda kuadrit të IPA-s në kuadër të aspekteve të klimës. Raportimi për asistencën e BE-së do të përfshijë përfundimet në lidhje me shkallën e integritimit të çështjeve klimatike.

4.3.5 Projektet pilot, konkrete për integrimin

Table16 jep shembuj të kohëve të fundit të planeve dhe strategjive, ku është integruar ose po integrohet përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike. Aktivitetet integruese, sikurse tregohet, është mirë të kuptohen si projekte pilot, të cilët dëshmojnë potencialin dhe strategjitë për integrimin. Strategjia integruese gjithëpërfshirëse, sikurse shpjegohet më lart, lipset të mbështetet në mësimet e nxjerra nga këto projekte pilot.

Duke qenë se aktivitetet integruese pak a shumë kanë përfunduar për hartimin e planeve dhe të strategjive, sfida në të ardhmen do të jetë marrja në konsideratë gjatë procesit të zbatimit. Shembulli i SKZHI-së në rubrikën më lart tregon se si mund të bëhet kjo marrje në konsideratë.

Plan me rëndësi për integrimin	Periudha planifikimit shqyrtimit	e ose	Drejtimi strategjik i integritimit	Instrumenti integrues
SKZHI	Qershor 2015		Ofron kuadrin për pasqyrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në përgatitjen dhe zbatimin e politikave sektoriale në të ardhmen.	Thjerra klimatike

Plani Kombëtar i Territorit / Plani Ndërsektorial i Integruar për Bregdetin	Mars 2016	Ulja e vulnerabilitetit nëpërmjet Planit.	Përfshirja e mbrojtjes klimatike në vlerësimin strategjik mjedisor, shfrytëzimi i ekspertizës nga Komunikimet Kombëtare të Shqipërisë për UNFCCC-ën. Futja në dokument e një kapitulli të shkurtër për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
Plani për Zhvillimin e Bregdetit	Fund i vitit 2016	Lidhja me mekanizmat e zbatimit të NAP-it.	Përfshirja në ekip e ekspertit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, shfrytëzimi i ekspertizës nga projektet e GIZ-it dhe KTK-së.
Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore	Prill 2016	Sigurimi i një sektori uji me aftësi rimëkëmbëse kundrejt ndryshimeve të klimës.	Futja e ndryshimeve klimatike si një element ndërsektorial i strategjisë kombëtare. Kontribute të konsiderueshme nga projekte ekzistuese për të siguruar përputhshmërinë, nëpërmjet bashkërendimit me aktivitete të tjera sektoriale të lidhura me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
Strategjia Kombëtare e Energjisë	Vendim i KM, nr. 480, Dt.Aktit:31.07.2018,	Sigurimi i një sektori energjetik me aftësi rimëkëmbëse kundrejt ndryshimeve të klimës.	Parashikimi i thjerrës klimatike në varësi të ecurisë së mëtejshme të përgatitjes së strategjisë, shfrytëzimi i ekspertizës së Komunikimeve Kombëtare të Shqipërisë për UNFCCC-në.

Tabela 16: Disa procese planifikimi të përzgjedhura me disa pika hyrëse për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike

4.4 Objektivat kryesorë të politikave për adresimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike

Një drejtim i efektshëm i procesit të përshtatjes kërkon objektiva dhe tregues të orientuar nga rezultatet. Ata e kufizojnë kompleksitetin, përmes reduktimit mbi treguesit kryesorë që karakterizojnë progresin e përshtatjes dhe përmes mbështetjes tek objektivat dhe treguesit ekzistues, për shembull ata që janë përcaktuar në SKZHI.

Parimet për një proces përshtatjeje të orientuar nga rezultatet

Procesi i NAP-it do të orientohet drejt zvogëlimit të vulnerabilitetit së Shqipërisë, nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit të rreziqeve klimatike në sektorët përkatës. Ky proces do të ndjekë një qasje afatgjatë, duke qenë se ndryshimet klimatike, si edhe kundërpërgjigjet përkatëse të politikave për uljen e rreziqeve, evoluojnë gjatë shumë viteve / dekadave.

Objektivat dhe treguesit gjithëpërfshirës

Në përputhje me parimet e mësipërme, janë formuluar objektivat dhe treguesit për ato fusha të cilat janë me rëndësi strategjike gjithëpërfshirëse në procesin e përshtatjes në Shqipëri. Objektivat dhe treguesit në nivel operativ dhe për masa të veçanta sektoriale nuk mbulohen në NAP, por në strategjitë sektoriale përkatëse ose në SKZHI, e cila ka funksionin e saj drejtues për të gjithë procesin e zhvillimit dhe integrimin në Shqipëri.

Objektivat dhe treguesit e përmendur më poshtë, kanë nevojë për më shumë specifikim në lidhje me:

- Aktorët përgjegjës për monitorimin
- Burimet e informacionit
- Afatet dhe përcaktimin e piketave.

Këto hollësi do të zhvillohen në kuadër të Sistemit të Monitorimit të Zbatimit të NAP-it (veprimi prioritar nr. 4).

15 Objektivat dhe treguesit për procesin e NAP-it të Shqipërisë dhe lidhja e tyre me prioritetet e strategjisë

Fusha	Objektivi	Treguesi	Lidhja me prioritetet e (SP)
Rezultatet e përshtatjes	<p>Objektivi 1: Pakësim i dëmeve të përmbytyjeve.</p> <p>Objektivi 2: Rritje e aftësisë rimëkëmbëse të bujqësisë kundrejt thatësirave.</p> <p>Objektivi 3: Sigurimi i cilësisë së ujit të pijshëm për rajonet e Shkodrës, Fierit dhe Vlorës, pavarësisht nga ndikimet e ndryshimeve klimatike.</p>	<p>Treguesi 1.1: Dëmet mesatare në rast përmbytyjeje (të përlogaritura në miliona lekë) zvogëlohen me 5% për çdo periudhë pesëvjeçare të mëpashme.</p> <p>Treguesi 2.1: Pothuaj të gjitha produktet e fermave, të shprehura në rendiment për hektar, qëndrojnë të njëjta edhe në vitet me thatësi.</p> <p>Treguesi 3.1: Standardet e cilësisë së ujit të pijshëm përbushen në të gjitha bashkitë në çdo rajon.</p>	SP.6
Drejtimi i zbatimit të NAP-it	<p>Objektivi 4: Masat e parashikuara në dokumentin e NAP-it janë zbatuar në mënyrë efektive.</p> <p>Objektivi 5: Organizimi i një sistemi mbi “mësimet e nxjerra” për procesin e NAP-it.</p>	<p>Treguesi 4.1: Ngritja e një sistemi monitorim-vlerësimi, i cili ndjek statusin e zbatimit të veprimeve prioritare dhe mundëson bërjen e korrigjimeve në procesin e NAP-it.</p> <p>Treguesi 5.1: Raportet e vlerësimit për procesin e NAP-it dalin çdo 4 vjet dhe japin rekomandime për korrigjimet e mundshme të procesit.</p>	SP.3; SP.6
Integrimi	<p>Objektivi 6: Pasqyrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në procesin e formulimit dhe zbatimit të SKZHI-së.</p> <p>Objektivi 7: Nxitja e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në asistencën për aderim në përputhje me objektivat e politikës së BE-së për përshtatjen.</p> <p>Objektivi 8: Planifikimi territorial dhe rregulloret për planin bregdetar për të adresuar masat për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike që duhen marrë nga bashkitë në nivel vendor.</p> <p>Objektivi 9: Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural të orientojë aftësinë rimëkëmbëse të prodhimit bujqësor ndaj ndryshimeve klimatike.</p> <p>Objektivi 10: Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore si dhe Planet e Menaxhimit të baseneve lumore të përfshijnë masat e përshtatjes në fushën e disponibilitetit të ujit.</p> <p>Objektivi 11: Strategjia Kombëtare për Energjinë të orientojë masat e përshtatjes në fushën e prodhimit të energjisë.</p>	<p>Treguesi 6.1: Krijohet një mekanizëm për reflektimin e rregullt të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, si pjesë e procesit të zbatimit të SKZHI-së.</p> <p>Treguesi 6.2: Në një strategji sektoriale përkatëse përfshihet të paktën një qasje integruare në vit.</p> <p>Treguesi 7.1: Asistenca financiare e BE-së brenda kuadrit të IPA-s ndiqet në përputhje me treguesit statistikorë të OECD-CAD-së për ndryshimet klimatike.</p> <p>Treguesi 8.1: Bashkitë më vulnerabel ndaj ndryshimeve klimatike i kanë transferuar kornizat kombëtare të përshtatjes në strategjitë vendore për zhvillim dhe në planet e qeverisjes vendore.</p> <p>Treguesi 9.1: Masat e përshtatjes që përcaktohen në Strategjinë Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural janë duke u zbatuar.</p> <p>Treguesi 10.1: Masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të pasqyrohen në mënyrë adekuate në planin dhe procesin e zbatimit për dy plane menaxhimi pilote të baseneve lumore..</p> <p>Treguesi 11.1: Masat e përshtatjes që përcaktohen në Strategjinë Kombëtare për Energjinë janë duke u zbatuar.</p>	SP.4; SP.6
Financimi mbi klimën	<p>Objektivi 12: Aksesimi me sukses i buxhetit publik të Shqipërisë për financimin e zbatimit të NAP-it.</p> <p>Objektivi 13: Kërkesat e miratuara për projekte të cilat sigurojnë mbështetje e GCF-ës për procesin e përshtatjes në Shqipëri.</p>	<p>Treguesi 12.1: Evidencat publike tregojnë se të paktën 5 milionë USD janë shpenzuar brenda muajit janar 2018, si fillim, nga buxheti publik i Shqipërisë për zbatimin e NAP-it.</p> <p>Treguesi 13.1: GCF-ja i ka dhënë Shqipërisë mbështetje financiare për aktivitetet e gatishmërisë brenda muajit dhjetor 2016.</p> <p>Treguesi 13.2: Një propozim me rëndësi për zbatimin e NAP-it të Shqipërisë është aprovuar nga mbledhja e Këshillit të GCF-së në muajin mars 2018.</p>	SP.3; SP.5
Komunikimi	Objektivi 14: Publiku të informohet për	Treguesi 14.1: Informacioni për përshtatjen	SP.4; SP. 5

dhe përfshirja e publikut	ecurinë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.	përfshihet në sistemin e ri të realizimit të shërbimeve publike dhe qeverisjes elektronike (të parashikuar nga SKZHI). Treguesi 14.2: Realizimi i një fushate në vit për çështjet e lidhura me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.	
Ngritja e institucioneve dhe zhvillimi i kapaciteteve.	Objektivi 15: Aktorët dhe palët e interesit të përfshira në procesin e NAP-it të kenë njohuri dhe aftësi mbi çështjet e përshtatjes. Objektivi 16: Strukturat, rregulloret dhe politikat institucionale në sektorë të përzgjedhur janë në mbështetje të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.	Treguesi 15.1: Njësia e ndryshimeve klimatike pranë MM-ës si dhe pjesëtarë të grupit ndërministror të punës marrin pjesë rregullisht të paktën një takim të NAP-it në vit. Treguesi 16.1: 2-5 politika dhe rregullore me rëndësi për procesin e NAP-it të përfshijnë dispozita të lidhura me përshtatjen deri në vitin 2020.	SP.3

NAP-i shqiptar është projektuar si një proces afatgjatë. Afati i përgjithshëm për arritjen e objektivave për përshtatjen është 20 vjet (deri në vitin 2035). Kjo vlen kryesisht për 3 objektivat e parë për rezultatet e procesit të përshtatjes. Shumë objektiva të tjerë janë më në vijë dhe mund të arrihen brenda afateve shumë më të shkurtra. Treguesit specifikë do të përcaktojnë edhe këto afate.

Objektivat e Zhvillimit të qëndrueshëm

Objektivat 13.1, 13.2, 13.3 dhe 11.b të Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm

Qëllimi 13: Të ndërmerren masa urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e saj [1]

Synimi 13.1: Forcimi i qëndrueshmërisë dhe aftësisë përshtatëse ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe fatkeqësitë natyrore në të gjitha vendet.

Shqipëria nuk ka një strategji kombëtare për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë. Është planifikuar të zhvillohet një strategji e tillë në 2019 e cila është inkuorporuar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për periudhën 2015–2020 (SKZHI-II).

Dokumenti kryesor politik i Shqipërisë për reagimin emergjent është Plani Kombëtar i Emergjencave Civile të vitit 2004. Ai specifikon veprimet për të rritur elasticitetin ndaj përmbajtjeve si katastrofa më e rëndësishme në lidhje me ndryshimet klimatike në Shqipëri, nëpërmjet sistemeve më të mira të paralajmërimit të hershëm dhe mekanizmave për parandalimin e katastrofave. Ajo gjithashtu adreson zjarret në pyje, reshjet e larta të borës dhe rrëshqitjet e tokës.

Plani kombëtar i veprimit të draft strategjisë kombëtare për ndryshimet klimatike (Veprimi Prioritar nr. 15) ka për qëllim rritjen e qëndrueshmërisë së sistemit të lagunës Kune–Vain.

Qëndrueshmëria e ekosistemeve dhe komuniteteve lokale do të përmirësohet pas aplikimit të disa teknikave, nga e butë në të vështirë. Veprimi Prioritar ka tri qëllime, nga të cilat dy synojnë drejtpërsëdrejti qëndrueshmërinë, përkatësisht:

- Objektivi 2: Rritja e aftësisë rikuperuese e lagunës Kune–Vainit, nëpërmjet Adaptimit me bazë Ekosistemin, duke përdorur demonstrimin e praktikave më të mira dhe konkrete të EbA-s, dhe ndërhyrje të tjera për përshtatjen.

- Indikator 2.1: Zbatimi I një sërë ndërhyrjesh përfshirë EBA-n në sistemin lagunor të Kune–Vainit.

- Indikator 2.2: Krijimi i një strategjie për monitorimin e ndërhyrjeve të EbA-s.

- Objektivi 3: Rritja e ndërgjegjësimit të aktorëve lokalë dhe kombëtarë ndaj rreziqeve të ndryshimeve klimatike dhe rikuperimit, nëpërmjet sistemit EbA, për rritjen e rezistencës së komuniteteve lokale ndaj ndryshimeve klimatike.

- Indikator 3.1: Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese mbi avantazhet e adaptimit me bazë ekosistemin.

Synimi 13.2: Integrimi i masave të ndryshimeve klimatike në politikat, strategjitë dhe planifikimin kombëtar

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2016 për periudhën 2015–2020 dhe Plani i Përgjithshëm Kombëtar Territorial 2016 “Shqipëria 2030” janë strategjitë kryesore ndërsektoriale që trajtojnë, ndër të tjera, çështjet që lidhen me zbutjen e ndryshimeve klimatike. Plani i Përgjithshëm Kombëtar Territorial “Shqipëria 2030” përfshin shumë masa që ndikojnë pozitivisht në zbutjen e ndryshimeve klimatike në sektorë të ndryshëm, si energjia, transporti, bujqësia dhe LULUCF.

Përshtatja ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike në sektorin e shëndetësisë është shënjestruar në Strategjinë e vitit 2011 për përshtatjen e sistemit shëndetësor ndaj ndryshimeve klimatike. Strategjia mbulon çështjet e zbutjes dhe adaptimit.

Përveç dy NAMA, dokumentet e politikave në sektorin e energjisë të lidhura me çështjet e ndryshimeve klimatike përfshijnë:

- Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë 2011 për periudhën 2011–2018;
- Plani Kombëtar i Veprimit për Energjitë e Rinovueshme 2016 për periudhën 2015–2020.

Kuadri kryesor politik i lidhur me ndryshimet klimatike për sektorin bujqësor është Strategjia Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (ISARD) dhe Programi i saj për Zhvillimin Rural 2014–2020 në kuadër të Instrumentit të Ndihmës së Paraanëtarësimit në Zhvillimin Rural (IPARD).

Që nga viti 2011, integrimi i ndryshimeve klimatike në dokumentet strategjike sektoriale ka përparuar në të gjithë sektorët, megjithëse shkalla e integritimit ndryshon. Ka potencial të madh për të përmirësuar integrimin në politikat, strategjitë dhe planifikimin kombëtar. Instrumenti i VSM mund të përdoret, ndër mjetet e tjera, për të kontribuar në një integrim të tillë. Miratimi i Dokumentit të Strategjisë Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike do të ishte një shtyllë e rëndësishme për të integruar masat e ndryshimeve klimatike në kuadrin e politikave kombëtare.

Synimi 13.3: Përmirësimi i edukimit, rritjes së ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve njerëzore dhe institucionale për zbutjen e ndryshimeve klimatike, përshtatja, ulja e ndikimit dhe paralajmërimi i hershëm

Nuk ka masa qeveritare sistematike të implementuara ose të zbatuara për të përmirësuar arsimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për zbutjen e ndryshimeve klimatike, përshtatjen, uljen e ndikimit dhe paralajmërimin e hershëm. Sipas draftit të planit kombëtar të veprimit të draft strategjisë kombëtare të ndryshimeve klimatike, ndërgjegjësimi i kufizuar i ndryshimeve klimatike në nivelin e hartimit të politikave dhe njohjes publike pengon një proces të fuqishëm kombëtar të planit të veprimit. Politika e ndryshimeve klimatike ende renditet relativisht e ulët në axhendën politike. Sidoqoftë, disa iniciativa dhe veprime për të përmirësuar ndërgjegjësimin janë marrë nga palët e ndryshme të interesit.

Qëllimi 11: Krijimi i qyteteve dhe vendbanimeve njerëzore përfshirëse, të sigurta dhe të qëndrueshme

Synimi 11.b: Deri në vitin 2020, të rritet ndjeshëm numri i qyteteve dhe vendbanimeve që miratojnë dhe zbatojnë politika dhe plane të integruara drejt përfshirjes, eficiencës së resurseve, zbutjes dhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike, qëndrueshmërisë ndaj fatkeqësive dhe të zhvillojnë dhe zbatojnë, në përputhje me Kuadrin Sendai për Reduktimin e Rrezikut të Katastrofave 2015–2030, menaxhimi i rrezikut holistik të fatkeqësive në të gjitha nivelet.

5. PLANI KOMBËTAR PËR ZBUTJEN E NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Plani Kombëtar për Zbutjen e Ndryshimeve Klimatike (PKZNK) rendit masat dhe veprimet e detajuara, të përfshira në dokumentet e analizuara siç paraqiten në tabelën 12, i cili i përgjigjet Objektivave të Politikave të Identifikuara në tabelën 14. Masat e zgjedhura janë analizuar duke dhënë informacionin e mëposhtëm:

- **ID:** Secilës prej masave i caktohet një Id, duke vendosur një shkronjë e cila identifikon sektorin (E= Energjia; T= Transporti; A = Bujqësia; L= LUCF; C=Ndërsektoriale) dhe një numër serial i cili identifikon masën.

- **Masa:** Titulli i masës.

- **Përshkrimi:** Përshkrimi i masës sikurse raportohet në dokumentin e origjinës.
- **Viti/periudha e zbatimit:** Viti ose periudha në të cilën duhet zbatuar masa.
- **Dokumenti burimor:** Referenca e dokumentit nga ku vijnë masat.
- **Objektivi i Reduktimit:** Objektivi i reduktimit të masave sikurse janë raportuar në dokumentin burimor.

- **Lloji i efektit:** Të kategorizuara sidirekte, indirekte ose masa mundësuese, për sa i përket zbutjes së ndryshimeve klimatike (reduktim i shkarkimeve ose rritje e përthithësve).

- **Kosto e vlerësuar:** Vlerësimi i kostos sikurse raportohet në dokumentin burimor ose vlerësimi në mënyrë specifike.

- **Objektivat e politikave:** Lidhja e Objektivave të Politikave sikurse identifikohen në tabelën 14.

- **Prioriteti:** Prioriteti i caktuar në lidhje me eficiencën e masës për të përmbushur Objektivat e Politikave.

- **Ndërlidhja me sektorë të tjerë:** Paraqitja e sektorëve të tjerë të cilët lidhen me masën.

Prioritetet caktohen duke u bazuar në shkallën e eficiencës së vlerësuar të masës, për të përmbushur Objektivat e Politikave, të cilat janë në funksion të objektivit kryesor të dokumentit të SKNK&P-ës: garantimi i zhvillimit me nivel të ulët të karbonit në Shqipëri në një mënyrë kosto-eficiente.

Për më tepër, lloji i efektit që i përket zbutjes së ndryshimeve klimatike (reduktim i shkarkimeve ose rritje e përthithësve), paraqitet nga masat e identifikuara në plan, të cilat janë grupuar si më poshtë:

1) Masa direkte: ku përfshihen ato masa që kanë një impakt të drejtpërdrejtë tek zbutja e ndryshimeve klimatike, për sa i përket reduktimit të shkarkimeve ose rritjes të përthithësve të karbonit (p.sh. veprime konkrete, masa specifike për një zonë të caktuar etj.);

2) Masa indirekte: ku përfshihen ato masa që kanë një impakt pozitiv, për sa i përket zbutjes së ndryshimeve klimatike dhe që do të çojnë nga reduktimi afatshkurtër deri tek afatmesëm dhe afatgjatë; te një reduktim indirekt i shkarkimit ose rritje të përthithësve të karbonit (p.sh. trajnime dhe rritje të ndërgjegjësimit, certifikim dhe skemë etiketimi, financimi etj.);

3) Masa mundësuese: ku përfshihen ato masa që janë funksionale për arritjen e kushteve të nevojshme, që lejojnë aplikimin e masave direkte/indirekte të cilat çojnë në zbutjen e ndryshimeve klimatike (p.sh. forcimi i planifikimit territorial, përforcimi i marrëveshjeve institucionale, monitorimi etj.).

Në përgjithësi, janë identifikuar 222 masa, nga të cilat 95 janë klasifikuar me prioritet të lartë, 95 të mesëm dhe 32 të ulët.

Masat janë kryesisht të fokusuar në një periudhë afatmesme (deri në vitin 2020), pjesa më e madhe e tyre lidhen me hyrjen në fuqi të projektligjeve (p.sh. ligji BER dhe ligji mbi Ndryshimet Klimatike), dhe vetëm disa fokusohen në periudhën afatgjatë (2030 dhe 2050). Strategjia e ardhshme e energjisë mund të japë me të vërtetë më shumë elemente për masat afatgjata që mund të përfshihen në rishikimin e ardhshëm të dokumentit të SKNK-ës.

Pjesa më e madhe e masave janë në sektorin e energjisë (77) dhe në sektorin e transportit (71), të ndjekur nga LUCF-ja (53) dhe bujqësia (17), si dhe 4 masa të cilat janë ndërsektoriale.

Janë identifikuar çështje ndërsektoriale, veçanërisht ndërmjet sektorit pyjor dhe atij energjetik, lidhur me sigurimin e burimeve të qëndrueshme të energjisë së rinovueshme; ndërmjet sektorit bujqësor dhe energjetik, lidhur me përmirësimin e pajisjeve për energjinë efikase në praktikat bujqësore.

Çdo sektor është përshkruar në paragrafët e mëposhtëm, për të dhënë një pasqyrë të masës kryesore sektoriale të propozuar, dhe lidhjen e saj me objektivat e Politikave dhe Prioriteteve Strategjike të Zbutjes, duke theksuar edhe zgjidhjet e propozuara për të plotësuar mangësitë e identifikuara. Lista e masave jepet veçmas për secilin sektor në paragrafin 5.6.

Vëmendje e veçantë i është dhënë sistemit të matjes, monitorimit dhe raportimit në Shqipëri. Vlerësimi i plotë, standard dhe transparent për raportimin dhe përgjegjësinë ndaj shkarkimeve

dhe përthithësve GES, është thelbësor për të vlerësuar progresin e arritjes së objektivave, për të vlerësuar performancën e politikave dhe masave në nivel ndërkombëtar, për të vlerësuar suksesin e përpjekjeve të përbashkëta për të reduktuar ndryshimet klimatike (duke marrë në konsideratë parimin e përgjegjësive të përbashkëta, por të diferencuara, dhe aftësive përkatëse).

5.1 Energjia

Në përgjithësi, masat e propozuara në PKZNK-ë për sektorin e Energjisë, lejojnë progresin drejt objektivave kryesorë të politikës, të njohura në dokumentin e SKNK-ës dhe që iu përgjigjen prioriteteve strategjike të identifikuara për zbutjen e ndryshimeve klimatike, të renditura në kreun 3, me shumicën e masave të marra në konsideratë të vëna në fokus në pjesën: “*Nxitni eficiencën e energjisë dhe Nxitni Burimet e Qëndrueshme të Energjisë së Rinovueshme*”.

Një nga shqetësimet kryesore në sektorin e energjisë është përshtatshmëria e buxhetit, veçanërisht për masat në PKVEE; megjithatë, kjo mund të kapërcehet në vitet në vazhdim nga një zbatim i kujdesshëm i ligjit mbi Eficiencën e Energjisë dhe ligjit mbi BER-in.

Sipas ligjit të Eficiencës së Energjisë, në fakt, financimi i mjaftueshëm duhet të jetë një nga parimet mbështetëse të politikës shqiptare mbi eficiencën e energjisë (neni 5, 3b), dhe dispozitat për planifikimin me kujdes të aspekteve financiare në PKVEE-të e ardhshme të jenë bërë në nenin 7, 2 i, j, m, si për burimet publike dhe për ato private dhe planifikimin financiar afatshkurtër dhe afatgjatë. Ligji krijon një institucion financiar, atë të Fondit për Eficiencën e Energjisë, për të lehtësuar sigurimin e fondeve të mjaftueshme, që mbështesin përmirësimet e denja të eficiencës së energjisë, dhe përcakton në detaje qëllimin, funksionimin dhe qeverisjen e tij (kreu V, nenet 19–24). Prandaj është e rëndësishme që këto rregulla të vihen në jetë përmes akteve të duhura nënligjore, sa më shpejt të jetë e mundur. Njëkohësisht, masa të njëjta janë parashikuar nga ligji mbi BER-in për politikën e BER-it, duke ngritur një fond me karakteristika dhe objektiva të njëjtë. Përsëri është e rëndësishme që të hartohen ligje dhe akte nënligjore të përshtatshme për BER-in. Duke qenë se tarifat që i paguhen prodhuesve të energjisë së rinovueshme për çdo njësi energjie të prodhuar dhe të transmetuar në rrjetin elektrik (*feed-in tariffs*), janë një skemë mbështetëse tradicionale për investimet BER, të cilat ndikojnë në të gjithë tregun elektrik, kjo mund të jetë gjithashtu një pjesë e rëndësishme e Strategjisë së Energjisë. Prandaj, për të përgjithësuar rekomandimin e mësipërm, është e rëndësishme të përfshihen rregulla të qarta dhe të realizueshme rreth masave të politikave financuese në të gjitha politikat që lidhen me energjinë, dhe që ato të funksionojnë përmes akteve të duhura nënligjore, sa më shpejt të jetë e mundur.

Bashkërendimi mes të gjitha strategjive dhe planeve të ministrive që punojnë drejtpërdrejtë ose jo me energjinë, është po aq i rëndësishëm. Lidhjet e forta kryesore që duhen konsideruar, janë ato ndërmjet energjisë dhe transportit lidhur me lëndët e djegshme fosile në një perspektivë afatgjatë; lidhur me energjinë elektrike dhe ato me bujqësinë dhe me pyjet për biomasën. Instrumenti që siguron këtë bashkërendim është Strategjia Kombëtare të Energjisë për periudhën 2018–2030, miratuar me VKM nr. 480, datë 31.7.2018, duke garantuar përvijimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike në çdo aspekt të strategjisë, në bashkërendim me strategji dhe plane të tjera në këtë sektor (Strategjia BER dhe PKVEE), si dhe të përkthehet në veprime, nëpërmjet një organi të përshtatshëm në aktet nënligjore.

Pavarësisht se harmonizimi i politikave sektoriale me *Acquis* të BE-së duket të jetë integruar në kuadrin e politikave të energjisë shqiptare, rreziku i politikave të copëzuara mund të jetë mjaft i spikatur dhe duhet trajtuar menjëherë, me qëllim që të rrisë në mënyrë të ndjeshme bashkëpunimin mes të gjithë aktorëve përkatës institucionalë. Veprimi i parë që do të merret në këtë rast, është sinkronizimi i politikave shqiptare të energjisë dhe klimës, me agjendën e politikave të BE-së mbi temat përkatëse. Fusha tjetër ku bashkërendimi në kohë i iniciativave politike është i rëndësishëm, është bashkërendimi i brendshëm, ndërmjet strategjive sektoriale dhe planeve të ndryshme. Përpjekja e bashkërendimit e përshkruar në paragrafin e mësipërm, duhet të sjellë jo vetëm bashkërendimin tematik, por edhe atë të përkohshëm.

Dërgimi i sinjaleve dhe stimujve të duhur te konsumatorët, është shumë i rëndësishëm për zbatimin e politikave me kosto efektive. Kjo ka kryesisht dy pasoja, që të dyja me rezultate të drejtpërdrejta në PKZNK-ë. Nga njëra anë tregjet e energjisë që funksionojnë mirë janë një parakusht i domosdoshëm, që masat e politikave të orientojnë në mënyrën e duhur sjelljen e konsumatorit, që të arrihen kështu objektivat e dekarbonizimit. Konsumatorët duhet të marrin sinjalet e duhura nga tregu nëpërmjet çmimeve. Prandaj humbjet joteknike të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe prerja e paqëndrueshme e druve për ngrohje dhe gatim, duhet të çrrënjosen me domosdo. Së dyti, është e rëndësishme të shmanget besimi i tepruar në skemat subvencionuese që synojnë të realizojnë objektivat e politikave (të tilla si: mbështetja e eficiencës së energjisë dhe përhapja e BER-it), për të shmangur përfituesit “parazitarë”. Një kurs veprimi i ngjashëm mjaft i rekomanduar është: forcimi i anës zbatuese. Aktualisht, vetëm ligji mbi Eficiencën e Energjisë parashikon sanksione administrative për shkeljen e rregullave të tij; megjithatë duhet të vendoset dhe hyjë në fuqi një sistem i qëndrueshëm dhe i besueshëm dënimi për shkelësit. Për shkeljet më të rënda që rezultojnë me mashtrime ose situata të rrezikshme për shëndetin publik dhe mjedisin, duhet të zbatohet Kodi Penal.

Një çështje e rëndësishme për t’u trajtuar është: grumbullimi i të dhënave në sektorin e energjisë për të garantuar sistemin e duhur të informacionit. Kjo nënkupton ngritjen, hedhjen dhe mbajtjen e bazës së të dhënave të detajuara, të aksesueshme nga të gjitha institucionet e përfshira, në të gjitha aspektet informative që lidhen me hartimin e politikave për uljen e shkarkimeve GES në Shqipëri. Do të ishte i këshillueshëm integrimi i të tilla bazave të të dhënave me atë të konsumit të energjisë së parashikuar nga ligji mbi Eficiencën e Energjisë.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, Shqipëria aktualisht qëndron në një pozicion unik në rrugën e saj të zhvillimit, i cili do të lejonte lehtësisht kalimin në standardet më të larta të eficiencës së energjisë, performancës së rrjetit dhe depërtimit të BER-it. Duhet futur stimuj të veçantë me anë të politikave, për të nxitur përhapjen e teknologjive më të përparuara që janë sot. Merrni në konsideratë futjen e skemave të veçanta të stimujve, planeve të investimit dhe certifikimit për banesat pasive dhe me humbje zero të energjisë, matjen “smart” dhe faturimin, rrjetet “smart” dhe sistemet domotike të kursimit të energjisë. Kostot e tyre më të larta të investimit do të jenë të detyruara të ulen, duke qenë se rritet përhapja e tyre dhe kompensohen gjithsesi nga efikasiteti më i lartë dhe aftësia për të tërhequr fonde ndërkombëtare. Ato ndoshta janë marrë parasysh për planifikime të ardhshme strategjike, por do të ishte e këshillueshme të fillohej të merreshin në konsideratë këto alternativa në një fazë më të hershme, nëse do të ishte e mundur, në këtë plan aktual.

Lista e plotë e masave për sektorin e energjisë paraqitet në paragrafin 5.6.1 në vijim.

5.2 Transporti

Sektorin e transportit në Shqipëri është trajtuar në një nivel të dyfishtë: nga njëra anë kemi një plan për zhvillimin e lëvizshmërisë (SSTPV), në drejtim të cilësisë, sigurisë, nxitjes së alternativave të qëndrueshme modale ose bashkëmodale, por që synojnë rritjen e kapaciteteve, dhe nga ana tjetër një plan me qëllimin e veçantë të të pasurit të një transporti të qëndrueshëm (TECTQ), i cili përcakton një numër masash konkrete për reduktimin e shkarkimeve. Disa masa sipas SSTPV-ës mund të kenë një ndikim pozitiv mbi zbutjen e klimës.

Masat e identifikuara në këtë PKZNK-ë janë të dobishme për përmbushjen e objektivave të politikave kryesore të njohura në NCSS-ë për t’u përgjigjur prioritetëve strategjike të identifikuara për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Masat e planifikuara nxisin zhvillimin e sektorit të transportit në Shqipëri, në përputhje me Kuadrin Ligjor Evropian 2020 dhe 2030, përmes veprimeve që synojnë përmirësimin e lidhjeve kombëtare dhe ndërkombëtare të territorit, mundësinë e arritjes së territoreve, mënyrave të qëndrueshme të transportit dhe eficiencës së energjisë.

Disa masa të propozuara në PKZNK-ë për sektorin e transportit, kanë për qëllim të përmbushin në veçanti, objektivat e politikave të *“Nxitjes së një sistemi miqësor me mjedisin- të automjeteve”*. Ky grup masash ka për qëllim: uljen e shkarkimeve të automjeteve nëpërmjet

modernizimit të automjeteve private, rregullave dhe rregulloreve strukturore, të tilla si: miratimi dhe zbatimi i direktivave për etiketimin e makinave dhe standardet e BE-së; sistemi i taksave dhe stimujve, si dhe nxitja e përdorimit të lëndëve djegëse alternative. Duke qenë se nuk është alternativë frenimi i lëvizshmërisë dhe aksesit i plotë në të gjithë territorin kombëtar është një nevojë, lëvizshmëria e motorizuar në shkallë vendi nuk mund të shmanget. Prandaj, masa të shumta mund t'i përmirësojnë opsionet e aksesit dhe lëvizshmërisë edhe me një “mënyrë jo të qëndrueshme”, duke ndikuar mbi eficiencën e automjeteve dhe motorëve sa mesatarja në BE. Zbatimi i rregullave për të rritur përqindjen e automjeteve me shkarkime të ulëta është jetësor, duke qenë se me një rritje të parashikuar ekonomike dhe rritje të pagave, indeksi i motorizimit do të arrijë të paktën mesataren e BE-së, duke e rritur numrin e automjeteve për banorë në 450-500 automjete/1000 banorë, krahasuar me numrin aktual që është 200.

“*Nxitja e mënyrave të qëndrueshme të transportit*” do të thotë krijimi i kushteve që nxitin zgjedhje të sjelljes që shmang përdorimin e automjeteve private. Prandaj duhet zbatuar një sistem multimodal transporti efikas, i sigurt, i aksesueshëm dhe i ndërlidhur, përmes opsioneve, të tilla si përmirësimi i sigurisë dhe cilësisë së transportit për një treg të hapur; përmirësimi i transportit kolektiv; përmirësimi i transportit të kombinueshëm. Ndryshimi i mënyrës së transportit në lëvizshmëri me nivel të ulët karboni ka nevojë për infrastrukturë dhe ndryshim të sjelljes. Prandaj, nxitja e mënyrave të qëndrueshme duhet të mbështetet nga bashkëpunimi i palëve të interesuara, për trajtimin e masave zbutëse, për ndryshimet klimatike.

Sistemi hekurudhor ka vuajtur për një kohë të gjatë dhe duhet ripërtërirë plotësisht, dhe në një shkallë të gjerë, të rindërtohet nga e para. Rregullat dhe rregullorja duhet të përditësohen, për të përdorur një skemë koncesioni publik-privat. Është shumë e thjeshtë të transportohen mallrat me linjë hekurudhore (nëse kushtet teknike dhe ekonomike janë me fitim), por sjellja dhe zgjedhjet e njerëzve duan kohë më të gjatë të ndryshojnë. Kalimi i pasagjerëve nga përdorimi i makinave private drejt udhëtimit me tren është edhe më i vështirë, sidomos kur ekziston një sistem i përmirësuar rrugor dhe janë të disponueshme makinat e reja. Prandaj PKZNK-ja sugjeron zhvillimin e një vlerësimi të plotë të transportit hekurudhor, duke marrë në konsideratë ofertën, kërkesën, alternativën e projektit për arritjen e një sistemi rrjeti gradual, koherent, afatgjatë, që me të vërtetë mund të konkurrojë me transportin rrugor për një numër të qëndrueshëm pasagjerësh, siç kërkohet nga kuadri ligjor i BE-së, dhe në përputhje me një skemë të mundshme koncesioni.

Shumë masa të propozuara për sektorin e transportit i përgjigjen gjithashtu, objektivit politik për *Nxjitjen e eficiencës së energjisë*, duke pasur parasysh se transporti është një nënsektor i sektorit të energjisë. Në mënyrë të veçantë, për transportin rrugor nevojiten përpjekje të mëtejshme, për të arritur një standard të qëndrueshmërisë. Masa të tilla përfshijnë: eficiencë më të lartë të energjisë, për shkak të kongestionit më të ulët në rrugët e bajpasit të Tiranës dhe lidhjes Thumanë - Vorë; eficiencë më të lartë të energjisë, për shkak të kongestionit më të ulët në rrugët lidhëse të bajpasit të Shkodrës, bajpasit të Lezhës, Vorë-Durrës, bajpasit të Tepelenës, Shkodrës, Bajpasit të Gjirokastrës, bajpasit të Elbasanit, Elbasan - Qafë Thanë; një strategji e re kontraktuale për mirëmbajtjen e rrugëve që shërben për uljen e IRI-t (indeksi ndërkombëtar i ashpërsisë), që lidhet me konsumin e karburantit, duke filluar nga Rrjeti Rrugor Parësor (1390 km). Jo vetëm udhëtarët, por edhe mallrat përdorin sistemin rrugor për të lëvizur e për t'u shpërndarë në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, dhe mund të përfitojnë nga të gjitha masat për përmirësimin e rrugëve. Duke qenë se lëvizjet e mallrave në portet kombëtare duhet të rriten, dhe lidhjet hekurudhore nuk janë të mjaftueshme, një përmirësim i faktorit të ngarkesës mund ta nxisë eficiencën e energjisë. Prandaj, TECTQ-a merr në konsideratë përmirësimin e faktorit të ngarkesës së mallrave përmes kombinimi të veprimeve, si zbatimi i njyave të përforcuara, zhvillimi i proceseve të menaxhimit të trafikut të integruar, etj.

Pjesa më e madhe e masave të propozuara duhet të mbështeten nga një sistem i fuqishëm MRV-ë, që duhet të monitorojë me kujdes edhe kërkesat e transportit rrugor. Prandaj, masat që kanë si qëllim krijimin e një sistemi për mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave, janë theksuar në PKZNK-ë, për të përmbushur objektivat politike të parashikuara, për “*Krijimin e sistemeve për*

mbledhjen e të dhënave dhe MRV-së për inventarin vjetor GES, në përputhje me kërkesat e raportimit të BE-së dhe UNFCCC-së. Në PKZKNK-ën janë propozuar gjithashtu masa të rëndësishme që kanë si qëllim: *Nxitjen e ndërgjegjësimit dhe aktiviteteve edukative, për të mbështetur sjelljet që çojnë në ulje të shkarkimeve.*

Lista e plotë e masave për sektorin e transportit jepet në paragrafin 5.6.2 më poshtë.

5.3 Bujqësia

Masat e propozuara në PKZKNK-epër sektorin bujqësor në përgjithësi, pajtohen për të përmbushur objektivat kryesorë të njohura në NCSS-ë, për t'iu përgjigjur prioritetëve strategjike të identifikuar për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Masat e planifikuara sigurojnë një rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të sektorit të bujqësisë në Shqipëri, në përputhje me kuadrin e Strategjisë Evropë 2020, si dhe përputhen mirë me parimet kryesore të Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së (PBB) 2014–2020, pasqyruar në Strategjinë Shqiptare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural (SNBZHR) dhe Programin e saj për Zhvillimin Rural 2014–2020 (IPARD).

Masat e propozuara për bujqësinë në PKZKNK-ë kanë si qëllim përmbushjen në veçanti, të **objektivave politikë që nxitin uljen e shkarkimeve për prodhimin e qëndrueshëm të ushqimit, ruajnë dhe shtojnë përmbajtjen e karbonit në tokat bujqësore dhe, rrjedhimisht, rritin potencialin e përthithësve të karbonit dhe mbrojtjen e rezervave të karbonit në ekosistemet tokësore, nëpërmjet nxitjes së praktikave të qëndrueshme bujqësore, uljes së çrregullimeve të tokës, përmirësimit të administrimit të blegtorisë dhe futjes e mbrojtjes së elementeve agro-pyjore dhe infrastrukturave të gjelbra në zonat bujqësore.**

Sidoqoftë, janë parashikuar gjithashtu masa vendimtare ndërsektoriale me sektorin e energjisë, në mënyrë të veçantë, për të përmbushur objektivat politikë të **“Nxitjes së Burimeve e Qëndrueshme të Energjisë së Rinovueshme”**, nëpërmjet **nxitjes së përdorimit të qëndrueshëm të mbetjeve bujqësore, për prodhimin e bioenergjisë nga biomasa bujqësore e gjeneratës së dytë, dhe “Nxitjes së Eficiencës së Energjisë”,** nëpërmjet modernizimit të më shumë pajisjeve bujqësore efikase.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet **prodhimit të biokarbureve** për të përmbushur objektivat në masën 10% të penetrimit të biokarbureve në përdorimin e energjisë totale për sektorin e transportit deri në vitin 2030 (sipas INDC). Duhet zbatuar masa të veçanta të aktiviteteve përgatitore të rekomanduara të PKZKNK-epër vlerësimin e fizibilitetit të zinxhirit të furnizimit të biokarbureve, duke i kushtuar një vëmendje të veçantë disponueshmërisë së tokës së përshtatshme bujqësore, llojit të përshtatshëm të biokarbureve dhe proceseve përkatëse të prodhimit si dhe aktivitete rregullatore, për të siguruar përputhshmëri me Direktivën 2015/1513 të BE-së, **mbi shmangien e zhvendosjes së prodhimit të ushqimit ose ndryshimit indirekt të përdorimit të tokës.**

Në përgjithësi, sektori bujqësor vuan nga një mungesë e përgjithshme të dhënash që do të ishin të dobishme për monitorimin e zonave bujqësore dhe kategorizimin e praktikave bujqësore që lejojnë **edhe vlerësimin e efekteve mbi ndryshimet klimatike.** Prandaj, në PKZKNK-ë janë theksuar masa që synojnë krijimin e një **sistemi për mbledhjen e të dhënave në nivel ferme në zonat bujqësore** dhe praktikatat me bazë vjetore për monitorimin e GES-it, me qëllim përmbushjen e objektivave politikë të parashikuar për **“Ngritjen e sistemeve të mbledhjes së të dhënave dhe sistemeve MRV, për inventarin vjetor të GES në përputhje me kërkesat e raportimit të BE-së dhe UNFCCC-ë”.** Sistemi duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me një sistem të ardhshëm informacioni të parcelave të tokave (LPIS) të përdorur në kuadrin e PBB-ës. PKZKNK-ja propozon gjithashtu, masa të rëndësishme që synojnë: *Nxitjen e aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe atyre edukative që mbështetin sjelljet që çojnë në uljen e shkarkimeve.*

Lista e plotë e masave për sektorin bujqësor pasqyrohet në paragrafin 5.6.3 më poshtë.

5.4 Ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyjeve

Masat e propozuara në PKZKNK-ë për sektorin LUCF-ë garantojnë përmbushjen e përgjithshme të objektivave politikë kryesorë të njohura në NCSS-ë, për t'iu përgjigjur prioritetëve strategjike të identifikuar për zbutjen e ndryshimeve klimatike. Sektori shqiptar i

përdorimi të tokës dhe pyjeve është shfrytëzuar mbi kapacitet në dekadat e fundit dhe tani po rregullohet me projektligjin e propozuar mbi Administrimin e Fondit Kombëtar të Pyjeve në Republikën e Shqipërisë, me qëllim krijimin e një rruge që të çon drejt një administrimi të qëndrueshëm të pyjeve dhe të përdorimit të tokës, si dhe me qëllim për ta kaluar sektorin nga një burim neto në një përthithës neto karboni. Për të përmbushur objektivin e *“Rritjes së potencialit të përthithësve të karbonit dhe mbrojtjes së stoqeve të karbonit në ekosistemet tokësore dhe Reduktimit të zjarreve në pyje”*, masat e veçanta përfshijnë nxitjen e administrimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, rritjen e zonave të mbrojtura dhe pyjeve, si dhe rritjen e mbrojtjes së zonave ekzistuese, përtëritjen e tokave të degraduara dhe të dëmtuara, parandalimin e zjarreve dhe zbatimin e masave të nevojshme për zhdukjen e shpejtë të tyre.

Për më tepër, janë parashikuar gjithashtu, masa ndërsektoriale me sektorin e energjisë, në veçanti për përmbushjen e objektivave politikë të *“Nxitjes së eficiencës së energjisë, si dhe Nxitjes së Burimeve të Qëndrueshme të Energjisë së Rinovueshme”* që kanë për qëllim një përdorim të qëndrueshëm të pyjeve për të reduktuar shfrytëzimin e pyjeve dhe për të përmirësuar përdorimin e teknologjisë së drurit, me anë të futjes së teknikave dhe pajisjeve teknologjike moderne, për të reduktuar sasinë e biomasës që mbetet aktualisht në pyje nga pemët e shfrytëzuara dhe teknologjitë e përmirësuara në djegien e druve, për të rritur eficiencën e procesit të përdorimit të druve për ngrohje dhe gatim.

Pavarësisht krijimit të bazës së të dhënave për pyjet, administrimi i pyjeve dhe kullotave i parashikuar në projektligjin për pyjet dhe kullotat, në momentin e mbledhjes së të dhënave mbi përdorimin e tokës dhe ndryshimit të përdorimit të tokës, mbetet një aset i munguar që mund të luajë rol kyç në monitorim, për të mundësuar vlerësimin e efekteve të aktiviteteve dhe ndryshimeve të përdorimit të tokës mbi ndryshimet klimatike. Prandaj, në PKZNK-ë janë theksuar masa që synojnë krijimin e një sistemi për mbledhjen e të dhënave në sektorin LUCF-ë për monitorimin e shkarkimeve GES, për të përmbushur objektivat politikë të parashikuar, për *“Ngritjen e sistemeve për mbledhjen e të dhënave dhe sistemeve MRV për inventarin vjetor të GES, në përputhje me kërkesat e raportimit të BE-së dhe UNFCCC-ë”*. PKZNK-ja propozon gjithashtu, masa të rëndësishme që synojnë *“Nxitjen e aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe atyre edukative që mbështetin aktivitetet e reduktimit të shkarkimeve dhe Forcimin e kapaciteteve të institucioneve përkatëse dhe bashkëpunimin ndër-institucional për trajtimin e zbutjes së ndryshimeve klimatike.”*

Lista e plotë e masave për sektorin bujqësor pasqyrohet në paragrafin 5.6.4 më poshtë.

5.5 Sistemi kombëtar për matjen/monitorimin dhe raportimin

Për një zbatim të suksesshëm të detyrimit të monitorimit dhe raportimit në kuadrin e UNFCCC-ës, BE-së dhe në të ardhmen në kuadrin e Marrëveshjes së Parisit, nevojitet një kuadër kombëtar qeverisjeje, në mënyrë që të promovohet bashkërendimi dhe bashkëpunimi i fortë ndërmjet niveleve të shumta të vendimmarrjes, përfshirë partnerë, palë të interesuara dhe sektorë, në mënyrë që të krijohen marrëveshje institucionale efektive për planifikim.

Intensifikimi i kërkesave të raportimit në kuadrin e UNFCCC-ës përmes raporteve të përditësuara dyvjeçare (BURs) dhe hapi i mëtejshëm drejt raportimit vjetor në kuadrin e BE-së, paraqet një mundësi që Shqipëria të krijojë më shumë vazhdimësi në drejtim të bashkëpunimit, shkëmbimit të informacionit dhe mirëmbajtjes së kapaciteteve, si dhe një mundësi për të krijuar marrëveshje institucionale që mund të mbështeten me kalimin e kohës.

Marrëveshja institucionale duhet të jetë e projektuar mirë, për të përcaktuar qartë rolet dhe përgjegjësitë e partnerëve të ndryshëm, me qëllim që të kontribuojë në fund në raportet politike që lidhin veprimet klimatike me prioritetet kombëtare të zhvillimit dhe mbështetjen zbatimin e UNFCCC-ës në nivele kombëtare dhe vendore nëpërmjet:

1 punonjës shtesë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për drejtimin e procesit të NAP-it i cili përfshin të gjitha veprimet për përshtatjen.
2,7 milionë lekë në vit.

6.2.2 Veprimi Prioritar nr. 2

Titulli i veprimit prioritar nr. 2 Nisma integruese gjithëpërfshirëse	Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
--	---

Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar

Qeveria, pjesërisht me mbështetjen e donatorëve, ka ndjekur tashmë disa qasje për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në sektorë dhe aktivitetet zhvillimi të ndryshme:

- Vlerësimi i ndikimit dhe alternativat për përshtatjen për sektorin bujqësor (2013);
- Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në grykëderdhjen e lumenjve Drin dhe Mat dhe më gjerë (2013);
- Vlerësimi i legjislacionit dhe kapacitetit institucional për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (2011);
- Vlerësimi i vulnerabilitetit dhe strategjia për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin shëndetësor (2011);
- Studim për përshtatjen e infrastrukturës energjetike vulnerabël nga ndryshimi i klimës (2009);
- Dokument politik për financat klimatike.

Përveç këtyre nismave sektoriale, nevojat për integrim gjithëpërfshirës të përshtatjes ndaj ndryshimeve

klimatike del dhe nga Kuadri BE-IPA. Dokumenti Strategji Orientuese për Instrumentin IPA II (2014-2020) thekson se ndihma financiare e BE-së duhet të jetë në përputhje me objektivat politikë të BE-së, duke përfshirë edhe politikën për klimën. Nevojiten dhe parashikohen strategji për ndryshimet klimatike, integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, si edhe tregues monitorimi të shpenzimeve klimatike. Draft SKZHI 2014–2020 është shqyrtuar në vitin 2015, përmes një thjërre klimatike, lidhur me situatën aktuale të klimës dhe kushtet përshtatëse. Rekomandimet dhe rrjedhojat mbeten ende për t'u reflektuar dhe për t'u vënë në jetë.

Arsyetimi / objektivat / treguesit

Integrimi i përshtatjes në politikat sektoriale dhe politikat gjithëpërfshirëse për zhvillim, është një parim gjithëpërfshirës për procesin e NAP-it, duke qenë se përshtatja e efektshme nuk është një aktivitet “shtesë”, por duhet të integrohet në politikat sektoriale. Ndërkohë që disa aktivitete integruese janë prezantuar tashmë (shih më lart), ekziston ende nevoja për qasje intensive në të gjithë sektorët përkatës. Kjo duhet të nxitet nëpërmjet një nisme integruese sistematike.

- Objektivi 1: Pasqyrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në procesin e formulimit dhe zbatimit të SKZHI-së.
 - Treguesi 1.1: Është krijuar të paktën një mekanizëm për reflektimin e rregullt të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike si pjesë e procesit të zbatimit të SKZHI-së.
 - Treguesi 1.2: Në një strategji sektoriale përkatëse përfshihet të paktën një qasje integruese në vit.
- Objektivi 2: Nxitja e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në asistencën për aderim, në përputhje me objektivat e politikës së BE-së për përshtatjen.
 - Treguesi 2: Asistenca financiare e BE-së brenda kuadrit të IPA-s ndiqet në përputhje me treguesit statistikorë të OECD-CAD-it për ndryshimet klimatike.

Elementet dhe afatet me rëndësi të veprimit prioritar

- Integrimi duhet kuptuar si një proces i vazhdueshëm i cili kërkon bashkërendim dhe bashkëpunim të palëve të ndryshme sektoriale të interesuara. GNMP-ja për ndryshimet klimatike do të vijojë të punojë nën drejtimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke përfshirë nismat integruese si një prej detyrave kryesore. Nevojat dhe rezultatet e integrimit do të pasqyrohen rregullisht gjatë mbledhjeve të GNMP-ës.
- Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike mund të mbështetet dhe të vihet në eficiencë nëpërmjet një pakete me instrumente të ndryshme, si thjerra klimatike, rezilienca klimatike, vlerësimi mjedisor strategjik me ndjeshmëri klimatike dhe treguesit e shpenzimeve klimatike. Kjo paketë instrumentesh do të shtjellohet dhe përcaktohet për situatën shqiptare nëpërmjet kontributit të një eksperti në vitin 2017/8.
- GNMP-ja do të marrë vendim për një projekt-pilot në vit për integrimin, që do të kryhet nga një sektor ministrie përkatëse, dhe do të mbështetet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet kontributeve të ekspertëve.
- Kryeministria do ta përdorë kuadrin zbatues të SKZHI-së edhe për reflektime të rregullta se deri ku janë ndjekur rekomandimet e nxjerra nga thjerrës klimatike.
- Strategjia e klimës e BE-së do të përdoret si orientim kryesor për integrimin e ndryshimeve klimatike në mbështetjen financiare në kuadër të IPA-s. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të sigurojë përputhjen e NAP-it me strategjinë e klimës së BE-së.
- Asistenca e BE-së do të duhet për ndjekjen në mënyrë sistematike të shpenzimeve brenda kuadrit të IPA-s në kuadër të aspekteve klimatike. Raportimi për asistencën e BE-së do të përfshijë përfundimet në lidhje me shkallën e integrimit të çështjeve klimatike.

Aktorët kryesorë të përfshirë

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit funksionon si agjenci udhëheqëse për nismën integruese, e lidhur me funksionin drejtues për GNMNAP-in. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të sigurojë hallkën lidhëse të nismës integruese me programimin dhe asistencën financiare të BE-së. Kryeministria do të sigurojë reflektimin e nismës integruese në përgatitjen dhe zbatimin e SKZHI-së.

Burimet

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të bashkërendojë nismën integruese, nëpërmjet sektorit të ndryshimeve klimatike që do të krijohet rishtazi.
- Fondet e Aderimit do të përdoren për të siguruar përputhshmërinë e asistencës financiare me politikat klimatike të BE-së. Kjo mund të çojë në konsulencë për integrimin e çështjeve të ndryshimeve klimatike. Kostot afërsisht 4 milionë lekë në vit.

6.2.3 Veprimi Prioritar nr. 3

<p>Titulli i Veprimit Prioritar nr. 3 Gatishmëria financiare për klimën – Zhvillimi i kapaciteteve për financimin dhe zbatimin e NAP-it në Shqipëri.</p>	<p>Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (AKP) për Fondin e Gjellbërt të Klimës (GCF)</p>
<p>Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar</p> <p>Procesi i NAP-it nuk është i lidhur zyrtarisht vetëm me një burim financiar. Nëpërmjet negociatave ndërkombëtare nën Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), dhe pse në qershor të 2016, përgjatë takimit të 13-të, bordi i Fondit të Gjellbërt vendosi që të ristrukturojë programin e mbështetjes së gatishmërisë si dhe ngritjen e një fushe aktiviteti veçanërisht për përpilimin e raporteve të NAP-it apo proceseve të tjera përshtatëse për vendet në zhvillim. Bazuar në këtë vendim, një dritare e re mundësie është hapur dhe rreth 3 milionë dollarë mund të merren për secilin vend, në kuadër të përgatitjes së planeve kombëtare të përshtatjes, nëpërmjet programit të gatishmërisë për përshtatje.</p> <p>Veprimet Prioritare të paraqitura në dokumentin e NAP-it shqiptar kanë nevojë për financim që të zbatohen. Duke qenë se efektet e ndryshimeve klimatike sa vijnë e po rriten me kalimin e viteve, dhe në mënyrë që të ndalohen ndryshimet e mëdha transformuese në sektorë, Shqipëria ka nevojë të kërkojë mbështetje financiare si afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për t'iu përshtatur këtyre efekteve. Kategoritë e ndryshme të burimeve dhe mjeteve financiare do të jenë të rëndësishme për Shqipërinë, të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> Publike dhe/ose burime private; Burimet e brendshme buxhetore dhe/ose ndërkombëtare; Projekte të mundshme në fushë dhe/ose programe të tjera të fushës; Burimet për investime dhe/ose shpenzimet operative. <p>Shqipëria ka nevojë të bëjë në mënyrë urgjente rregullimet institucionale për të qenë e aftë të hyjë në financimet e kërkuara dhe të duhura, qofshin këto kombëtare apo ndërkombëtare, si dhe të gjejë kanalet e financimit të implementimit të NAP-it. Për këtë arsye, është përpiluar dhe dokumenti i financimit (në aneksin IV).</p> <p>Ky Veprim Prioritar është i lidhur ngushtësisht me këtë dokument financiar dhe nëpërmjet zbatimit të tij synohet përparimi i të gjitha veprimeve prioritare të NAP-it.</p> <p>Veprimi prioritar fokusohet në dy fusha:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Aksesimi i buxhetit publik për zbatimin e aktiviteteve të NAP-it. 2. Aksesimi i burimeve të mundshme Ndërkombëtare të Financimit (të identifikuar në dokumentin e financimit), veçanërisht aksesimin e Fondit të Gjellbërt të Klimës (GCF). 	
<p>Arsyetimi / objektivat / treguesit</p> <p>AKP-ja do të luajë një rol të rëndësishëm në vlerësimin dhe menaxhimin e financave klimatike. Mbështetja sistematike nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve dhe asistencës teknike, do t'i japë mundësi Shqipërisë të integrojë produktet e NAP-it në planifikimin dhe buxhetimin kombëtar, si edhe ta rrisë mundësinë e Shqipërisë për të aksesuar fondet klimatike ndërkombëtare.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Objektivi 1: Përdorimi me sukses i buxhetit publik të Shqipërisë për financimin e zbatimit të NAP-it. <ul style="list-style-type: none"> ○ Treguesi 1.1: Evidencat publike tregojnë fillimisht të paktën 625 milionë ALL janë shpenzuar brenda muajit janar 2018, nga buxheti publik i Shqipërisë për zbatimin e NAP-it. • Objektivi 2: Fitimi i mundësisë së përfitimit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga fondet e GCF-ës për zbatimin e NAP-it të Shqipërisë. <ul style="list-style-type: none"> ○ Treguesi 2.1: GCF i ka dhënë Shqipërisë mbështetje financiare për aktivitetet e gatishmërisë brenda muajit dhjetor 2017. ○ Treguesi 2.2: Një propozim prej të paktën 1250 milionë ALL për zbatimin e NAP-it të Shqipërisë është aprovuar nga mbledhja e Këshillit të GCF-ës në muajin mars 2017. 	
<p>Elementet dhe afatet me rëndësi të veprimit prioritar</p> <p>1) <u>Krijimi i një sektori të financimit të klimës (brenda 12 muajve)</u> nëpërmjet: zhvillimit të kapaciteteve për AKP-ën dhe njësinë e klimës pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, duke angazhuar palët e interesit, përfshirë edhe ato të procesit të NAP-it, kontrollit mbikëqyrës të aktiviteteve të</p>	

ndryshimeve klimatike (përfshirë edhe identifikimin e shpenzimeve ekzistuese klimatike të Shqipërisë), ndërgjegjësimit dhe dhënies së informacioneve për mundësitë për financim klimatik përfshirë GCF-ën, paraqitjes së kërkesës për mbështetje të gatishmërisë nga GCF-ja, fillimit të ndërlidhjes me GCF-ën.

2) Përditësimi i rregullt i mjetit (tool) të shqyrtimit të zhvilluar me dokumentin e financimit: Ky mjet (tool) i shqyrtimit është paraqitur në Aneksin 1 të dokumentit të financimit. Aty janë shqyrtuar më shumë se 40 burime potenciale financimi dhe kanë ndihmuar në përcaktimin e prioriteteve në lidhje me fushat prioritare të ndryshme të NAP-it, fillimi i hartimit të një procesi strategjik të shkallëzuar për ngritjen e kapaciteteve dhe vendosja e një historiku me organizatat partnere financuese, vlerësimi kategorive të ndryshme të financimit (p.sh. buxheti publik i Shqipërisë, asistenca zyrtare konvencionale për zhvillim nëpërmjet partnerëve për zhvillim të Shqipërisë, fondet shumëpalëshe për klimën dhe fondet nga sektori privat, që shpesh shfrytëzohen me të paktën një prej burimeve të tjera), vlerësimi paraprak i mundësive alternative të disponueshme për financimin klimatik dhe miratimi i një liste me alternativat prioritare për Shqipërinë, fillimi i përgatitjeve për t'i përdorur menjëherë.

3) Rritja e mundësive për të marrë financim klimatik (brenda 24 muajve) nëpërmjet: sqarimit të procedurave dhe kriterëve për përdorimin e alternativave prioritare të përzgjedhura ndërkombëtare të financimit, harmonizimit të procedurave me zbatimin e NAP-it shqiptar, mundësimin të një procesi bashkërendimi strategjik, ndërmjet institucioneve kombëtare dhe partnerëve për zhvillim për financimin e zbatimit të prioriteteve të NAP-it, zhvillimit të linjës së projekteve të gatshme, paraqitjes dhe dorëzimit të propozimeve.

4) Nxjerrja e mësimëve dhe inovacioni (brenda 30 muajve) nëpërmjet: vendosjes së një sistemi monitorim-vlerësimi të vazhdueshëm për financimin e lidhur me klimën, dhe në veçanti për financimin e NAP-it, që integron financat e brendshme dhe jo të brendshme; vlerësimin të alternativave afatmesme për akreditimin e Subjekteve Zbatuese Kombëtare (identifikimi i kandidatëve, projektimi i masave përngritjes kapacitetesh etj.); lidhjes së financimit të përshtatjes me proceset e planifikimit dhe buxhetimit kombëtar dhe vijimit të integritetit të ndryshimeve klimatike në planifikimin shqiptar për zhvillim; fillimit të hartimit të reformave të politikave fiskale për të shfrytëzuar levën e financimit të përshkallëzuar të zbutjes rrezikut ndaj ndryshimeve klimatike dhe përshtatja ndaj saj në periudhën afatmesme.

Aktorët kryesorë të përfshirë

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit /AKP: udhëheq për financimin ndërkombëtar.
Ministria e Financave: udhëheq procesin e financimit të brendshëm.
Të gjitha ministratë sektoriale të përfshira në procesin e NAP-it.

Burimet

Paketat e aktiviteteve 1-4 (shih më lart) do të kërkonin një projekt të vogël të përkushtuar në formë të asistencës teknike për ngritjen e kapaciteteve të AKP-ës/njësisë për klimën:

- Buxheti: min. 37.5 milionë lek në vit për 3 vjet;
- Mundësitë për financim: Mbështetja nga GCF-ja për gatishmërinë, asistencë zyrtare dypalëshe për zhvillim (mbetet për t'u konfirmuar);
- Ekipi: Min. 1 ekspert afatgjatë i përfshirë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit në mbështetje të punës së përditshme të AKP-ës/njësisë së klimës;
- Trajnime dhe program pune me AKP-në dhe sektorin/njësinë e klimës (MM);
- Konsulenca të synuara afatshkurtra për analizat e politikave dhe zhvillim i linjës së projekteve në të njëjtën linjë.

6.2.4 Veprimi prioritar nr. 4

<p>Titulli i veprimit prioritar nr. 4 Sistemi i monitorimit të implementimit të NAP-it (monitorimi i mbështetur në rezultate)</p>	<p>Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse Agjencia Kombëtare e Mjedisit / Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</p>
<p>Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar Monitorimi i mbështetur në rezultate i punës së qeverisë, nuk është diçka e re në Shqipëri. Një mekanizëm monitorimi i mbështetur në rezultate, është miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 139, datë 01.07.2010, për të monitoruar zbatimin e SKZHI-së. Ky mekanizëm është zhvilluar “për të përmirësuar sistemin ekzistues të monitorimit – përmes zhvillimit të një raporti realist që identifikon dobësitë dhe problemet”. Përveç kësaj, mekanizmi i monitorimit i mbështetur në rezultate evidenton: i) ku dhe kur ka probleme në zbatimin e strategjive sektoriale ii) si të zgjidhen këto probleme. Programe të tjera politike, si programi 300-ditor ose 600-ditor i Qeverisë, vlerësohen rregullisht dhe ofrojnë një</p>	

referim shtesë për monitorimin afatshkurtër.

Monitorimi faktik i situatës mjedisore bëhet në kuadër të kontratave ekskluzive afatgjata, ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit/Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe institucioneve të përzgjedhura. Në funksion të ndryshimeve klimatike, nuk është identifikuar ende një sistem specifik monitorimi.

Monitorimi i mbështetur në rezultate në lidhje me klimën që synohet të krijohet në bazë të këtij veprimi prioritar, duhet të mbështetet në sistemet ekzistuese të monitorimit dhe të përfshijë 2 fusha:

- Monitorimi i progresit të efekteve të ndryshimeve klimatike (të ashtuquajturit tregues të efektit): Këta tregues do të bazohen në informacionet e marra nga sistemet ekzistuese ose të zhvilluara rishtazi të vlerësimit, si Sistemi i Monitorimit Mjedisor të Konsoliduar për Shqipërinë (CEMSA), si edhe nga monitorimi bregdetar, hidrologjik ose meteorologjik.
- Monitorimi i progresit dhe suksesit të veprimeve për përshtatjen (të ashtuquajturit tregues të kundërpërgjigjes): Zhvillimi i këtyre treguesve të kundërpërgjigjes do të bazohet kryesisht te treguesit e NAP-it, si edhe në tregues të përzgjedhur nga veprimet prioritare.

Arsyetimi / objektivat / treguesit

Ky veprim prioritar mbulon, si monitorimin e efekteve klimatike, ashtu edhe monitorimin e kundërpërgjigjes për një përshtatje të suksesshme.

- Objektivi 1: Vlerësimi i progresit kundrejt objektivave për aftësitë ripërtëritëse ndaj klimës
 - Treguesi 1.1: Procesi i zbatimit të NAP-it monitorohet lidhur me arritjen e objektivave të përcaktuar të PKP-ës (rritje e kapaciteteve për të vlerësuar efektet klimatike mbulohen nga Matricat e Vlerësimit të Performancës të Mjedisit dhe nga strategji të tjera sektoriale përkatës nga SKZHI).
- Objektivi 2: Ngritja e një sistemi monitorimi të mbështetur në rezultate për ndryshimet klimatike.
 - Treguesi 2.1: Hartohet dhe aprovohet një program monitorimi i integruar.
 - Treguesi 2.2: Vlerësohet rregullisht një paketë treguesish (të efektit dhe kundërpërgjigjes).
 - Treguesi 2.3: Vendoset dhe fillon shfrytëzimi i një sistemi monitorimit të integruar për një basen lumor pilot.

Elementet kryesore dhe afatet e veprimit prioritar

Viti i parë

- Vlerësimi i situatës dhe analiza e boshllëqeve të sistemeve ekzistuese të monitorimit në lidhje me përdorueshmërinë e tyre për monitorimin e mbështetur në rezultate.
- Konceptimi i sistemit të monitorimit të mbështetur në rezultate: Objektivat e monitorimit, treguesit/parametrat konkretë që duhen matur, burimet e të dhënave, përgjegjësitë dhe bashkëpunimi.

Viti i dytë

- Projektimi i hollësishëm i një sistemi monitorimi të mbështetur në rezultate përfshirë zinxhirët e rezultateve, si edhe treguesit e përcaktuar (skedat e treguesve) dhe përzgjedhja e treguesve më kryesorë. Reflektimi i 2 fazave të monitorimit të mbështetur në rezultate: Fillimi paraprak i një monitorimi qendror të mbështetur në rezultate. Zgjerimi drejt një monitorimi të gjithanshëm të mbështetur në rezultate.
- Ngritja e sektorëve institucional, mbështetja teknike dhe rritja e kapaciteteve për ngritjen e monitorimit të mbështetur në rezultate. Hartimi i një plan zbatimi.

Viti i tretë

- Krijimi i një sistemi monitorimi pilot / një monitorimi qendror të mbështetur në rezultate.
- Miratimi i udhëzuesit për monitorimin e mbështetur në rezultate dhe fillimi i monitorimit.

Viti i katërt

- Përzgjedhja për vlerësime të thella, për zona veçanërisht vulnerabël, ndaj ndryshimeve klimatike si:
 - zonat pranë brigjeve, plazhet, dunat dhe kanalet,
 - mekanizmat sedimentare (mbi baticë, në zonën e baticë-zbaticës dhe nën zbaticë),
 - ngritja dhe shfrytëzimi i monitorimit gjithëpërfshirës të mbështetur në rezultate,
 - përpunimi i sistemeve adekuate të raportimit për monitorimin e mbështetur në rezultate.

Afati gjithsej: 4 vjet

Aktorët kryesorë të përfshirë

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit / Agjencia Kombëtare e Mjedisit
Ministria për Evropën dhe Punët e

Burimet

- Vlera gjithsej 688 milionë lekë
- Viti i parë 75 milionë lekë
- Viti i dytë 150 milionë lekë

Jashtme Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë / Shërbimi Gjeologjik Shqiptar IGJEUM-i Institucione të tjerë relevante dhe ekspertë	<ul style="list-style-type: none"> Viti i tretë 200 milionë lekë Viti i katërt 262 milionë lekë
---	---

6.2.5 Veprimi Prioritar nr. 5

Titulli i veprimit prioritar nr. 5	Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse
Nisma për informim dhe përfshirje të publikut	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
<p>Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar</p> <p>Pavarësisht nga aktivitetet në rritje për ndërgjegjësimin e publikut për çështjet mjedisore në përgjithësi, çështja e ndryshimeve klimatike është ende pasive në Shqipëri, madje, dhe në nivel të vendimmarrësve të politikave, nuk ka njohuri të thella për ndryshimet klimatike dhe çështjet e lidhura me të.</p> <p>Rezultatet e një studimi kanë treguar se, pavarësisht punës së kryer për ndërgjegjësimin, komunikimin, trajnimin dhe edukimin e lidhur me ndryshimet klimatike, ka nevojë për ndërhyrje madhore të tjera. Këto duhet të fillohen me një strategji komunikimi, e cila mund të ndryshojë sjelljen e përgjithshme dhe mënyrat se si bëhen gjërat. Veprimi i nevojshëm përfshin zhvillim të mëtejshëm të kapaciteteve të institucioneve në nivel qendror dhe vendor, për të qenë në gjendje të projektojnë dhe zbatojnë kundërpërgjigjet e duhura ndaj ndryshimeve klimatike.</p>	
<p>Arsyetimi / objektivat / treguesit</p> <ul style="list-style-type: none"> Objektivi 1: Rritja e kapaciteteve të institucioneve publike përkatëse. <ul style="list-style-type: none"> Treguesi 1.1: Përmirësimi i nivelit të njohurive mbi ndryshimet klimatike në institucionet publike të lidhura me veprimin për klimën. Objektivi 2: Rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes për ndryshimet klimatike në grupet e shoqërisë civile. <ul style="list-style-type: none"> Treguesi 2.1: Përfshirja publike e komuniteteve dhe grupeve të shoqërisë civile e orienton një plan veprimi për pjesëmarrjen dhe përfshirjen e publikut. 	
<p>Elementet kryesorë dhe afatet e veprimit prioritar</p> <p>Përmes disa drejtimeve të punës, ky veprim prioritar siguron zhvillim të kapaciteteve për institucionet publike, punë përfshirëse, nëpërmjet institucioneve arsimore, angazhimin e shoqërisë civile, si edhe shërbime informimi për sektorët ekonomikë. Secili drejtim i punës i përshkruar më poshtë, përfshin fazën e konceptimit (viti 1) dhe fazën e zbatimit (viti 2 + 3).</p> <ul style="list-style-type: none"> Ngritja e kapaciteteve për institucionet shtetërore. Dhënia e mbështetjes institucionale të njësisë së sapo krijuar të ndryshimeve klimatike pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Përmirësimi i komunikimit ndërmjet institucionet publike dhe shpërndarja e informacioneve klimatike te to. Kryerja e një vlerësimi të nevojave për trajnim dhe dhënia e kontributeve të synuara trajnuese të personelit përkatës të institucioneve publike. Përfshirja nëpërmjet institucioneve arsimore. Hartimi i moduleve edukuese mbi ndryshimet klimatike dhe prezantimi i fushatave në shkolla. Përfshirja e njohurive mbi ndryshimet klimatike në programet mësimore përkatëse. Puna përfshirëse dhe angazhimi me shoqërinë civile. Hartimi i një plani veprimi për pjesëmarrjen dhe përfshirjen e publikut. Organizimi i dëgjësave dhe debateve publike për aktivitetet e lidhura me përshtatjen. Rritje e ndërgjegjësimit nëpërmjet fushatave (mediave, organizatave të shoqërisë civile etj.). Zhvillimi i aktiviteteve konkrete të promovimit (p.sh. nëpërmjet konkurseve, aktiviteteve publike). Shpërndarje e informacionit në sektorët ekonomikë përkatës. Përfshirja e informacioneve klimatike në shërbimet mbështetëse për bujqit. <p>Afati 3-4 vjet</p>	
Aktorët kryesorë të përfshirë	Burimet
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Ministria e Arsimit Sportit dhe	<ul style="list-style-type: none"> 93.75 milionë lekë

Rinisë PNUD-i Universitetet Mediat OJQ-ët	
---	--

6.2.6 Veprimi Prioritar nr. 6

Titulli i veprimit prioritar nr. 6 Nisma për ngritjen e kapaciteteve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
<p>Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar</p> <p>Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, si një qasje relativisht e re, ende nuk mbështetet me kapacitete adekuate në vend. Vlerësimi i situatës, kryer me instrumentin SNAP (shih kapitullin 3 të dokumentit të NAP-it), ka identifikuar nevoja të konsiderueshme për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale. Planifikimi dhe zbatimi i përshtatjes nënkupton nevojën për kapacitete institucionale dhe aftësi individuale në institucione të ndryshme dhe në disa nivele administrative (që nga politikat e deri në nivel operativ). Aftësitë individuale të nevojshme nuk lidhen thjesht me njohuri teknike për ndryshimet klimatike, por po aq edhe me aftësitë në drejtim dhe pjesëmarrje, aq të nevojshme për të arritur ndryshimin.</p> <p>Në lidhje me këtë koncept, janë prezantuar qasjet e para për zhvillim të kapaciteteve, në kuadër të fazave të para të procesit të NAP-it:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontribut në formën e trajnimit mbi bazat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, në të kuptuarit konceptual për procesin e NAP-it, si dhe mbi integrimin, u dha më 17 shkurt 2015. • Një trajnim tjetër për mundësinë e aksesimit të financave të klimës u zhvillua më 8 shtator 2015. 	
<p>Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar</p> <p>Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, si një qasje relativisht e re, ende nuk mbështetet me kapacitete adekuate në vend. Vlerësimi i situatës, kryer me instrumentin SNAP (shih kapitullin 3 të dokumentit të NAP-it), ka identifikuar nevoja të konsiderueshme për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale. Planifikimi dhe zbatimi i përshtatjes nënkupton nevojën për kapacitete institucionale dhe aftësi individuale në institucione të ndryshme dhe në disa nivele administrative (që nga politikat e deri në nivel operativ). Aftësitë individuale të nevojshme nuk lidhen thjesht me njohuri teknike për ndryshimet klimatike, por po aq edhe me aftësitë në drejtim dhe pjesëmarrje, aq të nevojshme për të arritur ndryshimin.</p> <p>Në lidhje me këtë koncept, janë prezantuar qasjet e para për zhvillim të kapaciteteve në kuadër të fazave të para të procesit të NAP-it:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontribut në formën e trajnimit mbi bazat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, në të kuptuarit konceptual për procesin e NAP-it, si dhe mbi integrimin, u dha më 17 shkurt 2015. • Një trajnim tjetër për mundësinë e aksesimit të financave të klimës u zhvillua më 8 shtator 2015. 	
<p>Elementet kryesorë dhe afatet e veprimit prioritar</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veprimi 1 (12/2018): Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të hartojë një plan koherent trajnimi me mbështetjen e donatorëve që janë aktivë në këtë fushë. Plani i trajnimit do të përcaktojë se cilat boshllëqe në njohuri do të trajtohen për cilin veprim të procesit të NAP-it. Plani do të përcaktojë edhe burimet dhe mbështetjen për kontributet e trajnimit. • Veprimi 2 (2018): Do të zhvillohen trajnime të synuara për tema të përzgjedhura sipas planit të trajnimit. Trajnimet do të ndjekin konceptet didaktike interaktive konceptuale dhe do të sigurojnë që të kenë shumë lidhje me punën praktike të pjesëmarrësve. • Veprimi 3 (2018 + 2019): Do të mbështeten disa masa të përzgjedhura dhe në bazë të kërkesës për zhvillimin e kapaciteteve institucionale gjatë procesit të NAP-it. Ndër temat mund të përfshihen: zhvillimi i mekanizmave të përpunimit dhe vlerësimit të të dhënave të lidhura me ndryshimet klimatike, mbështetje e kapaciteteve institucionale për financimin klimatik, zhvillimi i kapaciteteve për përgjigjen ndaj situatave të jashtëzakonshme, sidomos në fushën e menaxhimit të rrezikut të përmytjeve, zhvillimi i kapaciteteve për AKP-ën dhe sektorin e klimës pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, zhvillimi i veprimeve rregullatore, për shembull për standardet për të pasur një infrastrukturë me aftësi rimëkëmbëse. 	
<p>Aktorët kryesorë të përfshirë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (udhëheq)</p>	<p>Burimet 246.000 milionë lekë, MTM-ja nëpërmjet GCF-ës</p>

Sektorë të Ministrive të linjës(marrin pjesë) Agjencitë donatore (marrin pjesë) Konsulentë / ekspertë (marrin pjesë)	Qendrës së Mbështetjes së Gatishmërisë.
--	---

6.2.7 Veprimi Prioritar nr. 7

Titulli i veprimit prioritar nr. 7 Ujitje, kullim dhe mbrojtje nga përmbytjet me aftësi ripërtëritëse kundrejt ndryshimeve të klimës	Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
<p>Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar</p> <p>Gjatë 50 viteve të fundit (1951–2001), është regjistruar një rritje e temperaturave prej afërsisht 0,3°C në mbarë vendin. Si pasojë e ndryshimeve klimatike, priten dukuri më të shpeshta të motit ekstrem, si temperatura të larta, thatësi dhe zgjatur, përmbytje, rrëshqitje më të mëdha toke dhe rrezik zjarri. Këto ndryshime klimatike do të ndikojnë fuqimisht te produktiviteti rural dhe të ardhurat. Në Shqipëri, prodhimi i të lashtave dhe i bimëve frutore ka një rëndësi më të madhe, krahasuar me blektorinë</p> <p>Veprimi nr. 7.1: Duke qenë se ndryshimet klimatike do të kenë ndikim në shumë kultura bujqësore, nevojiten njohuri të qarta për sasinë e ujit që u duhet bimëve për konsumim. Kështu, duhet të llogaritet bilanci uJOR (sasia e ujit të pranishëm dhe sasia e ujit që nevojitet nga bimët) për të gjetur ide dhe propozime për përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik.</p> <p>Veprimi nr. 7.2: Ndryshimet klimatike kërkojnë modernizim dhe reformim të strukturave për të bërë një përdorim më efikas të ujit, një menaxhim më intensiv, si edhe procedura financiare më të besueshme. Ky veprim mund të ndahet në dy fusha kryesore: njëra fushë për kullimin dhe tjetra për përmbytjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sa u takon përmbytjeve, kjo fushë mund të lidhet me administrimin e lumenjve dhe me sigurinë e digave. Kapaciteti i digës ka rënë rreth 45% për shkak të mbushjes së vëllimit me sediment, dhe kështu është rritur edhe rrezikui përmbytjeve. Rritja e shpeshtësisë së përmbytjeve dhe shkallës së tyre kërkon ndryshime (përmirësim) të infrastrukturave të mbrojtjes nga përmbytjet (rritje e efikasitetit të digave, duke mirëmbajtur digat ekzistuese dhe duke ndërtuar diga të reja, si dhe përmirësim i sigurisë së digave) si dhe gjetjen e burimeve të reja ujore. Për përmbytjet e shkaktuara nga lumenjtë është e rëndësishme të bëhet një administrim më i mirë i lumenjve, përfshirë modelimin hidraulik, sipas qasjeve dhe sistemeve kompjuterike më të reja. • Sa i takon kullimit, është shumë e rëndësishme të gjenden mënyra dhe teknologji të reja për përmirësimin e rrjeteve të kullimit. Kjo duhet të përfshijë mirëmbajtjen dhe pastrimin e kanaleve ekzistuese të ujitjes si edhe hapjen e kanaleve të reja. 	
<p>Arsyetimi / objektivat / treguesit</p> <p>Objektivi 1: Përmirësimi i llogaritjes së nevojave për ujë dhe potencialit furnizues për kulturat bujqësore, duke mbajtur në konsideratë efektet nga ndryshimet klimatike.</p> <p>Objektivi 2: Përmirësimi i infrastrukturës dhe mirëmbajtja e saj për t'u bërë ballë ndryshimeve në regjimin e reshjeve dhe sedimentit të shkaktuara nga ndryshimet klimatike (kullimi, siguria e digave dhe përmbytjet).</p>	
<p>Elementet kryesorë dhe afatet e veprimit prioritar</p> <p>Veprimi 7.1:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Llogaritja e nevojave për ujë të bimëve sipas një metodike të re (përditësim i formulave ekzistuese ose përdorim i formulave të reja). • Zhvillim i një plani për pakësimin e erozionit nëpërmjet bimëve (buxheti 270 milionë lekë). Studim fizibilitetimbukurimet ujore ekzistuese, 626 rezervuarë ujitjeje duhen kontrolluar për sasinë reale të ujit që mund të mbledhin, gjendjen e digave të ujitjes dhe përdorimin e ardhshëm të digave. (buxheti 97 milionë euro). • Forcimi i strukturave dhe ngritja e kapaciteteve të IGJEUM-it për krijimin e një sistemi për shkëmbimin e të dhënave hidrologjike. <p>Veprimi 7.2:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Riorganizimi i strukturave të monitorimit të përmbytjeve (2018-2020, buxheti 72 milionë lekë). • Krijimi i strukturave të kontrollit teknik të infrastrukturave të mbrojtjes nga përmbytjet (2017-mes i vitit 2018, buxheti 60milionë lekë). • Forcimi i strukturave të monitorimit të sigurisë së digave (2018-2020, buxheti 10 milionë lekë) • Harta të mbrojtjes nga përmbytjet në rast çarjedige (2019-2020, buxheti 10 milionë lekë). • Zhvillimi i një sistemi trajnimi dhe certifikimi për punonjësit që punojnë në sektorin e ujitje- 	

<p>kullimit (2017-2018, buxheti 75 milionë lekë).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rehabilitimi dhe rritja e sigurisë së 210 digave, sipas studimit të BB-ës të vitit 2009 (900 milionë lekë). • Ngritje e një sistemi trajnimi dhe certifikimi për punonjësit që punojnë në sektorin e erozionit (2017-mes i vitit 2018, buxheti 7.5 milionë lekë). • Fuqizimi i strukturave për ndërhyrjet dhe veprat e marrjes së ujit në shtratin e lumenjve (buxheti 60 milionë lekë). • Studime dhe projekte zbatimi për ndërtimin e strukturave të mbrojtjes nga përmbytjet (2017-2027, buxheti 280 milionë lekë). 	
<p>Aktorët kryesorë të përfshirë</p> <p>Roli udhëheqës i përket MBZHR-së dhe Drejtoritë e Ujit dhe të Kullimit në mbarë vendin, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit.</p> <p>Aktorët e tjerë që do të marrin pjesë janë:</p> <p>Njësitë e vetqeverisjes Vendore / bashkitë që janë përgjegjëse për parandalimin e përmbytjeve në territorin e tyre dhe për masat që duhen marrë në rast përmbytjeje.</p> <p>Kompanitë që përdorin dhe konsumojnë ujë të cilat janë përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe pastrimin e kanaleve të kullimit në territorin ku ushtron aktivitet shoqëria.</p>	<p>Burimet</p> <p>Vlerësimetbuxhetore janë paraqitur më lart, sipas veprimeve kryesore. Fondet e nevojshme mund të gjenden si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fonde të brendshme (shtetërore) kryesisht për masat e buta dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore. • Mbështetje nga donatorët e nevojshme në fushën e investimeve.

6.2.8 Veprimi Prioritar nr. 8

Titulli i veprimit prioritar nr. 8 Menaxhimi i integruar i burimeve ujore	Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
<p>Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar</p> <p>Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore është hartuar për periudhën 2017-2027, për të nxitur dhe bashkërenduar zhvillimin dhe administrimin e burimeve ujore, tokësore dhe burimeve të lidhura me to, për të maksimizuar mirëqenien ekonomike dhe shoqërore të lidhur me këtë fushë, në mënyrën e duhur pa kompromentuar qëndrueshmërinë në kohë të ekosistemeve jetike. Në strategji janë reflektuar efektet e ndryshimeve klimatike, për të rritur aftësinë rimëkëmbëse të burimeve ujore ndaj ndryshimeve klimatike.</p> <p>Si e tillë, kjo strategji nuk zhvillon plane veprimi të hollësishtme për sektorët e ndryshëm të ujit, por do të përfshijë një plan veprimi të përgjithshëm dhe do të shërbejë si një kuadër i përgjithshëm i politikave, që vendos kushtet për strategjitë e lidhura me sektorin e ujit. Në bazë të strategjisë, planet e monitorimit të mbështetur në rezultate do të përcaktojnë masat për basenet lumore. Janë prezantuar dy planet e para pilot për basenet ujëmbledhëse të Drin-Bunës dhe Semanit. Këto plane do të marrin në konsideratë efektet e ndryshimit të klimës, sidomos lidhur me rreziqet e thatësirës dhe përmbytjeve. Sa u takon këtyre të fundit, këto plane do të përfitojnë nga programi i mbështetur nga GIZ-i “Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor” i cili flet dhe jep masa konkrete për menaxhimin e tyre. Planifikimi do të mbështetet në një modelim sistematik dhe do të ketë si rezultat propozime për ndërhyrje dhe masa konkrete.</p> <p>Projektet për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore dhe të planeve të monitorimit të mbështetur në rezultate, mbështeten nga Banka Botërore dhe SIDA. Ekipet e projekteve përfshijnë specialistë të ndryshimeve klimatike. Përveç planeve të menaxhimit të baseneve lumore të lartpërmendura, janë planifikuar të përpilohen dhe 4 plane të tjera për menaxhimin e baseneve lumore të mbetura. Dy prej tyre (Vjosa dhe Mati) kanë nisur dhe janë zhvilluar pjesërisht, dhe ai i Shkumbinit është në fillimet e tij. Baseni tjetër do të fillojë direkt pas vendosjes në dispozicion të fondeve IPA. Të gjitha planet e menaxhimit të baseneve lumore do të ndjekin standardet evropiane, duke përfshirë këtu dhe kapitullin mbi ndryshimet klimatike.</p>	
<p>Arsyetimi / objektivat / treguesit</p> <p>Fokusi kryesor i veprimit prioritar është përgatitja e planeve të monitorimit të mbështetur në rezultate me qasje të orientuar nga zbatimi. Në këtë aspekt, objektivi i këtij veprimi prioritar është:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Objektivi 1: Masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike pasqyrohen në mënyrë adekuate në planin dhe procesin e zbatimit për dy plane menaxhimi të baseneve ujore (Drin, Bunë dhe Seman) dhe të 	

një të treti (plani menaxhimi i basenit ujqor për lumin Vjosë) që sapo ka filluar dhe është ende në fazën paraprake të tij.

- Treguesi 1.1: Të paktën disa masa specifike të lidhura me përshtatjen përfshihen në planin e zbatimit për secilin plan menaxhimi të baseneve ujqorë si më poshtë:
 - Planifikim hapësinor i duhur
 - Harta të rreziqeve të përmytjeve dhe të thatësisë
 - Ndërgjegjësim i popullsisë për zona specifike sipas hartave të rrezikshmërisë
 - Përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike në bujqësi
 - Plane të menaxhimit të rreziqeve të përmytjeve dhe të thatësisë.
- Treguesi 1.2: Procesi i zbatimit për planet e monitorimit të mbështetur në rezultate hartohet në atë mënyrë që gjatë zbatimit të pasqyrohet në mënyrë adekuate ndryshimet klimatike.
 - Objektivi 2: Katër planet e menaxhimit të baseneve lumore janë pjesë e projektplaneve të ministrisë, nga ku, në secilin prej tyre, do të reflektohen ndryshimet klimatike në mënyrë adekuate.
- Treguesi 2.1: Planet e menaxhimit të baseneve lumore janë përpiluar mbi direktivën kuadër të ujit të BE-së, standardet e direktivës së përmytjeve të BE-së, si dhe reflektojnë përshtatjen ndaj ndryshimeve të klimës në menyë adekuate.
- Treguesi 2.2: Planet e menaxhimit të baseneve lumore janë të përgatitur dhe ato përfshijnë dhe masa për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në to.
- Treguesi 2.3: Ndryshimet klimatike do të reflektohen në mënyrë adekuate dhe në fazën e implementimit të Planeve të Menaxhimit të Baseneve Lumore.
- Treguesi 2.4: Forcimi institucional dhe ngritjen e kapaciteteve në drejtim të përgatitjes së planit të menaxhimit të baseneve lumore është arritur.
- Treguesi 2.5: Ndryshimet e klimës janë pasqyruar dhe/ose janë pjesë e Vlerësimit Strategjik Mjedisor për secilin nga basenet lumore.
- Treguesi 2.6: Efekti ndërkuftar i ndryshimeve klimatike është marrë parasysh.
- Treguesi 2.7: Ndryshimet e klimës janë marrë në konsideratë gjithashtu dhe nga komisionet ndërkuftare për basenet përkatëse.

Elementet dhe afatet me rëndësi të veprimit prioritar

Veprimi 1 (gjatë gjithë vitit 2017): Ekspertë të ndryshimeve klimatike (p.sh. të përfshirë në projektin e GIZ-it “Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor”) do të përfshihen në procesin e konsultimit, për të shfrytëzuar përvojat në proceset e përshtatjes në Shqipëri dhe për të dhënë më shumë orientim mbi përgatitjen e planeve të menaxhimit të baseneve ujqore lidhur me aspektin e ndryshimeve klimatike.

Veprimi 2 (fund i vitit 2017): Lista e masave të propozuara do të vlerësohet në këndvështrimin e ndryshimeve klimatike (për shembull një vlerësim strategjik mjedisor ku merren parasysh ndryshimet klimatike) dhe një VKM-je të mundshme (mbetet ende për t’u vendosur).

Veprimi 3 (2017): Procesi i zbatimit për planet e menaxhimit të baseneve ujqore do të hartohet në atë mënyrë që, gjatë zbatimit, të pasqyrohen në mënyrë adekuate ndryshimet klimatike.

Veprimi 4 (Përafërsisht 2020): Katër planet e tjera të menaxhimit të baseneve lumore do të fillojnë fazën e ideim – projektimit dhe ndryshimet klimatike do të reflektohen, si në fazën e hartimit dhe në fazën e dizenjimit.

Aktorët kryesorë të përfshirë

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujqore dhe Planet e Menaxhimit të Baseneve Lumore do të drejtohen Këshilli Kombëtar i Ujit që do të shoqërohet nga një grup i menaxhimit të integruar të politikave.

Partnerë të tjerë të përfshirë: Ministria e Brendshme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkitë dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Burimet

Projekti për përgatitjen e strategjisë po zbatohet nga Ministria përgjegjëse për bujqësinë dhe financohet nga një hua e BB/IBRD, si edhe nga grante të SIDA-s. Sa u takon planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore (2 prej të cilëve) shuma është 174.5 milionë lekë.

Burimet financiare për PMBL-ën do të sigurohen nga donatorë dhe shuma e përafërt për një plan menaxhimi do të jetë 217.5 milionë lekë +20% (në varësi të basenit lumor dhe karakteristikave të tij).

6.2.9 Veprimi Prioritar nr. 9

Titulli i veprimit prioritar nr. 9
Përshtatja në sektorin bujqësor:

Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

<ol style="list-style-type: none"> 1. Mbrojtja e fermës 2. Administrimi i prodhimit bujqësorë 3. Sistemet e informacionit 4. Menaxhimi i blegtorisë 	
<p>Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar</p> <p>Efektet e ndryshimeve klimatike po ndihen përditë e më shumë në të gjithë sektorët dhe sidomos në bujqësi, që është një prej sektorëve më të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Kontributi ekonomik kryesor për Shqipërinë vjen përmes bujqësisë, prandaj zonat rurale në vend luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces. Nëse nuk përdoret asnjë masë përshtatjeje, ndryshimet stinore do të çënojnë kulturat dhe blegtorinë.</p> <p>Veprimi nr. 1: Rritja e temperaturave do t'i zgjasë stinët. Pritet një rritje e përqendrimit të CO₂, që do të prekë edhe rritjen e bimëve, si edhe në varësi të zonës, do të ketë një rritje të sasisë së shirave, rritje të erozionit të tokës dhe një ndryshim të burimeve ujore. Për këto arsye, nevojitet një mbrojtje e madhe fermave dhe disa prej konstatimeve që dalin në dritë lidhen kryesisht me mënyrat alternative për sistemet e përdorura nga fermeret, si rritja e numrit të serrave, tuneleve dhe barrierave bimore, sistemeve të mbrojtjes nga breshëri etj.).</p> <p>Veprimi nr. 2: Rënia e sasisë së reshjeve dhe rritja e luhatshmërisë së tyre, si edhe rritja e temperaturave dhe e shpeshtësisë së dukurive të motit ekstrem, do të kenë si rezultat pakësim të sasisë, sigurisë dhe cilësisë, sa u takon kulturave bujqësore, mosrritje të tyre, dhe në zona të veçanta, edhe erozion të tokës. Kulturat e rrushit dhe ullirit, të cilat në Shqipëri janë kultura ujëdashëse, kanë një potencial të lartë t'u bjerë rendimenti. foragjeret për bagëti, gruri dhe jonxha kanë një potencial të lartë për rritje të rendimentit, për shkak të pasojave pozitive të rritjes së temperaturave dhe zgjatjes së sezonit të rritjes. Rendimenti i domates së fushës mund të bjerë paksa. Ekziston potenciali për pasoja më të konsiderueshme të kulturave të perimeve dhe frutave, si shalqiri, të cilat mund të vuajnë nga temperaturat e larta dhe thatësira, sidomos gjatë periudhave të rëndësishme të rritjes së tyre. Për pasojë, shumë prej masave të përshtatjes klimatike të cilat duhen identifikuar do të kenë efekte të menjëhershme për rritjen e rendimentit, si edhe për përmirësimin e aftësisë rimëkëmbëse ndaj ndryshimeve klimatike në të ardhmen. Në këtë kuadër, është e rëndësishme të sigurohen varietete farash me aftësi më të lartë përshtatëse ndaj klimës së ndryshuar, të optimizohen plehurat bujqësore, të përmirësohen dhe përshtaten teknikat e kultivimit, të përgatiten modele të kulturave bujqësore, të rehabilitohet dhe përmirësohet sistemi i ujitjes dhe kullimit (shih veprimin prioritar 8) etj.</p> <p>Veprimi nr. 3: Masat e efektshme të përshtatjes kanë nevojë për informacion më të mirë programatik. Një pjesë e madhe e kapacitetit për përshtatjen, varet nga një nivel i lartë funksionaliteti i të dhënave (të dhënat hidrometeorologjike dhe ato gjeohapësinore, në mënyrë që të sigurohet mbështetje e fermerëve). Tani për tani, në Shqipëri ekzistojnë këto sisteme, por ato duhen përmirësuar për të rritur mundësitë e fermerëve për të marrë informacionin e gatshëm dhe për të shfrytëzuar teknologjinë më të fundit, për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, për të përmirësuar shpërndarjen e të dhënave hidrometeorologjike, potencialin kullues dhe përshtatshmërinë e kulturave bujqësore.</p> <p>Veprimi nr. 4: Ndryshimet klimatike paraqesin një rrezik madhor edhe sa i takon blegtorisë. Rritja e temperaturave mund të ndikojë në produktivitetin në blegtori ose mund të rrisë shkallën e vdekshmërisë në raste ekstreme të klimës. Rritja e temperaturave dhe ndryshimi i sasisë së reshjeve mund të rrisë përhapjen e sëmundjeve ekzistuese vektoriale dhe përhapjen e makroparazitëve, shoqëruar dhe me përhapjen e sëmundjeve të reja. Në ndikimet indirekte të ndryshimeve klimatike në blegtori përfshihet ndikimi në mjaftueshmërinë e ushqimit për kafshë (sidomos misri i cili kërkon sasi të mëdha uji, duke qenë se është burimi kryesor i koncentratit të përdorur si ushqim për kafshët. Brenda vitit 2040, priten humbje në rreth 35% në prodhimin e pulave dhe gjedhëve, për shkak të temperaturave të pritshme tejet të larta. Për këtë arsye, ka rëndësi ngritja e mjediseve të standardizuara për strehimin e bagëtive, monitorimi dhe mbajtja në kontroll e përhapjes së sëmundjeve ekzistuese vektoriale dhe të makroparazitëve, mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës ujëtare etj.</p>	
<p>Arsyetimi / objektivat / treguesit</p> <p>Ky veprim prioritar trajton përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në bujqësi, në katër fusha. Prandaj, edhe objektivat për këtë veprim prioritar janë hartuar sipas fushave të identifikuara.</p> <p>Veprimi nr. 1</p> <ul style="list-style-type: none"> • Objektivi 1: Fermat bujqësore përdorin me sukses infrastrukturën mbrojtëse, me një kosto totale prej 800 milionë lekësh <ul style="list-style-type: none"> ○ Treguesi 1: Numer i konsiderueshëm fermash janë mbështetur financiarisht për ndërtimin e 	

infrastrukturës mbrojtëse, si p.sh. ndërtimi i serrave, tuneleve, sistemeve të mbrojtjes nga breshëri.

Veprimi nr. 2

- Objektivi 2: fermerët përdorin teknologji bujqësore të reja për menaxhimin e prodhimit të kulturave bujqësore.

- Treguesi 2.1: Një numër i caktuar teknologjish bujqësore të reja për prodhimin e kulturave bujqësore janë vënë në zbatim.

- Treguesi 2.2: Rritje e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale nëpërmjet trajnimeve të zhvilluara për fermerët dhe institucionet bujqësore.

Veprimi nr. 3:

- Objektivi 3: Përmirësimi mundësisë së marrjes së të dhënave mbi motin dhe burimet ujore me një kosto, vetëm për indikatorin 3.2, 15 milionë lekë.

- Treguesi 3.1: ngritja e një sistemi për aksesimin dhe marrjen e të dhënave hidrometeorologjike dhe burimet ujore.

- Treguesi 3.2: Përmirësimi i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale mbi praktikat më të mira për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe kontrollin e dëmtuesve. Kosto 15 milionë lekë

Veprimi nr. 4:

- Objektivi 4: sigurimi i përshtatjes për blegtorinë, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të përparuara me një kosto totale prej 4 miliardë lekë.

- Treguesi 4.1: Një numër masash përshtatëse për sigurimin e ushqimit për kafshë janë vënë në zbatim.

Elementet kryesore dhe afatet e prioritar

Veprimi.1 (2017–2020):

- Ndërtimi i sistemeve të mbrojtjes nga breshëri (përdorimi i teknikës *me re artificiale*, i rrjetave mbrojtëse).

- Mbjellja e brezave mbrojtës bimore sipas nevojës (orientuar nga ana gjeografike, aty ku ka më shumë nevojë).

- Kalimi i kulturave bujqësore në serra.

- Krijimi i barrierave vegjetative mbrojtëse, gardheve për mbrojtjen nga dëborat, mbulesave kundër erës, brezave pyjorë.

- Përdorimi i perdeve të tymit për të trajtuar brymën në fund të pranverës dhe fillim të vjeshtës.

Veprimi 2 (2017–2020):

- Ndryshimi i teknikave të kultivimit.

- Punimi mbrojtësi tokës, diversifikimi dhe rrotacioni i kulturave bujqësore.

- Përdorimi i varieteteve/hibridëve bujqësorë që e durojnë të nxehtin dhe thatësinë.

- Optimizimi i kohës së operacioneve (mbjelljes, faktorëve të prodhimit, ujitjes, korrjes a vjeljes).

- Rajonalizimi i kulturave bujqësore duke marrë parasysh ndikimin e ndryshimeve klimatike.

- Rehabilitimi dhe modernizimi i infrastrukturës ujitëse.

- Sigurimi i kullimit, me përparësi në ultësinë perëndimore, nëpërmjet administrimit të qëndrueshëm të sistemeve të kullimit dhe mbrojtjes nga përmytjet. Rehabilitimi dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese.

- Ofrimi i sigurimeve për bujqit në rast katastrofe.

- Rritja e kapaciteteve të institucioneve kërkimore shkencore në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

- Rritja e kapaciteteve njerëzore të shërbimeve këshillimore dhe fermerëve nëpërmjet trajnimeve dhe seminareve.

Veprimi 3:

- Përmirësimi i sistemit të informimit për mbajtjen në kontroll të dëmtuesve.

- Sigurimi i mundësisë për marrjen e informacioneve për dukuritë e motit, të dhënave nga sistemet e sinjalizimit të hershëm, të dhënave nga monitorimi etj.

- Sigurimi i aksesit për marrjen e informacionit për burimet ujore ekzistuese të përdorshme.

Veprimi 4 (2017–2020):

- Mbështetje financiare për mbarështimin e racave me rezistente ndaj ndryshimeve klimatike në blegtori.

- Monitorimi dhe mbajtja në kontroll e përhapjes së sëmundjeve ekzistuese të transmetueshme nëpërmjet vektorëve dhe makroparazitëve, të shoqëruara nga qarkullimi i sëmundjeve të reja.

- Mirëmbajtja dhe riparimi i infrastrukturës ujitëse, për të siguruar gatishmërinë e ujit në momentet

<p>kritike të stinës së rritjes, sidomos për misrin dhe foragjeret e tjera, për të ruajtur disponueshmerine e ushqimit për kafshë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja në ndërtimin e mjediseve të standardizuara të strehimit të bagëtive, për të siguruar mbrojtjen e tyre. • Përmirësimi i punës kërkimore, menaxhimit të blegtorisë, ushqyerjes dhe shëndetit e të kafshëve në kushtet e ndryshimeve klimatike. - Përshtatja e fermave blegtorale ndaj stresit klimatik. Kalimi në racat e bagëtisë që e durojnë më shumë motin e nxehtë. - Rritja e kapaciteteve njerëzore për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për fermerët, nëpërmjet trajnimeve dhe seminareve. 	
<p>Aktorët kryesorë të përfshirë MBZHR-ja Agjencia Rajonale e Shërbimit Veterinar dhe Mbrojtjes së Bimëve Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (Fushë-Krujë dhe Korçë). Autoriteti Kombëtar i Ushqimit Njësitë e vetqeverisjes vendore Bujqit/ fermerët</p>	<p>Burimet Mbetet ende për t'u llogaritur buxheti i programit kompleks të aktiviteteve. Parashikohen këto burime financimi: Veprimi 1: Buxheti shtetëror 100 milionë lekë dhe buxheti ndërkombëtar (financime të huaja) 700 milionë lekë. Veprimi 2: Buxheti shtetëror 45 milionë lekë dhe 65 milionë lekë financime të huaja (për shembull fonde nga IPA). Veprimi 3: Buxheti shtetëror vetëm për treguesin 3.2, 15 milionë lekë. Veprimi 4: Buxheti shtetëror 1.8 miliardë lekë dhe financime të huaja 2.2 miliardë lekë.</p>

6.2.10 Veprimi Prioritar nr. 10

<p>Titulli i veprimit prioritar nr. 10 Nxitja e zbatimit të strategjisë së përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin e shëndetësisë</p>	<p>Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</p>
<p>Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar Efektet e ndryshimeve klimatike ndihen përditë e më shumë në Shqipëri, me rritjen e temperaturave dhe ndryshimin e intensitetit të sasisë së reshjeve. Për pasojë, problemet shëndetësore të lidhura me cilësinë e ajrit (sëmundjet e aparatit të frymëmarrjes) mund të rëndohen në qytetet kryesore të Shqipërisë dhe në veçanti, në kryeqytetin e vendit. Pasojë e shtimit të ditëve të nxehta dhe valët e të nxehtëit mund të jenë edhe disa vdekje të shkaktuara nga sëmundje të aparatit kardiovaskular dhe të frymëmarrjes. Si pasojë e reshjeve ekstreme, mund të ketë sëmundje, aksidente dhe dëmtime të lidhura me ujin si dhe cilësinë e tij. Pasojat e ndryshimeve klimatike tek shëndeti, mund të ndikojnë në rritjen e pabarazisë në Shqipëri, ndaj ekziston nevoja për t'i përshtatur dhe përmirësuar kapacitetet ekzistuese në sektorin shëndetësor, për t'u bërë ballë sfidave të ndryshimeve klimatike dhe efekteve që kanë në shëndet. Pasojat e ndryshimeve klimatike në sektorin e shëndetësisë, si edhe masat e mundshme të përshtatjes, janë analizuar sistematikisht në strategjinë "Për përshtatjen e sistemit shëndetësor ndaj ndryshimeve klimatike" (tetor 2011), që është edhe strategjia e parë sektoriale e gjithanshme për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri. Kjo strategji përfshin edhe një plan veprimi, me afate dhe përgjegjësi të përcaktuara. Gjithsesi, zbatimi në praktikë ka mbetur mbrapa dhe do të mbështetet nëpërmjet këtij veprimi prioritar.</p>	
<p>Arsyetimi / objektivat / treguesit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Objektivi 1: Rritja e zbatimit të disa masave shëndetësore të përzgjedhura në lidhje me efektet e ndryshimeve klimatike, me fokus të veçantë tek mbajtja në kontroll e vektorëve të sëmundjeve, masat mbi shëndetin publik dhe gatishmëria për dukuritë e motit ekstrem (valët e motit të nxehtë). <ul style="list-style-type: none"> ○ Treguesi 1.1: Fushatat e lidhura me klimën përfshijnë pasojat që ka klima mbi shëndetin. ○ Treguesi 1.2: Rritja e gatishmërisë për dukuritë e motit ekstrem, nëpërmjet sistemeve të sinjalizimit të hershëm dhe qendrave të kujdesit shëndetësor parësor. ○ Treguesi 1.3: Përmirësimi i masave të mbikëqyrjes dhe parandalimit të sëmundjeve ngjitëse të shkaktuara nga ndryshimet klimatike. 	
<p>Elementet dhe afatet me rëndësi të veprimit prioritar</p>	

<p>1. Ndërgjegjësimi i publikut për efektet që kanë ndryshimet klimatike të shëndeti</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përfshirja e pasojave shëndetësore të ndryshimeve klimatike në fushatat e ndërgjegjësimit në kuadër të veprimit prioritar nr. 6. <p>2. Gatishmëria mbi dukuritë ekstreme të motit të lidhura me klimën</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ofrimi i trajnimeve për profesionistë të përzgjedhur të shëndetit (2013–2021) • Informimi i komuniteteve në kohë dhe sistematikisht për valët e mundshme të të nxehtit. (2012–2021). • Përshtatja e politikave të sektorit shëndetësor për ndërtimin e qendrave shëndetësore. (2015–2021). <p>3. Ndryshimi i klimës dhe sëmundjet vektoriale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbështetje me trajnime dhe informim për Drejtoritë e Shëndetit Publik dhe bashkitë.(2013–2021). • Përshtatja e sistemeve ekzistuese të mbikëqyrjes për sëmundjet vektoriale (2013–2021). • Rritja e kapaciteteve në Institutin e Shëndetit Publik për laboratorin entomologjik dhe kërkimet entomologjike (2013–2021). • Sigurimi i vazhdueshëm i cilësisë së raporteve të reja të mbikëqyrjes dhe vlerësimet e lidhura me të (2014–2021). • Mbështetje e Autoritetit të Ushqimit me trajnime mbi laboratorët e sigurisë ushqimore dhe vlerësimet e rrezikut (2013–2018). • Mbështetje e vazhdueshme për bashkitë dhe drejtoritë e shëndetit publik (2013–2021). 	
<p>Aktorët kryesorë të përfshirë Instituti i Shëndetit Publik Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë Fakulteti i Mjekësisë IGJEUM-i Agjencia e Mjedisit Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare Autoriteti i Ushqimit Drejtoritë e Shëndetit Publik</p>	<p>Burimet Burimet financiare bëhet të ditura pjesërisht në Strategjinë për Përshtatjen për Sektorin e Shëndetësisë. Buxheti për aktivitetet e përzgjedhura në kuadër të këtij veprimi është 145 milionë ALL nga ku 73 milionë ALL do të mbulohet nga buxheti i shtetit.</p>

6.2.11 Veprimi Prioritar nr. 11

<p>Titulli i veprimit prioritar nr. 11 Plan i integruar ndërsektorial për Zonën Bregdetare (PINSZB)</p>	<p>Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë / AKPT-ja</p>
<p>Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar Një plan veprimi për përshtatjen për zonën bregdetare, që merr në konsideratë qasjen për menaxhimin e integruar të zonës, është përgatitur në kuadër të Komunikimit të Tretë Kombëtar (KTK). Plani i integruar ndërsektorial për zonën bregdetare përgatitur nga Ministria përgjegjëse për Zhvillimin Urban dhe AKPT-ja dhe aprovuar nga këshilli territorial në qershor të 2016, është dizenuar duke marrë në konsideratë politikën dhe direktivat evropiane rajonale për menaxhimin e integruar të Zonave Bregdetare të Mesdheut, si dhe duke u fokusuar veçanërisht në përshtatjen e tyre për zonat bregdetare shqiptare. Ky prioritet do të bazohet mbi Planin e Integruar Ndërsektorial të Bregdetit për të realizuar një studim të thelluar që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit, zbutjen dhe mbrojtjen ndaj ndryshimeve klimatike, mbrojtjen nga erozioni bregdetar etj</p>	
<p>Arsyetimi / objektivat / treguesit Sfida e ndryshimeve klimatike duhet trajtuar, ndër të tjera, nëpërmjet qasjeve dhe instrumenteve të mbështetura në ekosistem, si menaxhimi i integruar i zonave bregdetare (MIZB). Këto janë me rëndësi kritike për hedhjen e bazave për menaxhimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm bregdetar, në mbështetje të zhvillimit shoqëroro-ekonomik, larmisë biologjike dhe shërbimeve mjedisore. MIZB-i njihet dhe nxitet gjerësisht, si procesi më i përshtatshëm për të trajtuar ndryshimet klimatike, rritjen e nivelit të detit dhe sfidat e tjera të tanishme dhe afatgjata për bregdetin, krahas përparësive të tjera që ka kundërshtuar qasjeve thjesht sektoriale. Duke nxitur qasjet shumëdisiplinore dhe shumësektoriale për zgjidhjet teknike, mbështet hartimin më tërësor të politikave dhe rritjen e kapaciteteve për përshtatjen brenda institucioneve.</p>	

- Objektivi: Nxitja e mjedisit të duhur të favorshëm për integrimin e përshtatjes në planifikimin kombëtar dhe vendor në zonat bregdetare.
 - Treguesi: Planet vendore hartohen në harmoni me prioritetet/objektivat kombëtarë dhe direktivën e MIZB-it brenda kufizimeve të kapaciteteve njerëzore ekzistuese.

Elementet dhe afatet me rëndësi të veprimit prioritar

Viti i parë

- Prezantimi dhe përshtatja me instrumentet dhe politikat e BE-së në lidhje me ekosistemet dhe larminë biologjike të zonave bregdetare.
- Përforsimi i legjislacionit të lidhur me ndërtimet në zonën bregdetare.

Viti i dytë

- Aktivitete të zhvillimit të kapaciteteve njerëzore në bashkitë bregdetare e ndërthurur me zhvillimin bregdetar dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
- Masa në nivel politikash për ndërtesat.
- Prezantimi i projekteve pilot konkrete me rëndësi për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Viti i tretë

- Vijohet me projektet pilot për zvogëlimin e rrezikut të përmbytjeve/thatësirës në vendbanime, për shkak të pasojave të dukurive të motit ekstrem (lidhet me veprimin prioritar nr. 8).

Aktorët kryesorë të përfshirë

Ministria përgjegjëse për Zhvillimin Urban / AKPT-ja
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Universitetet
OJQ-ët

Shumat maksimale, të ndara sipas viteve për të cilat do të aplikohet për financim:

Buxheti për tre vite në total: 148.5 milionë lekë

- Viti i parë 15 milionë lekë
- Viti i dytë 50 milionë lekë
- Viti i tretë 80 milionë lekë
- Buxheti për vitin e katërt mbetet për t'u vlerësuar.

Për sigurimin e buxhetit do të aplikohet për fonde nëpërmjet donatorëve të ndryshëm, Fondet IPA, një pjesë nga buxheti I shtetit nëpërmjet Fondit Rajonal të Zhvillimit.

Ndërsa sigurimi i fondeve është subjekt bashkëpunimi me donatorët apo me programet financuese, të cilat jo domosdoshmërisht do të përfitohen, më sipër janë shënuar vlerat maksimale të përafërta, për të cilat do të aplikohet për financim. Realizimit i programit të mësipërm do të varet nga sigurimi ose jo, i fondeve. Ndërkohë më poshtë gjendet edhe tabela e hartuar nga Drejtoria e Financës e cila indikon buxhetin e brendshëm, të përcaktuar tashmë, nga ish Ministria e Zhvillimit Urban për vitet 2018-2020, për veprimet prioritare 11 dhe 12. Buxheti i brendshëm, i PBA, lidhet më së tepërmi me shfrytëzimin e burimeve njerëzore.

***Tabela e PBA, e hartuar nga ish Ministria e Zhvillimit Urban**

Njesia	Viti Aktual	Shpenzimet e Planifikuara 2018 - 2020			
		2017	2018	2019	2020
Sasia nr. punonjesish	0	4	4	4	
Totali i Shpenzimeve mijëra lekë	0.0	1,132.0	1,132.0	1,132.0	
Shpenzime për njësi mijëra lekë	0.0	283.0	283.0	283.0	
Sasia % ndryshimit		0	0	0	
Totali i Shpenzimeve % ndryshimit		0	0	0	
Shpenzime për njësi % ndryshimit		0	0	0	

6.2.12 Veprimi Prioritar nr. 12

Titulli i veprimit prioritar nr. 12
Nisma për krijimin e planeve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në nivel bashkie

Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse
Ministria përgjegjëse për Zhvillimin Urban / AKPT-ja

Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar

Njësitë e vetëqeverisjes vendore preken nga efektete të ndryshme të ndryshimeve klimatike, si përmytje, degradim i infrastrukturës, pasoja në furnizimin me ujë dhe energji etj. Edhe pse ka studime sektoriale dhe janë bërë qasjet e para për sektorë si uji, energjia dhe menaxhimi i rrezikut të përmytjeve, ende nuk ka masa të integruara për të tëra këto bashkitë. Në veçanti, ende nuk ka asnjë nxitje dhe korniza për hartimin e planeve vendore për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Gjithsesi, dokumenti rregullues për planin e bregdetit thotë shprehimisht se bashkitë bregdetare duhet të përgatisin plane të përshtatjes për bregdetin. Me mbështetjen e GIZ-it, është publikuar në muajin maj 2015, një vlerësim i vulnerabilitetit dhe një plan veprimi për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për qytetin e Tiranës, si një dokument i parë pilot për të rritur përshtatjen dhe aftësinë përtëritëse ndaj klimës.

Planet lokale për 31 bashki janë ndarë në etapa të ndryshme dhe tashmë kanë arritur fazën e tretë. Planet e përshtatjes së zonave bregdetare do të jenë një element shtesë e planeve të integruara ndërsektoriale. Për të realizuar këto plane, është e nevojshme të ekzistojë një koordinim më i mirë i planifikimit hapësinor, në mënyrë që bashkitë pranë vijës bregdetare t'u rritet aftësia rikuperuese ndaj ndryshimeve klimatike.

Futja e Planit të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike për bashkitë më vulnerabël ndaj ndryshimeve klimatike, mund t'i shtohet planeve lokale dhe do të ketë një impakt pozitiv në përshtatje pas implementimit të tyre.

Arsyetimi / objektivat / treguesit

- Objektivi: Bashkive u jepen kompetencat për masat vendore të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.
 - Treguesi 1: Bashkive u vihet në dispozicion një udhëzues për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimit klimatik në planifikimin e qytetit.
 - Treguesi 2: Zhvillohen kapacitetet njerëzore dhe institucionale të bashkive.
 - Treguesi 3: Fillohen të paktën 10 veprime pilot që synojnë aftësinë ripërtëritëse të qyteteve.

Elementet dhe afatet me rëndësi të veprimit prioritar

Veprimi 1 (fundit i vitit 2018): Ofrohet një udhëzues i cili do t'i ndihmojë bashkitë me njohuri të thjeshta se si të integrojnë konceptet e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në planifikimin e qytetit dhe rregullimin e territorial. Informacioni i dhënë në udhëzues duhet të përdorë njohuritë dhe mësimet e nxjerra nga platforma e BE-së për përshtatjen ndaj klimës.

Veprimi 2 (2019): Aktivitete për rritjen e kapaciteteve, trajnime, shërbime këshillimore.

Në varësi të sigurimit të fondeve, do të vijohet me studimet për zonat e urbanizuara bregdetare.

Veprimi 3. (2020) Projekte pilot për masat vendore të përshtatjes.

Aktorët kryesorë të përfshirë

Ministria përgjegjëse për Zhvillimin Urban (udhëheq)

Bashkitë që bashkëpunojnë në nivel vendor

Burimet Shumat maksimale, të ndara sipas viteve për të cilat do të aplikohet për financim:

Veprimi 1: 27 milionë lekë.

Veprimi 2: 40.5 milionë lekë. Një pjesë e kësaj do të jetë kontribut nga buxheti i shtetit nëpërmjet alokimit të burimeve njerëzore..

Veprimi 3: 135 milionë lekë për projekte pilot vendore (mbështetje nga buxheti i shtetit nëpërmjet fondeve për zhvillimin rajonal), donatorë.

Ndërsa sigurimi i fondeve është subjekt bashkëpunimi me donatorët apo me programet financuese, të cilat jo domosdoshmërisht do të përfitohen, më sipër janë shënuar vlerat maksimale të përfaqësuara, për të cilat do të aplikohet për financim.

Realizimit i programit të më sipër do të varet nga sigurimi ose jo, i fondeve.

* Ndërkohë më poshtë gjendet edhe tabela e hartuar nga Drejtoria e Financës e cila indikon buxhetin e brendshëm të ish Ministrisë së Zhvillimit Urban për vitet 2018–2020, për veprimet prioritetet 11 dhe 12. Buxheti i brendshëm, i PBA, lidhet më së tepërmi me shfrytëzimin e burimeve njerëzore pjesë të Ministrisë së Zhvillimit Urban.

Produkti	X	Studim mbi adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike				
Përshkrimi		Realizimi i nje projekt-studimi mbi adaptimin ndaj kushteve klimatike ne bashkepunim me bashkite sipas Planit Kombetar te pershtatjes ndaj ketyre ndryshimeve				
Objektivat		1) Integrimi i veprimeve te pershtatjes ndaj ndryshimeve klimatike ne Planifikimin Sektorial dhe Vendor 2) Integrimi i veprimeve te pershtatjes ndaj ndryshimeve klimatike ne Planifikimin Sektorial dhe Vendor				
		Njësia	Viti Aktual	Shpenzimet e Planifikuara 2018 - 2020		
			2017	2018	2019	2020
Sasia	nr. punonjesish		0	4	4	4
Totali i Shpenzimeve	mijëra lekë	0.0	1,132.0	1,132.0	1,132.0	1,132.0
Shpenzime për njësi	mijëra lekë	0.0	283.0	283.0	283.0	283.0
Sasia	% ndryshimit		0	0	0	0
Totali i Shpenzimeve	% ndryshimit		0	0	0	0
Shpenzime për njësi	% ndryshimit		0	0	0	0

6.2.13 Veprimi Prioritar nr. 13

Titulli i veprimit prioritar nr. 13 Përshtatja në turizëm	Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Ministritë e linjës
<p>Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar</p> <p>Zona bregdetare përbën një potencial të konsiderueshëm për aktivitete turistike, për shkak të pozitës së favorshme gjeografike (plazhe të mëdha, klimë mesdhetare, burime ujore, peizazhe). Sektori turistik është rritur në mënyrë të konsiderueshme pas vitit 1990.</p> <p>Shqipëria është shndërruar në një destinacion turistik popullor, si pasojë e karakteristikave të papërsëritshme mjedisore (laguna bregdetare, trashëgimi kulturore, peizazhe etj.). Efektet e pritshme të ndryshimeve klimatike në bujqësi do të kenë një ndikim të tërthortë edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë në këtë zonë. Turizmi, si sektori kryesor i konsumit, ka shumë të ngjarë të preket fort nga to. Duke qenë se ushqimi për shumicën e objekteve turistike vjen nga rajonet lokale dhe mbështetet në bujqësi organike, një ndryshim në strukturën e kulturave bujqësore dhe rendimentin e tyre do të prekë edhe sektorin turistik. Priten efekte të ngjashme në formë matrice edhe nga sektorë të tjerë. Megjithëse zhvillimi i turizmit përbën një mundësi shumë të madhe ekonomike për zonën bregdetare, ai mbështetet mbi një bazë burimore të brishtë dhe është i cenusshëm nga ndryshimi, për shembull, kërkesa për burimet energjetike, trajtimi i ujërave të ëmbla dhe atyre të ndotura, efikasiteti energjetik në strukturat e ndërtesave etj.</p>	
<p>Arsyetime / objektivat / treguesit</p> <p>Deri në vitin 2050 kushtet e motit në verë për turizmin priten të ndryshojnë nga vlerësimi “ideale” në atë “të shkëlqyeshme”, dhe stina turistike do të bëhet më e gjatë. Indeksi i rehatisë së turistit (TCI) paraqet vlerën “i mirë” në tetor, “i shkëlqyeshëm” në maj, qershor dhe shtator dhe “ideal” në korrik dhe gusht.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Objektivi 1: Të hartohen objektiva dhe plane të integruara për sektorin e turizmit të cilët pasqyrojnë efektet e ndryshimit klimatike dhe përballimin e tyre. <ul style="list-style-type: none"> ○ Treguesi 1: Krijimi i një grupi teknik pune për ndryshimet klimatike, nën kujdesin e Grupit Ndërmnistror të Punës për Ndryshimet klimatike, do të punojë deri në miratimin e planeve të integruara për turizmin. 	
<p>Elementet dhe afatet me rëndësi të veprimit prioritar</p> <p>Veprimi për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike realizohet në mënyrë ad-hoc, projekt pas projekti. Për pasojë, ekziston nevoja e njohur për rritjen e bashkërendimit ndërmjet rajoneve dhe sektorëve. Kjo mund të arrihet nëpërmjet krijimit të një grupi teknik pune për ndryshimet klimatike.</p> <p>Viti 1</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përcaktohet mandati i grupit të punës për 3 vjet: <ul style="list-style-type: none"> ○ Sigurohet baza ligjore e nevojshme, strategjitë e përgjithshme dhe sektoriale, planet e veprimit etj., të cilët të përfshijnë politikat dhe masat e duhura (viti 1) ○ Përgatitet një strategji sektoriale që merr në konsideratë çështjet klimatike (viti 2 dhe 3) ○ Mbështeten sektorët vendorë dhe kombëtarë që merren me ndryshimet klimatike (viti 3). 2. Rishikimi i strategjive sektoriale në bazë të konstatimeve të grupit të punës (viti 2 dhe 3) <p>Viti 2</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Përmirësime në aktet ligjore e nënligjore për shpërndarjen e ujit ○ Futja e skemave të tarifave ose lejeve të tregtueshme të ujit ○ Zhvillimi i tregut nëpërmjet përmirësimit të logjistikës së duhur. <p>Viti 3</p>	

<ul style="list-style-type: none"> ○ Bashkëpunimin e sektorët e tjerë për sinergji në sektorin bujqësor ○ Rritet roli i shërbimeve këshillimore në bujqësi. Afati 3 vjet	
Aktorët kryesorë të përfshirë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural AKPT-ja Ministria e Financave dhe Ekonomisë Universitetet OJQ-ët	Burimet <ul style="list-style-type: none"> • 81.2 milionë lekë <ul style="list-style-type: none"> ○ Viti i parë 18.75 milionë lekë ○ Viti i dytë 37.5 milionë lekë ○ Viti i tretë 25 milionë lekë

6.2.14 Veprimi Prioritar nr. 14

Titulli i veprimit prioritar nr. 14 Rritja e nivelit të gatishmërisë së mbrojtjes civile dhe të zvogëlimit të rrezikut të fatkeqësive natyrore	Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile Ministria e Brendshme
<p>Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar</p> <p>Në Shqipëri, lumenjtë përbëjnë rrezikun më të madh të përmbytjes në vend. Përmbytjet kanë kryesisht origjinë pluviale dhe ndodhin gjatë muajve nëntor-mars, kur në vend bien 80-85% e reshjeve vjetore. Për shkak të kushteve topografike, përmbytjet ndodhin befas, duke u transportuar nëpërmjet rrjetit hidrologjik lumor për rreth 8-10 orë. Përmbytjet më të mëdha ndodhin në ultësirën perëndimore të vendit, ku lumenjtë derdhen në det, por përmbytje shkaktojnë edhe lumenjtë e vegjël dhe përrenjtë e rrëmbyeshëm. Sipas të dhënave ekzistuese të raportuara nga qeveria shqiptare, përmbytjet kanë prekur 130.000 hektarë tokë bujqësore.</p> <p>Përmbytjet përkeqësohen nga sedimentinë lumenj dhe në kanalet e kullimit. Sipas Sistemit të Inventarit të Fatkeqësive (DesInventar), që ka një inventar prej thajse 4000 rastesh të periudhës 1851 – 2013 në Shqipëri, më shumë se 95% e bashkive janë prekur të paktën një herë nga përmbytjet.</p> <p>Shqipëria është prekur nga përmbytje të mëdha në 1962-63, 1970-71, 2003, 2005, 2009, 2010, 2013, shkurt 2015 dhe në fund, në fillim të muajit janar 2016. Përmbytjet dhe vërshimet nga reshjet përbëjnë 20% të numrit të rasteve gjithsej. Rrethet me më shumë përmbytje dhe vërshime shirash janë Shkodra (160 raste) dhe Lezha (117 raste) në veriperëndim të Shqipërisë.</p> <p>Efekt i madh i përmbytjeve dhe vërshimeve ka qenë në sektorin bujqësor, duke dëmtuar mesatarisht 7.000 hektarë tokë çdo vit. Sasia mesatare e hektarëve të dëmtuar për përmbytje është rreth 300 ha, ku maksimumi është arritur në 20.000 ha në një bashki të vetme gjatë vetëm një përmbytjeje.</p> <p>Ndryshimi klimatik është një faktor shtesë përkeqësues, duke qenë se reshjet e shiut dhe borës në Shqipëri kanë nivelet më të larta të luhatjes në Evropë. Ndryshimi i klimës ka të ngjarë ta rrisë shpeshhtësinë dhe shkallën e përmbytjeve. Reshjet e shiut në të gjithë skenarët kanë të ngjarë të jenë më të mëdha dhe më pak të shpeshta. Krahas kësaj, rritja e niveli të detit dhe dallgët e shkaktuara nga stuhitë pritet t'i shtojnë përmbytjet në zonat bregdetare.</p> <p>Shpeshhtësia e rrezikut të përmbytjes është e lartë në Shqipëri (një rast në çdo gjashtë vjet). Humbjet ekonomike, për shkak të përmbytjeve gjatë 33 viteve të fundit, vlerësohen në 125 bilionë lekë. Parashikimet e Bankës Botërore për Shqipërinë përcaktojnë se ajo është e ekspozuar ndaj një përmbytjeje një në 100 vjet që prek 6% të GDP-së dhe 7% të popullatës.</p> <p>Parashikimi i përmbytjeve mund t'i pakësojë humbjet në jetë njerëzish dhe në humbje ekonomike, nëpërmjet dhënies së paralajmërimit. Vëzhgimet hidrometeorologjike janë thelbësore për zbulimin dhe parashikimin, duke e rritur kështu kohën në dispozicion të kundërpërgjigjes. Sipas standardit të Organizatës Botërore Meteorologjike (OBM), raporti mesatar kosto-përfitim për investimet në zhvillimin dhe fuqizimin e shërbimeve meteorologjike në formën e zvogëlimin të humbjeve ekonomike për Shqipërinë është 1:7.</p> <p>Sa i takon ciklit të duhur të menaxhimit të përmbytjeve, sipas Direktivës së BE-së për Përmbytjet 2007/60/KE, parandalimi (që përfshin masat e mbrojtjes natyrore, mbrojtjen e ndërtesave, mbrojtjen</p>	

teknike nga përmbytyet) është pjesa kryesore e ciklit. Megjithatë, edhe gatishmëria dhe kundërpërgjigja në raste të jashtëzakonshme (informimi, gatishmëria për reagim individual dhe kompensimi, kundërpërgjigja në ngjarje të jashtëzakonshme dhe mbajtja në kontroll e përmbytyeve) janë elemente të rëndësishme, krahas rigjenerimit (mbështetja financiare dhe rindërtimi). Ky veprim prioritar fokusohet te pjesa e gatishmërisë dhe kundërpërgjigjes në ngjarje të jashtëzakonshme, që përfshin edhe shpërndarjen e informacionit, në mënyrë që të vihen në lëvizje reagimet e duhura.

Në Shqipëri, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM) është identifikuar, si struktura kombëtare e monitorimit dhe paralajmërimit për rreziqet natyrore, përfshirë përmbytyet, zjarret në natyrë dhe tërmetet. Rrjeti hidrometeorologjik kombëtar nën kontrollin e IGJEUM-it është rritur në standarde gjatë 4 viteve, pjesërisht me mbështetjen e projektit të GIZ-it “Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor”. Por ende ka nevojë për shumë. Gjithashtu, për një sistem paralajmërimi të hershëm nevojiten modele hidrologjike dhe meteorologjike. Paralajmërimi i hershëm do të përbëjë bazën për ndjekjen e mëpasshme të këtij fenomeni.

Arsyetimi / objektivat / treguesit

Objektivat e këtij veprimi prioritar janë të dyfishta: objektivi i menjëhershëm, për të cilin financimi është siguruar në kuadër të instrumentit IPA 2013, dhe objektivi afatmesëm, i cili mbështetet në strategjinë e IGJEUM-it. Arsyetimi për këtë veprim prioritar është rritja e aftësisë ripërtëritëse nga përmbytyet me sisteme më të mira të paralajmërimit të hershëm dhe mekanizma të parandalimit të fatkeqësive në Shqipëri.

Objektivi konkret është rritja e kapacitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile për të parandaluar dhe kundërpërgjigjur fatkeqësive, deri në fund të vitit 2018.

Një objektiv tjetër është rritja e kapaciteteve të IGJEUM-it në mënyrë që Ministria e Brendshme t’i sigurohet shpërndarje informacioni cilësor dhe të standardizuar në formën e paralajmërimit të hershëm për përmbytyet dhe thatësirën, deri në fund të vitit 2020.

Elementet dhe afatet me rëndësi të veprimit prioritar

1. Mbështetje për përgatitjen e një harte rajonale të rreziqeve të përmbytyeve sipas Direktivës së BE-së për Përmbytyet.
2. Përgatitje e një sistemi të paralajmërimit të hershëm për përmbytyet dhe përmirësimi i komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave me Sistemin Evropian të Ndërgjegjësimit për Përmbytyet (EFAS), deri në fund të vitit 2019.
3. Analizë kosto-përfitim, vendosje prioritetesh dhe financim i masave në fuqizimin e sistemeve të sinjalizimit të hershëm përmbytyeve, deri në fund të vitit 2019.
4. Ndërgjegjësim /dukshmëri / komunikim: të përmirësohet ndërgjegjësimi publik për përmbytyet nëpërmjet informimit për rrezikun, sistemeve të sinjalizimit të hershëm dhe planit që duhen ndjekur në rast situatë të jashtëzakonshme, deri në fund të vitit 2019.
5. Të mbështetet Shqipëria në përgatitjen për anëtarësim në Mekanizmin e Bashkimit Evropian për Mbrojtjen Civile (EUCPM), deri në fund të vitit 2019.
6. Përforsim i kapaciteteve të IGJEUM-it lidhur me ofrimin cilësor dhe të qëndrueshëm të shërbimeve, deri në fund të vitit 2020.
7. Përforsimi i IGJEUM-it lidhur me burimet njerëzore dhe zhvillimin e kapaciteteve
8. Rritja e rolit të Taks Forcës për përshtatjen e ndryshimeve klimatike në nivel qarku, nën drejtimin e Prefektit të Qarkut.

Aktorët kryesorë të përfshirë

Ministria e Brendshme IGJEUM-i

Burimet

Disa prej aktiviteteve të renditura më lart do të financohen nga DBE-ja nëpërmjet instrumentit IPA 2013.

- 337.5 milionë lekë për 2 vjet (që mbulon aktivitetet 1-5)
- 594 milionë lekë (që mbulon aktivitetin 6. Fisha e projektit do të përgatitet nga Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor)
- 270 milionë lekë për një periudhë 5-vjeçare (kjo shifër mbështetet në strategjinë e zhvillimit të IGJEUM-it)
- Mundësitë për financim: Asistencë zyrtare dypalëshe për zhvillim, BB-ja, GCF-ja.

6.2.15 Veprimi Prioritar nr. 15

Titulli i veprimit prioritar nr. 15

“Ndërtimi për rikuperimin e lagunës

Agjencia / Ministria kryesuese përgjegjëse

GEF-i, UNEP-i / Ministria e Turizmit dhe

Kune–Vaini nëpërmjet adaptimit me bazë ekosistemin (EbA)”	Mjedisit
<p>Situata ekzistuese mbi të cilën mbështetet veprimi prioritar</p> <p>Sistemi lagunor Kune–Vaini (KVLS), i vendosur në deltën e lumit Drin–Mat në qarkun e Lezhës, ofron një gamë të gjerë të mirave dhe shërbimeve për komunitetet që jetojnë në afërsi të tillë. Këto komunitete lokale nxjerrin shumicën e të ardhurave të tyre nga peshkimi apo bujqësia, dhe për këtë arsye jetesat e tyre varet nga funksionaliteti i ekosistemeve lagunore.</p> <p>Rritja e shpejtë e numrit të popullsisë dhe varfëria e përhapur në këtë zonë, kanë çuar në një rritje të presionit mbi lagunë, për sa u përket të mirave të shërbimeve të ekosistemit, si dhe për ndryshimet e paplanifikuara në zonën e buferike përreth lagunës. Kjo situatë çon në mbishfrytëzimin e këtyre burimeve natyrore. Përdorimi i paqëndrueshëm i burimeve brenda sistemit lagunor të Kune–Vainit, po shkakton gjithashtu: i) një reduktim në cilësinë dhe sasinë e ujit në lagunë, duke ndikuar në produktivitetin lagunor; ii) një rritje të përmytjeve bregdetare; iii) një rritje të erozionit të dunave të rërës.</p> <p>Efektet e ndryshimeve klimatike do të ndihen edhe në sistemin lagunor të Kune–Vainit, respektivisht me uljen e kapaciteteve të këtij sistemi për të siguruar të mirat e domosdoshme të ekosistemit dhe shërbime për komunitetet lokale.</p> <p>Modelet e klimës kanë parashikuar një reduktim të reshjeve, i cili do të çojë në një rritje të kripësisë së lagunës me efekte të dëmshme mbi peshkimin.</p> <p>Gjithashtu, modelet parashikojnë një rritje të nivelit të detit (deri në 61 cm, deri në vitin 2100), që do të çojë në rritjen e erozionit dhe për rrjedhojë: humbjen e habitatit brenda sistemit lagunor.</p>	
<p>Arsyetimi / objektivat / treguesit</p> <p>Efektet e ndryshimeve klimatike në sistemin lagunor të Kune–Vainit duhet të trajtohen nëpërmjet një sërë ndërhyrjesh me masa përshtatëse, përfshi këtu dhe përshtatjen me bazë ekosistemi. Rikuperimi i ekosistemeve dhe komuniteteve lokale do të realizohet pas aplikimit të një sërë teknikave, nëpërmjet masave infrastrukturore dhe joinfrastrukturore.</p> <p>Tashmë, ka mundësi të kufizuara për të maksimizuar përfitimet e restaurimit të ekosistemit dhe planet e menaxhimit, për të përmirësuar qëndrueshmërinë e ekosistemeve dhe komuniteteve lokale, përkundrejt efekteve negative të ndryshimeve klimatike.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Objektivi 1: Rritja e aftësisë përshtatëse të qeverisjes lokale dhe komuniteteve që jetojnë pranë e sistemit lagunor të Kune–Vainit ndaj ndryshimeve klimatike, duke përdorur një gamë ndërhyrjesh në adaptim, përfshirë adaptimin me bazë ekosistemin. <ul style="list-style-type: none"> ○ Indikator 1.1: Trajnime të zhvilluara mbi adaptimin me bazë ekosistemin (EbA) për përfaqësues lokalë dhe ndërkombëtarë. ○ Indikator 1.2: Prodhimi i udhëzuesve teknikë në zbatimin e veprimeve përshatëse ndaj ndryshimeve klimatike duke përdorur EbA-n. • Objektivi 2: Rritja e aftësisë rikuperuese e lagunës Kune–Vainit, nëpërmjet Adaptimit me bazë Ekosistemin, duke përdorur demonstrimin e praktikave më të mira dhe konkrete të EbA-s, dhe ndërhyrje të tjera për përshtatjen. <ul style="list-style-type: none"> ○ Indikator 2.1: Zbatimi i një sërë ndërhyrjesh përfshirë EbA-n në sistemin lagunor të Kune–Vainit. ○ Indikator 2.2: Krijimi i një strategjie për monitorimin e ndërhyrjeve të EbA-s. • Objektivi 3: Rritja e ndërgjegjësimit të aktorëve lokalë dhe kombëtarë ndaj rreziqeve të ndryshimeve klimatike dhe rikuperimit, nëpërmjet sistemit EbA, për rritjen e rezistencës së komuniteteve lokale ndaj ndryshimit klimatike. <ul style="list-style-type: none"> ○ Indikator 3.1: Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese mbi avantazhet e adaptimit me bazë ekosistemin. 	
<p>Aktorët kryesorë të përfshirë</p> <p>Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (njësi ekzekutive)</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (pjesëmarrëse)</p> <p>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (pjesëmarrëse)</p> <p>Drejtoria e Turizmit (pjesëmarrëse)</p> <p>Universiteti i Tiranës (pjesëmarrës)</p>	<p>Burimet</p> <p>GEF/UNEP-i dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit</p> <p>Buxheti total 242 milionë lekë</p>

6.3 Burimet financiare për planin e përshtatjes

Kostoja totale e nevojshme për zbatimin e planit kombëtar të përshtatjes deri në 2020, është përlogaritur në bashkëpunim me anëtarët e grupit ndërministror të punës, duke bërë edhe një ndarje të burimeve të financimit. Alokimet e buxhetit afatmesëm (2017–2019) janë marrë gjithashtu në konsideratë gjatë kalkulimit të shpenzimeve totale si dhe të burimeve të financimit.

Vlerësimi i kostove për veprimet prioritare është bërë së bashku me anëtarët e grupit të punës. Gjithsesi, nevojat e financimit të NAP-it do të rishikohen pas 2020-ës. Përshtatja është një koncept i ri dhe janë bërë shumë përpjekje të udhëhequra nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të integruar kostot që lidhen me përshtatjen në PBA-n dhe buxhetin qeveritar.

Mobilizimi i burimeve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (NAP) është një çështje e re jo vetëm për Shqipërinë, por edhe në nivel global. Shumë shtete kanë miratuar një proces ose qasje të orientuar në kërkesat dhe rrethanat shoqëruese ndaj financimit të klimës. Në thelb, kjo qasje i referohet një procesi me anë të të cilit një shtet përcakton, përkufizon dhe mobilizon burimet financiare dhe burimet e tjera të nevojshme për kalimin e tij në një rrugë zhvillimi me emetime të ulëta dhe me aftësi rimëkëmbëse ndaj ndryshimeve të klimës.

SKNK&P), i cili ofron udhëzime për një proces të suksesshëm të aksesit ndaj financimit të përshtatjes, duke përfshirë edhe identifikimin e pikave të hyrjes,

a) një përmbledhjeje të mundësive përkatëse në lidhje me burimet e mundshme kombëtare dhe ndërkombëtare për financimin e përshtatjes,

b) identifikimin dhe priorizimin hapave që duhen marrë për të pasur akses ndaj financimit të përshtatjes në vitet e ardhshme dhe inicimi i hartimit të një udhërrëfyesi.

Në total, kosto për zbatimin e NAP-it është përlogaritur afërsisht 11 miliardë lekë (ALL), ose përafërsisht 80 milionë euro.

Kjo kosto është e përlogaritur për 5 veprimet prioritare të NAP-it, të ndara në dy grupe tematike. 1.2 miliardë lekë janë parashikuar për aktivitetet që kanë të bëjnë me veprimtarinë gjithëpërfshirëse të ministrisë dhe kuadrin e zbatimit të planit, ndërsa 9.8 miliardë lekë janë parashikuar për aktivitetet sektoriale dhe ndërsektoriale.

Nga buxheti i përgjithshëm i përlogaritur prej 11 miliardë lekësh, një pjesë e tij prej 2.9 miliardë lekë janë të mbuluara pjesërisht nga buxheti i shtetit (kryesisht përmes burimeve njerëzore) dhe pjesërisht përmes donatorëve, si: EU-ja, SIDA, WB-ja, UNEP-i, UNDP-ja. Boshllëku financiar për veprimet prioritare është përlogaritur në nivelin 10%, ose afërsisht 1 miliard lekë.

Veprimet të cilat kërkojnë më shumë buxhet janë ato të bujqësisë, për vetë natyrën e investimeve infrastrukturore të ndërhyrjeve.

Planifikimet buxhetore të NAP-it për veprimet prioritare për vitet 2017–2020 (në miliona lekë)

Lista e veprimeve	Buxheti total në mln lekë	Buxheti i shteti	Donatorët	Të tjerë	Boshllëku financiar
Veprimet gjithëpërfshirësedhe kuadri i zbatimit					
PA 1	10,800.00	10,800.00	-	-	-
PA 2	16,000.00	-	5,000.00	-	11,000.00
PA 3	150,000.00	4,920.00	49,200.00	-	95,880.00
PA 4	688,000.00	-	688,000.00	-	-
PA 5	93,750.00		50,000.00	43,750.00	-
PA 6	246,000.00		246,000.00	-	-
Veprimet sektoriale dhe					-

ndërsektoriale					
PA7	1,841,500.00	412,000.00	900,000.00	7,500.00	522,000.00
PA8	1,044,500.00	174,000.00	870,500.00	-	-
PA9	4,925,000.00	1,960,000.00	2,965,000.00	-	-
PA10	145,000.00	73,000.00	-	-	72,000.00
PA11	148,500.00	15,000.00	-	-	133,500.00
PA12	202,500.00	13,500.00	-	-	189,000.00
PA13	81,200.00	16,000.00	-	-	65,200.00
PA14	1,201,500.00	243,000.00	958,500.00	-	-
PA15	242,000.00	48,400.00	193,600.00	-	-
Total	11,036,250.00	2,970,620.00	6,925,800.00	51,250.00	1,088,580.00

Tabela 21 – Buxheti total i nevojshëm për zbatimin e NAP-it i ndarë sipas burimeve të financimit

Në figurën 32 jepet ndarja e kostove sipas gupeve tematike. Veprimet prioritare që zbatohen nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit kanë kryesisht të bëjnë me udhëheqjen e procesit të NAP-it, dhe përbëjnë 11% të kostos totale të buxhetit të planifikuar, ndërsa veprimet konkrete përbëjnë 89% të buxhetit.

Figura 32 – Ndarja e buxhetit sipas grupeve tematike

Figura 33 ilustron ndarjen e buxhetit sipas burimeve të financimit. Boshllëku financiar prej 10% i takon kryesisht veprimeve prioritare sektoriale, rrespektivisht PA7, PA10, PA11, PA12 dhe PA13.




Figura 33 – Ndarja e buxhetit sipas kontribuesve

Në një mënyrë ilustruese, ndarja e buxhetit sipas veprimeve prioritare jepet në figurën 34




Figura 34 – Ndarja e buxhetit sipas veprimeve prioritare

6.4 Zhvillimi i kapaciteteve, informimi dhe përfshirja

Kapacitetet adekuat administrative, ndërgjegjësimit publik, shkëmbimi i informacionit, komunikimi dhe angazhimi janë elemente të rëndësishme për rritjen në mënyrë të efektshme të aftësisë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri. Pasqyrimi i nevojave për përshtatje në **institucionet publike dhe organet vendimmarrëse të politikave** është rritur padysim, gjatë viteve të fundit, sidomos nëpërmjet projekteve të ndryshme në lidhje me përshtatjen në disa sektorë shtetërorë (shih kapitullin 7), nevojat institucionale për të arritur progres në harmonizimin me *Acquis*-në e BE-së në fushën e klimës dhe nëpërmjet krijimit të Grupit Ndërmnistror të Punës për Ndryshimet Klimatike.

Kapacitetet institucionale për përshtatjen

Ekziston një nevojë e ngutshme për të zhvilluar dhe mbështetur më tej kapacitetet institucionale dhe për të vendosur bazën për të vepruar, duke u dalë përpara ndryshimeve klimatike në të gjitha politikat sektoriale përkatëse. Kjo vlen në nivel të pushtetit qendror, të administratës rajonale, komuniteteve dhe të sektorit të OJQ-ve. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka treguar gatishmërinë e kësaj ministrie në drejtim të përmirësimit të kapaciteteve institucionale. Decentralizimi (i cili ka filluar në vitin 2000) ka sjellë rritje të përgjegjësive të qarqeve, përfshirë në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe administrimit të burimeve natyrore. Decentralizimi ofron mundësinë për t'i rritur kapacitetet në nivel vendor dhe rajonal, në mënyrë që të minimizohen dhe menaxhohen rreziqet që sjellë ndryshimi klimatik, nëpërmjet politikave dhe masave adekuat të kundërpërgjigjes. Por bashkitë kanë nevojë për mbështetje dhe orientim për një angazhim më të fuqishëm, për përshtatjen ndaj ndryshimit klimatik. Mbështetjen në këtë aspekt e organizon veprimi prioritar nr. 8.

Fuqizimi i ndërgjegjësimit publik

Puna për rritjen e **ndërgjegjësimit publik** për ndryshimin klimatik ka kontribuar pozitivisht në procesin e integritit të çështjeve të ndryshimit klimatik. Por rëndësia e ndryshimeve klimatike ende nuk merr vlerësimin e duhur në opinionin publik. Ndërgjegjësimit klimatik në të gjitha nivelet mbetet i ulët dhe bashkëpunimi ndërmjet të gjitha palëve përkatëse të interesit kërkon fuqizim të mëtejshëm.

Qasjet e ardhshme

Pavarësisht punës së kryer për ndërgjegjësimin dhe komunikimin, trajnimin dhe edukimin e lidhur me ndryshimin klimatik, ka nevojë për ndërhyrje madhore të tjera. Kjo përfshin edhe aktivitetet e zhvillimit të kapaciteteve në nivel qendror dhe vendor, si edhe një strategji komunikimi për çështjet e ndryshimit klimatik, e cila t'u drejtohet nivelit qendror dhe vendor, si edhe palëve publike dhe private të interesit. Kjo qasje përcaktohet në veprimin prioritar nr. 6 (shih shtojcën 1).

Kjo qasje kërkon një strategji gjithëpërfshirëse për zhvillimin e kapaciteteve, punën afruese me publikun dhe angazhimin. Kjo strategji do të mbulojë në veçanti drejtimit e mëposhtme të punës:

1. Zhvillimi i kapaciteteve për institucionet shtetërore

Dhënia e mbështetjes institucionale për rritjen e kapaciteteve në fushën e ndryshimeve klimatike pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;

Përmirësimi i komunikimit ndërmjet institucionet publike dhe shpërndarja e informacioneve klimatike tek ato;

Kryerja e një vlerësimi të nevojave për trajnim dhe dhënia e kontributeve të synuara trajnuese personelit përkatës të institucioneve publike.

2. Punë afruese nëpërmjet institucioneve arsimore

Hartimi i moduleve edukuese për ndryshimin klimatik dhe prezantimi i fushatave në shkollë;

Përfshirja e njohurive për ndryshimet klimatike në programet mësimore përkatëse.

3. Punë afruese dhe angazhimi me shoqërinë civile

Hartimi i një plani veprimi për pjesëmarrjen dhe punën afruese me publikun;

Organizimi i angazhimit dhe debatit publik për aktivitetet e lidhura me përshtatjen;

Fuqizimi i ndërgjegjësimin nëpërmjet fushatave (mediave, organizatave të shoqërisë civile etj.);

Zhvillimi i aktiviteteve konkrete të promovimit (p.sh. nëpërmjet konkurseve, aktiviteteve publike).

4. Shpërndarje e informacionit sektorëve ekonomikë përkatës

Përfshirja e informacioneve klimatike në shërbimet mbështetëse për bujqit.

RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Është krijuar një sistem koherent monitorimi dhe vlerësimi në mënyrë që të sigurohet një arritje efikase dhe efektive e objektivave të strategjisë.

Dokumenti i SKNK&P-ës bazohet në disa strategji sektoriale dhe ndërsektoriale, si dhe plane që parashikojnë në strukturën e tyre monitorimin institucional dhe kuadrin e vlerësimit, me objektiva dhe tregues, sipas një metodologjie specifike dhe institucionet përgjegjëse (tabela20).

Bashkërendimi i përgjithshëm i aktiviteteve në lidhje me strategjinë është përgjegjësi e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. *Grupi i punës në fushën e Ndryshimeve Klimatike*, krijuar në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 155, datë 25.4.2014⁵⁶ dhe i kryesuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, do të vlerësojë çdo vit, përparimin e strategjive kombëtare dhe planeve që lidhen me ndryshimet klimatike dhe që ndodhen në listë. Çdo vit, ministrinë përkatëse do të raportojnë mbi përparimin në përmbushjet e objektivave, sa i përket aspektit cilësor dhe sasior të strategjive dhe planeve përkatëse, si dhe do të informojnë rregullisht Kryeministrin mbi zhvillimet në sektor.

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektoril/ndërsektorial të integruar”, u miratua urdhri i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 34, datë 19.2.2019 “Për ngritjen e sekretariatit teknik, në kuadër të funksionimit të komitetit drejtues sektorial, (KDS) në fushën e mjedisit, klimës dhe menaxhimit të mbetjeve”. Referuar urdhrit nr. 34/2019, Komiteti Drejtues sektorial “Mjedisi, klima dhe menaxhimi i mbetjeve”, drejtohet nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit dhe luan rolin e Komitetit Sektorial të

⁵⁶ Urdhëri i Kryeministrit nr. 155, datë 25.04.2014 “Krijimi dhe Funksionimi i Grupit të Punës Ndërmënor në Fushën e Ndryshimeve Klimatike”

monitorimit të IPA-s për Mjedisin, klimën dhe menazhimin e mbetjeve, për 2 grupet tematike “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike” si dhe “Menaxhimi i mbetjeve të ngurta”.

Së fundi, një vlerësim *ex-post* do të përqendrohet në vlerësimin e përgjithshëm të rëndësisë, efikasitetit, ndikimit dhe qëndrueshmërisë së ndërhyrjeve të strategjisë ndërsektoriale dhe analizës së faktorëve që ndikojnë në efektivitetin dhe ndikimin e strategjisë dhe mësimet e nxjerra. Rezultatet e vlerësimit *ex-post* do të përdoren për planifikim dhe rishikim të veprimeve të masave zbutëse të ndryshimeve klimatike.

Për sa u përket planeve të energjisë PKVEE, institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e tyre janë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe agjencia e saj e varësisë–AKBN-ja, por duke qenë se ajo mbulon të gjithë sektorët, të gjitha ministritë e tjera janë pjesë e zbatimit të tyre.

Tabela 22 – Marrëveshje Monitorimi dhe Vlerësimi (M&E) të krijuara për secilin Plan dhe Strategji të marrë në konsideratë

Dokumenti	Vlefshmëria	Institucioni/M&E	Metodologjia e M&E
Kontributi i Kombëtar i Pikësnyuar (INDC) në kuadrin e UNFCCC-ës	2015-2030	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	E papërcaktuar
Strategjia e Ndërlidhur Mjedisore (SMNS)	2015-2020	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	VKM nr. 1189 datë 18/11/2009 “Mbi rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit mjedisor”
Strategjia Kombëtare për Integrim dhe Zhvillim (SKZHI-II)	2014-2020	DDFFA- Departamenti i Financimeve të Zhvillimit dhe Ndihmës së Huaj	Raportim vjetor (metodologjia e përshkruar në SKZHI II)
NAMA: Zëvendësimi i lëndëve djegëse fosile me mbetje të parrezikshme në industrinë shqiptare të çimentos	2015-2020	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Raportim vjetor në procesin e MRV-ës
NAMA – Mekanizëm Financimi për Eficiencën e Energjisë në Banesa	2015-2020	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (nën përgjegjësinë e Palës Zbatuese të NAMA-s)	Raportim vjetor në procesin e MRV-ës
Plani i Parë i Veprimit në Nivel Kombëtar mbi Eficiencën e Energjisë	2010-2018	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Raportim vjetor sipas Planit
Plani i Veprimit (BER) mbi Burimet e Energjisë së Rinovueshme në Shqipëri	2015-2020	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Raportim vjetor sipas Planit
Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin e Bujqësisë dhe atë Rural (SNBZHR)	2013-2020	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Raportim vjetor sipas Vendimit të Kryeministrit nr. 139, datë 1/07/2010
Programi i Zhvillimit Rural 2014–2020 në kuadrin e Instrumentit të Asistencës Paraanëtarësim (IPARD)	2014-2020	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Raportim vjetor (metodologjia e përshkruar në këtë dokument)
Dokument i politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit (DPSMB)	2016-2020	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Raportim vjetor (metodologjia e përshkruar në Plan)
Strategjia e Sektorit të Transportit dhe Plani i Veprimit (SSTPV)	2016-2020	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	n/a
Plani i Transportit të Qëndrueshëm (TECTQ) – Dokumenti bazë	2016-2020	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Raportim vjetor, treguesit e raportuar në dokument

Aneksi1 – Lista e plotë e dokumenteve të analizuara për Planin e Zbutjes së Ndryshimeve Klimatike

Titulli i Dokumentit	Viti i publikimit
Komunikimi i Parë Kombëtar i Shqipërisë me UNFCCC-ën(KPK)	2002
Raporti i Vlerësimit të Nevojave Teknologjike të Shqipërisë	2005
Komunikimi i Dytë Kombëtar i Shqipërisë në Konferencën e Palëve në kuadrin e Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KDK)	2009
Komunikimi i Tretë Kombëtar i Shqipërisë	2016
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 691, datë 29.7.2015 Mbi aprovimin e strategjisë ndërsektoriale për decentralizimin dhe qeverisjen vendore 2015-2020	2015
Ndryshimet klimatike dhe biodiversiteti në Evropën Juglindore. Ndikimet dhe veprimi i raportit me natyrë teknike	2008
Ndikimet e Ndryshimeve Klimatike: Politikat Publike dhe Perceptimi në Shqipëri	2013
Legjislacioni Mjedisor Kombëtar krahasuar me Legjislacionin Mjedisor të BE-së	2013
Ndryshimet klimatike në Zonat Bregdetare të Mesdheut	2010
Ndryshimet Klimatike në Ballkanin Perëndimor	2012
Transferimi i njohurive dhe nevojat kërkimore për përgatitjen e portofolit të politikave të zbutjes/përshtatjes	2013
Dokument me natyrë teknike i INDC-it për Shqipërinë	2015
Strategjia Ndërsektoriale Mjedisore 2015-2020	2015
Strategjia Kombëtare për integrim dhe zhvillim	Drafti i dytë, 31 korrik 2015
Krijimi dhe funksionimi i Grupit Ndërmintor të Punës në fushën e Ndryshimeve Klimatike	2014
Teknologjia Kombëtare në Shqipëri (Ndryshimet Klimatike)	2013
Udhëzime për Transferimin e Bashkërenduar të Legjislacionit të BE-së në Fushën e Ndryshimeve Klimatike	2014
NAMA Zëvendësimi i lëndëve djegëse fosile me mbetje të parrezikshme në industrinë shqiptare të çimentos	2015
NAMA Mekanizëm Financimi për Eficiencën e Energjisë në Banesa	2014
Plani Kombëtar i Veprimit mbi Eficiencën e Energjisë	2011
SLED (Projekte për shkarkimet e ulëta)	2013
Shqipëria –Projekt për Rimëkëmbjen e Energjisë: P144029 –Raporti i Statusit të Zbatimit të Rezultateve: Sekuenca 02 (Anglisht)	2016
Raporti i Studimit dhe Përmbledhje Joteknike për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe Social të Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP)	2012
Komunikimi i Tretë Kombëtar i Shqipërisë –Skenari Bazë dhe Masat Zbutëse– Raport mbi Analizat e Masave Zbutëse për shkarkimet GES në energji dhe transport	2016
Komunikimi i Tretë Kombëtar i Shqipërisë –Skenari Bazë dhe Masat Zbutëse– Raport mbi Analizat e Masave Zbutëse për shkarkimet GES në Bujqësi dhe LUCF-ë	2016
Plani i Përpunimit të karbonit me nivel të ulët – Shqipëri	2014
Vlerësimi i dobësive klimatike–Një Vlerësim i Dobësive të Ndryshimeve Klimatike dhe Përshtatja në Sektorin Shqiptar të Energjisë Elektrike	2009
Plani i Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme në Shqipëri (BER)	2016
Ndryshimet Klimatike dhe Bujqësia në Shqipëri–Nota e shtetit shqiptar	2011
Raporti i Katërt Vendor në Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Diversitetin Biologjik	2011
Integrimi Mjedisor në Bujqësi dhe Progresin Pyjor dhe Perspektivat në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore Volumi II SHQIPËRIA Shqyrtim Vendor	2007
Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin e bujqësisë dhe atë rural në Shqipëri	2014
Programi për Zhvillimin Rural 2014-2020, në kuadrin e Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA)	2015
Dokument strategjik i Planit të Veprimit mbi Mbrojtjen e Biodiversitetit	2016

Titulli i Dokumentit	Viti i publikimit
Ligji për pyjet–Fondi kombëtar për administrimin e pyjeve në Republikën e Shqipërisë (draft)	2018
Raporti fillestar i studimit të sektorit mbi ngrohjen me bazë biomase në Ballkanin Perëndimor	2015
Riformatimi i Bujqësisë në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore si Pasojë e Ndikimeve të Ndryshimeve Klimatike dhe Reagimeve të Përshtatura	2013
Ulja e ndjeshmërisë së sistemit bujqësor shqiptar ndaj ndryshimeve klimatike	2013
Raport i Rigjenerimit Natyror të Asistuar të Tokave të Degraduara në Shqipëri	2005-2012
Asistencë Teknike për përgatitjen e Strategjisë së Sektorit të Transportit në Shqipëri–Strategjia Përfundimtare dhe Plani i Veprimit	Draft 0.1 i datës 31 janar 2016
Shqipëria: Plani i Transportit të Qëndrueshëm – Raporti Fillestar	2015
Shqipëria: Rishikimi i Praktikave më të Mira të Planit të Transportit të Qëndrueshëm & Raporti i Objektiveve të Qëndrueshmërisë	2015
Shqipëria: Projektplani i Transportit të Qëndrueshëm	2016

Aneksi2 – Lista e legjislacionit të BE-së për masat zbutëse për GES-in

Skema tregtare e shkarkimeve në BE	
Direktiva 2003/87/EC	Direktiva 2003/87/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 13 tetor 2003 përcakton një skemë për kuotën tregtare të shkarkimit të gazeve serrë brenda Komunitetit, që ndryshon Direktivën e Këshillit 96/61/EC
Direktiva 2004/101/EC	Direktiva 2004/101/ EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 27 tetor 2004, që ndryshon Direktivën 2003/87/EC e cila përcakton një skemë për kuotën tregtare të shkarkimit të gazeve serrë brenda Komunitetit, në lidhje me mekanizmat e projektit të Protokollit të Kiotos
Rregullorja e Komisionit (EC) Nr 2216/2004 e datës 21 dhjetor 2004	Rregullorja e Komisionit (EC) nr.2216/2004 e datës 21 dhjetor 2004 për një sistem të standardizuar dhe të sigurt të regjistrave ndryshuar nga: Rregullorja e Komisionit (EC) nr.916/2007 e datës 31 korrik 2007 dhe Rregullorja e Komisionit (EC) nr.994/2008 e datës 8 tetor 2008 - version i zbatueshëm deri në 31 dhjetor 2011
Rregullorja e Komisionit 2006/780/EC e datës 13 nëntor 2006	Rregullorja e Komisionit 2006/780/EC e datës 13 nëntor 2006 mbi shmangien e numërimit të dyfishtë të shkarkimeve të gazeve serrë, nën skemën tregtare të shkarkimeve të Komunitetit për aktivitete të projektit në kuadrin e Protokollit të Kiotos në përputhje me Direktivën 2003/87/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (bërë me dije në dokumentin me numër C(2006) 5362)
Vendimi i Komisionit 2007/589/EC i datës 18 korrik 2007	Vendimi i Komisionit 2007/589/EC i datës 18 korrik 2007 për vendosjen e udhëzimeve për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve serrë në përputhje me Direktivën 2003/87/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, ndryshuar me Vendim të Komisionit 2009/73/EC dhe Vendimit të Komisionit 2009/339/EC
Direktiva 2009/29/EC	Direktiva 2009/29/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 23 prill 2009 që ndryshon Direktivën 2003/87/EC për të përmirësuar dhe zgjeruar kuotën tregtare të shkarkimit të gazeve serrë të Komunitetit
Vendimi i Komisionit 2010/2/EU i datës 24 dhjetor 2009	Vendimi i Komisionit 2010/2/EU i datës 24 dhjetor 2009 përcakton një listë të sektorëve dhe nënsektorëve të cilët konsiderohen të ekspozuar ndaj një rreziku të konsiderueshëm të rrjedhjes së karbonit, në përputhje me Direktivën 2003/87/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit
Rregullorja e Komisionit (EU) nr. 920/2010 e datës 7 tetor 2010 f	Rregullorja e Komisionit (EU) nr.920/2010 e datës 7 tetor 2010 për një sistem standard dhe të sigurt regjistrash, në përputhje me Direktivën 2003/87/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe vendimit nr.280/2004/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit
Rregullorja e Komisionit (EU) nr. 1031/2010 of 12 nëntor 2010	Rregullorja e Komisionit (EU) nr.1031/2010 i datës 12 nëntor 2010 mbi kohën dhe administrimin, si dhe aspekte të tjera të ankandit të kuotave të shkarkimeve të gazeve serrë, në përputhje me Direktivën 2003/87/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e cila përcakton një skemë për kuotën tregtare të shkarkimit të gazeve serrë brenda Komunitetit
Vendimi i Komisionit 2011/278/EU i datës 27 prill 2011	Vendimi i Komisionit 2011/278/EU i datës 27 prill 2011 përcakton kushte tranzitore për të gjitha sindikatat për dhënie të lirë të fondeve të shkarkimeve, në përputhje me Nenin 10a të Direktivës 2003/87/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit
Rregullorja e Komisionit (EU) Nr 550/2011 e datës 7 qershor 2011	Rregullorja e Komisionit (EU) nr. 550/2011 e datës 7 qershor 2011 për përcaktimin e disa kufizimeve të zbatueshme në përdorimin e kredive ndërkombëtare nga projekte që lidhen me gazet industriale, në përputhje me Direktivën 2003/87/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit
Vendimi i Komisionit 2011/745/EU i datës 11 nëntor 2011	Vendimi i Komisionit 2011/745/EU i datës 11 nëntor 2011 që ndryshon vendimet 2010/2/EU dhe 2011/278/EU që kanë të bëjnë me sektorët dhe nënsektorët të cilët janë të ekspozuar ndaj një rreziku të konsiderueshëm të rrjedhjes së karbonit
Rregullorja e Komisionit Nr 1193/2011 e datës 18 nëntor 2011	Rregullorja e Komisionit nr. 1193/2011 e datës 18 nëntor 2011 krijon një Regjistër të Sindikatave për periudhën e tregtisë duke filluar nga data 1 janar 2013, dhe periudha të mëvonshme tregtare të skemës tregtare të shkarkimeve të Sindikatave në përputhje me Direktivën 2003/87/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe vendimi nr. 280/2004/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit që ndryshojnë Rregulloret e Komisionit (EC) nr. 2216/2004 dhe (EU) nr. 920/2010

Rregullorja e Komisionit 601/2012 e datës 21 qershor 2012	Rregullorja e Komisionit 601/2012 e datës 21 qershor 2012 mbi monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve të gazeve serë në përputhje me Direktivën 2003/87/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit
Vendimi i Komisionit 2012/498/EU i datës 17 gusht 2012	Vendimi i Komisionit 2012/498/EU i datës 17 gusht 2012, Vendimet e ndryshuara 2010/2/EU dhe 2011/278/EU që kanë lidhje me sektorët dhe nënsektorët të cilët janë të ekspozuar ndaj një rreziku të konsiderueshëm të rrjedhjes së karbonit
Rregullorja e Komisionit (EU) 784/2012 e datës 31 gusht 2012	Rregullorja e Komisionit (EU) 784/2012 e datës 31 gusht 2012, që ndryshon Rregulloren (EU) nr. 1031/2010 për të renditur një platformë ankandi e cila do të caktohet nga Gjermania dhe korrigjon Nenin 59(7) prej saj
Rregullorja e Komisionit (EU) nr.1042/2012 e datës 7 nëntor 2012	Rregullorja e Komisionit (EU) nr. 1042/2012 e datës 7 nëntor 2012, që ndryshon Rregulloren (EU) nr. 1031/2010 për të renditur një platformë ankandi e cila do të caktohet nga Mbretëria e Bashkuar
Vendimi nr.377/2013/EU	Vendimi nr.377/2013/EU i Parlamentit Evropian dhe Këshillit, i datës 24 prill 2013 shmang përkohësisht Direktivën 2003/87/EC, krijimin e një skeme për kuotën tregtare të shkarkimit të gazeve serë brenda Komunitetit
Rregullorja e Komisionit EU nr. 389/2013 e datës 5 maj 2013	Rregullorja e Komisionit EU nr.389/2013 e datës 5 maj 2013 për krijimin e një Regjistri të Sindikatave në përputhje me Direktivën 2003/87/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Vendimi nr.280/2004/EC dhe nr.406/2009/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe shfuqizimi i Rregulloreve të Komisionit (EU) nr.920/2010 dhe nr.1193/2011
Vendimi (EU) 2015/1814	Vendimi (EU) 2015/1814 i Parlamentit Evropian dhe Këshillit, i datës 6 tetor 2015 lidhur me krijimin dhe funksionimin e një rezerve të qëndrueshme tregu për skemën tregtare të shkarkimit të gazeve serë të Sindikatës që ndryshon Direktivën 2003/87/EC
Vendimi nr.406/2009/EC	Vendimi nr.406/2009/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit i datës 23 prill 2009 mbi përpjekjen e Shteteve Anëtare për të ulur shkarkimet e tyre të gazeve serë në përbushjen e angazhimeve për uljen e shkarkimit të gazeve serë të Komunitetit, deri në vitin 2020
Vendimi i Komisionit i datës 26 mars 2013	Vendimi i Komisionit i datës 26 mars 2013 mbi përcaktimin e shpërndarjes së shkarkimit vjetor të Shteteve Anëtare për periudhën nga viti 2013 në vitin 2020 në përputhje me Vendimin nr. 406/2009/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit
Direktiva 2009/31/EC	Direktiva 2009/31/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit i datës 23 Prill 2009 mbi depozitimin gjeologjik të dioksidit të karbonit që ndryshon Direktivën e Këshillit 85/337/EEC, Direktivat e Parlamentit Evropian dhe Këshillit 2000/60/EC, 2001/80/EC, 2004/35/EC, 2006/12/EC, 2008/1/EC dhe Rregulloren (EC) nr.1013/2006
Vendimi i Komisionit 2010/670/EU	Vendimi i Komisionit 2010/670/EU që përcakton kriteret dhe masat për financimin e projekteve me demonstrim komercial që synojnë një ambient të sigurt dhe depozitim gjeologjik të CO ₂ si dhe projekte demonstrimi të teknologjive të reja të energjisë së rinovueshme nën skemën për kuotat tregtare të shkarkimit të gazeve serë brenda Komunitetit të përcaktuar nga Direktiva 2003/87/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit
Eficienta e Energjisë	
Direktiva 2012/27/EU	Direktiva 2012/27/EU mbi eficientën e energjisë, që ndryshon në Direktivat 2009/125/EC dhe 2010/30/EU dhe Direktivat e shfuqizuara 2004/8/EC dhe 2006/32/EC.
Direktiva 2010/31/EU	Direktiva 2010/31/EU mbi performancën e energjisë së banesave
Direktiva 2009/28/EC	Direktiva 2009/28/EC mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme që ndryshon dhe më pas shfuqizon Direktivat 2001/77/EC dhe 2003/30/EC.
Rregullorja e Komisionit (EC) nr. 245/2009	Rregullorja e Komisionit (EC) nr. 245/2009 në zbatim të Direktivës 2005/32/EC lidhur me kërkesat e prodhimit të llambave fluoreshente pa balast të integruar, për llamba me intensitet të lartë shkarkimi, dhe për balast dhe abazhurë të aftë të punojnë me të tilla llamba, si dhe Direktiva e shfuqizuar 2000/55/EC
Direktiva 2009/125/EC	Direktiva 2009/125/EC krijon një kuadër për përcaktimin e kërkesave për projektimin ekologjik të produkteve në fushën e energjisë.
Direktiva 2008/28/EC	Direktiva 2008/28/EC që ndryshon Direktivën 2005/32/EC krijon kuadrin e përcaktimit të kërkesave për projektimin ekologjik të produkteve që përdorin energji, si dhe Direktiva 92/42/EEC dhe Direktivat 96/57/EC dhe 2000/55/EC, sa i përket zbatimit të kompetencave të dhëna në Komision
Direktiva 2005/32/EC	Direktiva 2005/32/EC krijon një kuadër për kërkesat me projektim ekologjik të produkteve që përdorin energji dhe që ndryshon Direktivë e Këshillit 92/42/EEC dhe Direktivat 96/57/EC dhe 2000/55/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit
Vendimi i Këshillit 2006/1005/EC	Vendimi i Këshillit 2006/1005/EC lidhur me përfundimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Komunitetit Evropian mbi bashkërendimin e programeve të etiketimit të eficientës së energjisë në produktet e zyrës
Direktiva e Këshillit 93/68/EEC	Direktiva e Këshillit 93/68/EEC që ndryshon Direktivat 87/404/EEC (makina të thjeshta me avull), 88/378/EEC (siguria e lodrave), 89/106/EEC (produkte ndërtimi), 9/336/EEC (përputhshmëria elektromagnetike), 89/392/EEC (makineri), 89/686/EEC (pajisje të mbrojtjes personale), 90/384/EEC (instrumente peshimi joautomatike), 90/385/EEC (pajisje transplantuese mjekësore aktive), 90/396/EEC (pajisje që punojnë me lëndë djegëse dhe gaz), 91/263/EEC (pajisje terminali telekomunikacioni), 92/42/EEC (bojlerë të rinj me ujë të nxehtë që punojnë me lëndë djegëse të lëngshme ose gaz) dhe 73/23/EEC (pajisje elektrike të projektuara të punojnë me një kufi

	të caktuar tensioni).
Direktiva 2006/32/EC	Direktiva 2006/32/EC mbi eficientën e përdorimit fundor të energjisë dhe shërbimet e energjisë dhe shfuqizimi i Direktivave të Këshillit 93/76/EEC
Direktiva 2004/8/EC	Direktiva 2004/8/EC mbi promovimin e bashkëprodhimit bazuar në kërkesat e dobishme për ngrohje në tregun e brendshëm të energjisë që ndryshon Direktivën 92/42/EEC.
Direktiva 2010/30/EU	Direktiva 2010/30/EU mbi treguesit që vijnë nga etiketimi dhe informacioni standard i produktit lidhur me konsumin e energjisë dhe burime të tjera nga produkte të tjera të lidhura me energjinë
Direktiva 2009/28/EC	Direktiva 2009/28/EC mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme dhe Direktivat e ndryshuar dhe më pas të shfuqizuara 2001/77/EC dhe 2003/30/EC.
Direktiva 2001/77/EC	Direktiva 2001/77/EC mbi nxitjen e energjisë së prodhuar nga burimet e energjisë së rinovueshme në tregun e brendshëm të energjisë elektrike
Transporti	
Direktiva 2009/29/EC	DIREKTIVA 2009/29/EC E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT, e datës 23 prill 2009 që ndryshon Direktivën 2003/87/EC në mënyrë që të përmirësojë dhe zgjerojë skemën tregtare të kuotës së shkarkimit të gazeve serrë të Komunitetit
Direktiva 2009/28/EC	Direktiva 2009/28/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 23 Prill 2009 mbi nxitjen e përdorimit të energjisë nga burime të rinovueshme, që ndryshon dhe shfuqizon Direktivat 2001/77/EC and 2003/30/EC
Vendimi 2009/406 EC	VENDIMI Nr 406/2009/EC I PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT i datës 23 prill 2009 mbi përpjekjen e Shteteve Anëtare për të ulur shkarkimet e gazeve serrë me qëllim përmbushjen e angazhimeve të uljes së shkarkimit të gazeve serrë të Komunitetit deri në vitin 2020
Komunikatë 2013/169	LIBRI I GJELBËR A 2030 kuadri për politikën klimatike dhe ato mbi energjinë
Komunikatë 2011/ 112	KOMUNIKATA NGA KOMISIONI I PARLAMENTIT EVROPIAN, KËSHILLI, KOMITETI EVROPIAN PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE DHE SOCIALE DHE KOMITETI PËR RAJONET Një plan për të lëvizur drejt një ekonomie konkurruese me nivel të ulët të karbonit në vitin 2050
Rregullorja 2009/443/EC	Rregullorja (EC) Nr 443/2009 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 23 prill 2009 përcakton standarde të performancës së shkarkimit për makinat e reja për pasagjerë, si pjesë e qasjes së integruar të Komunitetit në uljen e shkarkimeve CO ₂ nga makinat e vogla
Rregullorja 2011/510 /EU	Rregullorja (EU) Nr 510/2011 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 maj 2011 e cila vendos standardet e performancës së shkarkimeve për makinat e reja, të vogla, tregtare si pjesë e qasjes së Integruar të Sindikatës për shkarkimet CO ₂ nga makinat e vogla në detyrë
Rregullorja 2014/253/EU	Rregullorja (EU) Nr 253/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 26 shkurt 2014 Rregullorja e ndryshuar (EU) Nr 510/2011 e cila përcakton modalitetet për arritjen e objektivit të vitit 2020 për uljen e shkarkimeve CO ₂ nga makinat e reja të vogla tregtare
Rregullorja 2014/333/EU	Rregullorja (EU) Nr 333/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 Mars 2014 që ndryshon Rregulloren (EC) Nr 443/2009 për të përcaktuar modalitetet për të arritur objektivat e vitit 2020 në uljen e shkarkimeve CO ₂ nga makinat e reja të pasagjerëve
KOMUNIKATË 2014/ 285 final	Strategjia për uljen e konsumit dhe shkarkimet CO ₂ të makinave të rënda
Vlerësimi i Direktivës 1999/94/EC	Vlerësimi i Direktivës 1999/94/EC i Parlamentit Evropian dhe Këshillit, i datës 13 dhjetor 1999 lidhur me disponimin e informacionit nga konsumatori mbi ekonominë e lëndëve djegëse dhe shkarkimeve CO ₂ në lidhje me marketingun e makinave të pasagjerëve të rinj ('Direktiva mbi etiketimin e makinave')
Direktiva 2009/30/EC	DIREKTIVA 2009/30/EC E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE KËSHILLIT e datës 23 prill 2009 që ndryshon Direktivën 98/70/EC në lidhje me cilësinë e benzinës dhe nënprodukteve të naftës naftës dhe gazolit, si dhe prezantimi i një mekanizmi që monitoron dhe ul shkarkimet e gazeve serrë, që ndryshon Direktivën e Këshillit 1999/32/EC për sa i përket specifikimit të lëndëve të djegshme të përdorura nga anijet që lundrojnë brenda vendit, që shfuqizon Direktivën 93/12/EEC (Direktiva e Cilësisë së Karburantit)
Rregullorja 2015/757/EU	Rregullorja (EU) 2015/757 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 29 prill 2015 mbi monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të dioksidit të karbonit nga transporti detar, që ndryshon Direktivën 2009/16/EC (Rregullorja MRV)
Komunikatë 2011/144 – libri i bardhë	LIBRI I BARDHË Udhërrëfyesi për një Zonë të Vetme të Transportit Evropian – Drejt një sistemi transporti konkurrues dhe burimi efikas
Direktiva 2014/94/EU	Direktiva 2014/94/EU e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit e datës 22 tetor 2014 mbi shpërndarjen e infrastrukturës alternative të karburanteve
KOMUNIKATË 2013/ 913 final (me Aneks)	NJË KONCEPT PËR PLANET URBANISTIKE TË LËVIZJES SË QËNDRUESHME – Së bashku drejt lëvizshmërisë urbane konkurruese dhe me burime efikase
Komunikatë 2009/ 490	Komunikatë nga Komisioni i Parlamentit Evropian, Këshilli, Komiteti Evropian për Çështjet Ekonomike dhe Sociale, Komiteti për Rajonet – Plani i Veprimit mbi Lëvizshmërinë Urbane
Përdorimi i Tokës, Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pyllëzimi	
Vendimi 529/2013/EU	Vendimi Nr 529/2013/EU i Parlamentit Evropian dhe Këshillit i datës 21 maj 2013 mbi rregullat e përgjegjësisë mbi shkarkimet e gazeve serrë dhe përthithësve që rezultojnë nga aktivitetet të cilat lidhen me përdorimin e tokës, ndryshimi i përdorimit të tokës dhe pyllëzimi, si dhe mbi informacionin që lidhet me veprimet e lidhura me këto aktivitete

Aneksi 3 – Dokumenti i financimit të NAP-it

Përmbledhje

Dokumenti financiar shoqëron dokumentin e Planit Kombëtar të Përshtatjes (NAP) dhe do t'i paraqiten së bashku për miratim Këshillit të Ministrave.

Dokumenti i NAP-it ka krijuar një kuadër zbatimi, kryesisht përmes përcaktimit të objektivave dhe synimeve gjithëpërfshirëse, si edhe të 15 veprimeve prioritare. Gjithashtu, dokumenti financiar ofron udhëzime në lidhje me mënyrën e financimit të këtyre veprimeve të propozuara dhe të veprimit për përshtatjen më gjerësisht ndaj ndryshimeve klimatike. Objektivat e dokumentit janë si më poshtë:

a) ofrimi i udhëzimeve për një proces të suksesshëm të aksesit ndaj financimit të përshtatjes, duke përfshirë edhe identifikimin e pikave të hyrjes;

b) dhënia e një përmbledhjeje të mundësive përkatëse në lidhje me burimet e mundshme kombëtare dhe ndërkombëtare për financimin e përshtatjes;

c) Identifikimi dhe dhënia e prioritetit hapave që duhen marrë për të pasur akses ndaj financimit të përshtatjes në vitet e ardhshme dhe inicimi i hartimit të një udhërrëfyese.

Mobilizimi i burimeve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike (NAP) është një çështje e re jo vetëm për Shqipërinë, por edhe në nivel global. Shumë vende kanë miratuar një proces apo qasje të orientuar në kërkesat dhe rrethanat shoqëruese për sigurimin e fondeve të klimës. Shumë shtete kanë miratuar një proces ose qasje të orientuar në kërkesat dhe rrethanat shoqëruese ndaj financimit të klimës. Në thelb, kjo qasje i referohet një procesi me anë të të cilit, një shtet përcakton, përkufizon dhe mobilizon burimet financiare dhe burimet e tjera të nevojshme për kalimin e tij në një rrugë zhvillimi me emetime të ulëta dhe me aftësi rimëkëmbëse ndaj ndryshimeve të klimës. Dokumenti financiar propozon ndjekjen e një qasjeje të ngjashme për Shqipërinë. Meqë situata dhe modalitetet e financimit të përshtatjes janë duke u formuar gradualisht dhe duke ndryshuar në mënyrë të vazhdueshme, qasja kërkon përditësime të rregullta dhe të përsëritura.

Mobilizimi i burimeve për ndërhyrje të përshtatjes së ndryshimeve klimatike është një proces që kërkon vënien në funksionim të disa elementeve kyç:

Elementi 1: Krijimi i procesit – Krijimi i një ekipi kryesor; Elementi 2: Arritja e një mbështetjeje politike të një niveli të lartë; Elementi 3: Metodologjia e vlerësimit për përshtatje – Kuptimi i stimujve financiarë – Komunikimi i përshtatjes në një mënyrë që tërheq financuesit dhe investuesit; Elementi 4: Ndërtimi i kapaciteteve në financimet e klimës dhe sigurimin e burimeve financiare për mobilizimin e burimeve dhe identifikimin e burimeve të mundshme të financimit në planin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë.

Në varësi të tipit dhe kategorisë të masës specifike të planifikuara të përshtatjes, strategjia për identifikimin dhe aksesin në financimin për përshtatjen, si dhe shumat e kërkuara mund të ndryshojnë ndjeshëm. Llogaritjet e kostos përkatëse dhe strategjitë e financimit duhet të marrin parasysh specifikat e kategorive të ndërhyrjeve për përshtatje, për shembull kostoja rritëse e realizimit të mbrojtjes klimatike. Financimi i përshtatjes zakonisht kombinohet me financimin 'bazë' që fokusohet në përfitime më të zgjedhura zhvillimore (ekonomike, sociale, mjedisore).

Dokumenti shqyrton dy burime dhe kanale për aksesin e financimit për përshtatje: 1) buxhetin kombëtar (PBAM) (MTBP); 2) burimet ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh buxhetin kombëtar, duhet të krijohen procese dhe kuadro specifike institucionale, me qëllim integrimin e masave prioritare të NAP-it në procesin e PBAM-it (MTBP). Dokumenti paraqet rekomandime më specifike në këtë drejtim. Çështjet e shqyrtuara janë: a) integrimi i PNK-ut në politikat sektoriale, b) dhënia e prioritetit të masave të propozuara prioritare në PBAM (MTBP) në një qasje me ndarje në faza, c) përpjekje sistematike për ndërtimin/rritjen e kapaciteteve të lidhura me NAP-in (në secilën ministri përkatëse), d) forcimi i koordinimit ndërministror dhe masave institucionale, të tilla si roli dhe mandati i ardhshëm i GNNK-ës (IMWG).

Ekzistojnë shumë burime të mundshme ndërkombëtare të fondeve të përshtatjes që ofrojnë një gamë të gjerë modalitetesh financimi. Granti tradicional dhe financimi i huave plotësohet nga qasje për kombinimin e fondeve private dhe publike (për shembull partneritetet publike-private), ndërsa modalitete më inovative (për shembull pagesa për shërbime mjedisore, siguracionet e rrezikut) janë

testuar aktualisht dhe nuk janë ende gati për të ardhmen afatshkurtër. Megjithatë, kombinimi i këtyre modaliteteve ka shumë të ngjarë të avancojë procesin, me synim përshtatjen e financimit në Shqipëri në planin afatmesëm dhe afatgjatë. Dokumenti jep përshkrime të shkurtra të këtyre modaliteteve dhe shembujve nga aplikimet e tyre fillestare dhe testuese në Shqipëri.

Më tej, dokumenti jep udhëzime për aspekte përkatëse që janë të rëndësishme për t'u shqyrtuar në procesin e identifikimit dhe aplikimit për financim ndërkombëtar të përshtatjes në sektorë të ndryshëm, të tillë si mobilizimi transnacional i burimeve, cilësia e projektpropozimeve dhe aspektet në lidhje me aksesin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në fondet ndërkombëtare.

Gjithashtu, është përgatitur një metodologji që zbaton një qasje me tre komponentë për t'i dhënë prioritet donatorëve dhe financuesve të mundshëm të përshtatshëm:

1. Verifikimi dhe dhënia e prioritetit donatorëve të jashtëm/burimeve të financimit
2. Prioritizimi i PA-ve, Veprimeve Prioritare, duke pasur parasysh gatishmërinë për mobilizimin e burimeve në vitet e ardhshme
3. Kombinimi i PA-ve, Veprimeve Prioritare në bazë të donatorëve të huaj /burimet e financimit.

Zbatimi i hapit 1 rezultoi në një verifikim të më shumë se 40 burimeve të mundshme financuese dhe ndihmoi për prioritetin e tyre, duke pasur parasysh fushat e ndryshme prioritare të NAP-it.

Dokumentu mbyllet me paraqitjen e një udhërrëfyesi (shihni f. 312) që përmbledh hapat dhe masat që kërkohen të vënë në funksionim një mekanizëm efikas, për të identifikuar, aksesuar dhe kanalizuar financimin për masat prioritare të NAP-it, dhe ndërhyrje të tjera të ardhshme të përshtatjes. Fushat e hapave të propozuara janë si më poshtë:

1. Hapat për integrimin e përshtatjes dhe prioritet e NAP-it në PBAM (MTBP) dhe për forcimin e proceseve dhe kuadrove institucionale të lidhura me përshtatjen;
2. Ndërtimi i kapaciteteve në zhvillimin e projekteve, mbrojtja klimatike, planifikimi, programimi, teknikat e llogaritjes së kostos ose analiza për efektivitetin e kostos dhe financimit për klimën;
3. Hapat për krijimin e sistemit monitorues të zbatimit dhe monitorimin e bazuar në rezultate;
4. Identifikimi i projekteve dhe përgatitja e propozimeve;
5. Hapat për krijimin e procesit të mobilizimit të burimeve për financimin e klimës.

Hyrje

Dokumentu financiar shoqëron dokumentin e Planit Kombëtar të Përshtatjes (NAP) dhe do të paraqiten bashkërisht në Këshillin e Ministrave për miratim.


Dokumentu i NAP-it ka krijuar një kuadër zbatimi kryesisht nëpërmjet përcaktimit të objektivave dhe qëllimeve gjithëpërfshirëse, si dhe 15 masave prioritare. Përveç kësaj, Dokumenti Financiar jep udhëzime për mënyrën e financimit më gjerësisht të këtyre masave të propozuara dhe veprimeve të përshtatjes për ndryshimet klimatike. Objektivat e dokumentit janë si më poshtë:

1. Dhënia e udhëzimeve për një proces të suksesshëm për aksesimin e financave të përshtatjes, duke përfshirë identifikimin e pikave hyrëse në këto buxhete;
2. Dhënia e një përmbledhjeje të mundësive përkatëse në lidhje me burimet e mundshme kombëtare dhe ndërkombëtare për financimin e përshtatjes;
3. Identifikimi dhe dhënia e prioritetit të hapave që duhet të merren për aksesin në financimin e përshtatjes në vitet e ardhshme dhe fillimin e përgatitjes së një udhërrëfyesi me hapat përkatëse.

Mobilizimi i burimeve për përshtatjen e ndryshimeve klimatike është një problem i ri jo vetëm për Shqipërinë, por edhe në nivel global. Shumë vende kanë miratuar një qasje të orientuar ndaj procesit ose kërkesave dhe rrethanave shoqëruese për financime të klimës. Në thelb, kjo qasje i referohet procesit me anë të të cilit një vend përcakton, përkufizon dhe mobilizon burime financiare dhe burime të tjera të nevojshme për kalimin e tij në një rrugë zhvillimi me aftësi rimëkëmbëse ndaj klimës dhe emetimeve të ulëta. Dokumenti Financiar propozon miratimin e një qasjeje të ngjashme për Shqipërinë. Meqë situata dhe modalitetet e financimit të përshtatjes janë duke u formuar gradualisht dhe duke ndryshuar në mënyrë të vazhdueshme, qasja kërkon përditësime të rregullta dhe të përsëritura.

- Parimet e ekonomisë së Përshtatjes dhe financimi

- Për shkak të natyrës së masës specifike të planifikuar për përshtatjen, burimet financiare të kërkuara mund të ndryshojnë ndjeshëm.



Burimi: Përshtatur nga Mc Gray et al. (2007)

Figura 1: Tipologjia e masave të përshtatjes – përshtatja si një formë vazhdimësie që trajton faktorët nxitës të cenueshmërisë për përballimin e ndikimeve të ndryshimit të klimës (Burimi: Përshtatur nga McGray 2007 dhe GIZ dhe WRI 2011)

Siç përcakton figura 1, shumë veprime dhe projekte investimesh nuk fokusohen kryesisht në rezultatet e përshtatjes, por në rezultate të tjera kryesore ekonomike, sociale, mjedisore ose të mirëqenies. Llogaritjet e kostos përkatëse dhe strategjitë financuese duket ta kenë këtë faktor parasysh dhe zakonisht, financimi i përshtatjes kombinohet më mirë me financim tjetër ‘bazë’⁵⁷ që fokusohet në përfitime të tjera ose më të zgjeruara.

Termet ‘element shtesë’ dhe ‘element rritës’ përdoren nga instrumente të financimit të klimës, të tilla si: Shërbimi Mjedisor Global (SHMG) (GEF), Fondi i Vendeve më Pak të Zhvilluara (FVPZH) (LDCF), Fondi i Përshtatjes (FP) (AF) për t’u referuar një devijimi nga projektet ‘bazë’. Ky koncept shpesh përdoret si një kriter pranueshmërie ose verifikimi nga fondet e përshtatjes, pra vetëm fondet rritëse sigurohen, nëse financimi bazë ofrohet nëpërmjet një donatori tjetër. Gjithashtu, projektpropozimi duhet të tregojë se komponenti ‘përshtatës’ është thelbësor për suksesin e projektit.

Përveç kësaj, shumë strategji përshtatjeje kryejnë dallimin midis tri kategorive të veprimeve:

Kategoria 1: Stimulimi/përmirësimi i masave ekzistuese dhe të planifikuara

Kategoria 2: Ndryshimi i masave ekzistuese nëpërmjet mbrojtjes klimatike

Kategoria 3: Masat e reja të dedikuara për ndryshimin e klimës.

Gjithashtu, Komunikimi i Tretë Kombëtarë e Shqipërisë identifikon kategori, të tilla si masa të buta të gjelbra (p.sh. përshtatja e bazuar në ekosistem), masa gri/gjysmë të forta (pra, ndërhyrje inxhinierike) dhe masa fiskale për përshtatje.

Për qëllime të mobilizimit të burimeve financiare, elementi shtesë i lidhur me përshtatjen dhe tipi i përshtatjes përkatëse ose kategoria e një mase specifike të planifikuar do të përcaktojnë llojin e financimit të kërkuar dhe qasjen përkatëse për mobilizimin e këtyre burimeve. Çështjet në vijim duhet të trajtohen si pjesë e një qasjeje të tillë:

- A do të duhet që fondet që do të mblidhen të mbulojnë shpenzimet e plota të ndërhyrjes së planifikuar apo vetëm disa pjesë të saj?

- Cili kombinim i investimeve ose fondeve/investuesve është i përshtatshëm për projektin bazë dhe përpjekjen e përshtatjes shtesë?

⁵⁷ <https://climate-exchange.org/2014/07/08/using-official-development-assistance-to-complement-adaptation-funding/>

- A ka qasje, projekte dhe teknologji ekzistuese që mund të përdoren për kanalizimin e financimit të 'ri' të përshtatjes? Si mund të identifikohen ato më mirë?

- A mund të mbështetet/zgjerohet sektori publik në përshtatjen e pavarur ekzistuese nga qytetarët/grupet e qytetarëve, sektori privat, OJF-ët etj.?

Efektiviteti i përshtatjes nuk është gjithmonë proporcional me shumën e financimit ose investimin e përshtatjes

Përshtatja përkufizohet si një përshtatje ndaj stimujve klimatike, pra kushtet klimatike dhe fenomeneve rrjedhuese të motit. Pra, efektiviteti i përshtatjes varet nga cilësia e vlerësimit të ndikimit të ndryshimit të klimës, si dhe nga shkalla dhe përshtatshmëria e procesit për marrjen parasysh të rezultateve të vlerësimit përkatës gjatë planifikimit dhe projektimit të një përpjekjeje për përshtatje.

Çfarë do të thotë kjo për financimin e këtyre përpjekjeve? Për përgjigje ndaj ndryshimeve të klimës, 'vendi' dhe 'mënyra' e aplikimit të një mase shpesh përcakton, nëse një projekt përshtatjeje është i rëndësishëm dhe i përshtatshëm apo jo. Në veçanti, në një mjedis ku fondet janë përgjithësisht të kufizuara dhe aksesit tek fondet është tepër konkurrues, mënyra më e mirë për gjenerimin e një ndikimi më të gjerë është rritja e efektivitetit (pra, arritja e rezultatit duke vepruar siç duhet). Efektiviteti i të njëjtat aktivitet/projekt përshtatjeje mund të rritet ndjeshëm, nëse kryhet 'në kohën e duhur' dhe në 'vendin e duhur.'

Në mungesë të të dhënave të besueshme të ndikimeve të klimës, varfëria është treguesi më i mirë përfaqësues për cenueshmërinë/vulnerabilitetin. Kjo ka rezultuar nga një numër i madh studimesh⁵⁸. Në këtë drejtim duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje çështjes së shenjëstrimit dhe përzgjedhjes së përfituesve. Të varfrit janë shpesh ata që vuajnë më shumë nga ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe si rrjedhojë, duhet t'u jepet prioritet gjatë përzgjedhjes së aktiviteteve dhe vendndodhjeve të projektit, vetëm nëse nuk ka të dhëna se faktorë të ndryshëm nga ata ekonomikë do të përcaktonin vulnerabilitetin në një zonë specifike.

Duke pasur parasysh rezultatet e PNNK-ut (IPCC) AR5⁵⁹, është gjithashtu thelbësore që të theksohet dhe rëndësia politike si pjesë integrale e një mase efektive të përshtatjes. Ndryshimet Klimatike (CC) nuk duhet të transmetohen vetëm si një çështje teknike, por, siç u përmend më lart, është e rëndësishme të thuhet që përshtatja nuk është element shtesë dhe nuk varion shumë nga një projekt i zakonshëm. Ndonjëherë, një ndryshim i vogël i një aktiviteti të 'rregullt' është i mjaftueshëm për mbrojtjen e tyre klimatike ose për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve klimatike.

Kjo do të thotë, për mobilizimin e burimeve të procesit të NAP-it, përveç dhënies së prioritetit të masave të caktuara në NAP, është i nevojshëm një shtjellim më i hollësishëm i aspekteve, të tilla si "ku", "kush" dhe "si" për rritjen e efektivitetit të masave të përshtatjes.

Dimensioni i financimit të kërkuar të përshtatjes

Nevojat financiare mund të ndryshojnë ndjeshëm, në varësi të llojit të masës së përshtatjes që do të financohet. Shpesh bëhet dallim midis përshtatjes transformuese dhe rritëse. Përshtatjet transformuese që nënkuptojnë kalimin e një pragu për ndryshime sistematike (sistemi A transformohet në sistemin B) shpesh kërkojnë investime të mëdha fillestare, me përfitime, ndikimet e eliminuara, të perceptuara mirë vetëm në të ardhmen. Përshtatja rritëse sjell një ndryshim, por ruan karakteristikat kryesore të një sistemi dhe mund të tolerojë rreziqe të mbetura shtesë, por kërkesat financiare mund të rregullohen gradualisht dhe strategjia e ngjashme e mobilizimit të fondeve mund të përdorë arritje fillestare si stimul për investime të ardhshme.

Shpenzimet e veprimeve të përshtatjeve që janë zgjerime ose përpunime të përshtatjeve të bëra më parë mund të llogariten shpesh nga ekstrapolimi, ndërsa shpenzimet e përshtatjeve të reja dhe ndryshimet e vendndodhjeve janë të panjohura, por prezumohen të jenë të larta.

Elementët e një Qasjeje të Suksesshme të Mobilizimit të Burimeve Financiare

Procesi i mobilizimit të burimeve për ndërhyrje të përshtatjes kërkon vënien në funksionim të disa elementeve kyç:

Elementi 1: Ndërtimi i procesit – Krijimi i një ekipi kryesor

⁵⁸ <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/22787/9781464806735.pdf>

⁵⁹ <https://www.ipcc.ch/report/ar5/>

GNNK-ja (IMWG) dhe MM-ja (MoE) janë të autorizuar për menaxhimin e procesit të përshtatjes në Shqipëri. Megjithatë, në lidhje me dokumentin financiar detyrat e këtij grupimi duhet të shpjegohen më tej dhe duhet të dakordësohet një strukturë e qartë për bashkëpunim.

Elementi 2: Arritja e një mbështetjeje politike të një niveli të lartë

Mbështetja e nivelit të lartë mund të arrihet nga rekomandimet nga një nivel i lartë qeverisjeje ose nga detyrimet ligjore, edhe në rastet kur vijnë nga një sektor i vetëm. Për të garantuar një angazhim afatgjatë për përshtatje, mund të jetë fillimisht e nevojshme, nga vendimmarrësit politikë ose menaxhimi publik i nivelit të lartë (që tejkalon periudhën legjislativë), rritja e ndërgjegjësimit. Kapitulli 2 do të paraqesë opsione të mënyrës së arritjes së kësaj mbështetjeje dhe udhëheqjen e saj.

Elementi 3: Vlerësimi i situatës në këndvështrimin e përshtatjes - Kuptimi i stimujve-Komunikimi i përshtatjes në një mënyrë që i bën thirrje financuesve/investuesve.

Është shumë e rëndësishme që të kuptohen stimujt politikë dhe financiarë për financuesit/investuesit privatë dhe publikë (kombëtarë dhe ndërkombëtarë) për të investuar në përshtatje, pasi në pamje të parë përshtatja mund të keqinterpretohet vetëm si një kosto shtesë.

Në rastin e sektorit publik, është kryesisht reduktimi i humbjes ose dëmit të shkaktuar nga ngjarje/ndikime të lidhura me klimën dhe ofrimi i shërbimeve publike në lidhje me objektivat socialë, ekonomikë dhe shëndetësorë. Investimi në përshtatje madje, mund të ketë ndikime pozitive në krijimin e vendeve të punës. Megjithatë, edhe sektori privat mund të ketë interes real në investimin e përshtatjes. Argumente, të tilla si rimëkëmbja e zinxhirit të furnizimit, mbrojtja e aseteve produktive, mundësi të reja të tregut ose pajtueshmëria me standardet, mund të jenë stimuj për investimin e fondeve private në përshtatje. Këta stimuj duhet të identifikohen dhe përdoren gjatë komunikimit me financues/investues.

Elementi 4: Ndërtimi i kapaciteteve në financimin për klimën dhe sigurimi i burimeve financiare për mobilizimin e burimeve dhe identifikimin e burimeve të mundshme të financimit për periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

Procesi i vetë mobilizimit të burimeve kërkon sigurim të burimeve njerëzore dhe kapacitete teknike specifike, me qëllim realizimin e aktiviteteve, të tilla si vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve të donatorëve, kuptimi i kërkesave të donatorëve, negocimi me donatorë, vlerësimi dhe identifikimi i burimeve të financimit të përshtatjes.

- Mobilizimi i Fondeve Kombëtare Publike- Integrimi dhe Institucionalizimi i Përshtatjes

Përpjekjet për mobilizimin e fondeve publike lidhen ngushtë me masat rregullatore që rregullojnë mënyrën, sesi politikat e Ndryshimeve Klimatike (CC) integrohen në një mjedis më të zgjeruar institucional, si dhe në procese të administrimit publik në Shqipëri. Ky kapitull jep një përmbledhje të strukturave ekzistuese institucionale për formulimin e politikave, proceset e planifikimit dhe zbatimin. Gjithashtu, jepet një analizë për identifikimin e pikave hyrëse, forcimin e mëtejshëm të institucioneve dhe proceseve përkatëse që do të rregullojnë mobilizimin dhe kanalizimin e fondeve për masat e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

- Masat aktuale institucionale dhe opsionet për forcimin e tyre, me synim aksesin në Fondet Kombëtare Publike

Qeveria e Shqipërisë ka treguar leadership për ndryshimet klimatike nëpërmjet krijimit të Grupit Ndërmintor për Ndryshimet Klimatike (GNNK) (IMWG), të drejtuar nga zëvendësministri i Mjedisit, me 15 anëtarë që përfaqësojnë menaxhimin e nivelit të mesëm të ministrive kryesore të linjës⁶⁰.

Qëllimi i përgjithshëm i GNNK-ës (IMWGCC) është që të koordinojë të gjitha institucionet e përfshira në procesin e zbatimit dhe përshtatjes së Ndryshimeve Klimatike (CC) dhe të lehtësojë integrimin e tyre në mënyrë koherente, në politikat, programet dhe aktivitetet e reja dhe ekzistuese. Kjo lidhet në veçanti me proceset dhe strategjitë e planifikimit të zhvillimit, brenda të gjithë sektorëve përkatës dhe në nivele të ndryshme, sipas rastit. Funkcionet kryesore të Grupit të Punës të Ndryshimeve Klimatike (IMWG) janë: (i) hartimi i politikave dhe strategjive; (ii) koordinimi i

⁶⁰Urdhri i Kryeministrit nr. 155, datë 25.04.2014

institucioneve gjatë zbatimit të strategjive kombëtare dhe planit të ndryshimeve klimatike; (ii) identifikimi i mundësive për të lehtësuar, nxitur, vlerësuar projektet dhe herë pas here, për të shprehur mendimin e tyre për projektidetë dhe propozimet.

Pika e kontaktit për ndryshimet klimatike është Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Ky departament gjithashtu, vepron si sekretariati i grupit ndërministror për ndryshimet klimatike.

Ministritë e linjës dhe bashkitë janë përgjegjëse për formulimin e politikave/rregulloreve (në nivel kombëtar dhe vendor) dhe zbatimin e strategjive përkatëse sektoriale të integruara, në më shumë se 20 programe afatmesme dhe plane financiare vjetore. Përveç kësaj, agjencitë kombëtare, nën mbikëqyrjen e ministrive të linjës, janë përgjegjëse për ekzekutimin dhe monitorimin e buxhetit.

Aktualisht, grupi ndërministror i punës së ndryshimeve klimatike (IMWG) është një ekip teknik në nivel ekspertësh nga të gjitha ministritë pjesëmarrëse, i paraqitur dhe i koordinuar nga departamenti i ndryshimeve klimatike dhe ajrit, pranë Ministrisë së Mjedisit, që mbështet procesin e identifikimit të rreziqeve të klimës dhe procesin e menaxhimit.

Megjithëse Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është udhëheqëse për planet e formulimit dhe zbatimit të politikave të ndryshimeve klimatike (CC), të gjitha institucionet kombëtare dhe të qeverisë vendore janë përgjegjëse për Integrimin e ndryshimeve klimatike (CC), në fushat e tyre përkatëse të politikave, planifikimin, mobilizimin e burimeve financiare, programimin dhe shpenzimin për ndryshimet klimatike (CC) dhe monitorimin.

Dokumenti i NAP-it, nëpërmjet Veprimit Prioritar nr. 1 tregon që drejtimi i vazhdueshëm duhet të sigurojë orientim afatgjatë, siç rekomandohet në Udhëzimet Teknike të NAP⁶¹-it. Për trajtimin e çështjeve të mësipërme, janë të nevojshme të bëhen rregullime ligjore ose nënligjore të lidhura me qasjen institucionale ndaj ndryshimeve klimatike, duke pasur parasysh kuadrin ekzistues institucional për planifikimin strategjik dhe afatmesëm. Kjo, pasi roli i përgjithshëm mbikëqyrës, mobilizimi i burimeve dhe roli monitorues për ndikimin e politikave të ndryshimeve klimatike (CC) në disa sektorë nuk mund të mbulohen siç duhet nga grupi ndërministror i punës së ndryshimeve klimatike ekzistues dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Kuadri Institucional për Planifikim Strategjik dhe Afatmesëm

Kuadri institucional⁶² për planifikim strategjik dhe afatmesëm përcakton përgjegjësi në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, nga poshtë lart dhe anasjelltas. Vendimet bazohen në informacion programatik të lidhur me objektivat strategjike të politikave dhe të integruar në planifikimin e programit të qeverisë. Hierarkia e roleve dhe përgjegjësi të të gjitha strukturave institucionale

⁶¹Referojuni Objektiveve 1 deri 4 të PA nr. 1

⁶²Ligji nr. 9936/2008 (i rishikuar në vitin 2016); Ligji nr. 10296/2010 (i rishikuar në vitin 2015); Udhëzimi i MF-ës nr. 8/2012



Figura 2 Programi i buxhetit afatmesëm – Rishikim Institucional (burimi: ekspert GIZ)
Diagrami i PBAM-it (MTBP) përcakton qartë Departamentin për Zhvillim dhe Mirëqeverisje (DZHM) pranë Kryeministrisë, si autoriteti i përgjithshëm strategjik mbikëqyrës dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si autoritetin e përgjithshëm për mbikëqyrjen dhe monitorimin e buxhetit.

- Mekanizmi i Menaxhimit për Zbatimin e Strategjive Ndërsektoriale

Kuadri aktual ligjor për PBAM-in (MTBP) nuk ofron një ndarje të qartë të detyrave, midis institucioneve që menaxhojnë politika komplekse ndërsektoriale, të tilla si politika të lidhura me ndryshimet klimatike (CC) të financuara nga buxheti i shtetit dhe financimit të huaj, të cilat kërkojnë një shkallë të lartë bashkëpunimi ndërministror. Megjithatë, ligji nr. 10296/2010, neni 8 parashikon bazën ligjore për bashkëpunim: ‘Në zbatimin e programeve që përfshijnë më shumë se një institucion dhe/ose strukturë të sektorit publik, drejtuesit e interesuar do të nënshkruajnë marrëveshje ose udhëzime të ndërsjella për objektin e përgjegjësisë menaxheriale që do të mbajë secili prej tyre’.

Me qëllim finalizimin e procedurave sipas kuadrit të PBAM-it (MTBP), Kryeministri është duke zbatuar masa të reja institucionale që mund të konsolidohen në vite. Aktualisht janë krijuar katër Grupe të Integruara të Menaxhimit të Politikave (GIMP) (IPMG) në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 129/2015, brenda Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) (IPS), të drejtuara nga ministri i ministrisë udhëheqëse respektive, dhe të përbëra nga sekretariatet e përgjithshme të ministrive të linjës. Grupet nëntematike operojnë pranë ministrive kryesore të linjës dhe përbëhen nga drejtues të programeve dhe ekspertë.




Figura 3 Mekanizmi i Integruar i Menaxhimit të Politikave për Zbatimin e Strategjive Ndërsektoriale (Burimi: projektimi individual).

Vendimi i Këshillit të Ministrave ndërhyr në dy nivele të rëndësishme vendimarrjeje, duke respektuar njëkohësisht masat e përgjegjshmërisë sipas skemës së PBAM-it (MTBP), siç vërehet në figurën 3 më lart (vijat me ngjyrë të verdhë). Tre institucionet kyçe, të tilla si Kryeministria (DZHM), Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme përfaqësohen në secilën GIMP (IPMG).

- Rekomandime për Forcimin e Masave Institucionale Afatshkurtra -Afatgjata

Një përmbledhje e avantazheve dhe disavantazheve të qasjeve institucionale të përshkruara më lart, paraqitet në një tabelë në shtojcën 4. Duke pasur parasysh masat institucionale të përshkruara më lart, si dhe pikat e forta dhe ato të dobëta respektive, fazën aktuale të procesit të NAP-it në Shqipëri, si dhe diskutimet gjatë mbledhjes së 7-të të Grupit Ndërmintor të Punës për Ndryshimet Klimatike të mbajtur në datën 21 tetor 2016, janë dhënë rekomandimet e mëposhtme (CC), janë bërë rekomandimet e mëposhtme për një periudhë nga 1 deri 3 vjeçare, për përmirësimin e masave ekzistuese institucionale, në bazë të kuadrit ligjor për planifikim strategjik dhe afatmesëm:

1. Ngritja/ndryshimi i statusit se Grupit Ndërmintor të Punës për Ndryshimet Klimatike në një Grup i Menaxhimit të Politikave të Integruara (GMPI), me qëllim përfitimin nga avantazhet e këtij statusi grupimi (të përshkruar sipas shtojcës 3). Kryetari i GNMP-ës (IPMG) aktuale për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, do të jetë anëtar i GNMP-ës (IPMG) për ndryshimet klimatike;

2. Ngritja e statusit të departamentit të ndryshimeve klimatike në një Sekretariat Teknik të GMPI-së. Krijimi i nëngrupeve tematike brenda secilës ministri të linjës (me pjesëmarrje të paktën e Drejtuesit të Programit dhe ekspertë). Anëtarët aktualë të Grupit Ndërmintor të Punës për Ndryshimet Klimatike mund të veprojnë si drejtues të grupeve nëntematike;

3. Përgatitja dhe Miratimi i VKM-ës për “Integrimin e ndryshimeve klimatike në PBAM (MTBP)”;

4. Përgatitja dhe miratimi i një Udhëzimi të Përbashkët ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM) dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MoF) për “Procedurat për

Integrimin e Ndryshimeve Klimatike në PBAM (MTBP)” dhe garantimine shkëmbimit të informacionit gjatë procesit të ekzekutimit të PBAM-it (MTBP).

- Integrimi i Planit kombëtar të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në Planifikimin e Buxhetit Kombëtar

Integrimi i përshtatjes në sektorë dhe politikat gjithëpërfshirëse zhvillimore janë në thelb të procesit të PKP-ës (NAP), meqë përshtatja efektive është kryesisht jo një aktivitet ‘shtesë’, por duhet të integrohet në politikat sektoriale. Shqipëria ka një sërë kërkimesh shkencore dhe studimesh mbi vulnerabilitetin ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin e bujqësisë dhe energjisë si dhe një strategji sektoriale, si: Strategjia Kombëtare e Shëndetit, Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, Planin Kombëtar Territorial si dhe Planin e Zhvillimit të Bregdetit, në të cilat GIZ-i ka dhënë një mbështetje të madhe në adresimin dhe integrimin e ndryshimeve klimatike në këto plane, nëpërmjet projektit “Përshtatja ndaj ndryshimeve Klimatike për vendet e Ballkanit Perëndimor”.

Qasjet specifike sektoriale nëpërmjet integrimit shpjegohen në kapitullin 6 të dokumentit të NAP-it; objektivat dhe treguesit e lidhur me integrimin dhe financimin e klimës janë mirëpërcaktuar në dokumentin e NAP-it (objektivat 6 deri 12, f. 29). Aktivitetet e hollësishme gjithëpërfshirëse përshkruhen sipas Veprimit Prioritar nr. 2.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim përfshihet në Kuadrin e Politikave Shqiptare, duke reflektuar koston e reformave strukturore në buxhetin kombëtar, dhe përcakton qëllimet dhe objektivat që çdo sektor duhet të ndjekë, duke shërbyer si pikë fillimi për ministritë e linjës për të analizuar dhe realizuar misionet e tyre. Programi i Buxhetit Afatmesëm (PBAM) është një instrument operacional për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe komponent kyç i Sistemit të Planifikimit të Integruar.




Figura 4: Marrëdhëniet ndërmjet Kuadrit të Politikave, Strategjive dhe Buxhetin Kombëtar (burimi: projektimi individual)

Veprimi Prioritar i tretë e NAP-it deklaron: “Shqipëria do të përdorë procesin e NAP-it si një mundësi për dialog të vazhdueshëm për integrimin e ndryshimeve klimatike në planifikimin dhe buxhetimin e zhvillimit kombëtar, si dhe opsionet e politikave fiskale. Qëllimi 1: Aksesimi me sukses në buxhetin publik të Shqipërisë për financimin e zbatimit të NAP-it; Treguesi 1.1: Të dhënat publike dëshmojnë se të paktën një buxhet fillestar publik i Shqipërisë prej 5 milionë USD u shpenzua për zbatimin e NAP-it, deri më 01/2018”⁶³.

Integrimi i procesit të NAP-it në buxhetin kombëtar, duhet të kryhet nëpërmjet programit strategjik dhe buxhetit afatmesëm (PBAM), i cili fillon me përgatitjen nga ministritë e linjës të një rishikimi të politikave të programeve (RPP) për secilin program. Një fokus i rishikimit stimulues është përmirësimi i analizës së koston për njësi për rezultatet. Çdo program pritet të bazohet në një ose më shumë politika specifike që duhet të shprehen qartë në Strategjinë Kombëtare për

⁶³ Ky tregues duhet të rishikohet pas përfundimit të shtojcës 2.

Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), strategjitë sektoriale dhe dokumentin e NAP-it. RPP-ja përgatit një deklaratë politike për secilin program; duke përfshirë një deklaratë misioni, qëllimin e politikës së programit, objektivin e një politike programi dhe standardet e politikës së programit. RPP-ja duhet të jetë e qartë, e kuptueshme dhe duhet të rishikohet periodikisht, p.sh. mbi bazë vjetore.

Komponenti i dytë i procesit të PBAM-it (MTBP) është planifikimi i investimeve dhe shpenzimeve të programit (PISHP). PISHP-i përdoret për alokimin e burimeve midis programeve, dhe bazohet në procesin e RPP-ës. Rezultatet kryesore identifikohen dhe kostoja e tyre llogaritet për secilin program. Kjo kërkon dokumentim të rreziqeve prioritare që mund të pengojnë arritjen e objektivave dhe qëllimeve të secilit program, masat e parashikuara për minimizimin e tyre, si dhe ndikimin përkatës financiar. NAP-i përmbush kërkesat e një plani të menaxhimit të rrezikut dhe është i rëndësishëm për përgatitjen e PISHP-it.



Figura 5: Ndërlidhjet (pikat hyrëse) dhe progresi i deritanishëm (pra, komponentët në ngjyrë portokalli janë realizuar, ndërsa komponentët me ngjyrë bojë qielli duhet të arrihen) midis:

1. Procesit të menaxhimit të rrezikut ndaj ndryshimeve të klimës (MRRNK);
2. Procesit të Planifikimit Strategjik dhe buxhetimit afatmesëm;
3. Ciklit të investimeve të projektit. (Burimi: UNEP 2011 dhe UNDP- GEF 2015)

Tre proceset e mësipërme, konkretisht: (1) Procesi i menaxhimit të rrezikut ndaj ndryshimeve klimatike (2) Procesi i planifikimit strategjik dhe buxhetimit afatmesëm; (3) Cikli i investimeve të projektit, duhet të zhvillohen paralelisht, duke ndjekur hapat vijues. Rezultatet e secilës fazë të procesit të menaxhimit të rrezikut shërbejnë, si kontribute për faza të ndryshme të dy proceseve të tjera të lidhura me planifikimin dhe zbatimin. Secili proces është projektuar në një mënyrë të përsëritur, duke kërkuar masa të rregullta monitoruese, vlerësimi dhe korrigjuese, sipas rastit.

Hapat e paraqitura në ngjyrë portokalli tregojnë progresin e arritur deri tani në integrimin e procesit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në buxhetin kombëtar. Është e qartë se gjatë përgatitjes së dokumentit të NAP-it, disa fusha prioritare janë diskutuar dhe dakordësuar, si dhe janë identifikuar aktivitetet/projektet. Megjithatë, cikli i investimeve të projektit është në fillim, fakt që mund të krijojë vështirësi në mobilizimin e burimeve financiare dhe integrimin e procesit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike brenda buxhetit kombëtar. Grafiku tregon se masat afatshkurtra dhe afatmesme duhet të fokusohen në plotësimin e hapit të dytë dhe të tretë të procesit të menaxhimit të rrezikut ndaj ndryshimeve klimatike, përfundimin e hapit të dytë dhe të tretë të ciklit të investimeve të projektit që nga ana e vet ka çuar në plotësimin e hapit të katërt të procesit të planifikimit - PBAM.

Në realizimin e hapit të katërt të procesit të planifikimit, ministrinë e linjës do të udhëhiqen nga kalendari PBAM dhe institucionet përgjegjëse për procesin e miratuar nga VKM-ja në fillim të çdo viti (Kalendari i PBAM) për periudhën 2017-2019. Përveç kësaj, Procesi i Investimeve të Shpenzimeve të Programit Vjetor (PISHP) në një Institucion të Qeverisë Qendrore do të ndihmojë institucionet që të kuptojnë se përse cikli i investimeve të projektit është i rëndësishëm

që të zhvillohet paralelisht me procesin e menaxhimit të rrezikut ndaj ndryshimeve klimatike. Kërkesa kryesore e PISHP-it është përcaktimi (gjatë muajve maj-qershor) i projekteve që duhet të përfshihen në PBAM me objektivat, aktivitetet, produktet dhe shpenzimet përkatëse. Vetëm projektet e miratuara për financim nga ana e donatorëve/kreditorëve të huaj dhe bashkëfinancimi nga buxheti i shtetit duhet të përfshihen në PBAM-in (MTBP) e tre viteve të ardhshme. Kjo kërkesë përmbushet nëse ciklet e mësipërme zhvillohen në mënyrë paralele pas përfundimit të tri fazave të para të planifikimit strategjik dhe ciklit të buxhetimit (2), si dhe dy fazave të para të ciklit të investimit të projektit (3).

Në bazë të fushave prioritare të identifikuar në dokumentin e NAP-it dhe urdhrin e Kryeministrit për krijimin e grupit ndërministror për ndryshimet klimatike (IMWGCC), si dhe në përbërjen aktuale të programeve buxhetore, 22 programe buxheti afatmesëm u identifikuan dhe analizuan, të cilat u menaxhuan nga ministrinë e linjës të përfshira në procesin e PKP-ës (NAP). Programe të tjera buxhetore mund të identifikohen në të ardhmen në procesin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike (shihni listën e programeve buxhetore në f. 328). Dokumenti i NAP-it identifikoi një qëllim të rëndësishëm dhe tregues ambicioz brenda veprimit prioritar nr. 3:

Objektivi 1: Aksesi i suksesshëm në buxhetin publik të Shqipërisë për financimin e zbatimit të NAP-it.

Treguesi 1.1: Të dhënat publike dëshmojnë se të paktën një shumë fillestare prej 5 milionë USD e buxhetit publik të Shqipërisë u shpenzua për zbatimin e NAP-it deri në janar 2018.

Përveç kësaj, dokumenti i NAP-it ka identifikuar shumë sfida/pengesa dhe fushat përkatëse prioritare për zbutjen e tyre, të tilla si veprimi prioritar nr. 6 “Komunikimi dhe iniciativa për zgjerimin e ofrimit të shërbimeve” dhe fusha të tjera prioritare strategjike ndërsektoriale dhe sektoriale nr. 8 deri nr. 15.

Përvoja e vendeve të tjera ka treguar se procesi i ndërtimit të rimëkëmbjes ndaj ndryshimeve klimatike në ekonomi dhe shoqëri, do të thotë përballje me më shumë sfida, të tilla si qasja e fragmentuar institucionale dhe pengesa rregullatore, burime të pamjaftueshme financiare në nivel vendor për të trajtuar përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, njohuri të pakta për procesin e buxhetimit vjetor dhe afatmesëm, kompleksitet dhe koordinim sektorial të shpenzimeve për ndryshimet klimatike etj. Sfidat për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në paraqitjen e buxhetit vjetor dhe afatmesëm shpjegohen më tej në f. 329.

- Monitorimi i financimeve të klimës

Trajtimi dhe ndjekja e monitorimit të performancës dhe raportimi mbi rezultatet e përshtatjes janë thelbësore për caktimin e prioritetëve, duke udhëhequr zbatimin dhe vlerësimin e progresit drejt përshtatjes (shihni figurën 3: faza e fundit e MNRRK-ës dhe ciklin e planifikimit). Monitorimi dhe raportimi do të duhet të marrin në konsideratë natyrën e larmishme të përshtatjes, përfshijnë gamën e barrierave dhe objektivave socialë, ekonomikë dhe mjedisorë të përshtatjes.

Ky tip i raportimit mund të bazohet në raportet e rregullta të progresit të përshtatjes nga institucionet kryesore qeveritare që ofrojnë elemente të përshtatjes. Veprimi prioritar 4 mbulon monitorimin e ndikimit të klimës, si dhe monitorimin e reagimit në përshtatjen e suksesshme.

Objektivi 1: Vlerësimi i progresit ndaj objektivave të përtëritjes së klimës.

Objektivi 2: Krijimi i një sistemi monitorimi të bazuar në rezultate (MBR) për ndryshimet klimatike.

Dokumentin Tregues Strategjik për IPA II (2014-2020) thekson se asistencë financiare e BE-së duhet të jetë në përputhje me objektivat e politikave të BE-së, duke përfshirë politikën për klimën.

Shpenzimet e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike mund të gjurmohen gjatë ekzekutimit të buxhetit dhe të monitorohen, nëpërmjet miratimit të shenjuesve statistikorë të përcaktuar nga OECD-ja, siç paraqitet në f. 330–331.

Klasifikimi, monitorimi dhe raportimi aktual i buxhetit

Kërkesat e klasifikimit të buxhetit vendosen me ligj dhe përcaktohen nga ministri i Financave, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ato unifikohen me skemën publike të llogarive për të gjitha institucionet qendrore, të qeverisë vendore dhe fondeve të posaçme. Minimalisht, klasifikimet buxhetore mbulojnë klasifikimin ndërqeveritar, klasifikimin administrativ, klasifikimin funksional, klasifikimin e bazuar në programe, klasifikimin sipas burimeve të financimit (shtetërore, vendore, financimi ndërkombëtar) dhe klasifikimin ekonomik. Vendimet politike të qeverisë merren mbi bazë programi. Alokimet miratohen nga njësi administrative, programi dhe kategoria kryesore ekonomike: shpenzime të kapitalit dhe shpenzime rrjedhëse (personeli, interesi financiar, operacionet dhe mirëmbajtja, subvencionet, transfertat për individët). Përbërja kryesore e të ardhurave shtetërore përfshin grante, taksa dhe të ardhura jotatimore.

Të gjitha transaksionet e qeverisë qendrore dhe vendore janë ekzekutuar nga Llogaria e Vetme e Thesarit në Bankën Qendrore, nëpërmjet Sistemit Qeveritar të Informacionit Financiar të administruar nga Departamenti i Thesarit pranë Ministrisë së Financave. Sistemi refuzon çdo shpenzim për të cilin ka alokime të pamjaftueshme. Të gjitha transaksionet kontrollohen nga programet buxhetore dhe klasifikimi institucional, dhe gjurmohen nëpërmjet sistemit elektronik në nivel të detajuar (nivele shtesë: sipas rajoneve, rretheve dhe projekteve dhe deri në 7 shifra të shpenzimeve ekonomike kundrejt 3 shifrave të miratuara me ligj). Një numër i kufizuar i institucioneve vendore dhe qendrore (15 nga 100 institucione) janë përdorues të drejtpërdrejtë të Sistemit Qeveritar të Informacionit Financiar.

Ekzekutimi i buxhetit dhe raportet e monitorimit përgatiten katër herë në vit nga sekretarët e përgjithshëm të ministrive të linjës dhe kryetarët e bashkive dhe i paraqiten Ministrisë së Financave. Brenda një muaji pas përfundimit të periudhës raportuese, Ministri i Financave paraqet raportet e monitorimit dhe zbatimit të buxhetit në Këshillin e Ministrave dhe Kuvend. Këto raporte bazohen në performancë dhe përbëhen nga: performanca financiare e secilit program; produktet e prodhuara nga çdo program; objektivat e arritur nga çdo program.

Gjatë tre viteve të ardhshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të përmirësojë Sistemin Qeveritar të Informacionit Financiar e sistemit ekzistues financiar, në një sistem të ri informacioni të menaxhimit financiar (SIMFSH), duke integruar planifikimin dhe monitorimin afatmesëm, si dhe procesin e menaxhimit të projektit. Kjo ndoshta do të shoqërohet me përmirësimin e klasifikimeve buxhetore.

- Avancimi i procesit për integrimin e fondeve të klimës në PBAM

Menaxhimi i rrezikut të klimës, koordinimi i aktiviteteve dhe kuadrove të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe integrimi i tyre në proceset vendimmarrëse dhe të planifikimit të zhvillimit janë fusha kërkimore dhe përpjekje praktike relativisht të reja. Gjithashtu, përvoja shqiptare nga fusha të tjera, të tilla si çështjet gjinore, ka treguar se integrimi në politikën sektoriale kombëtare dhe PBAM (MTBP) është një proces multidimensional, i vazhdueshëm që kërkon kohë (p.sh. procesi i integritit gjinor në PBAM filloi në vitin 2012, me identifikimin dhe përgatitjen e kuadrit përkatës dhe strukturat institucionale dhe është ende në zhvillim si një qasje pilot).

Ndërsa po punohet drejt rritjes së ndërgjegjësimit midis qeverisë dhe popullatës, me qëllim garantimin e një zbatimi të suksesshëm të politikave të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe masave prioritare të NAP-it, mund të merren në konsideratë hapat e mëposhtëm:

1. Rishikimi/përmirësimi i strategjive aktuale sektoriale dhe lidhja me SKZHI, bazuar në NAP-in për ndryshimet klimatike dhe masat prioritare nr. 2 dhe nr. 6⁶⁴.

2. Përgatitja e rregullimeve të nevojshme.

3. Trajnimi dhe rritja e cilësisë së njohurive të⁶⁵:

- personave kyç të qeverisë qendrore dhe vendore të përfshirë në formulimin e politikave dhe procesin e buxhetimit afatmesëm;

⁶⁴ Objektivat 6 deri 11, faqe 29 dhe treguesi 6.2: Të paktën 1 qasje integruese në vit po përfshihet në një strategji përkatëse sektoriale.

⁶⁵ Duhet të shqyrtohet sipas PA 3 dhe 7

- ekipet teknike që çmojnë vlerësimin e investimeve të projektit, në mënyrë që të kenë kapacitetin për të shqyrtuar ndikimin e ndryshimeve klimatike;
- shkëmbimi i përvojave me qeveri të tjera që kanë qenë të suksesshme në përfshirjen e kostos së reformave strukturore në buxhet, do të ishte tepër i vlefshëm.

4. Procesi aktual i miratimit të projektit kryhet nga Komiteti i Zhvillimit Rajonal (Kryeministria) dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mund të përfshijë një kërkesë për të treguar se ndryshimet e klimës janë marrë në konsideratë për investime në zonat me rrezik të lartë (për zonat e tjera mund të duhen kërkesa më të buta, në varësi të vulnerabilitetit të zonës). Ky proces mund të përfshijë një pyetje të thjeshtë cilësore lidhur me verifikimin e marrjes në konsideratë të ndryshimeve klimatike për programe më të vogla apo programe që nuk pretendohen të jenë të rëndësishme për klimën. Për programe më të mëdha lidhur me klimën, kjo duhet të përfshijë një analizë më rigorozë. Paraqitja e analizës së përmirësimit të klimës në vlerësimin e projektit mund të koordinohet nga Sekretariati i Zhvillimit Rajonal pranë zyrës së Kryeministrit (PMO, me kontribut të përbashkët nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (për çështjet klimatike) dhe Ministrinë e Financave (për çështjet ekonomike).

5. Procesi i gjurmimit dhe monitorimit:

- Sistemin qeveritar i informacionit financiar dhe/ose sistemi i klasifikimit buxhetor mund të përmirësohen (pa ndryshuar parimet kryesore) për të ofruar informacion për shpenzimet klimatike brenda ministrive, qoftë nëpërmjet krijimit të nënprogrameve për ndryshimet klimatike ose nëpërmjet dhënies së detajeve të lidhura me projekte, sipas aktiviteteve të programit/veprimtarisë ose rezultatet. Kjo do të ndihmojë ndjeshëm në të ardhmen e afërt për raportim në BE për përdorimin e fondeve IPA, nga të cilat 20% parashikohen për shpenzimet për përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike dhe do të monitorohen si të tilla. Gjithashtu, mbështetja e buxhetit të BE-së ndaj sektorit mjedisor që mund të bazohet në skemën e rimbursimit për shpenzimet e shkaktuara nga buxheti kombëtar, kërkon monitorim nga afër dhe raportim të shpenzimeve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

- Gjurmimi alternativ i shpenzimeve mund të kryhej nëpërmjet Agjencisë Kombëtare Mjedisore, funksioni kryesor i së cilës është monitorimi mjedisor. Ju lutemi vëreni se ky nuk duhet të jetë burimi kryesor për monitorimin e përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, për shkak se reforma e plotë e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike nuk lidhet me “lejen mjedisore”.

Rekomandohet qasja e mëposhtme integruese:

Faza 1 - Qasja afatshkurtër dhe afatmesme:

Para integritit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në një zhvillim më të gjerë, vendimmarrësit financiarë duan të shqyrtojnë një periudhë demonstrimi për të mësuar për kompleksitetin e procesit, si dhe për të pasur një perceptim të rreziqeve dhe përfitimeve të mundshme prej tij. Do të ishte e parakohshme që brenda sistemit kombëtar të integroheshin opsione të kuptuara jo qartë. Pra, fokusi afatmesëm duhet të vendoset në plotësimin e kuadrit ligjor, duke forcuar strukturat institucionale dhe rritjen e kapaciteteve në të njëjtën kohë me integrimin e masave të përzgjedhura prioritare të NAP-it, nëpërmjet një projekti pilot në një ose dy programe buxhetore ekzistuese⁶⁶ (të barasvlefshme me departamentet e politikave pranë ministrive të linjës dhe një bashkie të ndodhur në një zonë me rrezik të lartë klimatik). Masat prioritare duhet të integrohen eventualisht në nivelin e projekteve ose aktiviteteve sipas programeve ekzistuese.

Institucionet e ‘pilotimit’ duhet të përzgjidhen në bazë të një angazhimi të nivelit të lartë të treguar gjatë përgatitjes së NAP-it dhe performancës së buxhetit të viteve të mëparshme (opinionin nga Ministria e Financave është i rëndësishëm). Institucionet drejtuese do të vazhdojnë të jenë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zyra e Kryeministrit,

⁶⁶ Përzgjedhja duhet të kryhet në përputhje me strategjinë e përzgjedhur sektoriale: shihni treguesin 6.2: Të paktën 1 qasje integruese në vit është duke u përfshirë në një strategji përkatëse sektoriale.

(Fondi Zhvillimit Rajonal dhe zyra e Planifikimi Strategjik) dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Harmonizimi i PBAM-it dhe NAP-it

Dokumenti i NAP-it shërben si një dokument për vlerësimin dhe identifikimin e rrezikut që mund dhe duhet të plotësohet në një plan të përshtatshëm të menaxhimit të rrezikut. Dokumenti i NAP-it parashtron 15 masa prioritare dhe për secilën prej tyre përcaktohen objektivat dhe treguesit, grupet kryesore të interesit dhe identifikohen kërkesat financiare (llogaritje të përafërta).

Përafrimi i një mase prioritare të PKP-ës (NAP) në programin e buxhetit afatmesëm mund të kryhet si më poshtë:

PBAM NAP	Politika	Objektivi	Aktiviteti	Rezultati	Kostoja
- Të paqarta për secilën PA	- X	-	-	-	-
- Objektivat sipas çdo PA	-	- X	-	-	-
- Masa prioritare/elementet thelbësore	-	-	- X	-	-
- Treguesit sipas çdo objektivi	-	-	-	- x	-
- Kostoja PA e ndarë në financim të brendshëm dhe të jashtëm	-	-	-	-	- x

Rekomandimi i mësipërm kryhet duke pasur parasysh punën e kryer deri tani për identifikimin e masave prioritare me të gjitha problemet shoqëruese. Elementët e paraqitur sipas rubrikës së PKP-ës(NAP) shërbejnë si pikë fillimi për procesin e rishikimit dhe orientimin për dialogun ndërmjet anëtarëve të ekipit të programit të MTB-ës për arritjen/përmbushjen e kërkesave të PBAM-it (MTBP).

Nënkuptohet se ky proces është i vështirë dhe varet nga kapacitetet profesionale dhe mbështetja politike e ministrive të linjës, si dhe nga asistenca teknike. Përafrimi/integrimi mund të kryhet një herë për të gjitha ministrinë (avantazhet: përfitimi për shkurtimin e kohës dhe zbatim më të shpejtë të PA-ve; problem të mundshme: cilësia e ulët e planifikimit dhe programimit; probleme komplekse gjatë ekzekutimit dhe monitorimit) ose mund të përgatiten gradualisht mbi bazë pilot⁶⁷ (përfitime potenciale: procesi do të bëhet më i matur, vendimmarrje e saktë, besueshmëri e lartë e procesit, monitorimi paraprak nënkupton identifikimin e mësimëve të nxjerra që do të shërbenin si referencë për qarkullimin, zbatimin me sukses të PKP-ës (NAP) në planin afatgjatë).

Faza 2 – Qasja afatgjatë:

Nëse pas dy vlerësimeve të pavarura (nga institucionet ndërkombëtare), qeveria shqiptare tregon leadership të qëndrueshëm në procesin e integritit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, të shoqëruar me financim thelbësor nga buxheti kombëtar dhe nëse institucionet shqiptare tërheqin me sukses financim ndërkombëtar për projektin përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, atëherë qeveria duhet të marrë parasysh krijimin e një programi të ri multisektorial qeveritar për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, të aksesueshëm nga të gjitha institucionet qeveritare zbatuese dhe më tej, një fond i ri i posaçëm për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike mund të krijohet me ligj të veçantë (sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të menaxhuara nga një agjenci e vetme qeveritare).

⁶⁷ Refferenca ndaj treguesit

- Mobilizimi i fondeve të financimit të përshtatjes nga burime private dhe ndërkombëtare

Mobilizimi i financimit ndërkombëtar, si dhe financimi privat dhe investimet do të duhet të veprojnë paralelisht me krijimin e fondeve publike në nivel kombëtar. Megjithatë, kjo do të kërkojë ngritjen e proceseve specifike dhe ndërtimin e kapaciteteve specifike të mobilizimit të burimeve në të gjitha vitet në vazhdim. Në kuadrin e 15 fushave prioritare (NAP) që do të financohen, duhet të bëhet një dallim i përgjithshëm midis fushave prioritare 1 deri 7, që mbulojnë proceset institucionale dhe të menaxhimit që janë me më pak kosto intensive, dhe fushave prioritare 8 deri 15 të sektorëve specifike që do të kërkojnë investime më të konsiderueshme në infrastrukturë, pajisje dhe teknologji. Fushat prioritare 9 dhe 12 bëjnë përjashtim, pasi fokusohen kryesisht në proceset e planifikimit që janë përsëri me më pak kosto-intensive.

- Gatishmëria e veprimeve prioritare dhe kërkesat për akses në financim

Shumica e fushave prioritare të NAP-it janë në një fazë të hershme të planifikimit të projekteve të tyre dhe si rrjedhojë gatishmëria e tyre e përgjithshme (për projekte investimi shpesh të referuara si 'garanci për sjellje përfitimesh') është e ulët. Deri tani preventivët nuk kanë marrë parasysh parime të rëndësishme të përshtatjes së llogaritjes së koston. Një përmbledhje e preventivëve aktualë jepet më poshtë në dokument. Kjo duhet të korrigjohet në hapat e ardhshëm të planifikimit për t'u bërë gati për financim të jashtëm⁶⁸. Me qëllim përmbushjen e kërkesave të financuesve ndërkombëtarë të përshtatjes që ndryshon qartë sipas fondit të veçantë, propozime të aplikimit të plotë duhet të shqyrtojnë elementet e propozimit të mëposhtëm 'tipik' (zhvillimit):

- Harmonizimi i politikave (kombëtare, sektoriale);
- Procesi i planifikimit, pjesëmarrja dhe transparenca;
- Masa mirëbesimi dhe institucionale;
- Analiza e grupeve të interesit;
- Menaxhimi financiar dhe programatik (duke përfshirë planet e prokurimit);
- Kuadri i rezultateve dhe sistemi i monitorimit dhe vlerësimit;
- Analiza ekonomike (p.sh. analiza e eficiencës dhe efektivitetit të koston) dhe analiza financiare (në veçanti për projektet e investimeve);
- Garanci mjedisore, sociale dhe gjinore.

Për sa u përket masave specifike për një ndërhyrje të përshtatjes, udhëzimet e Fondit të Përshtatjes⁶⁹, Programi Pilot për Ripërtëritjen e Klimës (PPCR)⁷⁰ ose Fondi i Gjellbër i Klimës⁷¹ përcaktojnë disa objektiva dhe rezultate strategjike që duhet të trajtohen në një projekt propozim/aplikim. Meqë këto tre fonde fokusohen specifikisht tek përshtatja dhe midis fondeve më të rëndësishme të përshtatjes, mund të konsiderohen si kërkesa maksimale potenciale. Kjo do të thotë se fonde të tjera (veçanërisht ato që fokusohen qartë në përshtatje) mund të kërkojnë më pak nga këta elemente specifike përshtatjeje në projektim. Në përgjithësi, propozimi duhet të tregojë në shumë mënyra se në cilën mënyrë dhe shkallë trajtojnë rrezikun e identifikuar/ të parashikuar klimatik.

⁶⁸ <http://adaptasiapacific.org/news/attracting-climate-funds-begins-good-project-proposals>

⁶⁹ <http://www.adaptation-fund.org/wp-content/uploads/2015/01/Results%20Frameöork%20and%20Baseline%20Guidance%20final%20compressed.pdf>

⁷⁰ <https://www-cif.climateinvestmentfunds.org/fund/pilot-program-climate-resilience>

⁷¹ http://www.greenclimate.fund/documents/20182/239759/GCF_Concept_Note_User_s_Guide.pdf/64866eea-3437-4007-a0e4-01b60e6e463b

Kostoja e përgatitjes së projektit mund të jetë e konsiderueshme, dhe si rrjedhojë është vendimtare që këto kosto të përfshihen në fazat e hershme të planifikimit dhe bisedimeve me financues/investues potencialë.

Për shkak të kapaciteteve ekzistuese dhe shumës totale që duhet të krijohet, këshillohet që të ndiqet një qasje e bazuar në hapa, pra duke fokusuar përpjekjet në një ose dy fusha prioritare.

Ekzistojnë shumë udhëzime dhe mësim të nxjerra mbi mënyrën sesi të realizohen hapa specifikë të zhvillimit të projekteve të përshtatjes (për shembull USAID-i për Hartimin e Projekteve të Përshtatjes me Garanci Përfitimesh⁷², udhëzimi i PROVIA⁷³-s, përvojat e mbledhura nga Grupi i Punës i Institucioneve të Financimit Evropian për Përshtatje ndaj Ndryshimeve klimatike⁷⁴).

- Identifikimi i financuesve potencialë të përshtatjes dhe instrumenteve të financimit

Si pjesë përbërëse e këtij dokumenti financimi, burime kombëtare dhe ndërkombëtare të financimit publik dhe privat të përshtatjes janë verifikuar për përshtatshmërinë e tyre për financimin e fushave aktuale prioritare dhe masa të tjera të ardhshme të përshtatjes. Identifikimi i financuesve potencialë nuk është një ushtrim i drejtpërdrejtë dhe kriteret specifikë janë përzgjedhur për t'u dhënë prioritet burimeve të financimit që mund të jenë më të mundshme, sesa të tjera për ofrimin e financimit për përshtatje në Shqipëri. Për ta bërë këtë, qasja e mëposhtme me tre komponentë është zbatuar për prioritetin e donatorëve/financuesve të përshtatshëm të mundshëm të përshtatjes:

1. Verifikimi dhe prioriteti i donatorëve të jashtëm/burimeve të financimit.
2. Prioriteti i fushave prioritare, duke pasur parasysh gatishmërinë për mobilizimin e burimeve në vitet e ardhshme.
3. Harmonizimi i fushave prioritare kryesore me donatorë të jashtëm prioritar/burime financimi.

Kjo metodologji e dhënies prioritet është fleksibël, dhe instrumenti i verifikimit mund të përditësohet vazhdimisht. Ajo jep udhëzime për mënyrën sesi duhet të identifikohen donatorë/financues të përshtatshëm të përshtatjes. Kriteret e reja të dhënies prioritetit mund të shtohen lehtësisht dhe rëndësia e kriterëve të veçanta mund të ndryshohet, nëse është e përshtatshme. Është e rëndësishme që të mbahet parasysh se një instrument i tillë për të dhënë prioritet, është vetëm hapi i parë për të kufizuar fondet /financuesit e ardhshëm. Kërkime më të thelluara për kërkesat dhe bisedimet fillestare me financues të mundshëm, duhet të vazhdojnë.

Hapi i dytë i metodologjisë është diskutuar gjatë takimit të 7-të të Grupit Ndërmintor të Punës së Ndryshimeve Klimatike dhe rezultoi në dhënien e prioritetit të veprimeve prioritare 8 dhe 9 (nr. 8: Ujitja me Aftësi Rimëkëmbëse ndaj Ndryshimeve Klimatike, Mbrojtja nga Kullimi dhe Përmbytjet, nr. 9: Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore- përpilimi i planeve të menaxhimit të baseneve ujore). Këto veprime prioritare janë identifikuar, si prioritete për zhvillimin e mëtejshëm të projektit në funksion të tërheqjes së fondeve ndërkombëtare të përshtatjes. Vendimi bazohet në kriteret e mëposhtme:

- a) nivelin e planifikimit ekzistues dhe kapaciteteve zbatuese përkatëse;
- b) nivelin e vulnerabilitetit dhe urgjencës;
- c) nivelin e lidhshmërisë dhe ndërgjegjësimit politik.

- Aspektet që duhet të merren parasysh në procesin e identifikimit

Mobilizimi i Burimeve Ndërkombëtare

Për shkak të financimit aktual dhe situatës politike, opsioni i krijimit dhe kanalizimit të fondeve në nivel transnacional ose rajonal duhet të merret parasysh. Ekzistojnë disa platforma

⁷² <http://adaptasiapacific.org/library/guidelines-designing-bankable-adaptation-projects>

⁷³ http://www.unep.org/provia/Portals/24128/PROVIA_guidance_report_loë_resolution.pdf

⁷⁴

<http://www.ebrd.com/cs/Satellite?c=Content&cid=1395250899650&d=&pagename=EBRD%2FContent%2FDo wnloadDocument>

bashkëpunimi, nëpërmjet të cilave mund të kërkohej financim rajonal, të tilla si ECRAN⁷⁵ (Rrjeti i Aderimit Rajonal Mjedisor dhe Klimatik) ose EUSAIR⁷⁶ (bashkëpunimi sipas Strategjisë së BE-së për Rajonin e Jonit dhe Adriatikut).

Gjithashtu, disa prej agjencive të mundshme të financimit kanë fonde ndërkombëtare dhe rajonale, të tilla si Kuadri i Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF)⁷⁷ ose Fondi Rajonal i Fondit të Përshtatjes.

Cilësia e projektpropozimeve- Ndërtimi i kapaciteteve për përgatitjen e propozimeve cilësore

Në veçanti, duke pasur parasysh proceset konkurruese të përzgjedhjes së projekteve nga financues dhe investues të mundshëm, cilësia e projektpropozimit do të bëhet një faktor thelbësor konkurrueshmërie. Pranohet se në këtë drejtim në Shqipëri, duhet të krijohen nevoja për kapacitete. Aktivitetet për krijimin e fondeve do të duhet të pranojnë këtë fokus në ndërtimin e kapaciteteve. USAID⁷⁸-i, për shembull, thekson dy faktorë suksesi në funksion të zhvillimit të projektit:

1. Subjektet e akredituara kombëtare zbatuese SKZ-ë (nuk duhet të hartojnë vetë projekte përshtatjeje; ato mund të bazohen në njohurinë e organizatave të shoqërisë civile për hartimin e projekteve për veten e tyre. Në këtë kontekst, këto organizata janë më të përshtatshme për hartimin e ndërhyrjeve të përshtatjes në bazë të kushteve vendore.

2. Elementi kryesor për hartimin e projekteve të financueshme të përshtatjes për subjektet e akredituara kombëtare zbatuese SKZ-ë (NIE) është që të kenë një perceptim të plotë të kërkesave të financuesve, në mënyrë që të mund të asistojnë mbështetësit e projekteve gjatë procesit të hartimit dhe vlerësimit.

Aksesi i drejtpërdrejtë kundrejt aksesit të tërthortë

Disa agjenci financimi, të tilla si FGJK-ja (GCF) dhe Fondi për Përshtatje AF⁷⁹ ofrojnë dy mënyra të aksesit në financim, ose nëpërmjet subjekteve të akredituara kombëtare zbatuese (SKZ) (NIE), referuar edhe si akses i drejtpërdrejtë, ose nëpërmjet subjekteve të akredituara shumëpalëshe ose ndërkombëtare; referuar edhe si akses i tërthortë. Deri tani Shqipëria nuk ka ushtruar përpjekje për akreditimin e një SKZ-je (NIE) shqiptare. Për shkak të kërkesave që duhet të përmbushen, mund të ishte i vlefshëm një vlerësim i kujdesshëm i potencialit të institucioneve specifike shqiptare, në vitet e ardhshme. Me qëllim aksesin në këto fonde, Shqipëria mund të mbështetet tek partnerët aktivë ndërkombëtarë të akredituar, dhe si rrjedhojë, të pranueshëm për aksesin dhe menaxhimin e fondeve. Megjithatë, çështja e aksesit të drejtpërdrejtë duhet të shqyrtohet në planin afatgjatë. Aksesi i drejtpërdrejtë mundëson që vendi të forcojë kapacitetin në planifikimin dhe zbatimin e projekteve zbatuese të përshtatjes, si dhe në mobilizimin e financimit të klimës, ndërsa aksesi i tërthortë do të rrezikojë të humbë vazhdimisht këtë mundësi. Ia vlen të përmendet gjithashtu, se shumica e përgatitjes së projektit dhe mbështetjes së gatishmërisë është e vlefshme vetëm për vendet me një SKZ-ë të akredituar⁸⁰.

Instrumentet e financimit

- Huat (koncesionare)

Niveli aktual i borxheve publike të Shqipërisë kufizon huamarrjen nga fonde dhe financues ndërkombëtarë. Kjo zbatohet në përgjithësi, por veçanërisht, për një fushë politike që është relativisht e re, e tillë si përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike.

Përveç kërkesave të huadhënësve potencialë, në funksion të qëndrueshmërisë së borxhit, standardeve të mirëbesimit etj., aktiviteti i huamarrjes do të rregullohet edhe nga prioritetet e qeverisë aktuale. Nëse përshtatja dakordësohet nga drejtues politikë, mundësia për të marrë hua

⁷⁵ <http://www.ecranetwork.org/>

⁷⁶ <http://www.adriatic-ionic.eu/about>

⁷⁷ <https://www.wbif.eu/about-the-wbif>

⁷⁸ http://www.asiapacificadapt.net/sites/default/files/resource/attach/KP6%20Bankable%20Project_FINAL.pdf

⁷⁹ <https://www.adaptation-fund.org/apply-funding/>

⁸⁰ <https://www.adaptation-fund.org/apply-funding/grants/>

nga fondet ndërkombëtare të përshtatjes, të tilla si FGJK-ja (GCF), IFAD-i etj, do të rritet. Këto fonde mund të mbështeten në kushte koncesionare për Shqipërinë.

- Grantet

Grantet për masat e përshtatjes janë të disponueshme nga një gamë e fondeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe donatorët filantropë. Shumë prej këtyre mundësive i nënshtrohen një prej tre proceseve të mëposhtme: a) një procesi konkurrues aplikimi nga i cili aplikimet shqiptare do të ishin në kundërshtim me aplikimet nga vende të tjera; b) fondet e përshtatjes që kanë zarfe ose alokime specifike për Shqipërinë; c) financues/investues (dypalësh) që nuk synojnë specifikisht rezultatet e përshtatjes, por do të ishin të hapur të shtonin objektivat e përshtatjes në portofolin e financimit të tyre ose strategjinë për Shqipërisë. Për mundësinë e parë, cilësia e aplikimit është veçanërisht e rëndësishme dhe si rrjedhojë, kapacitete dhe burime të mjaftueshme janë të nevojshme për përgatitjen e këtyre propozimeve cilësore për përmirësimin e mundësive për akses në këtë financim. Procesi (b) dhe (c) do të kërkonte një proces proaktiv negociimi me donatorë/financues përkatës, për të garantuar që kërkesat dhe kriteret të kuptohen mirë dhe të respektohen, ndërsa sigurohet se përshtatja përkatëse sektoriale dhe nevojat e përfituesit janë përmbushur njëjloj.

Masat e mundshme që duhet të merren në vitet e ardhshme janë si më poshtë:

a) ministritë duhet të punojnë me departamentin e koordinimit të donatorëve të Kryeministritë për shënjestrimin e donatorëve specifike (duke përfshirë përgatitjen e fishave shtesë të projektit);

b) ministritë duhet të ndërtojnë kapacitete për përgatitjen e propozimeve cilësore të lidhura me përshtatjen;

c) ministritë duhet të sigurojnë fonde të përshtatshme për përgatitjen/zhvillimin e projekteve ose asistencë të ngjashme teknike;

d) ministritë duhet të punojnë me Ministrinë për Evropën dhe Punët për të pasur akses në grantet e IPA II / për të orientuar grantet IPA II ndaj objektivave të përshtatjes, në veçanti Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit si pikë kontakti, për të ndikuar në alokimin e burimeve të Fondit Mjedisor dhe IPA II për Klimën. Ushtrimi i një mundësie për të ndikuar në PED (CSP);

e) trajtimi i financuesve që nuk janë të lidhur drejtpërdrejtë me përshtatjen, të interesuar për Shqipërinë dhe sektorët që preken nga ndikimet e ndryshimeve klimatike dhe që theksojnë përfitimet e financimit/investimit në përshtatje (për shembull investimi në një rrugë/infrastrukturë e cila gjendet në një zone që ndikohet nga përmbytjet).

Grantet e asistencës teknike për përgatitjen e projektit

Duke pasur parasysh fazën e hershme të planifikimit të përshtatjes dhe zbatimit në Shqipëri dhe nivelin aktual të kapaciteteve, mundësitë për të marrë grante për ndërtimin e kapaciteteve dhe gatishmëria janë vendimtare si një hap tjetër për vitet e ardhshme.

- Instrumentet inovative të financimit – nxitja e financimit dhe investimit privat

Përveç instrumenteve më tradicionale të financimit të lidhura me ODA-n, ka instrumente të reja financimi që synojnë të tërheqin dhe nxisin investimin në projekte dhe programe me aftësi rimëkëmbëse ndaj ndryshimeve klimatike. Në veçanti, financimi i klimës ka nxitur tregjet financiare dhe ka sjellë disa risi që duhet të hulumtohen dhe testohen më tej, veçanërisht përshtatshmëria e tyre në kontekstin shqiptar. Mjedisi rregullator dhe legjislativ duhet të forcohet dhe përmirësohet më tej që disa prej instrumenteve të bëhen potencialisht burime të konsiderueshme financimi në të ardhmen afatmesme deri afatgjatë.

Këto instrumente janë veçanërisht të rëndësishme për masat prioritare në sektorët prodhues (p.sh. në bujqësi - PA 8, turizëm - PA 12), ku aktorët privatë luajnë rol të rëndësishëm në funksion të Ndryshimeve Klimatike nëpërmjet investimit ose zbatimit të zgjidhjeve me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike.

- Garancitë

FGJK-ja (GCF), për shembull, ofron garanci dhe angazhime në të cilat një garant ndërmerr të përmbushë detyrimet e një huamarrësi ndaj një huadhënësi, në rast të mospërmbushjes së

detyrimeve ose mospagimit nga huamarrësi të detyrimeve të tij, në këmbim të një tarife. Avantazhi është se ky tërheq kapitalin nëpërmjet borxhit në kushte që mund të siguronin fizibilitetin e një projekti dhe lehtëson ose menaxhon rreziqet, ndërsa është e vështirë të caktohet sasia e rreziqeve dhe në institucionet financiare ndërkombëtare përfaqëson të njëjtën shumë të kuotave të financimit si një hua. Sipas gjasave, kjo mund të ishte me interes për një investim që kombinon përfitimet e lehtësimit dhe përshtatjes në Shqipëri.

- Bonot e klimës

Bonot e klimës janë instrumente financiare me të ardhura fikse, të njohura edhe si bono të gjelbra. Ato përdoren për të financuar ose rifinancuar projekte të nevojshme për trajtimin e klimës. Ato variojnë nga feramat/zonat me turbina të erës për prodhimin e energjisë dhe hidrocentralet e impiantet diellore deri tek transporti hekurudhor dhe ndërtimi i mureve detare në qytete të rrezikuara nga rritja e nivelit të detit. Vetëm një pjesë e vogël e këtyre bonove në fakt janë etiketuar si bono të gjelbra ose klimatike nga emetuesit e tyre. Ashtu si bonot normale, bonot klimatike mund të emetohen nga qeveria, banka ose korporatashumëkombëshe. Subjekti emetues garanton shlyerjen e obligacionit brenda një periudhë të caktuar kohe, plus një normë kthimi fikse ose të ndryshueshme.

Përshtatshmëria e këtyre obligacioneve në kontekstin shqiptar duhet të vlerësohet më tej (shihni gjithashtu Inicativën e Obligacioneve të Klimës, 2015), si pjesë e aktiviteteve afatmesme në udhërrëfyes.

- Mikrofinancimi /Unionet kursim-kredi

Mikrofinancimi është një mjet i rëndësishëm për t'u shtrirë tek grupet e popullsisë me të ardhura të ulëta dhe ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NVM-të), veçanërisht në zonat rurale të Shqipërisë. Megjithatë është ende e nevojshme që të krijohet një infrastrukturë e fuqishme ligjore dhe të sigurohet një mjedis i favorshëm për mikrofinancim. Nga sot bankat tregtare nuk operojnë në zonat rurale për disa arsye (Cibuku 2014). Ky boshllëk zgjeron rolin e Unioneve të Kredive dhe Kursimeve.




Figura 6 tregon se shumica e mikrohuave janë përdorur në sektorin bujqësor që është një prej sektorëve kyç të shqyrtuar në dokumentin e NAP-it. Diskutime fillestare me një institucion financiar jobankar⁸¹ janë zhvilluar për eksplorimin e mundësive për integrimin e objektivave të përshtatjes në portofolin e ofruesve.

U identifikuan mundësitë e mëposhtme fillestare:

- Mbrojtja klimatike e produkteve të mikrofinancimit/verifikimi i aplikimeve për hua;
- Disa institucione mikrofinancimi kanë mbulim të përhapur në zonat rurale, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre. Ky mund të ishte një kanal i mundshëm për asistencë teknike për sensibilizimin e fermerëve ruralë dhe NVM-ve bujqësore.

- Kapitali privat

⁸¹FAF

Ekzistojnë stimuj të ndryshëm për investitorët dhe shoqëritë private për të investuar në përshtatje, p.sh. prodhimi i aseteve produktive kundër ndikimeve të përmytjeve, mbrojtja e zinxhirëve të furnizimit.

Ekzistojnë disa iniciativa për rritjen e financimit për NMV-të në Shqipëri. Për shembull, në mars 2016 u krijua Fondi i Financimit Crimson për Shqipërinë⁸² (FFC), një institucion financiar jobankar që do të ofrojë financim zhvillimor për bizneset mikro, të vogla dhe të mesme. FFC-ja Shqipëri është projektuar për të përmirësuar aksesin në financim për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme që kanë marrë shërbime të pamjaftueshme (NMV-të), sipërmarrësit, novatorët, bizneset e zotëruara nga gratë dhe fermerët në Shqipëri, me qëllim katalizimin e zhvillimit të biznesit dhe krijimin e vendeve të punës.

Produktet e FFC-ës do të ndihmojnë NMV-ët me akses të kufizuar financiar në sistemin bankar me anë të:

- Rritjes së likuiditetit të biznesit;
- Financimit të blerjes së pajisjeve, makinerive ose sendeve pasurore për nevojat e biznesit;
- Financimit të shpenzimeve paraprake të zhvillimit.

- Partneriteti publik-privat

Së fundmi, Qeveria e Shqipërisë ka kërkuar të arrijë objektiva kyç kombëtarë të zhvillimit ekonomik, nëpërmjet partneriteteve publike-private (PPP-të). Brenda kontekstit të politikës shqiptare, qëllimet dhe objektivat e PPP-ve janë si më poshtë:

- Të ofrojnë financim brenda kufizimeve të buxhetit dhe shkurtimeve të shpenzimeve publike;
- Të zgjerojnë investimin infrastrukturor si nxitës të zhvillimit ekonomik;
- Të përmirësojnë cilësinë e shërbimit, eficiencën dhe nxitjen e menaxhimit të sektorit publik;
- Të arrijnë eficiencë më të lartë në përdorimin e burimeve me anë të përfshirjes së një partneri privat dhe vlerësimit tregtar të aseteve publike.

PPP-të mund të bëhen një mënyrë më e rregullt financimi, menaxhimi dhe zbatimi të projekteve për arsyet e mëposhtme^{83,84}:

- Interesi dhe entuziazmi për PPP-të brenda ministrive të linjës të infrastrukturës së Shqipërisë, agjencive të sektorit publik dhe veçanërisht, midis udhëheqjes së nivelit të lartë pranë qeverisë, mbetet i lartë. Megjithatë përvoja e mëparshme e Shqipërisë me koncesionet ka qenë e përzier, me disa shembuj të PPP-ve që kanë dështuar, organet e sektorit publik të Shqipërisë ruajnë një nivel relativisht të lartë interesi për vazhdimin e përdorimit të PPP-ve.

- Udhëheqja e qeverisë aktuale shqiptare është e angazhuar si ndaj forcimit të kuadrit të saj të PPP-ve, edhe ndaj ndjekjes së një qëndrimi më proaktiv për përdorimin e PPP-ve për zbatimin e projekteve të përzgjedhura të një rëndësie strategjike për strategjinë e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit.

- Interesi në PPP-të në Shqipëri midis institucioneve financiare dhe investitorëve të sektorit privat paraqitet gjithashtu, relativisht i fuqishëm. Përfaqësues të sektorëve privatë, të tillë si Konfindustria dhe Dhoma Amerikane e Tregtisë, si dhe institucionet financiare ndërkombëtare, të tilla si Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe BERZH-i, çmojnë se, nëse Shqipëria mund të trajtojë boshllëqet aktuale në kuadrin e saj të PP-ve dhe forcimin e zbatimit të përgjithshëm të PPP-ve, do të ketë disa mundësi të reja të rëndësishme investimi për sektorin privat.

- Gjithashtu, donatorët ndërkombëtarë janë përgjithësisht të interesuar për të mbështetur forcimin e kuadrit dhe programit të PPP-ve në Shqipëri. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme, nëse qeveria është duke kërkuar mbështetje financimi për zbatimin e ndonjë prej rekomandimeve të bëra nga ky delegim i PPP-ve.

- PAGESA E SHËRBIMEVE TË EKOSISTEMEVE

Projekti i Shërbimeve Mjedisore' i udhëhequr nga BB-ja (16.8 milionë USD) është duke testuar aktualisht skemat e Pagesës për Shërbimet e Ekosistemeve (PSHE) (PES). Projekti shenjëstron

⁸² <http://www.aadf.org/project/crimson-finance-fund-albania/>

⁸³ <https://blogs.worldbank.org/ppps/stories-field-world-bank-ifc-collaboration-new-ppp-legislation-albania>

⁸⁴ <http://.atrako.gov.al/wp-content/uploads/2015/06/Albanian-ppp-key-aspects2.pdf>

persona në pyje dhe komunitetet e afërme, me përfitime të rritura monetare ose jomonetare nga pylli
b) persona në komunitete të synuara me përfitime të rritura monetare ose jomonetare nga tokat bujqësore.

Zhvillimi i mekanizmave të pagesës për shërbimet e pellgjeve ujëmbledhëse do të mbështesë menaxhimin e qëndrueshëm të peizazhit në zonat rurale, që përgatitnin një qasje inovative të bazuar në treg, në bazë të parimit se ata që përfitojnë nga shërbimet mjedisore duhet të paguajnë personat që i gjenerojnë. Projektimet e mekanizmave si për skemat e pagesave publike dhe private, do të hulumtohen. Ky nënkomponent do të zhvillojë një model që lidh praktikën e përdorimit të tokës me gjenerimin e shërbimeve të ekosistemeve, të tilla si ruajtja e sedimenteve, pastrimi i ujit dhe rrjedhat e ujit, si dhe një plan të përshtatshëm pagese dhe masa nëpërmjet një programi të asistencës teknike, për të ndihmuar fermerët, për të kaluar në praktika të pranueshme të Menaxhimit të Tokës (SML) (LM). Të gjitha këto aktivitete do të sjellin përfitime të përshtatjes në fushat përkatëse.

Përshtatshmëria e këtyre PSHE-ve (PES) për kontekstin shqiptar, duhet të vlerësohet më tej⁸⁵ si pjesë e aktiviteteve afatmesme në udhërrëfyes.

- Sigurimet e rrishtit

Projekti i propozuar i udhëhequr nga Banka Botërore ‘Zhvillimi i Bujqësisë me Aftësi Rimëkëmbëse ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe Menaxhimi i Përmblytjeve në Ultësirat Perëndimore të Shqipërisë (6 milionë USD) do të projektojë dhe zbatojë zgjidhje të sigurimeve ndaj përmblytjeve të bazuara në komunitet, të cilat do të përshtaten në përputhje me kërkesat e financimit të “Europa e Re”, që do të reflektojë praktikën globale të risigurimit, në mënyrë që rreziqet mund të grupohen/grumbullohen dhe më vonë të risigurohen, për të garantuar mbulim të sigurimeve për bashki, të zonës së synuar që përfaqësojnë pellgje të ndryshme ujëmbledhëse në nivelet e sipërme, të mesme dhe të ulëta të lumit. Për të mbështetur zhvillimin e skemës dhe stimulimin e komuniteteve për të marrë pjesë në skemat e sigurimeve ndaj përmblytjeve, një skemë e qëndrueshme e subvencionimit të primeve do të hartohet për grupet e cënueshme nga pikëpamja sociale.

Të gjitha përpjekjet për krijimin e sigurimeve të rrishtit në Shqipëri (p.sh. Projekti i Fondit të Sigurimeve të Rrishtit për Katastrofat në Kaukaz dhe Evropën Juglindore për Evropën dhe Azinë Qendrore) duhet të monitorohen dhe vlerësohen rregullisht, me qëllim nxjerrjen e mësimave dhe vlerësimin e aftësisë së tyre.

- Instrumente të tjera inovative

Financimi i përshtatjes së klimës është një fushë e re dhe instrumente të reja janë duke u përgatitur, testuar dhe përmirësuar në mënyrë progresive. Është e rëndësishme që të ndiqen këto zhvillime dhe të ndërtohet ekspertizë në një njësi ose institucion koordinues, që do të jetë përgjegjës për mobilizimin e burimeve për masën klimatike në Shqipëri.

Iniciativat përkatëse për gjurmim dhe përfshirje janë si më poshtë:

<http://climate-l.iisd.org/neës/stakeholders-reflect-on-innovative-finance-health-sdgs-climate-progress-data/>

<http://www.climatefinanceideas.org/>

<http://climatefinancelab.org/>

- Udhërrëfyesi i fokusuar në hapa dhe afate konkrete

Tabela 1 përmbledh hapat e planifikuar për vitet 2017 deri 2023 në bazë të analizës së ndërmarrë si pjesë e procesit të përgatitjes të strategjisë së financimit dhe diskutimeve të zhvilluara të grupit ndërmintor të ndryshimeve klimatike (IMWGCC).

⁸⁵ Shihni edhe kapitullin 3.1 në këtë raport vlerësimi të ECNC: <http://www.ecnc.org/uploads/2015/02/Initiatives-related-to-mapping-and-assessment-of-ecosystems-and-their-services-in-EECCA-and-SEE-countries-scoping-document.pdf>

Task Name	2017				2018				2019				2020				2021				2022				2023							
	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3
1 Hapat për integrimin e NAP dhe PA-ve në buxhetin kombëtar- Forcimi i p	[Yellow bar]																															
2 Përfundimi i NAP-it me shpenzimet e munguara të PA-ve dhe miratimin e	[Blue bar]																															
3 Përzgjedhja e detyrave pilot & përfshirja e një/dy prioriteteve të politikave	[Blue bar]																															
4 Përgatitja e udhëzimit të përbashkët ndërmjet MM-së dhe MF-së për "Pr	[Blue bar]																															
5 Zbatimi i rastit pilot gjatë një cikli buxhetor (planifikimi i PBA-së, mobilizimi,	[Blue bar]																															
6 Integrimi në mënyrë graduale i masave prioritare në sistemin e planifikimi	[Blue bar]																															
7 Vlerësimi fillestar i rastit pilot dhe rishikimit të procesit, nëse është e nevoj	[Blue bar]																															
8 Vlerësimi përfundimtar i rastit pilot, ndjekja/monitorimi dhe vendimi për pr	[Blue bar]																															
9 Prezantimi i procesit të integritit për të gjitha institucionet (PA 2)	[Blue bar]																															
10 Rishikimi i objektivave të strategjive sektoriale në lidhje me masat prioritar	[Blue bar]																															
11 Bisedime/bashkëpunim i ngushtë me MF-në për drejtimin, integrimin në F	[Blue bar]																															
12 Përgatitja dhe miratimi i VKM-së për "Integrimin e Ndryshimeve Klimatike	[Blue bar]																															
13 Shtimi i komponentit të përshtatjes për proceset I/NDCC (PA 2)	[Blue bar]																															
14 Shtimi i komponentit të përshtatjes për proceset I/NDCC (PA 2)	[Blue bar]																															
15 Forcimi i strukturës dhe pozicionit të Njësisë së Ndryshimeve Klimatike (P	[Blue bar]																															
16 Ndërtimi i kapaciteteve (PA 3, 5 & 6)	[Yellow bar]																															
17 Ministrinë kyçe për ndërtimin e kapaciteteve në zhvillimin e projekteve, mb	[Blue bar]																															
18 Përfshirja dhe informimi nëpërmjet institucioneve arsimore, Përfshirja dhe	[Blue bar]																															
19 Sistemi i Monitorimit të Zbatimit - Monitorimi i Bazuar në Rezultate (MBR,	[Yellow bar]																															
20 Inventarizimi dhe analiza për përmirësimin e sistemeve monitoruese ekziz	[Blue bar]																															
21 Projektimi i hollësishëm i sistemit të Monitorimit me bazë në rezultate (ME	[Blue bar]																															
22 Ngritja institucionale, mbështetja teknike dhe zhvillimi i kapaciteteve për kr	[Blue bar]																															
23 Krijimi i një sistemi monitorues pilot/MBR-je bazë. Miratimi i Udhëzimeve p	[Blue bar]																															
24 Vlerësimet e përzgjedhura të thelluara të sistemeve tejet të vulnerabël. K	[Blue bar]																															
25 Vazhdimi i planifikimit të përshtatjes përtej ZM-ve aktuale-përfshirja e mur	[Blue bar]																															
26 Identifikimi i projekteve dhe përgatitja e propozimeve	[Yellow bar]																															
27 Përmirësimi i shpërndarjes, përdorimi dhe interpretimi i informacionit klim	[Blue bar]																															
28 Përgatitja e propozimit për Komitetin e FZHR-së për përfshirjen e kriteret	[Blue bar]																															
29 Përgatitja e propozimit për Mbështetjen e Gadishmërisë të Fondit të Gjelt	[Blue bar]																															
30 Përgatitja e një propozimi të mirë-përgatitur të FGJK-së në bashkëpunim	[Blue bar]																															
31 ZM-Ministrinë duhet të punojnë me Mel-n për të pasur akses në grantet e	[Blue bar]																															
32 Krijimi i procesit të mobilizimit të burimeve	[Yellow bar]																															
33 Zhvillimi i masave të komunikimit të NAP-it dhe/ose strategjisë në secilën i	[Blue bar]																															
34 Trajtimi i financuesve që nuk janë përfshirë në procesin e përshtatjes, të i	[Blue bar]																															
35 Identifikimi dhe shfrytëzimi i mundësive të favorshme për fitimin e leadershi	[Blue bar]																															
36 Sigurimi i fondeve të përgatitjes/zhvillimit të projekteve të duhura ose asis	[Blue bar]																															
37 Caktimi i roleve dhe përgjegjësisë, duke pasur parasysh aktivitetet e mob	[Blue bar]																															
38 Monitorimi dhe vlerësimi në mënyrën e duhur i përshtatshmërisë dhe kap	[Blue bar]																															
39 Verifikimi i vazhdueshëm i burimeve të mundshme të financimit ndërkomb	[Blue bar]																															
40	[Blue bar]																															

Lista e referencave

CDKN dhe Dalberg (2015): Vlerësimi i strategjive për mobilizimin e burimeve dhe qëndrueshmërinë e fondeve kombëtare të ndryshimeve klimatike.

E3G (2014): [Qasjet strategjike kombëtare ndaj financimit të klimës](#) – Raport për punën e vlerësimit në Peru, Kili dhe Kolumbi për rrugët dhe strategjitë kombëtare të financimit të klimës.

OECD (2014): Manual për Shenjuesit e Klimës të OECD-DAC.

GIZ dhe WRI (2011): Rëndësia e Përshtatjes – Koncepte dhe Opsione për Monitorimin dhe Vlerësimin e Përshtatjes së Ndryshimit të Klimës.

Qeveria e Shqipërisë: Ligji nr. 90/2012 për “Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore”

Qeveria e Shqipërisë: Ligji për Menaxhimin dhe Kontrollin Financiar nr. 10296/2010 (i rishikuar në vitin 2015)

Qeveria e Shqipërisë: Ligji për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Shqipëri nr. 9936/2008 (i rishikuar në vitin 2016)

Qeveria e Shqipërisë: Urdhri i Kryeministrit nr. 155, datë 25.04.2014 “Krijimi dhe funksionimi i grupit ndërministror të punës për ndryshimin e klimës”

Qeveria e Shqipërisë: Procedura standarde për përgatitjen e PBAM (MTBP) nr. 8/2012, të lëshuar nga Ministri i Financave.

Qeveria e Shqipërisë: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 129/2015 “Për marrjen e masave operacionale dhe institucionale për zbatimin e qasjes sektoriale dhe krijimin e grupeve të menaxhimit të integruar të politikave”

OKB, Asambleja e Përgjithshme 2008 – Pikëpamje paraprake të Bashkimit Evropian mbi “Mobilizimin e burimeve të brendshme të financimit për zhvillim”

PNUD (UNDP)- SHMG (GEF) (2015): [Integrimi i Ndryshimit të Klimës në Planifikim](#).

UNEP (2011): Mundësi për Integrimin e Planit për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike (CCA) & DRR në Planifikimin e Zhvillimit dhe Vendimmarrje.

USAID (2016): Moduli 2 – Financimi i Përshtatjes së Ndryshimeve klimatike. Fondi i USAID-it për Përgatitjen e Projektit të Përshtatjes për Ndryshimet klimatike për Azinë dhe Paqësorin.

Statusi aktual i Masave Prioritare të NAP-it (për 8 vjet)

Masat gjithëpërfshirëse / kuadri i zbatimit	Kostoja totale	Buxheti kombëtar	Financuesit/investuesit e mundshëm të jashtëm	Hapi i ardhshëm
Nr. 1: Drejtimi i procesit të përshtatjes në Shqipëri	591.6 milionë LEKË	2.7 milionë LEKË/vit	- afatshkurtër: BE IPA II, aplikimi i dërguar (270 mil. LEK) - afatshkurtër: pjesërisht të mbuluar nga mbështetja e gatishmërisë së FGJK (GCF)	Shihni gjithashtu udhërrëfyesin në kapitullin 4
Nr. 2: Nisma integruese gjithëpërfshirëse	32 milionë LEKË	4 milionë LEKË/vit	- afatshkurtër: BE IPA II - afatshkurtër: pjesërisht të mbuluar nga mbështetja e gatishmërisë së FGJK (GCF)	Shihni gjithashtu udhërrëfyesin në kapitullin 4
Nr. 3: Gatishmëria financiare klimatike – Zhvillimi i kapaciteteve për financimin dhe zbatimin e NAP-it në Shqipëri.	112.5 milionë LEKË	për t'u vendosur	- afatshkurtër: pjesërisht të mbuluar nga mbështetja e gatishmërisë së FGJK (GCF) (37.5 milionë LEK/vit për 3 vjet) - pjesërisht të mbuluar nga mbështetja e gatishmërisë së FGJK (GCF)	Shihni gjithashtu udhërrëfyesin në kapitullin 4
Nr. 4: Sistemi i monitorimit të implementimit të NAP-it (monitorimi i mbështetur në rezultate)	688 milionë LEKË	për t'u vendosur		Shihni gjithashtu udhërrëfyesin në kapitullin 4 – rishikoni preventivët pasi rezultojnë tepër të lartë
Nr. 5: Nisma për informim dhe përfshirje të publikut	93.75 milionë LEKË	për t'u vendosur	Afatshkurtër-afatmesëm: grante nga donatorë dypalësh, të tillë si Gjermania, Suedia, Austria, Japonia, Franca	
Nr. 6: Nisma për ngritjen e kapaciteteve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	Nuk ka ende preventivë	për t'u vendosur	afatshkurtër -afatmesëm: grante nga donatorë dypalësh, të tillë si Gjermania, Suedia, Austria, Japonia, Franca	- Kostot e pjesshme për ndërtimin e kapaciteteve në mënyrë ideale duhet të përfshihen në secilin projekt buxhet, sipas rastit
Nr. 7: Ujitje, kullim dhe mbrojtje nga përmbytje, me aftësi ripërtëritëse kundrejt ndryshimeve të klimës	1841.5 milionë LEKË	për t'u vendosur	- afatshkurtër: BE IPA II, aplikimi i dërguar (1080 mil. LEKË) - afatmesëm/afatgjatë: FGJK (GCF), BERZH, KfW	- Duhet të prioritetizohet për përgatitjen/zhvillimin e projektit në fundryshimet klimatike të donatorëve ndërkombëtarë në shkallë të gjerë
Nr. 8: Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore	392 milionë LEKË	për t'u vendosur	- afatmesëm/afatgjatë: FGJK (GCF), BERZH, KfW (në fundryshimet klimatike të huave) dhe SIDA (si financues i mëparshëm), Gjermania/ICI (me fokus në Përshtatjen e bazuar në Ekosistem), në fundryshimet klimatike të granteve	- Nevojat për llogaritjen e shpenzimeve duhet të rishikohen. Llogaritja e shpenzimeve të masës së ardhshme në vend të masës së financuar - Duhet të prioritetizohet për përgatitjen/zhvillimin e projektit 217.5 milionë LEKË
Nr. 9: Përshtatja në sektorin agrar	925 milionë LEKË	160 milionë LEKË	- afatshkurtër: FAO (për grante më të vogla dhe asistencë teknike) - afatmesëm dhe afatgjatë: IFAD (për huatë koncesionare), BERZH - PES, sigurimet e rrezikut për fermerët ose instrumente të tjera inovative (afatmesme ose afatgjata) - BE Horizon 2020 për grante kërkimore	-të plotësohet/rishikohet treguesi 3.1 - të kontrollohet nëse aplikimi AF për ndryshimet Klimatike i drejtuar nga Banka Botërore është në progres apo nëse duhet të rishikohet
Nr. 10: Nxitja e zbatimit të strategjisë së përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin e shëndetësisë	145 milionë LEKË	73 milionë LEKË	-Hendek financimi i 12 milionë LEKË	- pronësia brenda Ministrisë së Shëndetësisë duhet të rinovohet

Nr. 11: Plan i integruar ndërsektorial për Zonën Bregdetare			- afatshkurtër-afatmesëm: grante nga donatorë dypalësh, të tillë si Suedia, Austria, Japonia, Franca ose WBIF	- Në cilën masë propozimi i PNUD-it FGJK (GCF) mbulon elementë të kësaj PA-je
Masat gjithëpërfshirëse / kuadri i zbatimit	Kostoja totale	Buxheti kombëtar	Financuesit/investuesit e mundshëm të jashtëm	Hapi i ardhshëm
Nr. 1: Drejtimi i procesit të përshtatjes në Shqipëri	591.6 milionë LEKË për vitin e katërt dhe 1.6 milionë LEKË për vitin e vendosur	2.7 milionë LEKË/ vit për t'u vendosur	- afatshkurtër: BE IPA II, aplikimi i dërguar (270 mil. LEK) - afatshkurtër: pjesërisht të mbuluar nga mbështetja e gatishmërisë së FGJK (GCF)	Shihni gjithashtu udhërrëfyesin në kapitullin 4
Nr. 12: Nisma për krijimin e planeve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në nivel bashkie	202.5 milionë LEKË	Fonde të FZHR (RDF), 13.5 milionë LEKË	- afatshkurtër: EU IPA II, aplikimi i dërguar (189 milionë LEKË) -afatshkurtër- afatmesëm: grante nga donatorë dypalësh të tillë si Suedia, Austria, Franca	- të mbështeren bashkitë në përgatitjen e komponentit me aftësi rimëkëmbëse ndaj ndryshimeve klimatike, të aplikimeve të FZHR (RDF) - Në cilën masë propozimi I PNUD FGJK (GCF) mbulon elementë të kësaj PA-je
Nr. 13 Përshtatja në turizëm	81.2 milionë LEKË (për 3 vjet)	për t'u vendosur	- afatmesëm: instrumente inovative financimi që mbështesin NVM-të në sektorin e turizmit, të cilat janë të gatshme të kontribuojnë për ripërtëritjen e klimës (shihni kapitullin 3.4) - Banka Evropiane e Investimeve BEI (për shembull Garancia e NVM-ve InnovFin, BB EDIF II)	- të specifikohen dhe projektohen aktivitete - të kontrollohen fituesit e kontratave të <u>thirrjes së USAID/SIDA për propozimin "Turizmi si Komponent Pararojë" për integrimin e aspekteve të NDRYSHIMEVE KLIMATIKE</u>
Nr. 14: Rritja e nivelit të gatishmërisë së mbrojtjes civile dhe të zvogëlimit të rrezikut të fatkeqësive natyrore	1201.5 miliardë LEKË	për t'u vendosur	- pjesërisht të mbuluara nga fonde të vazhdueshme të BE IPA II - afatshkurtër dhe afatmesëm: WBIF	- të rishikohen preventivët
Nr. 15 Ndërtimi për Rikuperimin e Lagunës Kune-Vaini nëpërmjet Adaptimit me bazë Ekosistemin (EbA)"	242 million LEKË		Afatshkurter- financiar nga GEF/UNEP	

1

Nr. 2: Nisma integruese gjithëpërfshirëse	32 milionë LEKË	4 milionë LEKË/vit	- afatshkurtër: BE IPA II - afatshkurtër: pjesërisht të mbuluar nga mbështetja e gatishmërisë së FGJK (GCF)	Shihni gjithashtu udhërrëfyesin në kapitullin 4
Nr. 3: Gatishmëria financiare klimatike – Zhvillimi i kapaciteteve për financimin dhe zbatimin e NAP-it në Shqipëri.	112.5 milionë LEKË	për t'u vendosur	- afatshkurtër: pjesërisht të mbuluar nga mbështetja e gatishmërisë së FGJK (GCF) (37.5 milionë LEK/vit për 3 vjet) - pjesërisht të mbuluar nga mbështetja e gatishmërisë së FGJK (GCF)	Shihni gjithashtu udhërrëfyesin në kapitullin 4
Nr. 4: Sistemi i monitorimit të implementimit të NAP-it (monitorimi i mbështetur në rezultate)	688 milionë LEKË	për t'u vendosur		Shihni gjithashtu udhërrëfyesin në kapitullin 4 – rishikoni preventivët pasi rezultojnë tepër të lartë
Nr. 5: Nisma për informim dhe përfshirje të publikut	93.75 milionë LEKË	për t'u vendosur	Afatshkurtër-afatmesëm: grante nga donatorë dypalësh, të tillë si Gjermania, Suedia, Austria, Japonia, Franca	
Nr. 6: Nisma për ngritjen e kapaciteteve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	Nuk ka ende preventivë	për t'u vendosur	afatshkurtër -afatmesëm: grante nga donatorë dypalësh, të tillë si Gjermania, Suedia, Austria, Japonia, Franca	- Kostot e pjeshme për ndërtimin e kapaciteteve në mënyrë ideale duhet të përfshihen në secilin projekt buxhet, sipas rastit
Nr. 7: Ujitje, kullim dhe mbrojtje nga përmbytje, me aftësi ripërtëritëse kundrejt ndryshimeve të klimës	1841.5 milionë LEKË	për t'u vendosur	- afatshkurtër: BE IPA II, aplikimi i dërguar (1080 mil. LEKË) - afatmesëm/afatgjatë: FGJK (GCF), BERZH, KfW	- Duhet të prioritetizohet për përgatitjen/zhvillimin e projektit në fundryshimet klimatikesion të donatorëve ndërkombëtarë në shkallë të gjerë
Nr. 8: Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore	392 milionë LEKË	për t'u vendosur	- afatmesëm/afatgjatë: FGJK (GCF), BERZH, KfW (në fundryshimet klimatikesion të huave) dhe SIDA (si financues i mëparshëm), Gjermania/ICI (me fokus në Përshtatjen e bazuar në Ekosistem), në fundryshimet klimatikesion të granteve	- Nevojat për llogaritjen e shpenzimeve duhet të rishikohen. Llogaritja e shpenzimeve të masës së ardhshme në vend të masës së financuar - Duhet të prioritetizohen për përgatitjen/zhvillimin e projektit 217.5 milionë LEKË
Nr. 9: Përshtatja në sektorin agrar	925 milionë LEKË	160 milionë LEKË	- afatshkurtër: FAO (për grante më të vogla dhe asistencë teknike) - afatmesëm dhe afatgjatë: IFAD (për huatë koncesionare), BERZH - PES, sigurimet e rrezikut për fermerët ose instrumente të tjera inovative (afatmesme ose afatgjata) - BE Horizon 2020 për grante kërkimore	-të plotësohet/rishikohet treguesi 3.1 - të kontrollohet nëse aplikimi AF për ndryshimet Klimatike i drejtuar nga Banka Botërore është në progres apo nëse duhet të rishikohet
Nr. 10: Nxitja e zbatimit të strategjisë së përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike për sektorin e shëndetësisë	145 milionë LEKË	73 milionë LEKË	-Hendek financimi 12 milionë LEKË	- pronësia brenda Ministrisë së Shëndetësisë duhet të rinovohet

Nr. 11: Plan i integruar ndërsektorial për Zonën Bregdetare	148.5 milionë LEKË (për 3 vjet), kostot për vitin e katërt dhe më pas për t'u vendosur	për t'u vendosur	- afatshkurtër-afatmesëm: grante nga donatorë dypalësh, të tillë si Suedia, Austria, Japonia, Franca ose WBIF	- Në cilën masë propozimi i PNUD-it FGJK (GCF) mbulon elementë të kësaj PA-je
Nr. 12: Nisma për krijimin e planeve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike në nivel bashkie	202.5 milionë LEKË	Fonde të FZHR (RDF), 13.5 milionë LEKË	- afatshkurtër: EU IPA II, aplikimi i dërguar (189 milionë LEKË) -afatshkurtër- afatmesëm: grante nga donatorë dypalësh të tillë si Suedia, Austria, Franca	- të mbështeten bashkitë në përgatitjen e komponentit me aftësi rimëkëmbëse ndaj ndryshimeve klimatike, të aplikimeve të FZHR (RDF) - Në cilën masë propozimi I PNUD FGJK (GCF) mbulon elementë të kësaj PA-je
Nr. 13 Përshtatja në turizëm	81.2 milionë LEKË (për 3 vjet)	për t'u vendosur	- afatmesëm: instrumente inovative financimi që mbështesin NVM-të në sektorin e turizmit, të cilat janë të gatshme të kontribuojnë për ripërtëritjen e klimës (shihni kapitullin 3.4) - Banka Evropiane e Investimeve BEI (për shembull Garancia e NVM-ve InnovFin, BB EDIF II)	- të specifikohen dhe projektohen aktivitete - të kontrollohen fituesit e kontratave të <u>thirrjes së USAID/SIDA për propozimin "Turizmi si Komponent Pararojë"</u> për integrimin e aspekteve të NDRYSHIMEVE KLIMATIKE
Nr. 14: Rritja e nivelit të gatishmërisë së mbrojtjes civile dhe të zvogëlimit të rrezikut të fatkeqësive natyrore	1201.5 miliardë LEKË	për t'u vendosur	- pjesërisht të mbuluara nga fonde të vazhdueshme të BE IPA II - afatshkurtër dhe afatmesëm: WBIF	- të rishikohen preventivët
Nr. 15 Ndërtimi për Rikuperimin e Lagunës Kune-Vaini nëpërmjet Adaptimit me bazë Ekosistemin (Eba)"	242 milionë LEKË		Afatshkurter- financiar nga GEF/UNEP	

Programi i Buxhetimit Afatmesëm – Rishikimi Institucional

- Përgjegjësitë e grupeve kryesore të interesit të përfshira në programin e buxhetimit afatmesëm janë si më poshtë:

Zyra e Kryeministrit – Drejtoria për Zhvillimin, Financimin dhe Ndihmën e Huaj (DZHFNH) (DFEAD) që përfshin Planifikimin Strategjik dhe Fondin e Zhvillimit Rajonal, është struktura përgjegjëse për koordinimin e strategjive kombëtare dhe sektoriale dhe luan rol kyç në rishikimin e Deklaratave të Politikave të Programeve. Detyra kryesore e kësaj drejtorie është vlerësimi i përputhshmërisë së këtyre deklaratave politike me të gjitha dokumentet e miratuara nga Këshilli i Ministrave ose Parlamenti.

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) - Ministri i Financave dhe Ekonomisë është autoriteti përgjegjës për miratimin e një sistemi të standardeve dhe procedurave që garanton një administrim ekonomik, eficient dhe efektiv të burimeve financiare publike. MF-ja alokon dhe rialokon të ardhurat kombëtare, nëpërmjet mbledhjes së të ardhurave dhe buxhetimit të shpenzimeve publike, si dhe krijon sisteme të informacionit financiar.

- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ)- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme analizon Deklaratën Politike për çdo program, produkte dhe aktivitete të paraqitura nga institucionet qendrore, për të garantuar se ato reflektojnë të gjitha detyrimet e Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit & Asociimit me BE-në.

- Drejtuesit e Institucioneve Qeveritare- Niveli politik miraton projekt dokumentin e PBAM (MTBP) (politika në nivel programesh) dhe ia paraqet Këshillit të Ministrave.

- Grupet e Menaxhimit Strategjik pranë secilës ministri linje- të drejtuara nga Drejtuesi i Organizatës dhe të përbëra nga Sekretari i Përgjithshëm, Drejtuesit e Programeve dhe Kryefinancierit.

- Sekretarët e Përgjithshëm të Institucioneve Qeveritare- Niveli më i lartë i Menaxhimit Teknik përgatit projekt dokumentin përfundimtar të PBAM (MTBP) dhe është përgjegjës për ekzekutimin e buxhetit.

- Drejtuesit e programeve (të barazvlefshëm me drejtuesit e departamenteve) përgatitin deklaratën politike për programin përkatës dhe ia paraqesin Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) (SMG).

- Ekipe të menaxhimit të programeve (të përbëra nga Drejtuesit e Drejtorive dhe drejtuesit e Agjencive Kombëtare pranë Ministrive të linjës) identifikojnë objektivat, aktivitetet, projektet, shpenzimet etj sipas programit.

Drejtuesit e Departamenteve të Financës që i raportojnë Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit, veprojnë si sekretarë për Grupet e Menaxhimit Strategjik dhe janë përgjegjës për cilësinë e dokumentit të PBAM (MTBP).

Gjatë procesit të zbatimit të buxhetit janë marrë vendime të rëndësishme për rialokimin e fondeve dhe janë vendosur rregulla në bazë të performancës së institucioneve buxhetore:

- rialokimi i fondeve deri në 10% midis programeve, miratohet nga Këshilli i Ministrave;
- midis linjave ekonomike brenda një programi dhe kategorisë së shpenzimeve rrjedhëse, rialokimi i fondeve miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm i MF-së (MoF);
- midis njësive të shpenzimeve brenda një programi dhe një zëri të shpenzimeve rrjedhëse, rialokimi i fondeve miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit të qeverisë qendrore;
- nuk mund të kryhet asnjë rialokim pas datës 15 nëntor;
- nuk ekzistojnë kalime midis shpenzimeve rrjedhëse dhe investimeve.

Avantazhet dhe Disavantazhet e Masave/Marrëveshjeve Ekzistuese Institucionale

Qasja institucionale	Avantazhet	Disavantazhet
IMWG	<ul style="list-style-type: none"> - Grupi Ndërmintor të punës i ndryshimeve klimatike (IMWG) është krijuar me mandatin më të lartë politik (Urdhër i Kryeministrit) - Masa/marrëveshja ekzistuese garanton lançimin me sukses të një procesi të gjatë përshtatjeje ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri - Roli i hartimit dhe koordinimit të Grupit Ndërmintor për ndryshimet klimatike (IMWG) pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (CCU) për përgatitjen e dokumentit të NAP-it. - Kompetencat e anëtarëve të Grupit Ndërmintor të ndryshimeve klimatike (IMWG) për identifikimin e mundësive për të lehtësuar, promovuar, vlerësuar projektet dhe shprehur opinionin e tyre për projektet. - Caktimi i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit, si pikë kontakti në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për ndryshimet klimatike. 	<ul style="list-style-type: none"> - Terminologjia e përdorur “grup pune” nënkupton një strukturë të përkohshme të krijuar vetëm për përgatitjen e dokumenteve, pa ndonjë autoritet administrativ për mbikëqyrje ose monitorim të miratimit të politikave (Ligji nr. 90/2012, neni 24/b) - Grupi bazë është kryesisht në nivel ekspertësh dhe jo vendim-marrësish/drejtuesish të programeve. - Përgjegjshmëria institucionale nuk ka hierarki vertikale dhe koordinim horizontal dhe bashkëpunimi nuk është i qartë në aktet nënligjore ekzistuese. - Njësia e ndryshimeve klimatike dhe ajritësitë e dobët në kapacitetet e Burimeve Njerëzore dhe pozicionohet në nivel ligji të organizatës. - Roli i përgjithshëm mbikëqyrës, mobilizimi i burimeve dhe roli monitorues për ndikimin e politikave të ndryshimeve klimatike (CC) në disa sektorë nuk mbulohet ose nuk mund të mbulohet siç duhet nga grupi ndërmintor i punës së ndryshimeve klimatike dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ekzistuese. - Grupi ndërmintor i punës së ndryshimeve klimatike nuk i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, duke vështirësuar identifikimin e çështjeve të lidhura me funksionimin e brendshëm dhe përgjegjshmërinë
<ul style="list-style-type: none"> - Buxhet i Afatmesëm dhe Strategjik 	<ul style="list-style-type: none"> - Roli i përgjithshëm mbikëqyrës strategjik është garantuar në nivelin më të lartë zyra e Kryeministrit; - Roli i përgjithshëm i monitorimit dhe kontrollit të buxhetit është garantuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë; - Role të qarta të të gjitha institucioneve, linja vertikale përgjegjshmërie dhe procedura standarde janë vendosur në bazë të ligjeve dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë; - Të gjitha institucionet e përfshira i nënshtrohen auditimit të brendshëm dhe të jashtëm. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kuadri aktual ligjor për PBAM nuk ofron një ndarje të qartë të detyrave ndërmjet institucioneve që menaxhojnë politikat komplekse ndërsektoriale që kërkojnë një shkallë të lartë bashkëpunimi ndërmintor.

<p>Mekanizmi i Menaxhimit të Integruar -</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Respekton linjat e përgjegjshmërisë dhe parimet e kuadrit institucional të PBAM (MTBP) - Procedura tepër të hollësishme koordinimi, komunikimi dhe monitorimi janë miratuar nga VKM; - Roli i Përgjithshëm Mbikëqyrës, Koordinimi Ndërsektorial, Mobilizimi i Burimeve dhe role monitoruese janë garantuar nga IPMG. - Anëtarësimi i nivelit të lartë në nivel politik dhe ekzekutiv (i kryesuar nga ministri i ministrisë drejtuese. Anëtarë- Sekretarë të Përgjithshëm të ministrive të linjës); - Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zyra e Kryeministrit (DZHFNH), Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme anëtarë kyç të IPMG-ës; - Miratimi i listës sektoriale të projekteve prioritare strategjike; - Sekretariati i IPMG-ës është krijuar nën varësinë e ministrisë drejtuese, me një strukturë të mjaftueshme (1 drejtues sekretariati, 2 ekspertë dhe 1 asistent administrativ) dhe i raportojnë drejtpërdrejt Sekretarit të Përgjithshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> - IPMG-ja është ende në fazën eksperimentale i monitoruar nga zyra e Kryeministrit. Efikasiteti dhe efienca e skemës së plotë është në proces monitorimi. - Nuk ka burime financiare për sigurimin e mirëfunksionimit të IPMG-së. - IPMG-ja nuk mund t'i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.
---	---	---



Masa të tjera të mundshme afatshkurtra-afatgjata

Opsioni afatshkurtër:

- Përditësimi i urdhrimit ekzistues të Kryeministrit nr. 155/2014, duke përfshirë:

Drejtorinë e DZHM- zyrës së Kryeministrit si anëtar dhe organ mbikëqyrës për të garantuar mirëfunksionimin e Grupit Ndërmintoror të Ndryshimeve Klimatike (ose gjendjen e ekzekutimit të urdhrimit të Kryeministrit);

- detyrimi i ministrive të linjës për integrimin e masave prioritare të ndryshimeve klimatike (CC) në programet e tyre përkatëse afatmesme.

- Përgatitja dhe miratimi i rregullores së brendshme të Grupit Ndërmintoror të Ndryshimeve Klimatike.

- Përgatitja dhe miratimi i një udhëzimi të përbashkët ndërmjet Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për “Procedurat për Integrimin e Ndryshimit të Klimës në PBAM (MTBP)” dhe garantimi i shkëmbimit të informacionit gjatë procesit të ekzekutimit të PBAM-it (MTBP).

- Forcimi i kapaciteteve në fushën e ndryshimeve klimatike pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Mjedisit) garanton dhe raporton për zbatimin e duhur të urdhrimit të Kryeministrit nr. 155/ 2014 dhe udhëzimit të përbashkët me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Disavantazhi: Grupit Ndërmintoror i Ndryshimeve Klimatike ende mbetet një “grup pune” (shihni disavantazhet në shtojcën 3)

Opsioni afatmesëm dhe/ose afatgjatë

Ky opsion mund të diskutohet në rast se skema e IPMG-ës nuk do të pranohet ose/nëse zbatimi i skemës së IPMG-ës tregon se nuk mund të garantojë qëndrueshmërinë e procesit të zbatimit të ndryshimeve klimatike në planin afatgjatë.

Përcaktimi nga Ligji për Ndryshimin e Klimës të Bordit/Komitetit Drejtues për Ndryshimin e Klimës:

- i përbërë nga Ministra (me të drejtën për delegim autoriteti për sekretarin e përgjithshëm përkatës),

- i drejtuar mbi bazë rotacioni për të garantuar lidhshmëri të qëndrueshme (çdo 6 muaj),

- bordi/komiteti do të jetë përgjithësisht përgjegjës për formulimin e politikave, planifikimin, mobilizimin e burimeve, rialokimet e buxhetit, mbikëqyrjen, monitorimin dhe marrjen e masave korrigjuese gjatë procesit të zbatimit;

- veprimi si organ këshillimor të Komitetit të Planifikimit Strategjik pranë KM-ës, megjithëse çdo ministri linje do të ruajë autoritetin për ekzekutimin e buxheti;

- njësia e ndryshime klimatike do të veprojë si sekretariat i bordit (duhet të rritet në nivel drejtorie brenda 3 vjetëve⁸⁶).

Avantazhet:

- Bordi/Komiteti i ri i Menaxhimit të Ndryshimeve Klimatike do të marrë vendime politike dhe administrative gjatë procesit të planifikimit dhe zbatimit (kalimi i shumë hapave të fragmentuar nga formulimi i politikave në monitorim, si dhe rregullore të fragmentuara që ndikojnë në procesin e lehtësimit dhe përshtatjes së ndryshimeve klimatike);

- Nivel i lartë i mbështetjes politike dhe lidhshmëritë të qëndrueshme;

- Burime të mjaftueshme financimi do të garantojnë mirëfunksionim dhe nivel të lartë përgjegjshmërie⁸⁷;

⁸⁶ Kostoja treguese është rreth 6 milionë LEKË/vit

⁸⁷ Kostoja treguese është rreth 1.35 milionë LEKË/vit (15 anëtarë, 4 takime bordi/në vit)

- Vendimet dhe funksionimi i strukturës së menaxhimit të ndryshimeve klimatike do t'i nënshtrohen auditimit të rregullt.

Disavantazhet: Rreziqet e lidhura me proceset e planifikimit dhe zbatimit mund të lehtësohen duke mos u shmangur.

Kalendari i Buxhetit (Buxheti Strategjik, Alokimi, Miratimi)

Fazat	Afatet	Përshkrimi	Institucionet përgjegjëse/drejtuese
I. Kuadri makroekonomik, prioriteti dhe përgatitja e taveve të	Janar	caktimi i treguesve makroekonomikë nëpërmjet parashikimit makroekonomik për periudhën 2017-2019.	MF
MTB-ës për çdo institucion të qeverisjes qendrore dhe fondet e posaçme	Janar	ratimi i Kuadrit Makroekonomik dhe Fiskal për periudhën 2017-2019	KM
	Shkurt	ntifikimi i prioriteteve të politikave me ndikim të konsiderueshëm tek shpenzimet dhe të ardhurat (paga, transfertat lokale, programe të reja, projekte kryesore të investimit publik)	MF, DZHFNH pranë ZKM, MIE
	Shkurt	aqitja e taveve përgatitore të PBAM (MTBP)	MF
	Shkurt	caktimi i taveve përgatitore të PBAM (MTBP) për periudhën 2017-2019 dhe informimi i Parlamentit	KM
	Shkurt	gatitja e Udhëzimeve për Përgatitjen e PBAM (MTBP) për Qeverinë Qendrore dhe Vendore.	MF
II. Rishikimi i Politikave të Programeve	Mars- prill	caktimi i politikave për secilin program dhe identifikimi i qëllimeve dhe objektivave të programit gatitja e Kërkesave të Buxhetit dhe paraqitja pranë MF	Çdo Institucion Qeveritar Qendror dhe Fondi i Posaçëm
III. Planifikimi i Shpenzimeve dhe Investimeve për secilin Program			
	Maj-Qershor	alيزات e kërkesave të buxhetit dhe seancat dëgjimore	MFE, (DZHFNH) pranë ZKM, MIE,
	Qershor (java e tretë)	Rishikimi i kuadrit fiskal, nëse është e nevojshme Hartimi i dokumentit të PBAM (MTBP) për periudhën 2017-2019, tavanet e reja dhe kufijtë e angazhimeve të reja financiare dhe paraqitja pranë Komitetit të Planifikimit Strategjik dhe Këshillit të Ministrave.	MF

	Fund Qershori	Miratimi i dytë i Kuadrit Fiskal dhe dokumentit të PBAM (MTBP) për periudhën 2017-2019 me tavane të reja. KM informon Parlamentin	SPC dhe KM
IV. Përgatitja e Programit të rishikuar të Buxhetit Afatmesëm	Korrik(java e parë)	Lëshimi i udhëzimeve plotësuese për përgatitjen e PBAM (MTBP) së rishikuar	MF
	Korrik-Gusht	Përgatitja e Programit të rishikuar të Buxhetit Afatmesëm	Çdo institucion qeveritar dhe Fondi i Posaçëm
	Shtator	Paraqitje e PBAM (MTBP) të rishikuar tek Ministria përgjegjëse për Financat	
	Shtator-Tetor	Analizat e kërkesave të buxhetit dhe raundi i dytë i seancave dëgjimore	MFE, (DZHFNH), MIE
	Tetor	Programi i Buxhetit Afatmesëm dhe Ligji Vjetor për Buxhetin të paraqitur pranë Komitetit të Planifikimit Strategjik dhe Këshillit të Ministrave	MF
	Fund Tetori	Miratimi i tretë i Kuadrit Fiskal, PBAM (MTBP) 2017-2019 dhe Buxheti Vjetor 2017	KM
	31 tetor	Paraqitje në Parlament për miratim	KM
V. Rishikimi dhe miratimi i buxhetit nga Parlamenti	Nëntor-Dhjetor	Komisionet parlamentare zhvillojnë seanca për buxhetin me Ministrinë e Financave dhe ministri të tjera	Komisioni për Ekonominë dhe Financat (komisioni drejtues)
	Brenda Dhjetorit	Buxheti i miratuar dhe i hyrë në fuqi nga data 1 janar 2017	Parlamenti
	Brenda Janarit	Duke përfshirë ndryshimet e Shteteve nga Këshilli i Ministrave dhe Parlamenti. (PBAM) (MTBP) e tretë e përgatitur për periudhën 2017-2019)	MF

Burimi: VKM nr. 59 e datës 27.1.2016. “Miratimi i Kalendarit për Shpenzimet e Administrimit Publik për vitin 2016”

Procesi i shpenzimeve vjetore të programit në një institucion të Qeverisë Qendrore
 (Shpjegim i hollësishëm i PBAM (MTBP), Faza III)




Figura 1 Procesi i programimit të shpenzimeve vjetore në një Institucion të Qeverisë Qendrore
 Burimi: MF-ja udhëzimi nr. 8/2012 “Procedurat standarde për përgatitjen e PBA-së”

Lista e Programeve Buxhetore të Ministrive të Linjës Sektori i Financës

	Institucioni/Programi Buxhetor
Klasifikimi i Buxhetit	
4	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
04130	Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik
04760	Zhvillimi i Turizmit
5	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
04220	Siguria e ushqimit dhe mbrojtja e konsumatorit
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së kullimit dhe ujitjes
04250	Mbështetja e Zhvillimit Rural, Prodhimit Bujqësor, Blegtoral, Agro-industrisë dhe Tregut
04860	Këshillim dhe Informacion Bujqësor
05470	Menaxhimi i Qëndrueshëm i Tokës
04230	Mbështetje për Peshkimin
05640	Menaxhimi i Ujërave
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
04520	Infrastruktura Rrugore
04530	Mbështetje për Studimet në Transport
04540	Transporti Detar
04550	Transporti Hekurudhor
06370	Furnizimi me Ujë dhe Kanalizimet
06220	Menaxhimi i Mbetjeve
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit
09120	Arsimi Bazë (duke përfshirë arsimin parashkollor)
09230	Arsimi Dytësor (i përgjithshëm)
09450	Arsimi Universitar
09770	Financimi për Shkencën
13	Ministria e Shëndetësisë
07220	Shërbimet e Kujdesit Parësor
07330	Shërbime të Kujdesit Dytësor
07450	Shërbime të Shëndetit Publik
16	Ministria e Brendshme
01160	Prefekturat e deleguara dhe funksionet e Qeverisë Vendore
01180	Menaxhimi i Rezervave të Shtetit
10910	Emergjenca Civile
25	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
10460	Përfshirja Sociale
09240	Arsimi Dytësor (Profesional)
26	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
05320	Programe të Mbrojtjes Mjedisore
04260	Menaxhimi i Pyjeve
56	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
06210	Programe Zhvillimi
78	Ministria e Integritimit Evropian
01150	Mbështetje Institucionale për Procesin e Integritimit
93	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
04320	Mbështetje për Energjinë
04430	Mbështetje për Burimet Natyrore
04440	Mbështetje për Industrinë
94	Ministria e Zhvillimit Urban

Sfidat për Integrimin e Përshtatjes së ndryshimeve klimatike në Paraqitjen e Buxhetit Vjetor

Burimet e pamjaftueshme financiare në nivel rrethi dhe komuniteti për trajtimin e sfidave të Përshtatjes së Ndryshimeve Klimatike.

Një sfidë për bashkitë është se shumë vendime për përshtatjen aktualisht të marra në nivel rrethi, duhet të merren në nivel rajonal për të qenë efektive. Kostot tejkalojnë buxhetet vendore, kështu që koordinimi midis buxhetit vendor dhe qendror, është i nevojshëm, si dhe caktimi i kritereve për investime private. Në këtë rast, Fondi i Zhvillimit të Rajoneve me politikën e tij të investimeve mund të vepronte si mekanizëm koordinimi, dhe mund të mbështesë reagime në shkallë më të gjerë.

Kompleksiteti dhe koordinimi sektorial i shpenzimeve të përshtatjes për ndryshimin e klimës.

Kompleksiteti i shpenzimeve të përshtatjes së ndryshimeve të klimës CC-ës nënkupton se përshtatja efektive mund të çonte në një rivlerësim të objektivave të tjerë politikë, duke përfshirë alternativa në zbatim dhe kërkon koordinim në rajone, sektorë dhe lidhje qeveritare. Kjo mund të kërkonte një rishikim të strategjive ekzistuese sektoriale, si dhe programit të buxhetimit afatmesëm, p.sh. në dokumentin e PBAM-it (MTBP); është e rëndësishme të garantohet që fondet e alokuara për përmbushjen e detyrimit të një ministrie, të shoqërohen me llogaritjen përkatëse në buxhetin e institucioneve të tjera, me qëllim arrijtjen e eficiencës së plotë për reforma.

Procesi i përgatitjes së vetë reformave strukturore.

Reformat strukturore shpesh formulohen pa elemente të detajuara të zbatimit të tyre dhe pa përcaktuar kostot përkatëse për çdo fazë. Si rrjedhojë, integrimi i tyre me buxhetin bëhet shumë i vështirë. Forma e PBAM-it (MTBP) e propozuar nga MF-ja kërkon një vlerësim të qartë të politikës, objektivave, aktiviteteve dhe rezultateve që do të realizohen në tre vitet e ardhshme. Problemet fillojnë kur institucionit i kërkohet të caktojë qëllimin e programit, objektivat e tij dhe gjithashtu, standardin e politikës së programit. Nëse një objektivi nuk është i mirëpërcaktuar, kjo sjell vështirësi në vlerësimin e produkteve të një programi. Megjithatë, ka raste edhe kur ministrinë e linjës janë të vetëdijshme për nevojën për një proces të saktë buxhetimi, por nuk arrijnë të shndërrojnë reformat në implikime monetare, për shkak të mungesës së një perceptimi të qartë të reformës apo kapacitetit të pamjaftueshëm të burimeve njerëzore.

Qasja e fragmentuar institucionale dhe pengesat rregullatore.

Arsyeja kryesore përse ministrinë e linjës dhe bashkitë nuk e marrin në konsideratë ndryshimin e klimës ose nuk marrin masa për të reduktuar ndikimet e saj, është se nuk ka asnjë kërkesë rregullatore për të vepruar në këtë mënyrë, ose ka shumë akte rregullatore të fragmentuara, që ndonjëherë janë në kundërshtim me njëra-tjetrën. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është duke punuar për një projektligj për ndryshimin e klimës, i cili do të përcaktojë bazën ligjore, si dhe rolin e organeve të qeverisjes. Përveç kësaj, një vendim i qeverisë për “Integrimin e Ndryshimeve Klimatike në PBAM (MTBP) dhe Qasjen Institucionale” i shoqëruar me një udhëzim qeveritar ose të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për “Procedurat për integrimin e Ndryshimeve Klimatike në PBA”, duhet të plotësojë kuadrin ligjor për të krijuar kushtet e nevojshme për zbatimin e integritit të përshtatjes, siç përshkruhet në NAP.

Bashkëpunimi dhe njohuria për procesin e PBAM-it (MTBP).

Sfida kryesore në formulimin dhe zbatimin e politikave është koordinimi ndërmjet ministrive të linjës përgjegjëse për zbatimin e reformave, veçanërisht në rastin e reformave ndërsektoriale që përfshijnë shumë prioritetë të sektorëve. Ministria e linjës e lidhur drejtpërdrejt me zbatimin e reformës, e përfshin atë në buxhet, ndërsa të tjera ministri të linjës nuk mund të caktojnë domosdoshmërisht fonde të disponueshme, për një reformë që nuk është prioritet për sektorët e tyre. Kjo mungesë bashkëpunimi nënkupton se mund të nisin reforma strukturore, por nuk mund të jenë operative, nëse të gjithë komponentët e tjerë nuk janë të harmonizuar. Gjithashtu, drejtoritë pranë ministrive të linjës që nuk njohin hollësisht politikën, strategjitë ose reformat e plota që do të zhvillohen në institucionet e tyre, nuk pajtohen me kërkesat e PBAM-it (MTBP) që kërkohen nga

Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Në shumicën e rasteve, megjithëse ministritë e linjës mund të kenë hartuar një reformë, zbatimi i së cilës kërkon disa vjet, ato nuk mund të sjellin kosto të sakta financiare për të gjitha vitet në të cilat do të zhvillohet reforma, edhe nëse kostot dhe produktet përcaktohen në planet përkatëse të veprimeve. Drejtoritë e politikave të ministrisë së linjës gjatë procesit të llogaritjes së shpenzimeve, kryesisht nuk bashkëpunojnë me agjenci varësie të specializuara dhe drejtori financimi pranë ministrisë. Kjo i sjellë vështirësi Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që të vlerësojë kërkesat e përgatitura nga institucionet buxhetore. Një problem tjetër për rishikim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është vlerësimi i kërkesave shpesh për politikën dhe objektivat e institucioneve që ishin paraqitur si më pak të rëndësishme gjatë caktimit të tavanëve.

Shenjuesit Statistikorë të Klimës të OECD-ës

Përkufizimi i OECD-ës për lehtësimin dhe përshtatjen është si më poshtë:

1. Zbutja – aktivitetet që kontribuojnë “ndaj objektivit të stabilizimit të përqendrimeve të gazit serrë (GHG) në atmosferë, në një nivel që do të parandalonte ndërhyrjen antropogjene të rrezikshme në sistemin klimatik, me anë të nxitjes së përpjekjeve për uljen ose kufizimin e emetimeve të GHG-ve ose për përmirësimin e sekuestrimit të CHG-ës”.

2. Përshtatja – aktivitetet që synojnë “rritjen e kapacitetit dhe ripërtëritjen e sistemeve njerëzore ose natyrore ndaj ndikimeve të ndryshimit të klimës dhe rreziqeve të lidhura me klimën”.

Sistemi i klasifikimit për shenjuesit e klimës

Mbledhja e të dhënave për shenjuesit e klimës bazohet në një sistem klasifikimi me tri vlera:


Objekti kryesor (2)- Shpenzimet ekonomike/ projektet/programet me rëndësi të lartë, të cilat kanë objektiva të qartë parësorë të dhënies së rezultateve konkrete dhe të dukshme që përmirësojnë ripërtëritjen e klimës. Ato përfshijnë përshtatjen ndaj tendencave të pritshme të klimës ose ngjarjeve ekstreme klimatike dhe ofrim të shërbimeve klimatike, të tilla si: ndërgjegjësimi, informacioni, ndërtimi i kapaciteteve, planifikimi dhe rregulloret. Supozohet se 80% e shpenzimeve në këto programe kontribuojnë në përshtatje.

Objekti i rëndësishëm (1) – Shpenzimet ekonomike/ projektet/programet me rëndësi të mesme që japin kontribute të fuqishme ndaj përshtatjes, por motivohen kryesisht nga probleme më të gjera zhvillimore. Ato përfshijnë programe dhe infrastrukturë për pylltarinë ekonomike, biodiversitetin, ujërat, të cilat kanë një element të fuqishëm të mbrojtjes klimatike. Në të njëjtën kohë ato mund të përfshijnë programe të kombinuara me një sërë aktivitetesh që nuk mund të dallohen lehtësisht. Supozohet se 50% e shpenzimeve kontribuojnë në përshtatje ose zbutje.

Jo i synuar ndaj objektivit politik (0) – Programe me rëndësi të ulët kontribuojnë në përshtatje vetëm në mënyrë të tërthortë. Ato përfshijnë kapacitete të përgjithshme infrastrukturore dhe administrative si dhe planifikues, dhe supozohet se 25% e shpenzimeve kontribuojnë në përshtatje.

Si të caktohen në praktikë?

Skema e mëposhtme tregon pyetësonin logjik në fazën e programimit të buxhetit:



Burimi: Manual për Shenjuesit e Klimës të OECD-DAC-it

Metodologjia për dhënien e prioritetit burimeve të jashtme të financimit të përshtatjes për zbatimin e PKP-ës (NAP)

Qasja e strategjisë së financimit ka zbatuar një metodë me tre komponentë për priorizimin e donatorëve/financuesve të përshtatshëm të mundshëm:

1. Verifikimi dhe dhënia e prioritetit të donatorëve të jashtëm/burimeve të financimit.
2. Prioriteti i PA-ve (Veprimeve Prioritare) në funksion të gatishmërisë për mobilizimin e burimeve në vitet e ardhshme.
3. Kombinimi i PA-ve prioritare me donatorë të jashtëm/burime financimi prioritare.

Instrumenti i dhënies së prioritetit është fleksibël dhe mund të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme. Ai jep udhëzime mbi mënyrën e identifikimit të donatorëve/financuesve të përshtatshëm të përshtatjes. Kriteret e reja të dhënies së prioritetit mund të shtohen lehtësisht dhe peshat e kriterëve specifike mund të ndryshohen, nëse çmohen të përshtatshme. Është e rëndësishme që të merret parasysh se një mjet i tillë prioriteti është vetëm një hap i parë për kufizimin e fondeve/financuesve të mundshëm. Duhet të vazhdojë një kërkim më i thelluar për kërkesat dhe bisedimet fillestare me fonde/investues të mundshëm.

Lista e mëposhtme e kriterëve për klasifikimin/prioritetin e burimeve të financimit ndërkombëtar të përshtatjes përmban dy tipe kriteresh: 1) Kriteret që përdoren në ‘rezultatit e prioritetit’ (shihni edhe rubrikën ‘përfshirë në rezultat’), 2) kriteret që grumbullohen si informacion i dobishëm shtesë.

Rubrika në instrumentin e prioritetit	Kriteri	Përfshirë në rezultat	Vlerat/kategoritë	Pesha	Supozimi/shpjegimi për rëndësinë
E	A është procesi i aplikimit një proces konkurrues?				
F	A është Shqipëria e pranueshme për marrjen e financimit nga fondi/investuesi?				
G	A ka siguruar më parë fondi/investuesi fonde për Shqipërinë (gjatë 5 viteve të mëparshme)?	X	1 = në çdo sektor, pa vëmendje të veçantë ndaj përshtatjes 2 = në sektor/projekte me objektiva të qartë përshtatjeje	3	Donatorët/financuesit që kanë siguruar më parë financim, kanë më shumë gjasa të sigurojnë sërish financim, nëse nuk kanë një prag alokimi për vend/shtet. Projekti i mëparshëm dhe përdorimi i fondeve ka sjellë rezultate pozitive dhe marrëdhënie të favorshme. Nëse jo, ky kriter mund të duhet të përjashtohet.
H	A ka fondi/investuesi një alokim/prag për një vend specifik?		0 = jo 1 = po		
I	A ka marrë Shqipëria një përqindje të konsiderueshme (më shumë se 50%) të këtij alokimi/ pragu?		0 = po 1 = jo		
J	A jep grante fondi/investuesi?	X	0 = jo 1 = po	1	Duke pasur parasysh çështjet aktuale të huamarrjes, donatorët/financuesit që ofrojnë

					grante, kanë prioritet.
K	A kërkon financuesi/investuesi bashkëfinancim?		0 = jo 1 = po		
L	Shkalla e fokusit për përshtatjen në strategjinë e financimit (për Shqipërinë)	X	0 = përshtatja nuk është marrë në konsideratë 1 = objektivat e përshtatjes nuk janë synuar qartë, por përmenden si bashkëpërfitim 2 = financimi fokusohet në objektivat e përshtatjes	1	
M	Madhësia e fondeve potencialisht të disponueshme (duke marrë gjithashtu parasysh shumat e mëparshme të financimit).	X	1 = < 100.000 USD 2 = 100.000 – 1 milion USD 3 = > 1 milion USD 4 = > 3 milionë USD	0.5	Në veçanti, fondet/investuesit që janë
N	A siguron fondi/investuesi fonde/mbështetje për përgatitjen e projektit?		0 = jo 1 = po		
R	A siguron fondi/investuesi financim për projektet e investimit?	X	0 = jo 1 = po	1	Në funksion të PA 8-15
P	A siguron fondi/investuesi financim për asistencën teknike?		0 = jo 1 = po		
Q	A siguron fondi/investuesi financim për trajnim dhe ndërtim kapacitetesh?		0 = jo 1 = po		
O	A siguron fondi/investuesi financim për forcim institucional/procese të politikave/koordinimit?	X	0 = jo 1 = po	1	Në funksion të PA 1-7
S-Y	A siguron fondi/investuesi financim në sektorët e mëposhtëm: a) ujë, ujë dhe mbrojtje nga përmbytjet b) bujqësi c) shëndetësi d) menaxhim/mbrojtje e bregdetit e) urban f) turizëm g) ulja e rrezikut nga fatkeqësitë/gatishmëria	X	0 = jo 1 = po	1	Në funksion të PA 8-15

Fondet/investuesit do të klasifikohen eventualisht (specifikisht, duke përdorur kolonën Z për klasifikim) sipas rezultatit të prioritetit, duke llogaritur rezultatit e mëposhtëm: Rezultati i prioritetit në kolonën Z = SHUMA (G*3; J; L; M*0,5; O; R:Y)

Ju lutemi vëreni: Në përgjithësi ka një tendencë ndaj prioriteteve të fondeve/ investuesve, të cilët parashikojnë projekte investimi në shkallë të gjerë.



Situata duke pasur parasysh Burime Specifike me Potencial të Lartë Financimi

Fondi i Gjellbër i Klimës (FGJK (GCF))

Në bashkëpunim të ngushtë me Autoritetin Kombëtar të Caktuar (NDA), UNEP-i përgatiti dhe i paraqet një propozim Shërbimit Mbështetës ndaj Gatishmërisë të FGJK-ës (GCF) që arrin shumën 300.000 USD (duke përfshirë bashkëfinansim 10% nga QSH-ja). Aktivitetet e propozuara mbulojnë 'forcimin e kapaciteteve institucionale të NFP-ës për të përmbushur me efikasitet rolet dhe përgjegjësitë e saj të lidhura me Fondin, si dhe zhvillimin, nëpërmjet një procesi të angazhimit të shumë aktorëve të konsultuar gjerësisht, tënjë programi vendor, duke përfshirë prioritetet e programimit, dhënien e prioritetit të qartë të programeve/projekteve dhe një grup të caktuar aktivitetesh që do të bazohen në paraqitjen e një projektpropozimi pranë FGJK-ës (GCF) '.

Përveç kësaj, PNUD-i aktualisht po përgatit një propozim për qytetet bregdetare me aftësi ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike për paraqitje te fondi i përshtatjes së FGJK-ës (GCF).

Në të ardhmen afatmesme, FGJK-ja (GCF) është ofruesi më i mundshëm i një granti të shkallës së gjerë për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike për Shqipërinë. Përveç granteve dhe huave koncesionare, FGJK-ja (GCF) ofron shumë modalitete të tjera financimi⁸⁸. Aplikimi i ardhshëm të FGJK-ja (GCF) duhet të shqyrtojë ato përveç huave dhe granteve.

Fondi i Përshtatjes (FP)

Meqë propozimi i udhëhequr nga Banka Botërore nuk u miratua në mars 2016, është e rëndësishme të shpjegohen zhvillimet më të fundit, duke pasur parasysh një riparaqitje (pra, një paraqitje të tretë).

Nga pikëpamja teorike, Shqipëria mund të marrë 10 milionë USD nga AF-ja, por nuk ka shfrytëzuar ende këtë burim financimi. Megjithatë, AF-ja aktualisht shqyrton një ndryshim të metodës/procedurës mbi shumën e përcaktuar në vend⁸⁹.

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve (FZHR) (RDF) luan rol kryesor në mbështetjen ndaj investimeve për autoritetet rajonale dhe vendore. FZHR-ja (RDF) u krijua në nëntor 2009 në bazë të Ligjit nr. 10190, dhe përdoret për mbështetjen e investimeve në nivele rajonale dhe vendore nëpërmjet një sistemi konkurrues grantesh në disa fusha politikash. FZHR-ja (RDF) ka karakteristikat e mëposhtme:

- Ministritë e linjës janë përgjegjëse për përzgjedhjen dhe zbatimin e projekteve, ndërsa koordinimi i përgjithshëm kryhet nga DSDC-ja me konsulencën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit;

- Çdo sferë politike ka alokimin e vet financiar dhe linjën e buxhetit për zhvillim rajonal;

- Këto fonde të ndara sipas sferës së politikave shpërndahen në qarqe mbi bazën e disa kritereve;

- Buxheti për projekt alokohet mbi bazën e një sistemi konkurrues granti;

- Projektet vlerësohen mbi bazën e një rrjeti vlerësimi, duke përdorur disa tregues dhe rezultate përkatëse, përfshirë rëndësinë e tyre ndaj një prioriteti të caktuar politike sektoriale.

Volumi financiar i granteve të dhëna nga FZHR-ja (RDF) arrin shumën deri 72.8 milionë Euro në vit. FZHR-ja (RDF) bashkëpunon me ministritë për caktimin e prioritetëve sektoriale të qeverisë qendrore në nivel rajonal mbi bazë vjetore. Programi për vitin 2019 përgatitet deri në fund të vitit 2018. Para muajit dhjetor 2018, çdo ministri duhet të ketë dërguar prioritetet e tyre për vitin e ardhshëm. Atëherë, bashkitë aplikojnë për projekte për fushat e përzgjedhura.

⁸⁸https://www.greenclimate.fund/documents/20182/24934/GCF_B.04_06_-_Business_Model_Framework_Financial_Instruments.pdf/7b8e96dd-4e06-46fd-b986-1b8743efa15b

⁸⁹ <https://www.adaptation-fund.org/wp-content/uploads/2016/02/AFB.B.27.8-Analysis-for-the-possible-modification-of-the-country-cap.pdf>

Planifikohet që FZHR-ja (RDF) do të integrojë kriteret e lidhura me përshtatjen në udhëzimet e saj për planifikimin e buxhetit, si dhe procesin e përzgjedhjes dhe verifikimit të projektit⁹⁰. Këto udhëzime do të miratohen nga Komiteti i FZHR-ës (RDF), i cili përbëhet nga Kryeministri dhe 85% e kabinetit të ministrave dhe përfaqësues nga bashki dhe shoqata rajonale. Komiteti miraton dokumente strategjike, programim, rregulla dhe rregullore të harmonizuara për zbatim, kriteret verifikimi për aplikime, vlerësimin deri tek autoriteti kontraktues për projektin e miratuar.

Instrumenti II i BE-së për Paraaderimin

BE IPA II ka një fond të mjedisit dhe klimës që arrin shumën 68 milionë Euro për periudhën 2014 deri 2020. Strategjia fillestare vendore IPA II e shqyrton përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike vetëm në mënyrë sipërfaqësore dhe nuk ka asnjë alokim të drejtpërdrejtë buxheti për masat e përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike. Në tetor 2016 ka pasur një kërkesë për përmirësimin e aspekteve të ndryshimeve klimatike për strategjinë. Ministria përgjegjëse, ish Ministria e Mjedisit, propozoi të përfshinte disa masa në përgjigje të saj (shihni për detaje shtojcën 1).

Procesi për miratimin e projekteve të financuara nga IPA II:

- Procesi i përgjithshëm mund të kërkojë deri 3 vjet.
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme i dërgon një kërkesë zyrtare të gjitha ministrive të linjës për paraqitjen e projektideve çdo vit.

- Ministrinë e linjës supozohen të paraqesin një projektpropozim të përmbledhur të 4 faqeve, që përfshijnë detajet e mëposhtme: i) titullin e projektit dhe pikën e kontaktit; ii) sektorin/nësektorin sipas Planit të Veprimit për Zbatimin e MSA-së, nëse projekti propozohet të përfshihet; iii) lidhjen me dokumente strategjike; iv) objektivin/qëllimin e përgjithshëm të projektit; v) përshkrimin e projektpropozimit; vi) kohëzgjatjen e projektit; vii) vlerësimin e kapaciteteve aktuale administrative të ministrisë/institucionit për menaxhimin e zbatimit të projekteve; viii) lidhjen e projektpropozimit aktual me asistencën e mëparshme në këtë fushë; ix) institucionin përfitues / institucionet e përfshira në zbatimin e projektit; x) koston treguese për projektin.

- Miratim nga EUD-ja pas 2 seancave (me përfaqësues nga KE-ja, Bruksel).

- Tavanet e projektit zakonisht miratohen për tre vite.

- Përgatitja dhe miratimi i Fishës Standarde të Projektit (rreth 30 faqe).

- Procesi i tenderimit.

- Nënshkrimi i kontratës.

- Fillimi i fazës së zbatimit.

Rekomandime:

- Ndjekja e parashtrimit në përgjigje të kontributit ndaj rishikimit afatmesëm të CSP/ IPA II
- Gjithashtu, duhet të merret parasysh mbrojtja klimatike e aktiviteteve të tjera të financuara nga IPA II, në fusha të tjera të financimit/ sektorëve të tillë si transporti, bujqësia etj.

⁹⁰ Takimet fillestare u zhvilluan në tetor 2016.

Selected Program	Amount	Donor	Year	Implementer
Third National Communication of Albania to the UNFCCC	\$481,018	GEF	2012–2016	UNDP
Institution Building for Enforcing Environmental and Climate Acquis	Unknown	EU	2015–2017	Agrotec with Sweco and CMCC
EU Flood Protection Infrastructure Project	€6.3 million	EU	2015–2017	UNDP
Climate Change Adaptation in the Western Balkans	€3.5 million	GIZ	2012–2018	GIZ and government ministries
Improving Coverage and Management Effectiveness of Marine and Coastal Protected Areas	\$2.93 million	GEF/UNDP, Govt. of Albania	2011–2016	Ministry of Environment, Forestry and Water Administration
Environmental Services Project	\$12.88 million	World Bank	2014–2019	Ministry of Environment, Forestry and Water Administration
Water Resources and Irrigation Project	\$45 million	World Bank	2012–2018	Ministries of Environment and Agriculture
Enhancement of Disaster Risk Reduction and Management (DRRM) capacities and mainstreaming CCA practices into agriculture sector in the Western Balkans	\$485,000	FAO	2016–2017	Unknown
Building Local Community Resilience for the Sustainable Development of Watersheds in South Eastern Europe (CRESSIDA)	€440,000	US EPA	2014–2019	Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe

Burimi: USAID (2016): Profili I rrezikut nga ndryshimet klimatike-Shqipëria – Fletë informative